REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE FILOLOGJISË
SHKOLLA DOKTORALE-MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE

Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë | Rr. Elbasanit, Tiranë | Tel:(+355 4) 2369664; Fax: (+355 4) 2369987 **E-mail: info.fhf@fhf.edu.al | http://www.fhf.edu.al**

DOKTRINA E ADMINISTRIMIT TERRITORIAL NDËRKOMBËTAR: RASTI I KOSOVËS NËN UNMIK-un 1999-2008

Specializimi: Marrëdhënie Ndërkombëtare

Disertanti:
MA.Bardhok Bashota

Udhëheqës shkencor:
Prof.Dr.Blerim Reka

Tiranë, 2014

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE FILOLOGJISË
SHKOLLA DOKTORALE-MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE

Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë | Rr. Elbasanit, Tiranë | Tel:(+355 4) 2369664; Fax: (+355 4) 2369987 **E-mail: info.fhf@fhf.edu.al** | **http://www.fhf.edu.al**

Disertacion i paraqitur nga

MA Bardhok A.BASHOTA

Në kërkim të gradës shkencore

DOKTOR

DOKTRINA E ADMINISTRIMIT TERRITORIAL NDËRKOMBËTAR: RASTI I KOSOVËS NËN UNMIK-un 1999-2008

Specializimi: Marrëdhënie Ndërkombëtare

Udhëheqës shkencor:

Prof.Dr.Blerim Reka

Mbrohet me datë...../...../2014

1.....Kryetar

2.....Anëtar (oponent)

3.....Anëtar (oponent)

4.....Anëtar

5.....Anëtar

Tiranë, 2014

PASQYRA E LËNDËS

PARATHËNIE III

HYRJE: PËRPJEKJET PËR NDËRKOMBËTARIZIMIN E PROBLEMIT TË KOSOVËS 1912-1999…….....XXI

KREU I: INTERPRETIMI TEORIK I NDËRHYRJES USHTARAKE TË NATO-s NË KOSOVË DHE I SISTEMIT TË ADMINISTRIMIT TERRITORIAL TË OKB-së 1

1.1 Ndërhyrja ushtarake e NATO-s dhe ndërkombëtarizimi i problemit të Kosovës: rasti i Kosovës në teoritë e Marrëdhënieve Ndërkombëtare 1

1.2 Vështrim i përgjithshëm mbi sistemin e Administrimit Territorial Ndërkombëtar të OKB-së dhe misioneve të saj paqëruajtëse 40

1.3 Teoria dhe historiku i Administrimit Territorial Ndërkombëtar 42

KREU II: SISTEMI I MISIONEVE PAQERUAJTËSE TË OKB-së DHE REFORMAT TRANSFORMUESE TË TIJ 48

2.1 Praktikat e misioneve paqeruajtëse të OKB-së: 1 948-2013: pozita e UNMIK-ut 48

2.2 Faktorët kontekstual dhe reformat në sistemin e paqeruajtjes së OKB-së 65

2.3 Modeli i operacioneve të paqes së OKB-së në shekullin 21: nga paqeruajtëse në paqendertuese 71

2.4 Misionet shumëdimensionale paqeruajtëse: qeverisja dhe shtetndërtimi ndërkombëtar 78

KREU III: FORMATI ORGANIZATIV DHE FUNKSIONAL I UNMIK-ut NË BAZË TË REZOLUTËS 1244: ROLI I UNMIK-ut NË QEVERISJEN NDËRKOMBËTARE TË KOSOVËS 86

3.1 Baza legale dhe specifikat politike të UNMIK-ut në bazë të Rezolutës 1244 86

3.2 Nomenklatura organizative dhe funksionale e UNMIK-ut 90

3.3 Mandati i UNMIK-ut dhe statusi juridik i Kosovës në bazë të Rezolutës 1244 . .92

3.4 Komponentët emergjent të qeverisjes së UNMIK-ut: fuqitë komplete qeveritare të UNMIK-ut.....97

3.5 Autoriteti, legjitimiteti dhe llogaridhënia e UNMIK-ut..... 111

KREU IV: ROLI I UNMIK-ut NË NGRITJEN E KOMPONENTËVE SHTETNDËRTUESE NË KOSOVË……..…..……118

4.1 Strategjitë dhe qasjet e shtetndërtimit ndërkombëtar.....118

4.2 Procesi dhe komponentët e shtetndertimit ndërkombëtar në Kosovë.....122

4.3 Komponentët e sigurisë..... 125

4.4 Komponentët e rendit dhe të drejtësisë 130

4.5 Komponentët e institucionalizimit dhe të demokratizimit 139

4.6 Komponentët e rindërtimit dhe zhvillimit ekonomik 156

KREU V: ROLI I UNMIK-ut NË ZHVILLIMIN E PROCESIT DIPLOMATIK TË ZGJIDHJES SË STATUSIT FINAL TË KOSOVËS……..…….168

5.1 Procesi i zgjidhjes së statusit të Kosovës, politika: "standardet para statusit"...168

5.2 Negociatat për statusin final të Kosovës: faktorët strukturor dhe kontekstual...174

5.3 Negociatat shtesë dhe shpallja e pavarësisë së Kosovës.....180

5.4 Shpallja e pavarësisë dhe inaugurimi *de jure* i shtetësisë së Kosovës.....183

AKRONIMET……..……..…195

PËRFUNDIME..... 198

BURIMET DHE LITERATURA..... 109

ANEKS…….231

PARATHËNIE

Ky punim, tipik për një tezë të doktoraturës, është fokusuar dhe baraspeshon në mes linjave empirike dhe teorike në studimin e "problemit" të paraqitur këtu si: "rasti i Kosovës". Ky rast, u referohet një sërë ngjarjesh unike që kanë ndodhur praktikisht në skenën e marrëdhënieve politike ndërkombëtare, në një kontekst të caktuar kohor dhe përmbajtësor. Para së gjithash, këtu është fjala për ato ngjarje që i referohen praktikës së administrimit të Kosovës nga Misioni i Përkohshëm Civil i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (UNMIK), si një shoqëri e dalë nga rrethana post-konfliktuale.

Megjithëkëtë, para se të studiohet Kosova si rast në këtë kontekst, është prezantuar një analizë retrospektive e disa çështjeve politiko-juridike, e që janë pjesë e zhvillimeve të mëhershme. Ato paraqesin origjinën e problemit të Kosovës dhe i kanë paraprirë krijimit të atyre rrethanave që kanë çuar më vonë në vendosjen e këtij territori nën administrimin e përkohshëm territorial ndërkombëtar.

Andaj, ndër objektivat parësore të këtij studimi, janë ato që kanë të bëjnë me përpjekjen për t'i ofruar audiencës së gjerë një sfond të përmbledhur analitik dhe profesional, lidhur me zhvillimet rreth këtyre ngjarjeve, tanimë të njohura si rasti i Kosovës.

Në realizimin e këtyre objektivave është parashtruar një platformë specifike e procedimit kërkomor, me të dhëna faktike dhe teorike. Në këtë procedim, nuk synohet që të analizohet rasti në fjalë vetëm nga këndi i njëanshëm i ndikimit të zhvillimeve politike të skenës së marrëdhënieve ndërkombëtare mbi rastin e Kosovës. Gjithashtu, këtu njëkohësisht synohet dhe analizimi i ndikimit të këtij rasti mbi këto zhvillime. Kjo do të thotë se, në skenën e politikës ndërkombëtare, njëkohësisht, si ngjarjet e veçanta, ashtu edhe zhvillimet e përgjithshme, qëndrojnë në relacion të pandashëm ndërveprues, përballë një mjedisi dinamik dhe kompleks.

Për ta kuptuar aplikimin e kësaj çasjeje specifike studimore në këtë kontekst, duhet të nisemi nga fakti evident që tregon se zhvillimet aktuale në skenën e marrëdhënieve ndërkombëtare, në të gjitha dimensionet, cilësohen me një shkallë të dinamizmit dhe kompleksitetit të pa precedent. Ky dinamizëm, ka imponuar shumë ndryshime rrënjësore në organizimin dhe funksionimin e sistemit të marrëdhënieve ndërkombëtare në përgjithësi.

Në planin kohor, një pjesë e konsiderueshme e këtyre zhvillimeve përkojnë me periudhën e pas Luftës së Ftohtë, e që i atribuohen transformimit të disa prej parimeve kryesore klasike të sistemit të marrëdhënieve ndërkombëtare. Para së gjithash, këtu kemi të bëjmë me rolin gjithnjë në rritje të organizatave ndërkombëtare në menaxhimin me situata konfliktuale në shoqëritë dhe territoret e ndryshme. Këto organizata, përmes parimit të "intervenimit humanitar" dhe "administrimit territorial të përkohshëm", kanë arritur t'i thyejnë dhe transformojnë disa nga këto parime, të tilla si: mos ndërhyrja në sovranitetin e shteteve të caktuara dhe ruajtja e integritetit territorial të shteteve. Ky fenomen, në vetvete ka sjellur sfida serioze për parimet vestfaliane të organizimit dhe funksionimit të sistemit të marrëdhënieve ndërkombëtare.

Në këtë drejtim, mund të thuhet se rasti i Kosovës është shembulli më tipik i pasqyrimit të transformimit të parimeve kryesore klasike të sistemit të marrëdhënieve politike ndërkombëtare. Njëkohësisht, ky rast, ka promovuar edhe disa parime të reja në doktrinën e së drejtës dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, duke mos lënë anash as doktrinën e administrimit territorial ndërkombëtar. Ky karakter dinamik që ka promovuar rasti i Kosovës, karakterizohet me kombinimin e dy qasjeve në menaxhimin e situatës konfliktuale në këtë vend. Është fjala për intervenimin ushtarak për sanimin imediat të rrethanave konfliktuale nga një organizatë ushtarake si NATO-ja, dhe për administrimin territorial civil ndërkombëtar për evitimin e këtyre rrethanave në plan afatgjatë, përmes një misioni paqeruajtës nga një organizatë politike si OKB-ja. Prandaj, studimi i rastit të Kosovës në të dyja kontekstet, argumentohet dhe baraspeshohet ndërmjet parimeve të së drejtës ndërkombëtare-legalitetit (gjuha eksplicite juridike) dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare-legjitimitetit (gjuha implicite politike).

Të studiuarit e rastit të Kosovës në këtë kontekst dhe nga kjo qasje specifike, e ngrehë pretendimin se ky studim përbën risi në vete, madje është unik dhe i dallueshëm në krahasim me qasjet dhe kontekstet tjera që janë përdorur më parë në studimin e këtij rasti.

Ky procedim kërkimor dhe të kuptuarit e tij, ngërthen në vete disa qasje dhe teknika, që për ne bëhen sine qua non (të domosdoshme), të paraqitura si në vijim. Fillimisht është dhënë një kornizë analitike, që përfshin sqarimin e komponentëve konceptual dhe kontekstual, për të vazhduar me ngritjen e disa supozimeve themelore

(hipotezave), që të marrura së bashku, këtë studim do ta vendosin në kuadër të një logjike shkencore të të shpjeguarit.

Në kuadër të kësaj kornize, analizohen një sërë problemesh dhe rrethanash që janë të domosdoshme për të ndërtuar një platformë të qëndrueshme, mbi të cilën ngriten linjat kryesore të cilat pasohen me qëllim për arritjen e një studimi sa më objektiv. Ndër këto çështje dhe rrethana që u referohemi këtu, disa prej tyre janë të natyrës konceptuale dhe disa të tjera të asaj kontekstuale. Thënë ndryshe, ato janë të natyrës teorike dhe praktikave në kontekst të caktuar, të cilat në raste të caktuara e plotësojnë dhe e ndikojnë njëra-tjetrën.

Në sfondin konceptual, formulimi i tezës: "Doktrina e Administrimit Territorial Ndërkombëtar: Rasti i Kosovës nën UNMIK-un 1999-2008", paraqet temën bosht rreth së cilës bie fokusi kryesor i studimit. Por, për t'i ikur abstraksionit dhe gjerësisë si dhe për ta konkretizuar tematikën e këtij studimi, do të analizohen anët më të rëndësishme të instalimit dhe funksionimit të këtij misioni. Analiza mbi veprimtarinë e tij, do të fokusohet veçanërisht në kontekstin dhe rolin që ka luajtur UNMIK-u në tri rrafshe esenciale. Së pari, në qeverisjen direkte të shoqërisë kosovare pas vitit 1999; së dyti, në ndërtimin e kapaciteteve shtetndërtuese në këtë shoqëri; si dhe së treti, në rolin e tij që ka pasur në lehtësimin e një procesi drejt zgjidhjes së statusit final të saj.

Ky rol dhe funksion i UNMIK-ut, siç do ta shohim më vonë, do t'ia jepte atij epitetin e një misioni unik dhe të papërsëritshëm, në krahasim me misionet e tjera të OKB-së gjithandej globit. Së këndejmi, rasti i Kosovës, si praktikë unike e studiuar në këtë kontekst, do t'i shërbejë konsiderueshëm njëkohësisht edhe pasurimit të teorive moderne të qeverisjes dhe shtetndërtimit ndërkombëtar, sidomos atyre teorive në lidhje me rastet e territoreve të administruara ndërkombëtarisht.

Ky instalim dhe funksionim i këtij misioni, paraqet një rrethanë praktike e cila shpjegohet teorikisht me të gjitha specifikat që ngërthen në vete. Mirëpo, përveç kësaj, për t'i kuptuar më objektivisht specifikat e administrimit ndërkombëtar të Kosovës, duhen analizuar edhe rrethanat dhe faktorët tjerë pararendës që janë të barasvlefshëm, e që kanë prodhuar situata specifike politike, të cilat i kanë paraprirë vendosjes së kësaj administrate ndërkombëtare në këtë vend. Është fjala këtu për ato rrethana dhe faktorë që i referohen shpërthimit të konfliktit të armatosur në Kosovë në vitet 1998-'99 dhe ndërhyrjes ushtarake të bashkësisë ndërkombëtare për ta zgjidhur këtë konflikt, që të marrura së bashku, poashtu paraqesin një lloj në vete të zhvillimeve praktike. Andaj këtu kemi të bëjmë me dy lloje "ngjarjesh të veçanta" praktike në

terren, të cilat kanë ndodhur në atë formë të një lidhje kauzale të tipit shkak-pasojë, në kuptimin që të parat i kanë prodhuar të dytat[1].

Me qëllim për përvijimin e koherencës logjike, së pari do të studiohen ato zhvillime politike të cilat i kanë paraprirë dhe kanë krijuar kushte për vendosjen e administratës ndërkombëtare në Kosovë. Kjo pjesë është konceptuar si periudha e paraadministrimit ndërkombëtar të Kosovës, ku për thjeshtësi analize i referohemi si: "Rasti i Kosovës në teoritë e Marrëdhënieve Ndërkombëtare". Kuptohet se zhvillimet politike që kanë ndodhur në Kosovë në kontekst të caktuar, e përbëjnë "rastin", dhe varësisht se si ky "rast" është trajtuar në arenën e marrëdhënieve ndërkombëtare, ***** *përbën çështje që duhen studiuar teorikisht, e që me studimin e një rasti në marrëdhëniet ndërkombëtare, merren teoritë e Marrëdhënieve Ndërkombëtare (TMN). Së dyti, analizohen të gjitha ato rrethana dhe specifika të instalimit dhe funksionimit të Misionit të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë-UNMIK, në kontekste të caktuara përmbajtësore dhe kohore. Poashtu, këto zhvillime dhe specifika, paraqesin një ngjarje tjetër të veçantë politike që do të njihen si "Rasti i Kosovës nën UNMIK-un". Gjithsesi, kjo ngjarje vështrohet dhe trajtohet nën objektivin e teorive të së drejtës dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare.*

Bazuar në këtë qasje, këtu krijohen relacione të pandashme fakte-teori, të shpjeguara sipas modelit të David Easton, sipas të cilit, "njohja shkencore" ka natyrë të kombinuar teorike dhe faktike, në kuptimin që sado që të kemi fakte, ato duhet të procedohen dhe analizohen teorikisht. Por, poashtu edhe teoria, sado që të jetë e strukturuar, nëse nuk mbështetet në fakte, ajo nuk mund të ketë vlerë shkencore[2]*. Thënë ndryshe, "në një procedim kërkimor, shtrimi i çështjes është vendosja në korrelacion të së paku dy variablave, prej të cilave njëra është e pavarur dhe tjetra e varur, njëra shpjegon dhe tjetra shpjegohet, përkatësisht, njëra është explanans dhe tjetra explanandum"* [3]*. Në këtë aspekt, në studimin e rastit të Kosovës, kuadri metodik*

---

[1] Karl Popper, *Mjerimi i Historicizmit* (Tiranë: Onufri 1996), f.121-129.

* Duke ndjekur përdorimin konvencional, shprehja "Marrëdhënie Ndërkombëtare" (ose vetëm MN) përdoret për ta paraqitur disiplinën akademike, ndërsa "marrëdhëniet ndërkombëtare" (ose mn) për ngjarjet praktike apo rastet në politikën botërore.

[2] Hysamedin Feraj, *Shkenca Politike*: *një hyrje* (Tiranë: Pegi, 2004), f. 215.

[3] Po aty, f.27.

*Metodat holiste nisen nga e tëra për të shpjeguar pjesët apo fenomenet e veçanta (ang. "whole"-e tëra).

dhe teorik së bashku edhe me qasjet dhe teknikat e tjera shkencore, e paraqesin atë variablin e pavarur (explanansin) që e shpjegon rastin e Kosovës. Në anën tjetër, rasti i Kosovës, paraqet atë variablin e varur (explanandumin) që shpjegohet nga i pari.

Në planin e definimit kontekstual, sidomos në atë kohor dhe përmbajtësor, studimi i rastit të Kosovës nuk shpjegohet në mënyrë holiste. Ne përqafojmë njëmendësinë e shumë studiuesve që mbrojnë argumentin se "çdo përshkrim dhe studim është detyrimisht përzgjedhës"* [4] *. Kosova si rast për studim (për periudhën e paraadministrimit) është fokusuar në kontekstin kohor 1998-'99, që është interval në të cilin kanë ndodhur zhvillimet politike më dinamike dhe më dramatike, dhe se ky interval përbën mostër të mirë kohore për një studim të rastit. Natyrisht që periudha para këtij intervali (1912-1999) e ka ndikuar kontekstin kohor të veçuar nga ne, dhe se gjithashtu ky interval i veçuar, i ka determinuar zhvillimet politike dhe shoqërore deri më sot. Kurse sa i përket periudhës së administrimit, Kosova si rast analizohet në konktekstin kohor ndërmjet viteve 1999-2008, si një periudhë e administrimit aktiv të Kosovës, e vetëm shkurtimisht, ky rast studiohet në kontekstin kohor ndërmjet viteve 2008-2013, si një periudhë pasive e administrimit të saj në rrethanat e pas pavavarësimit.*

Në kontekstin përmbajtjesor, është veçuar ajo se në çka konsistojnë, apo me çka karakterizohen ato zhvillime politike. Për pjesën e paraadministrimit, më i theksuari është konteksti i përdorimit të forcës si mjet politik i ndikimit (realpolitika). Përdorimi i forcës është vënë në qendër të vëmendjes dhe është fenomeni që më së shumti e ka karakterizuar këtë periudhë. Kështu që, kur i referohemi "forcës", aludojmë në politikën e pushtetshme, e përdorur kjo qoftë së brendshmi, ashtu edhe nga jashtë. D.m.th, politika e pushtetshme, ka qenë mjeti ndikues që është përdorur: a) ndërmjet palëve në konflikt, b) si mjeti ndikues i këtyre palëve ndaj faktorit të tretë (bashkësisë ndërkombëtare), dhe c) si mjet i faktorit ndërkombëtar për t'i ndikuar palët në konflikt. Pra, përdorimi i forcës është dhënë në manifestim "tre dimensional".

Mënyra se si është përdorur forca, veçanërisht nga bashkësia ndërkombëtare, përbën komponenten më të rëndësishme të kësaj analize. Kjo ngase, varësisht se si ka qenë i justifikuar legalisht dhe politikisht përdorimi i saj, i ka dhënë një dimension të ri edhe vet doktrinës së ndërhyrjes së bashkësisë ndërkombëtare për parandalimin apo zgjidhjen e një situate konfliktuale në terren, çfarë ka qenë edhe lufta në Kosovë.

---

[4] Popper, *Mjerimi i Historicizmit*..., f, 85.

Ky dimension i ri, në literaturën e së drejtës ndërkombëtare njihet si "intervencionizmi i ri"[5]*. Prandaj, vetë natyra specifike e reagimit të bashkësisë ndërkombëtare përmes NATO-s, në menaxhimin emergjent të kësaj situate konfliktuale, ka ndikuar në mënyrë vendimtare që edhe misioni i përkohshëm i OKB-së për administrimin e Kosovës, të ketë natyrë unike në raport me misionet e saj të mëparshme. Kjo do të jetë një çështje kyçe që do të baraspeshohet në kuadër të debatit dhe argumenteve të shkollave të ndryshme teorike lidhur me atë nëse kjo ndërhyrje është bërë mbi bazën e parimeve të së drejtës ndërkombëtare, apo mbi ato të marrëdhënieve ndërkombëtare, gjegjësisht ndërmjet parimeve të legalitetit apo të legjitimitetit.*

Nga ana tjetër, për pjesën analitike të administrimit ndërkombëtar të Kosovës, çështjet dhe problemet më të spikatura kontekstuale për UNMIK-un janë ato që kanë ndikuar në vendosjen e paqes në një shoqëri post-konfliktuale, dhe ato që kanë të bëjnë me kapacitetet dhe rolin e tyre shtetndërtuese në Kosovë.

Megjithëkëtë, kur jemi te konteksti përmbajtësor, në një gjuhë më të thjeshtëzuar mund të thuhet se të gjitha zhvillimet, si ato në periudhën e paraadministrimit, ashtu edhe ato të administrimit, janë realizuar në kontekst të "menaxhimit të konfliktit". Dallimi i vetëm konsiston në atë se, intervenimi është bërë për një sanim të menjëhershëm të gjendjes konfliktuale, kurse vendosja e administratës ndërkombëtare është bërë me qëllim që ta mbajë të sanuar këtë gjendje.

Përveç kësaj, në aspektin e procedimit kërkimor të studimit të rastit të Kosovës, janë shtruar edhe disa supozime themelore (hipoteza), konformë natyrës së çështjeve që analizohen. Kjo është bërë me qëllim që procedimi kërkimor brenda këtij studimi të jetë sa më koherent dhe logjik. Në fakt, kjo është edhe arsyeja që studiuesit më eminent pretendojnë që përfshirja e hipotezave në një studim është e domosdoshme.

Kështu, në kundërshtim me Albert Einstein-in, sipas të cilit "shkenca fillon dhe mbaron me fakte"[6]*; për Popper-in, "pikënisjen e vërtetë të çdo kërkimi e përbëjnë hipotezat d.m.th, hamendjet mbi realitetin, si në shkencat shoqërore ashtu edhe në*

---

[5] Richard Caplan, *International Governance of War-Torn* Territories: Rule and Reconstruction (Oxford: Oxford University Press, 2005), p. 5; John Baylis et al., *Strategjia në botën bashkëkohore: Hyrje në studimet e strategjisë* (Tiranë: UET Press, 2013), f. 377.

[6] Feraj, *Shkenca Politike...*, f. 63.

shkencat natyrore, dhe jo vetëm të ashtuquajturat fakte të kulluara"[7]*. Për më tepër, sipas Popperit, "shkencat natyrore si edhe ato shoqërore nisen gjithmonë nga probleme: nga ajo që ngacmon në një farë mënyre habinë tonë". Kjo tezë nga vetë Popperi është paraqitur në formën e një formulimi korelativ të tipit: "pa problem s'ka vëzhgim"*[8]**. Aplikueshmëria e kësaj logjike të Popperit është mjaft e përshtatshme për ngritjen e hipotezave në lidhje me studimin e rastit të Kosovës si një ngjarje unike në marrëdhëniet ndërkombëtare. Prandaj pasiqë Kosova paraqitet si rast ose si "problem"*[9]*, rrjedhimisht ka krijuar edhe mundësinë për një vëzhgim pasues. Vëzhgimi në këtë kontekst, ka të bëjë me analizimin apo më mirë të themi me shpjegimin e rastit apo problemit.*

Duke pasur në konsideratë faktin që zhvillimet politike që kanë ndodhur në Kosovë tanimë paraqesin gjendjet faktike në terren konform logjikës Popperiane, atëherë krijohen mundësitë për një shpjegim objektiv. Për ta realizuar këtë synim, hapat e parë që janë ndërmarrë kanë të bëjnë me formulimin e disa hipotezave shkakësore të tipit që vërtetohen në mënyrë induktive.

Në teorinë shkencore, tanimë është e qartë se ndërtimi induktiv i hipotezave përgjithësisht bëhet nga vëzhgimet dhe përvoja e realitetit social. Hipotezat shkakësore pohojnë lidhje shkakësore ndërmjet ndryshorëve në kuptimin që "A"-ja e shkakton "B"-në. Këto hipoteza mund të mirren si rast i posaçëm i hipotezave korelative[10]*.*

Këtu janë shtruar një numër hipotezash që konsistojnë mbi zhvillimet lidhur me rastin të cilat janë të natyrës politike dhe juridike. Shtrimi dhe argumentimi i tyre teknikisht është i organizuar dhe i ndarë në shqyrtime hyrëse dhe kapituj përkatës.

Në shqyrtimet hyrëse është shtruar hipoteza e parë që i referohet përpjekjeve për ndërkombëtarizimin e problemit të Kosovës: "Çështjet që kanë të bëjnë me evoluimin

---

[7] Po aty, f. 63.

[8] Karl Popper, *Për filozofinë dhe shkencën: Vepra dhe punime të përzgjedhura* (Tiranë: Fan Noli, 2009), f. 94.

[9] *Termi 'problem' përdoret sipas kuptimit që i jep Paul Horton në: *The Sociology of Social Problems* (New Jeresy, 1991): "Një problem përfaqëson një gjendje që përfshin një numër të konsiderueshëm personash, në një mënyrë që pranohet si e padëshiruar, kundrejt së cilës mund të reagohet, përmes një veprimi social kolektiv e të organizuar". Cituar nga: Lekë Sokoli, *Metodat e Kërkimit në Shkencat Sociale* (Tiranë: Instituti i Sociologjisë, 2009), f. 24.

[10] Feraj, *Shkenca Politike*..., f. 216.

e statusit politiko-juridik të Kosovës ndërmjet periudhës 1912-1999, përbëjnë përpjekjet e saj për vetëvendosje dhe ndërkombëtarizim të problemit". Çështjet rreth kësaj hipoteze që do të trajtohet në këtë pjesë, vështrohen nga prizmi i qasjes historike[11]*. Para së gjithash ato janë të orientuara drejt një sërë pyetjesh të tilla si: Cili ishte statusi dhe pozita ndërkombëtare e Kosovës që nga viti 1912? Cila ishte pozita e Kosovës në raport me konstituentët tjerë të Ish-Jugosllavisë dhe pas shpërbërjes së saj? Përse Komisioni i Badinterit nuk e aplikoi parimin "utti posidetis" në rapot me Kosovën? Cili ishte impakti i Marrëveshjes Paqësore të Dejtonit karshi Kosovës? Si arriti që problemi i Kosovës ta sensibilizonte opinionin ndërkombëtar: roli i komponentës paqësore dhe ushtarake?, etj.*

Në Kreun I, është dhënë një interpretim nga teoritë e Marrëdhënieve Ndërkombëtare mbi intervenimin ushtarak të NATO-s në Kosovë, ku do të trajtohen një sërë problematikash që i referohen ndërkombëtarizimit të problemit të Kosovës, e që përbëjnë hipotezën e dytë: "Ndërkombëtarizimi i problemit të Kosovës lidhet direkt me ndërhyrjen ushtarake të NATO-s me 1999 në Kosovë". Rreth këtyre çështjeve, sillen përpjekjet për sqarimin e argumenteve se Kosova, në raport me trajtimin e saj nga bashkësia ndërkombëtare, përbën një rast sui generis në të gjitha dimensionet. Këtu konstatohet që Kosova përbën rast sui generis për nga mënyra e përdorimit të forcës dhe të ndërhyrjes së bashkësisë ndërkombëtare për menaxhimin e konfliktit dhe të krizës humanitare në vitin 1999.

Të gjitha këto çështje, do të analizohen dhe shpjegohen nga dy teoritë pozitiviste më me ndikim në Marrëdhëniet Ndërkombëtare: Realizmi dhe Liberalizmi, si dhe nga ajo post-pozitiviste: teoria Kritike. Andaj, lidhur me sçarimin e këtyre çështjeve mund të shtrohen një varg pyetjesh të tilla si: Sa ka qenë e zbatuar praktikisht teoria mbi përdorimin e forcës si mjet ndikimi, dhe sa ka ndikuar rasti i Kosovës si ngjarje për ta ndryshuar këtë teori? Cila ka qenë baza legale dhe morale e përdorimit të kësaj force? A ka qenë përdorimi i kësaj force një tregues i saktë për të kuptuar se cilat parime e dominojnë politikën botërore: ato juridike apo politike? A ishte një intervenim për interesa strategjike apo humanitare? A krijoi kjo situatë një precedent në të drejtën

[11]* Qasja historike ndaj marrëdhënieve ndërkombëtare pohon se marrëdhëniet e sotme ndërkombëtare "kushtëzohen shumë nga ngjarjet dhe pikëpamjet nga e kaluara (lidhja kauzave shkak-pasojë), të cilat nga bota e sotme projektohen në të ardhmen në një formë mjaft të thjeshtëzuar": Rdovan Vukadinoviç, *Marrëdhëniet Politike Ndërkombëtare*, (Prishtinë: Kolegji Universitar Victory, 2006), f.37.

ndërkombëtare, apo ishte një eksperiment unik? A shërbeu ky rast në riaktualizimin e sistemit klasik të politikës së fuqive të mëdha (veçanërisht ShBA-ve) me një "neoklasicizëm", apo a shërbeu ky rast në paralajmërimin e një "sistemi kushtetues ndërkombëtar postmodern"[12]*? A ka ndikuar rasti i Kosovës në një transformim komplet të arkitekturës së mekanizmave të sigurisë ndërkombëtare? A ndikuan këto rrethana që Kosova të përbëjë një rast sui generis edhe për nga mënyra se si u vendos dhe u administrua nga OKB-ja përmes Misionit të saj të përkohshëm-UNMIK?*

Poashtu, në kuadër të këtij kreu, një pjesë e analizës është fokusuar në një vështrim të përgjithshëm mbi doktrinën e administrimit territorial ndërkombëtar të OKB-së dhe operacioneve paqëruajtëse të saj. Në këtë pjesë, shtjellohen një varg çështjesh teorike dhe empirike, që kanë të bëjnë me konceptimin e këtij fenomeni të marrëdhënieve ndërkombëtare, si dhe përvijimin historik të zhvillimit të tij. Kjo është bërë me qëllim të ndriçimit të rolit të OKB-së që ka patur në menaxhimin me situata konfliktuale dhe në krijimin e parakushteve për një ambient më të sigurt për shoqërinë njerëzore. Këtë objektiv, OKB-ja është përpjekuar ta realizojë në kuadër të filozofisë së saj paqeruajtëse, përmes një sërë operacionesh që kanë vepruar në terren. Kështuqë, shikuar nga një vështrim i përgjithshëm, në studimin e doktrinës së administrimit territorial ndërkombëtar, pyetjet të cilave duhet t'u pergjigjemi janë: Si konceptohej ky problem i marrëdhënieve ndërkombëtare dikur dhe si konceptohet sot? Cili është përvijimi historik i tij, etj?

Në kuadër të Kreut II, theksi është vënë në trajtimin e sistemit të misioneve paqeruajtëse të OKB-së dhe reformave transformuese ndaj këtij sistemi si dhe të filozofisë paqëruajtëse të OKB-së në përgjithësi. Së këndejmi, ky fenomen apo praktikë, si çdo ngjarje tjetër, poashtu mund të studiohet teorikisht nga kuadri teorik i MN, veçanërisht nën prizmin e teorive post-pozitiviste si: Postmodernizmi dhe Konstruktivizmi. Për shembull, në të definuarit e këtij fenomeni nga ana konceptuale, funksionale, qëllimore, kategorizuese dhe evoluese, secila nga këto teori ofron një kontribut specifik lidhur me secilin nga këto elemente. Kjo bëhet për faktin se duke i pasur të qarta këto elemente dhe natyrën e doktrinës së administrimit ndërkombëtar në përgjithësi, atëherë do të krijohen mundësi ta kuptojmë më saktë natyrën e UNMIK-ut si praktikë administruese në veçanti.

---

[12] Marc Weller, *Shtetësia e kontestuar*: *Administrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi* (Prishtinë: KOHA, 2009), f. 35-36.

Në këtë kontekst të reformave transformuese në sistemin paqeruajtës të OKB-së, është analizuar roli i ri që ka kjo organizatë në krijimin dhe ruajtjen e paqës në vatrat e ndryshme të krizës, në periudhën e fillimit të shekullit të njëzetë e një. Në vazhdën e këtyre analizave dhe lidhur me reformat transformuese, do të tërhiqet një paralele krahasuese në mes operacioneve tradicionale të paqes dhe atyre moderne apo komplekse dhe shumë dimensionale.

Përveç kësaj, një pjesë e konsiderueshme e analizës, do të fokusohet në shpjegimin e qasjeve të reja të OKB-së në veprimtarinë paqendërtuese të saj. Para së gjithash, këtu kemi të bëjmë me rolin e operacioneve shumë dimensionale, të cilat në përpjekje për ndërtimin e një paqeje të qëndrueshme, në disa territore, kanë ushtruar edhe autorizime shumë të gjëra qeverisëse, tipike me ato të një shteti modern. Për më tepër, këto operacione, duke u munduar t'i ngrisin kapacitetet vetëqevërisëse në disa shoqëri post-konfliktuale, kanë luajtur rolin e agjentit shtetndërtues! Këto atribute, tanimë janë bërë tipike për operacionet e reja të paqes së OKB-së. Kjo ka ardhur si rezultat i përshtatjes së qasjeve të OKB-së në ruajtjen e paqes përballë zhvillimeve të reja që kanë ngjarë në periudhën e pas Luftës së Ftohtë. Prandaj, konform kësaj qasjeje analitike, pyetjet të cilave do duhej përgjigjur janë: Cili ka qenë roli i sistemit paqeruajtës në ruajtjen e paqes në radhët e bashkësisë ndërkombëtare? Si kategorizohet ky sistem? Cilët ishin faktorët që ndikuan si shkak në transformimin e filozofisë paqëruajtëse të OKB-së? Me çfarë karakteristike u mveshën gjeneratat e reja të operacioneve të paqes? Cilat ishin objektivat që pretendoheshin të arriheshin nga këto operacione? Çfarë qasje u përdorën nga ato? Sa arritën këto operacione dhe këto qasje ta paqësonin kontekstin konfliktual në marrëdhëniet ndërkombëtare? Cili është trendi orientues i këryre operacioneve përballë zhvillimeve më të reja në sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare?, etj.

Në Kreun III, analizohen ato zhvillime dhe problematika që e kanë bërë Kosovën një territor të ndërkombëtarizuar, e që lidhen me hipotezën e tretë: "Kosova paraqet fenomenin e territorit të ndërkombëtarizuar me vendosjen e saj nën administrimin e UNMIK-ut: 1999-2008". Në grupin e çështjeve që analizohen në këtë pjesë, para së gjithash hyjnë ato që kanë të bëjnë me formatin organizativ dhe funksional të UNMIK-ut, ku fillimisht është bërë parashtrimi i disa çështjeve që i referohen natyrës juridike dhe politike të këtij misioni. Pastaj, një sërë çështjesh

tjera, janë fokusuar rreth nomenklaturës[13] organizative dhe funksionale të tij, e që përfshijnë çështje të tilla si: objektivat, struktura operacionale, funksionet, mandati, strategjia e implementimit të misionit, etj.*

Përveç kësaj, ky kre, përmbledhë trajtimet që i atribuohen analizimit të rolit që ka luajtur UNMIK-u në periudhën e menjëhershme të pas luftës në Kosovë, e që përkojnë me objektivat e tij imediate. Veçanërisht këtu, kemi të bëjmë me rolin e UNMIK-ut në formësimin e trajektorës së tranzicionit të shoqërisë kosovare, duke e transformuar këtë të fundit nga një shoqëri post-konfliktuale, në një shoqëri vetëqeverisëse. Këtë transformim, UNMIK-u e ka bërë në saje të ushtrimit të të gjithë autoritetit klasik shtetëror, atij ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor.

Ndër të tjera, çështjet që vihen në spikamë lidhur me ushtrimin e mandatit qeverisës të UNMIK-ut kanë të bëjnë edhe me rolin e këtij misioni në promovimin e vetëqeverisjes në Kosovë, përmes institucioneve të saj të përkohshme vetëqeverisëse. Në këtë drejtim, do të analizohen edhe specifikat e procesit të transferimit të autoritetit të UNMIK-ut te autoritetet lokale. Andaj, kjo veprimtari e UNMIK-ut, i referohet hipotezës së katërt se: "Përmes ushtrimit të autoritetit të gjerë qeverisës, UNMIK-u në Kosovë është shfaqur si një agjent shtetndërtues".

Poashtu, në vazhdën e këtyre analizave, vend të veçantë zënë edhe çështjet rreth performancës së UNMIK-ut, e që i referohen autoritetit, legjitimitetit, sfidave, të arriturave dhe dështimeve që ky mision i ka ndeshur gjatë ushtrimit të mandatit të tij. Andaj, në këtë drejtim, pyetjet që mund të shtroheshin do të ishin: Cila ishte baza e përgjithshme dhe specifike legale e këtij autoriteti? Cilat ishin specifikat e autoritetit qeverisës të UNMIK-ut? Me çfarë strukture ka operuar? Në çka konsistonte ky autoritet? Cilat janë specifikat, karakteristikat, funksionet dhe misioni i tij? Cila ka qenë strategjia e implementimit të misionit të tij? Cila ka qenë shkalla e legjitimitetit të tij? Cila ka qenë performanca? Me çfarë sfidash ka qenë ndeshur? Cilat janë të arriturat apo dështimet?, etj

Kreu IV, që njëherit përbënë pjesën më të gjerë dhe më komplekse të këtij studimi, ka të bëjë me analizimin e rolit të UNMIK-ut si një agjent shtetndërtues në Kosovë. Pra, në këtë kre kemi të bëjmë me studimin e pjesës tjetër të mandatit të UNMIK-ut;

[13] * Termi "nomenklaturë", është përdorur me një domethënie metaforike (ngjashëm me kuptimin që ka nga biologjia) për ta përshkruar një strukturë organizative që përmbledhë të gjithë ata element specifik të nevojshëm, që të marrë së bashku, mundësojnë kryerjen e një funksioni të caktuar.

me atë shtetndërtues, krahas mandatit qeverisës që ky mision ka ushtruar. Por, për dallim nga mandati qeverisës i cili ka qenë paraparë shprehimisht me Rezolutën 1244, ushtrimi i mandatit shtetndërtues nuk ka pasur një karakter të tillë dhe më tepër është manifestuar në mënyrë të nënkuptuar krahas atij qeverisës dhe si një objektivë afatgjate e UNMIK-ut. Këtu, para së gjithash, është fjala për ngritjen e kapaciteteve në komponentët e sigurisë, rendit dhe drejtësisë, kapaciteteve institucionale dhe qeverisëse, si dhe ato ekonomike.

Gjithsesi, para se të analizohet roli i UNMIK-ut në ditën e agjentit shtetndërtues, do të bëhet një elaborim teorik i qasjeve, strategjive dhe i debateve më të reja lidhur me fenomenin e shtetndërtimit nga faktorët e jashtëm, siç janë organizatat ndërkombëtare. Veçanërisht në këtë drejtim, shtetndërtimi elaborohet në atë dimension që ai paraqitet si pjesë e veprimtarisë paqendërtuese të administratave ndërkombëtare. Për më tej, shtetndërtimi do të analizohet si një strategji e operacioneve të paqes në eliminimin e shkaqeve konfliktuale me qëllim krijimin e rrethanave për një paqe të qëndrueshme. Pra, konformë kësaj qasjeje shpjeguese, pyetjet që mund të shtrohen në këtë drejtim janë: Çka e karakterizon një veprimtari shtetndërtuese nga administratat ndërkombëtare? Çfarë strategjie përdorin këto administrata në lidhje me shtetndërtimin? Cilat janë qasjet që aplikohen në arritjen e strategjive të caktuara? Në çka konsiston veprimtaria shtetndërtuese në kuadër të administratave ndërkombëtare? Sa ka arritur të bëhet një praktikë standarde kjo veprimtari?, etj.

Në Kreun V, përqendrimi është vënë në studimin e procesit diplomatik të zgjidhjes së statusit të Kosovës. Ky proces analizohet në kuadër të mandatit të UNMIK-ut dhe rolit të tij në këtë drejtim. Duke filluar me shqyrtimet e politikave fillestare të UNMIK-ut, që i atribuohen "standardeve para statusit", do të kalohet te procesi i negociatave për statusin, i ndërmjetësuar nga OKB-ja përmes emisarit të saj special. Pastaj, te analizimi i procesit negociator, do të analizohen një sërë specifikash politike që e kanë karakterizuar këtë proces. Për më tepër, procesi i zgjidhjes së statusit, shpjegohet në kontekstin që ai ka qenë shfaqur si një urë lidhëse në mes procesit të qeverisjes dhe shtetndërtimit ndërkombëtar të Kosovës, dhe më vonë si finalizues i tyre. Mbi bazën e kësaj logjike është ngritur hipoteza e pestë: "Procesi i zgjidhjes së statusit të Kosovës përbën hapin konkretizues (por jo përmbyllës) të shtetndërtimit ndërkombëtar në Kosovë".

Kur jemi te shqyrtimet rreth zgjidhjes së statusit të Kosovës, janë ngritur disa pyetje, përgjigjja ndaj të cilave është mjaft sfiduese, të tilla si: Cili ishte roli i Rezolutës 1244 respektivisht i UNMIK-ut në zhvillimin e këtij procesi të komplikuar politik dhe diplomatik? Me çfarë qasje politike ishte përfshirë UNMIK-u në adresimin e këtij problemi? Cili ishte roli i bashkësisë ndërkombëtare në raport me këtë proces? Me çfarë sfidash ka qenë karakterizuar ky proces? Cili ka qenë epilogu i këtij procesi? Çka ka treguar praktika negociatore për statusin e Kosovës në raport me parimet e politikës ndërkombëtare? Cilat kanë qenë rezultatet?, etj.

Kuadri metodologjik dhe teorik në studimin e rastit të Kosovës është përzgjedhur me kujdesë dhe ka për synim që të jetë i përshtatshëm me natyrën e problemeve që e karakterizojnë këtë rast.

Është evident fakti se në përfitimin e dijeve shkencore nuk ka një metodë apo rregulla standarde që procedohen nga të gjithëstudiuesit[14]*. Studiuesit e politikës ndërkombëtare, janë të vetëdijshëm se hapat e kërkimit mund të renditen në mënyra të ndryshme*[15]*. Edhe në këtë studimin, procedimi kërkimor nuk është i kundërta me ato forma të procedimeve që përgjithësisht i ndjekin studiuesit kur bëjnë studime, e sidomos të natyrës së temës sonë.*

Për një të kuptuar më në thelb të këtyre hipotezave dhe variablave si përbërëse të tyre në lidhje me studimin e rasti i Kosovës si njësi analize, paraqitet një domosdoshmëri e përdorimit të një kuadri të metodave që janë tipike për shkencat shoqërore dhe politike[16]*. Megjithatë, një pjesë e konsiderueshme e politologëve pohojnë se shkenca politike nuk ka një metodë dhe metodikë të vetën, në kuptimin që është vetëm e vetja ose "që është shpikur, zhvilluar dhe që është përdorë gati ekskluzivisht prej saj". Prandaj sipas tyre çështja e metodave në shkencën politike është e lidhur me çështjen e metodave të shkencës në përgjithësi, ose me fjalë të*

---

[14] David E. McNabb, *Research Methods for Political Science: Quantitative and Qualitative Methods*, (New York: M.E. Sharpe, 2004), p.571; Nathaniel Beck, *Political Methodology - A Welcoming Discipline Department of Political Science* (San Diego: University of California, May 11, 1999), pp. 1-12.

[15] Feraj, *Shkenca Politike*..., f.253; Robert E.Godin (ed.) *The Oxford Handbook of Political Science* (New York: Oxford University Press, 1996), p. 89-100.

[16] Veton Latifi, *Teoritë e Shkencës Politik* (Prishtinë: Fama, 2007), f.59-60.

tjera, metodologjia e shkencës politike është pjesë përbërëse e doktrinës së metodave të shkencës në përgjithësi [17].

Në anën tjetër, edhe pse në përgjithësi studiuesit argumentojnë se për studimin e fenomeneve sociale e politike, duhet të përdoren metodat cilësore apo kualitative[18], *megjithatë, në varësi të natyrës së problemeve që studiohen, është shumë me rëndësi të përdoret edhe një kuadër metodologjik sasior apo kuantitativ. Pasi që rasti ynë studimor përbëhet nga një grup i larmishëm çështjesh, atëherë kërkohet përdorimi i një metodologjie multidisiplinare të kombinuar, e përbërë edhe nga metoda cilësore, edhe sasiore.*

Ndër metodat cilësore që aplikohen më së tepërmi në këtë studim, janë: metoda historike, kritike, shpjeguese, normative, krahasuese, etj. Këto metoda, do të përdorën edhe në mënyrë specifike edhe në mënyrë të kombinuar, varësisht prej kahjes që do të marrin trajtimet e problematikave respektive.

Në anën tjetër, kuadri metodologjik sasior, do të jetë i përqendruar në përdorimin e metodave statistikore dhe teknikave hulumtuese, përmes të cilave do të bëhet i mundur matja dhe sistematizimi i të dhënave nga hulumtimet në terren. Këto të dhëna, do të nxirren mbi bazën e hulumtimeve empirike, e që kanë të bëjë me matjen dhe vlerësimin e opinioneve dhe perceptimeve të qytetarëve të Rpublikës së Kosovës në lidhje me problemet që janë trajtuar në këtë studim.

Teknikat hulumtuese për nxjerrjen dhe përpunimin e të dhënave, janë bërë përmes anketimeve të qytetarëve, ku është bërë një përzgjedhje me kujdes e mostrave që janë anketuar. Mostrat kryesore janë fokusuar në kategoritë profesionale të përbërë kruesisht nga student të shkencave sociale, siç janë ato politike, juridike, sociologjike, ekonomike etj. Pastaj, një mostër e rëndësishme përbëhet nga profesor dhe analist të çështjeve politike dhe sociale. Përveç tyre, një mostër është përfaqësuese edhe e qendrave hulumtuese profesionale, si dhe e subjekteve politike në Kosovë.

---

[17] Aleman & Forndran, *Methodik der Politkwissenchaft, kohlhammer* (Auflage, 1995), s.5: Cituar sipas Feraj, *Shkenca Politike*..., f. 221.

[18] Bob Matthews & Liz Ross, *Metodat e Hulumtimit: Udhëzues praktik për shkencat sociale dhe humane*, (Tiranë: Qendra për Arsim Demokratik (CDE), 2010), faqe 142; Lekë Sokoli, *Metodat e Kërkimit në Shkencat Sociale*, (Tiranë: Instituti i Sociologjisë, 2009), faqe 95-105.

Numri i të anketuarve është bërë konform qasjes që paraqet studiuesi Sekaran, që rekomandon se ato duhet të jenë më shume se 30, dhe pak se 500[19]*. Konform këtij rekomandimi, kemi bërë 220 anketime të përbëra nga 20 mostra. Përunimi dhe analizimi i këtyre të dhënave është bërë në bazë të programit më të avancuar deri më tani për hulumtime shkencore në fushat e shkencave sociale: Paketa Statistikore për Shkenca Sociale (SPSS-Statistical Package for Social Sciences).*

Në realizimin e këtij punimi, është përzgjedhur një literaturë specifike dhe u referohet autorëve dhe studimeve më të reja dhe ekuivalente me natyrën e problematikave që shtjellohen këtu. Para së gjithash ajo përbëhet nga autorë të huaj, por, duke mos i lënë anash as autorët nga trevat shqiptare në përgjithësi. Ndër autorët që kanë peshën më të madhe në referimet brenda këtij studimi janë: Alexander Wendt, Social Theory of International Politics, 1999; Bernhard Knoll, Legitimacy and UN Administration of Territory, 2007; Bernhard Knoll, The Kosovo Status Process and the Prospect of Sovereignty, 2008; Blerim Reka, UNMIK as an international governance in post-war Kosova, 2003; S. Burchill, R. Devetak, A.Linklater, M.Paterson, Ch.R.Smit and J.True, Theories of International Relations, 2001; Carsen Stahn, The Law and Practice of International Territorial Administration, 2008; David Armstrong, Lorna Lloyd, John Redmond, Organizatat Ndërkombëtare në Politikën Botërore, 2010; David Chandler, Empire in Denial, 2006; Dominik Zaum, The Sovereignty Paradox, 2007; Francis Fukuyama, Ndërtimi i Shtetit, 2010; Hans J. Morgenthau, Politika Ndërmjet Kombeve, 2008; Henry Kissinger, A ka nevojë Amerika për një politikë të jashtme, 2003; John Baylis and Steve Smith (editors), The Globalisation of World Politics, 2005; Karl Popper, Mjerimi i Historicizmit, 1996; Marc Weller, Shtetësia e kontestuar, 2009; Michael Ignatieff, Empire Lite, 2003; Noam Chomsky, The New Military Humanitarism, 1999; Oliver P. Richmond, Understanding the Liberal Peace, 2005; Ralph Wilde, From Danzing to East Timor and Beyond, 2001; Richard Caplan, International Governance of War-Torn Territories, 2005; Roland Paris & Timothy D.Sisk eds, The Dilemmas of Statebuilding, 2009; Simon Chesterman, You, the People, 2004, etj.

Lidhur me realizimin e këtij studimi, është një pjesë e konsiderueshme e njerëzve dhe institucioneve që më kanë përkrahur dhe që meritojnë një falënderim të denjë. Një

[19] Uma Sekaran, *Research methods for business: A skill building approach* (New Jersey: John Wiley & Sons, 2000, 4th ed.), pp. 2-31, 48-64.

falënderim i veçantë i drejtohet udhëheqësit tim shkencor, Prof. dr. Blerim Reka, Pro-Rektor për Hulumtime dhe Promovim në Universitetin e Evropës Juglindore në Maqedoni, pa përkrahjen e plotë të të cilit ky studim nuk do të ishte finalizuar. Falënderimi im shprehet edhe për profesorët dhe drejtuesit e Shkollës Doktorale të Degës së Historisë të Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë në Universitetin e Tiranës, për ofrimin e udhëzimeve dhe këshillave profesionale në hartimin dhe realizimin e këtij studimi. Gjithsesi, e falënderoj edhe Kolegjin Iliria në Prishtinë, për përkrahjen e vazhdueshme me të gjitha kapacitetet dhe resurset që më ka ofruar në realizimin e këtij studimi. Pa dyshim, që falënderimet dhe mirënjohjet më të sinqerta i takojnë familjes sime e cila më ka mbështetur dhe motivuar në çdo aspekt, gjatë gjithë rrugëtimit tim drejt edukimit, shkollimit, si dhe ngritjes profesionale.

\

HYRJE:

PËRPJEKJET PËR NDËRKOMBËTARIZIMIN E PROBLEMIT TË KOSOVËS 1912-1999

Kosova, edhe pse një territor i vogël, me vete ka mbartur një bagazh të rëndë historie ku elementet konfliktuale kanë qenë tiparet më të spikatura të saj dhe të cilat kanë reflektuar deri në ditet tona. Këtë fat të Kosovës, disa do ta quanin si një "histori e lashtë me pasoja moderne" [20]. Shikuar nga ky këndvështrim, shkaqet e konfliktualitetit në Kosovë kanë qenë shfaqur në formë të lidhjes kauzale të tipit shkak-pasojë. Mbi këtë bazë, do të mund të sillen argumente që përpjekjet e vazhdueshme të popullit të Kosovës për t'u ndërkombëtarizuar si problem, kanë shërbyer si faktor konfliktual, në kuptimin që këto përpjekje kanë qenë shtypur së brendshmi dhe injoruar së jashtmi. Këto përpjekje të popullit të Kosovës kanë qenë të adresuara në kuadër të forumeve më të rëndësishme ndërkombëtare, që do të duhej ta trajtonin dhe zgjidhnin këtë problem konformë standardeve dhe praktikave ndërkombëtare, duke përfshirë edhe atë të vetëvendosjes.

Ky fakt, imponon nevojën që interpretimet mbi natyrën e konfliktualitetit të situatës së ashtuquajtur "problemi i Kosovës", të fokusohen në gjetjen dhe analizimin e shkaqeve që e kanë prodhuar këtë situatë. Në këtë kontekst, qasja më e përshtatshme do të ishte ajo e interpretimit *strukturor* dhe *sistematik* e shkaqeve të një konflikti, e cila u kushton vëmendje rrethanave ndërkombëtare dhe njëherit përbën një qasje studimore bashkëkohore në marrëdhëniet ndërkombëtare[21]. Sipas kësaj qasje, lidhur me rolin e faktorëve sistemik, studiuesi Ignatieff, shkaqet e konflikteve ndërmjet popujve të Ballkanit (përfshirë këtu edhe atë të Kosovës), i shpjegon në kushtet e mungesës së një "arbitrariteti perandorak" për të imponuar një rend të fortë mbi këta popuj. Në këso rrethanash, pas shembjes së perandorisë Austro-Hungareze dhe asaj Osmane, popujtë e këtij rajoni, u bënë shumë armiqësor

[20] Marc Weller, *Shtetësia e kontestuar*: *Administrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi* (Prishtinë: KOHA, 2009), faqe 69.

[21] Lidhur me shpjegimin e llojeve të shkaqeve të shpërthimit të luftërave, shih më tej në: John Baylis et al., *Strategjia në botën bashkëkohore…,*2013, f.45.

ndaj njëri-tjetrit, ku natyra etnike e konflikteve u bë shumë e rrënjosur ndërmjet tyre[22].

Në lidhje me shkaqet konfliktuale në raport me problemin e Kosovës, mund të thuhet se, duke filluar me konstelacionin "post-osman" e deri te ai "post-jugosllav", në këtë vend vazhdimisht kanë ekzistuar elemente konfliktuale, derisa ato morën përmasat e luftës që shpërtheu në vitin 1998, gjë që imponoi për herë të parë "ndërkombëtarizimin e problemit të Kosovës", duke e vendosur bashkësinë ndërkombëtare para "aktit të kryer". Kjo do të sygjeronte që faktikisht, shkaqet e konfliktualitetit në Ballkan dhe në Kosovë duhen kërkuar në radhët e forcave sistemike të marrëdhënieve ndërkombëtare përgjatë fillimit të shekullit XX-të, kurse pasojat përgjatë dhe në fund të tij. Këtë shekull, disa e kanë konsideruar si "shekulli i vetëvendosjes", por përveç kësaj, ai ka qenë vlerësuar edhe si "shekulli i gjenocidit"[23].

Një qëndrim të tillë e mbron edhe studiuesja Macmillan, duke theksuar se: "për të gjithë kombet e Ballkanit, zhdukja e Austro-Hungarisë kishte dhënë një shans, ashtu si edhe disfata e perandorisë Osmane para luftës. Çdo kush kërkonte sa i kishte qejfi: vetëvendosje për vete, por jo për fqinjët e vet"[24]. Andaj, në kontekstin e Kosovës, ky territor - shikuar në prizmin gjenealogjik - me gjenarata ka qenë në konflikt ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve, ku gjatë shumicës së këtij shekulli, serbët kanë qenë minoritet në Kosovë[25]. Një pasqyrim numerik i përqindjes së popullsisë në Kosovë, sipas kriterit etnik dhe kohor, është dhënë në tabelën 1.

Në vitin 1912, Serbia e aneksoi Kosovën. Kjo situatë u njoh nga Traktati i Varsajës në vitin 1918, por në qerekun tjetër të shekullit, qeverisja serbe krijoi armiqësi të madhe me popullaten shqiptare. Siç do të shkruante Macmillan, Kosova në këtë konferencë (e cila prodhoi këtë traktat) nuk u bë çështje, sepse fuqitë panë se nuk kishin asnjë arsye që të zmadhonin kufinjtë e Shqipërisë në ndonjë drejtim[26].

---

[22] Michael Ignatieff, *Gjaku dhe Përkatësia*:Udhtime në Nacionalizmin e Ri (Tiranë: Dituria, 2000), f.14.

[23] Eric D. Weitz, *A Century of Genocide, Utopias of Race and Nation* (USA: Princeton University Press, 2003), p.360.

[24] Margaret Macmillan, *Paris 1919: Gjashtë muaj që ndryshuan botën* (Tiranë: Plejad, 2006), f.153.

[25] Po aty, f. 421.

[26] Macmillan, *Paris 1919...*, f. 406-425.

Tabela 1. Totali i popullsisë në Kosovë dhe shpërndarja në përqindje.

Vitet	Popullata në total	Popullata serbe	Shpërndarja e popullatës serbe në %
1948	728,436	171,911	23.6
1953	804,530	189,869	23.6
1961	966,026	227,016	23.5
1971	1,247,344	228,264	18.3
1981	1,585,333	209,498	13.2
1991	1,961,515	194,190	9.9

Burimi: The Kosovo Report Conflict, "International Response, Lessons Learned, The Indepedent International Commission on Kosovo", Published in the United States by Oxford University Press Inc., New York 2000, p. 39.

Lidhur me këtë, disa studiues (Morgernthau) argumentojnë që problemi më i madh në teorinë e së drejtës për vetëvendosje është interpretimi dhe justifikimi i saj[27]. Ndoshta rasti i Kosovës e paraqet më së miri natyrën kontradiktore të përmbajtjes së parimeve që proklamon e drejta për vetëvendosje. Kosova ka nxjerrë në pah më mirë se çdo kush tjetër të metat e këtij parimi që d.m.th, tregon për natyrën organike-pluraliste të tij.

Po të shikohet nga një prizëm moral dhe logjik, vetë doktrina e vetëvendosjes (për nga natyra e brendshme) nuk është e tillë, pasi që atë e proklamuan të fuqishmit ndaj të dobëtëve, dhe nuk ka vetëvendosje kur subjekti "A" vendos se çka duhet të vendos subjeki "B". Në këtë rast, "vetëvendosin" të fuqishmit! Por, për popullatën kosovare ishte edhe më keq! Kjo sepse, përveç që i treguan se çka kishte të drejtë, ata kurrë nuk i mundësuan ta realizonte këtë. Natyrisht, Kosova përgjatë këtij shekulli u përpoq vazhdimisht ta realizonte këtë të drejtë. Këtu mund të përligjet deklarimi i Morgentaut që "vetevendosja është ideologji më shumë se sa teori"[28].

Përveç kësaj, e drejta për vetëvendosje për shqiptarët e Kosovës, u mohua edhe një herë gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore. Për më tepër, Tito me dekretin e 8

[27] Hans J. Morgenthau, *Politika Ndërmjet Kombeve: Lufta për pushtet dhe paqe* (Tiranë: Instituti për Studime Ndërkombëtare, 2008), f.100-120.

[28] Po aty, f. 111.

shkurtit të vitit 1945 e vendosi një administratë ushtarake në Kosovë. "Kjo ndodhi saktësisht kur Fuqitë e Mëdha në Jaltë ishin duke i ndarë sferat e tyre të interesit, dhe udhëheqësit jugosllavë krijuan rrethana të tilla që çështja e vetëvendosjes për shqiptarët të mos ngrihej fare"[29].

Pas Luftës së Dytë Botërore, Kosova u qeveris si Krahinë Autonome Jugosllave pothuaj deri në fund të viteve '60-të. Pastaj, deri në nxjerrjen e Kushtetutës Jugosllave të vitit 1974, nuk ka patur ndonjë avansim të pozitës kushtetuese të Kosovës. Megjithë këtë, pozita e shqiptarëve në Kosovë u rendua edhe më tepër nga zhveshja e synuar e statusit federativ të Kosovës, përmes suprimimit të autonomisë që u bë në vitin 1989[30].

Gjatë procesit të shpërbërjes së Jugosllavisë, në Kosovë, me 1991, shumica shqiptare e popullsisë, mbajtën edhe një referendum, ku edhe një herë i proklamuan të drejtat e tyre për vetëvendosje. Në këto rrethana politike, udhëheqësi jugosllav Slobodan Millosheviçi, instaloi një regjim represiv dhe totalisht diskriminues. Si pasojë e kësaj, lidershipi kosovar filloj ta aplikonte një strategji jo aktive e rezistences, filloi një shtet paralel, u shpall kushtetuta e re dhe u mbajten zgjedhjet.

E drejta e Kosovës për vetëvendosje u mohua prerazi edhe në Komisionin e Arbitrazhit të Konferencës së Paqes për Jugosllavinë. Siç do të theksonte Woodward, Shpërbërja e Jugosllavisë shtroi tri dilema teorike në rastet për vetëvendosje[31]*. Ishte dilema e dytë ajo që më së shumti i kushtoi Kosovës, e që i referohet qasjes selektive të parimit *utti posidetis*, të aplikuar nga Komisioni i Arbitrazhit i Konferencës së Paqes për Jugosllavinë[32]*. Justifikimi kryesor i kritikave lidhet direkt me faktin që ky parim,

---

[29] Blerim Reka, *UNMIK as aninternational governance in post-war Kosova: NATO's Intervention, UN Administration and Kosovar Aspirations* (Skopje: Logos-A, 2003, p.43.

[30] Arsim Bajrami, *Sistemi Kushtetues i Republikës së Kosovës*, (Prishtinë: FAMA, 2011), f. 56-59; Hugh Beach, "Secessions, interventions and just war theory: the case of Kosovo", *Pugwash Study Group on Intervention, Sovereignty and International Security* 1 (2000).

[31]* Kush ishte i thirrur për këtë të drejtë: Republikatë apo Populli? Statusi i kufijve territorialë në mes ish-republikave dhe krahinave autonome, dhe së fundmi si të kualifikoheshin aspiratat kombëtare për vetëvendosje; si një kërkesë e minoriteteve ose si e *iredentistëve*: Susan L.Woodward, *Ballkan Tragedy, Chaos and Dissolution after the Cold War* (Washington DC: The Brookings Institute, 1995), pp. 223-272.

[32]* Hurst Hannum, "Self-Determiantion, Yugoslavia, and Europe: Old Wine in New Bottles?" *Transnational Law and Contemprorary Problems* 3 (1997): pp.59-69;

sipas së drejtës ndërkombëtare, është konsideruar si: "një parim gjeneral, që ka të bëjë me rastet në fitimin e pavarësisë"[33]. Në këtë rast, GJND-ja e konsideronte doktrinën *utti posidetis* si një rregull të së drejtës ndërkombëtare për kontestet kufitare[34]. Megjithë këtë, qasja selektive e aplikimit të këtij parimi nga Komisioni i Badinterit ka të bëjë me injorimin e disa fakteve kruciale juridike. Këtu duhen përmendur vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Jugosllavisë, të vitit 1990 dhe 1991, ku Kosovës dhe Vojvodinës ua njihte kufijtë si me karakter Kushtetues, ngjashëm me ata të republikave. Andaj në rrethanat e shpërbërjes së shteteve, parimi *utti posidetis* ishte një bazë juridike për njohjen ndërkombëtare të Kosovës, si njëra nga tetë njësitë e ish-RSFJ-së, me kufijtë e njohur të brendshëm të saj. Në përputhje me këtë parim, Badinteri ka mundur ta aplikojë opinionin e tij edhe në rastin e Kosovës, sepse në opinionin e tij numër 3, Komisioni kishte konkluduar se: "ish kufijtë e brendshëm do të bëheshin kufinjë të mbrojtur nga e drejta ndërkombëtare"[35].

Një anashkalim tjetër që iu bë zgjidhjes së problemit të Kosovës nga bashkësia ndërkombëtare, koinçidon me Konferencën e Paqes në Dejton të vitit 1995, nga e cila, realisht lidershipi dhe popullsia shqiptare e Kosovës kishin pritur shumë. Siç është dëshmuar, Dejtoni kishte fokusuar agjendën e tij në përfundimin e luftës në Bosnje dhe njohjen e kufijve të Kroacisë, dhe nuk e mori aq në konsideratë problemin e Kosovës[36]. Megjithatë, marrëveshja e Dejtonit e njohu Serbinë dhe Malin e Zi si Jugosllavia e re, përbrenda kufijve ekszistues, pa ndonjë njohje të veçantë për statusin e Kosoves[37]*. Kjo situatë bëri që një pjesë e akterëve politikë të Kosovës t'a ndërronin

---

Wolfgang F Danspeckgruber, *The Self-Determination of Peoples: Community, Nation, and State in an Interdepedent World* (USA: Lynne Rienner Publishers, 2002), pp. 52-53.

[33] ICJ Reports, 1986, p.554.

[34]Reka, *UNMIK as an international governance…*, p.62.

[35]Opinioni numër 3 i Komisionit të Badinterit, (11 Janar 1992).

[36] Iain King dhe Whit Mason, *Paqe me çdo kusht: Si dështoi bota në Kosovë* (Prishtinë: Koha, 2006), f. 57.

[37]* Studiuesi Caplan sjellë tri arsye kryesore në lidhje me neglizhimin e trajtimit të çështjes së Kosovës në Dejton: Së pari, mendohej se kjo të ishte një shkak që mund ta shtynte Millosheviçin të mos bashkëpunonte me Gjykatën e Hagës për krime të luftës. Së dyti, diskutimi për Kosovën mund të ishte faktor që do ta armiqësonte Millosheviqin me bashkësinë ndërkombëtare në kuptimin e inplementimit e kësaj marrëveshje. Së treti, në Kosovë nuk kishte luftë, kështu që nuk kishte nevojë të mirrej me të. Shih më tej në:

strategjinë e veprimit përkitazi me ndërkombëtarizimin më efikas të problemit të Kosovës[38]. Kështu filloi të vepronte Ushtria Çlirimtare e Kosoves (UÇK), e cila kërkonte ndarje me mjete të dhunshme nga Serbia. Në fakt, lindja dhe operimi i UÇK-së u bë konform "*logjikës së situatave*"[39]*.

Pasi që në terren ishin krijuar rrethana të reja, sidomos ato me natyrë konfliktuale, bashkësia ndërkombëtare filloi të reagonte ndaj këtyre zhvillimeve me një "logjikë përshtatëse", ashtu siç ato evoluonin. Kjo do të thotë se bashkësia ndërkombëtare nuk ka patur një strategji të qartë reaguese në lidhje me menaxhimin dhe zgjidhjen eventuale të situatës konfliktuale në Kosovë.

Kjo qasje është ilustruar mjaft qartë përmes përshkrimit të ngjarjeve në vijim. Për shembull, Këshilli i Sigurimit vuri një embargo të armëve në RFJ, duke përfshirë edhe Kosovën në muajin mars nga viti 1998, vetëm atëherë kur forcat e sigurisë të Jugosllavisë morën masa ndëshkuese ndaj popullatës shqiptare[40]. Ky hap i ndërmarrë nga Këshilli i Sigurimit, nuk pati kurrfarë efekti në parandalimin e përshkallëzimit të dhunës në muajt që pasuan. Përkundrazi, shkalla e dhunës shkoi duke u rritur gjithnjë e më shumë. Pas këtyre ngjarjeve në terren, Këshilli i Sigurimit vazhdoi me të njejtën qasje, duke dalë me reagime të reja, karshi zhvillimeve të reja. Kësaj radhe u bë thirrje

---

Richard Caplan, "International Diplomacy and the Crisis in Kosovo", International Affairs 74 (1998), pp. 745-761, at. p.750.

[38] Noam Chomsky, *The New Military Humanitarism: Lesson from Kosovo,* (Common Courage Press, 1999), pp.24-26.

[39]* Për më tepër, në kuadër të logjikës shkencore ndaj një studimi, madje edhe në rastin e Kosovës, mund të aplikohet edhe e ashtuquajtura *"Logjikë e situatave"*, sipas së cilës shpjegohet shumë qartë modeli *shkak – pasojë* i disa veprimeve në përdorimin e forcës. Siç argumenton Popper, këtë koncept e kanë përdorur shpesh në mënyrë më pak a më shumë të ndërgjegjshme historianët më të mirë, për shembull, Tolstoi kur shkruante se nuk ishte një vendim por "nevoja" që e detyroi ushtrinë ruse të dorëzonte Moskën pa luftë dhe të tërhiqej në vende ku mund të gjente ushqim: Poppre, *Mjerimi i Historicizmit*...,f. 109-120, 144-148. Prapa kësaj *"logjike të situatës"*, apo mbase si një pjesë e kësaj, ne detyrohemi të bëjmë njëfarë analize të lëvizjeve shoqërore. Në këtë mënyrë, duke e përdorur *logjikën e situatës,* arrijmë të kuptojmë se lindja e faktorit ushtarak të shqiptarëve të Kosovës (UÇK) nuk ishte rezultat i një vendimi të caktuar formal, por ishte nevojë e domosdoshme që në një farë mënyre e *shkaktoi* situata, apo rrethanat e caktuara. Rrethanat e njëjta ishin ekuivalente edhe për operacionet e NATO-s.

[40] UNSCR 1160 (1998).Avaliable: http://www.nato.int/kosovo/docu/u980331a.htm

për armëpushim,[41] thirrje e cila e vazhdoi edhe për disa herë. Andaj, me qëllim të lehtësimit të situatës humanitare, në fund të vitit 1998, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSCE) e dërgoi një Mision Verifikimi (KVM) me 2000 veta[42]. Në vazhdën e këtij epilogu, edhe NATO-ja dërgoi një Forcë Ekstraktimi në Maqedoni. Por, pavarësisht kërcënimeve reale, regjimi serb vazhdoi me politikën e vetë represive dhe gjenocidiale. Në janar të vitit 1999 forcat serbe vranë diku rreth 45 shqiptarë në Raçak, duke shkaktuar një mizori tjetër[43]. Kjo ngjarje, ndikoi fuqishëm në sensibilizimin e opinionit ndërkombëtar, i cili, në shenjë reagimi filloi të aktivizohej përmes "diplomacisë së konferencave".

Kosova u ndërkombëtarizua si problem, në momentin kur bashkësia ndërkombëtare filloi t'i aktivizojë mekanizmat dhe kanalet e veta diplomatike dhe ushtarake, lidhur me trajtimin e Kosovës si një problem me përmasa ndërkombëtare që duhej trajtuar me urgjencë. Ky pohim, mbështetet fuqishëm edhe nga opinioni kosovarë, i matur empirikisht përmes një anketimi që kemi bërë në terren. Shih më tej në figurën 1.

Figura 1. A mendoni se ndërkombëtarizimi i problemit të Kosovës u bë më i theksuar me ndërhyrjen ushtarake të NATO-s me 1999?



[41] UNSCR 1199 (1998).

[42] Reka, *UNMIK as an international governance…,* p.75.

[43] Beach, "Secessions"..., 2000.

Në saje të kësaj qasje reaguese, u mblodh Konferenca e Paqes në Rambuje (Rambouillet), nën kryesinë e përbashkët të Britanisë dhe Francës, që i mbajtën punimet prej 16-23 shkurt dhe prej 15-19 mars. Siç dihet nga përmbajtja e Marrëveshjes që doli nga kjo Konferencë, qëllimi i saj ishte arritja e një lloj zgjidhjeje me anë të kompromisit. Gjersa palës kosovare i premtohej një lloj autonomie vetëqeverisëse; palës serbe iu sigurua kontrolli i mëtutjeshëm i Kosovës. Megjithë këtë, kjo marrëveshje nuk prodhoi një zgjidhje të pranuar nga të dyja palët negociatore. Pavarësisht që pala kosovare e bëri nënshkrimin e saj, pala serbe e refuzoi pa kushte. Në këtë marrëveshje kishte diçka me të cilin nuk pajtohej, Serbia dhe (Rusia). Ajo kishte të bënte me kushtin që trupat e NATO-s të pranohen në Jugosllavi për t'a mbikqyrur marrëveshjen[44]. Gjatë kësaj kohe ishte e qartë se shkalla e lartë e ofensivës Serbe vazhdonte dhe Komisionieri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR) raportoi për praninë e 250,000 personave të zhvendosur përbrenda Kosovës[45].

Pas këtyre zhvillimeve, një "ultimatum" iu kishte bërë Millosheviçit nga diplomati amerikan Riqard Hollbruk, të cilin Millosheviçi e shpërfilli haptas. Kjo tregoj se nuk kishte mbetur shumë për t'u bërë në planin diplomatik, dhe se ishte hapur rruga për t'i realizuar kërcënimet që NATO ia kishte bërë Serbisë[46]. Pas këtyre zhvillimeve, Misioni i Verifikimit i OSCE dhe UNHCR që tashmë vepronin në Kosovë, i tërhoqën stafin e tyre në ditët vijuese, dhe pas kësaj filloi sulmi ajror i NATO-së. Fushata e sigurisë ishte kodi i quajtur "Forca Aleate"[47].

Në fakt, shikuar në rrafshin kohor dhe për nga mënyra e justifikimit, nga shumë çarqe është vlerësuar se fushata bombarduese e NATO-s kundër Jugosllavisë, si një reagim ndaj represionit të regjimit serb në Kosovë, ka qenë "një moment definues

---

[44] Corneliu Bjola, *Legitimising the Use of Force in International Politics: Kosovo, Iraq and the ethics of intervencion (*e-Library: Taylor & Francis, 2009), p. 95.

[45] David Morrison, *How NATO's "humanitarian intervention" in Kosovo led to a humanitarian catastrophe*, April 2011. Avaliable: http://www.david-morrison.org.uk/kosovo/kosovo-humanitarian-catastrophe.htm

[46] Stephen T. Hosmer, "The Conflict Over Kosovo: Why Milosevic Decided to Settle When He Did", *RAND Research Brief* MR-1351-AF (2001).

[47] Aidan Hehir, *Humanitarian Intervention after Kosovo: Iraq, Darfur and the Record of Global Civil Society* (UK: Palgrave Macmilan, 2008), 2008, p. 47.

thelbësor në zhvillimin e rendit ndërkombëtar që nga përfundimi i Luftës së Ftohtë"[48]. Përveç kësaj, lufta në Kosovë është njohur si "pikë vendimtare në evolucionin gradual të vendosjes së normave ndërkombëtare dhe reformës shoqëruese të masave ndërkombëtare të sigurimit"[49]. Lidhur me natyrën e konfliktit dhe mënyrën e reagimit të bashkësisë ndërkombëtare për menaxhimin e tij, Danchev në: *The Politics of Delusion (Politikat e Mashtrimit)*, argumenton që u vu në pah se shoqëria ndërkombëtare kishte filluar të hynte në një "zonë morale të shëndoshë". Këto vlerësime bëhen madje edhe përkundër kritikave lidhur me atë se ky veprim i bashkësisë ndërkombëtare ishte "selektiv, i vonuar, manipulues, i çrregullt dhe në shumë raste fatal, gjykimi përfundimtar duhet të jetë se së paku ishte, "një vend i mirë për të filluar"[50].

Rreth kësaj mënyre unike të reagimit të bashkësisë ndërkombëtare për sanimin e krizës humanitare në Kosovë, është argumentuar se një ndryshim i madh në marrëdhëniet ndërmjet parimeve klasike të ruajtjes së sovranitetit dhe atyre të mbrojtjes së të drejtave njerëzore është promovuar nga ky rast, por që perspektiva, ashtu siç edhe pritej, vazhdoi të mbetet akoma e paqartë[51]. Prandaj, bazuar në këto zhvillime, në një masë të konsiderueshme është imponuar nevoja për të rishikuar shkallën e përputhshmërisë ndërmjet aspiratave normative dhe strukturave të reja institucionale[52]. Më tutje, në rrjedhën e këtyre pohimeve konsiderohet se janë tri sfera ku kriza e Kosovës ka ngritur çështje të reja sfiduese në skenën e zhvillimeve të marrëdhënieve ndërkombëtare. "Së pari, në çështjet që bien rreth reformës së arkitekturës së sigurisë ndërkombëtare, së dyti, në ato çështje që i përkasin natyrës evoluese të së drejtës ndërkombëtare, dhe së treti, në çështjet lidhur me praktikat eksperimentuese me format e reja të rregullimit në Kosovë dhe me gjerë në regjionin Ballkanik"[53].

---

[48] Alex Danchev, *Gardening*, in: "Kosovo: The Politics of Delusion", edited by Michael Waller et al. (London, Portland, OR: Frank Cass 2001), pp. 95-98.

[49] Po aty, pp. 95-96.

[50] Po aty, pp. 95-98.

[51] Patric Thornbery, *Come, friendly bombs*, in: "Kosovo: The Politics of Delusion", edited by Michael Waller et al. (London, Portland, OR: Frank Cass 2001), pp. 43-58.

[52] David Chandler, "Kosovo and the Remaking of International Relations, Rewiew Essay", *The Global Review of Ethnopolitics* 1 (2002), p. 111.

[53] Po aty, p. 110.

Lidhur me të parën, reformën e arkitekturës së sigurisë ndërkombëtare, në lidhje me trajtimin e krizës së Kosovës për shembull, do të mirren dy teoritë pozitiviste si realizmi dhe liberalizmi. Kurse me çështjet që bien në kuadër të sferës së dytë dhe të tretë, do të reflektojë kryesisht teoria kritike ndërkombëtare si një teori e llojit post-pozitivist.

KREU I:
INTERPRETIMI TEORIK I NDËRHYRJES USHTARAKE TË NATO-s NË KOSOVË DHE I SISTEMIT TË ADMINISTRIMIT TERRITORIAL TË OKB-së

1.1 Ndërhyrja ushtarake e NATO-s dhe ndërkombëtarizimi i problemit të Kosovës: rasti i Kosovës në teoritë e Marrëdhënieve Ndërkombëtare

Lidhur me nevojën praktike të përdorimit të llojeve të ndryshme të teorive të Marrëdhënieve Ndërkombëtare për studimin e ngjarjeve në marrëdhëniet ndërkombëtare, teoricienët si Bull, e ndajnë përshtypjen se një plan i kompletuar teorik duhet të përbëhet nga të dyja llojet e teorive, si nga ato *shpjeguese të realitetit* (pozitiviste), ashtu edhe nga ato *konstituive të realitetit* (post-pozitiviste)[54]. Poashtu, në lidhje me nevojën e përdorimit të sa më shumë teorive në planin studimor, studiuesi Wight, vlerëson se "ajo çka është shumë me rëndësi të mbahet në mend, ka të bëjë me faktin se asnjë teori nuk mund të pranohet gjithmonë si e saktë, por është debati mes tyre ai që është me rëndësi. Për Wight, e vërteta nuk është veti e asnjë teorie, por e dialogut mes tyre"[55].

Kjo ndarje, vije si rezultat i një procesi të teorizimit mbi specifikat që i karakterizojnë ngjarjet në skenën e marrëdhënieve ndërkombëtare, e të cilat janë aq dinamike, saqë vetëm një teori e Marrëdhënieve Ndërkombëtare, nuk mund t'i shpjegoj ato në mënyrën se si fillojnë, evoluojnë dhe eventualisht përfundojnë[56]. Andaj, si pasojë, përdorimi i një kuadri teorik në dimensione më të gjera, bëhet pothuajse i pa shmangshëm.

Edhe në kontekstin e studimit praktik të rastit të Kosovës në perspektivën e ndërhyrjes ushtarake të NATO-s, kemi zgjedh një qasje të kombinuar të teorive nga të dyja llojet. Si perspektiva teorike më të rëndësishme janë: realizmi, liberalizmi dhe teoria kritike. Përzgjedhja e këtyre tri teorive, është bërë me qëllim që të sigurohet një kombinim sa më adekuat teorik, konform natyrës së problematikave që e

[54] Hedley Bull, *Shoqëria anarkike:Një studim i rendit në politikën botërore*, (Tiranë: AIIS, 2010), f.9-17.

[55] Scott Burchill et al, *Theories of International Relations, 2nd. edition* (London: Palgrave, 2001), pp.22-23.

[56] Bardhok Bashota, "The role of theory of international relations in explicating global political events", *Iliria International Review, Felix–Verlag, Holzkirchen, Germany and Iliria College, Pristina, Kosovo* 1 (2011), pp. 33-46.

karakterizojnë rastin në fjalë. Siç vërehet, dy teoritë e parat janë me natyrë pozitiviste, kurse e treta është me natyrë post-pozitiviste.

Megjithëkëtë, para se të fillohet me aplikimin e secilës nga këto teori në studimin praktik të rastit të Kosovës, është me rëndësi të veçantë, që fillimisht të paraqitet një skemë e thjeshtëzuar e qëndrimeve bazë *ontologjike* dhe *epistemologjike* për secilën prej tyre.

Analizimi i rastit të Kosovës, fillon prej këndvështrimit të realizmit, si teoria e parë për nga rëndësia shpjeguese e kësaj ngjarje. Pas kësaj, teoria e dytë me radhë është ajo e liberalizmit, dhe e treta i referohet teorisë kritike.

Rasti i Kosovës në teorinë realiste: Kjo kornizë teorike e quajtur realizëm, në përgjithësi vlerësohet si një qasje relativisht konservatore[57]. Kjo pikëpamje pesimiste për marrëdhëniet ndërkombëtare formulohet sistematikisht me emërimet: "*realizëm", "real politikë", "politikë e fuqisë" ose "politikë e pushtetit".* Ndër qëndrimet bazë *epistemologjike* (njohëse) të realizmit, kanë të bëjnë me faktin se të gjitha teoritë realiste nisen nga supozimi se pasiguria është tipar universal dhe i përhershëm i rendit ndërkombëtar, në saje të karakterit anarkik të këtij të fundit. "Në mungesë të një sovrani ndërkombëtar, secili shtet do të jetë potencialisht i kërcënuar nga cilido shtet tjetër, dhe nuk do të ketë rrugëdalje për sigurinë e tij, veçse të rrokë armët për të mbrojtur vetveten"[58]. Gara dhe lufta, janë efekte anësore të pashmangshme të sistemit ndërkombëtar, jo për vetë natyrën e shteteve, por në saje të karakterit anarkik të sistemit të shteteve si tërësi. Në anën tjetër, ndër qëndrimet *ontologjike* të realizmit konsistojnë në faktin se shtetet janë akterët e vetëm më të rëndësishëm në sistemin anarkik ndërkombëtar[59]. Kjo gjë bënë të kuptohet se parimet morale dhe sociale janë relevante vetëm brenda shtetit ku siguria arrihet nga vet shteti. Projektet kosmopolitane thuhet se kanë pak rëndësi për marrëdhëniet ndërkombëtare. Mundësia për luftë është përherë e pranishme në mes shteteve, dhe sipas realistëve, shtetet vazhdimisht bëjnë lufta të tilla, edhe pse në forma të ndryshme. Thënë ndryshe, ideja e përparimit global kryesisht mungon në fjalorin e saj.

Si duket, këto qëndrime e kanë bërë realizmin një pikë të pashmangshme referimi nga shumica e studiuesve dhe për studimin e shumicës së ngjarjeve në marrëdhëniet

[57] Joshua S.Goldstein, *Marrëdhëniet Ndërkombëtare* (Tiranë: Dituria, 2003), f. 67.

[58] Francis Fukuyama, *Fundi i Historisë dhe Njeriu i Fundit* (Prishtinë: Zenith, 2006), f. 264-265.

[59] Morgenthau, *Politika Ndërmjet Kombeve…,* faqe 3-17.

ndërkombëtare. Madje, edhe atëherë kur këto vlerësime realiste u dukë se u ndodhën përballë sfidave serioze nga kritikat që erdhën prej qarqeve liberaliste, dhe atë menjëherë pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, e me përfundimin e së cilës ngjarje u besua se konfliktet në mes shteteve do të mbesin diçka e tejkaluar, megjithatë rrethanat në terren e vërtetuan të kundërtën, për faktin se konfliktet e llojeve dhe përmasave të ndryshme, edhe pas Luftës së Ftohtë, vazhduan të jenë prezente. Ato madje vetëm sa shkuan duke u shtuar, sidomos nga përpjekjet e disa entiteteve për shkëputje[60]. Një pasqyrim real i prezencës së vazhdueshme të konflikteve në sjelljet ndërmjet aktorëve ndërkombëtar është ilustrues, madje edhe një dekadë pas Luftës së Ftohtë. Të dhënat në tabelën 2, flasin qartë në këtë drejtim.

Tabela 2. Konfliktet ndërkombëtare për nga shkalla e intensitetit në vitin 2002.

Realizmi				Vetëm 35 shtete u renditën si relativisht të lira.
Konfliket Ndërkombëtare	23	79	38	
Shkalla e Intenzitetit	E Lartë	E mesme	E ultë	
Numri i Viktimave	125.000	100-1000	25-100	

Burimi: Tabela është ndërtuar nga të dhënat e një raporti vjetor të konflikteve të botës të përgatitur më 2002 nga Programi Ndërdisiplinor Kërkimor për shkaqet e shkeljes së të drejtave të njeriut (PIOM), Linden Holandë. Cituar nga Z.Brzezinski, Zgjedhja, faqe 54-55.

Sipas realistëve, krejt kjo ndodhë për faktin se një sjellje e tillë ndërmjet aktorëve ndërkombëtar, imponohet në saje të një sistemi *anarkik*. Në këtë situatë shtetet mund të mbështeten mbi *vetëndihmën*, të cilën ata e plotësojnë me aleat dhe (ndonjëherë) me fuqinë detyruese të normave ndërkombëtare. Madje duke i ndjekur interesat e tyre të veçanta (p.sh. rritjen e fuqisë) në një sistem ndërkombëtar anarkik, shtetet e prodhojnë një ndjenjë frike dhe mosbesimi reciprok, që në terma konvencionalë njihet si fenomeni i *dilemës së sigurisë*. Pas kësaj, në rrethana të tilla, varësisht se cili shtet është më i fuqishëm në këtë drejtim, ai mund të bëhet shtet me fuqi *hegjemoniste*, i cili më pastaj vet, apo në aleancë me të tjerë, mund të *përdorë forcën* (si njësi e fuqisë) për t'i imponuar qëndrimet e veta.

[60] Zbigniew Brzezinski, *Zgjedhja: Dominim Global apo Udhëheqje Globale* (Prishtinë: Zenith, 2006), faqe 54-55.

Kjo logjikë dhe këta terma, përdoren nga realistët edhe në shpjegimin e zhvillimeve të lidhura me rastin e Kosovës. Para së gjithash, vëmendje e veçantë u kushtohet rolit të tre faktorëve kryesorë si: *dilema e sigurisë*, *fuqia e shtetit hegjemon*, dhe tek *roli i vazhdueshëm i forcës ushtarake* në sistemin ndërkombëtar. Ilustrimi i këtyre aspekteve është shumë i rëndësishëm në lidhje me shpjegimin e krizës së Kosovës nga këndi i një realisti. Por, megjithatë, ka shumë mënyra në të cilat kriza e vitit 1999 në Kosovë mund të paraqitet një sfidë për realizmin tradicional.

Fokusimi i shpjegimeve të realizmit mbi faktorët ndikues si dilema e sigurisë dhe konfliktet ndëretnike, është shumë i rëndësishëm, sidomos në lidhje me gjetjen e shkaqeve të konfliktit në Kosovë. Në këtë drejtim, mund të thuhet se shpjegimet në prizmin e dilemës së sigurisë lidhur me rastin e Kosovës, kishin të bënin pak a shumë me kombinimin e dy qasjeve. Së pari, ishte qasja *"brenda duke shikuar jashtë"*, e së dyti, qasja *"jashtë duke shikuar brenda"*.

Në prizmin e qasjes së parë, dilema u shkaktua nga zhvillimet ndërmjet grupeve etnike kuazi shtetërore në Kosovë, e sidomos ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës, e që më vonë reflektoi në zhvillimet e jashtme në sistemin ndërkombëtar.

Nga këndvështrimi realist i dilemës së sigurisë, kjo qasje mund të shpjegohet sipas modelit që ofron Posen dhe që është mjaft i përshtatshëm për ta analizuar edhe rastin e Kosovës. Posen sygjeron se shkaqet potenciale që mund të qojnë drejt një konflikti ndër etnik, varen në shumë aspekte nga shkalla e intensitetit të dilemës së sigurisë. Kjo shkallë mund të matet me llogaritjen e *aftësisë sulmuese* të secilit grup në raport me njëri-tjetrin. Kurse vetë kjo aftësi, para së gjithash, varet nga dy faktorë: kohezioni ndërveprues brenda radhëve të grupit etnik përkatës, në njërën anë, dhe me aftësi ushtarake të atij grupi, në anën tjetër[61]. Në rastin e Kosovës, ky shpjegim mund të mbështetet në disa rrethana faktike. Ndër këto rrethana, më e rëndësishmja që është vlerësuar nga shumë qarqe, lidhet direkt me fjalimin famëkeq të Slobodan Millosheviçit, të vitit 1987, para një mase të madhe të demonstruesve serbë të Kosovës. Ai përdorte retorika nacionaliste[62] të nxitjes së urrejtjes ndër etnike te serbët dhe i frymëzonte ata me ndjenjën e epërsisë absolute ndaj grupeve tjera etnike, e veçanërisht ndaj shqiptarëve të Kosovës. Ndër shprehjet që kanë përmbajtje të qartë

[61] Barry R. Posen, *The Security Dilemma and Ethnic Conflict*, 35 (1993), 27-47.

[62] King dhe Mason, *Paqe me çdo kusht: Si dështoi bota në Kosovë*, (Prishtina: Koha, 2006), f.54-55.

katalizatore ndaj promovimit të dilemës së sigurisë ishin ato si: "Askush nuk guxon t'ju rrahë", pastaj duke propaganduar kundër "separatizmit shqiptar", ai njëkohësisht bënte thirrje taktike për "maturi" tek protestuesit serbë[63]. Përveç kësaj, thirrje të tilla nga lidershipi serb i asaj kohe, ishin edhe më të ashpra. Njëra ndër ato ishte ajo që bënte thirrje për "goditje vendimtare kundër separatistëve shqiptarë"[64].

Shikuar sipas shpjegimit që ofron Posen në këtë kontekst, tanimë në radhët e grupit etnik të serbëve ishte rrënjosur bindja se serbët gjindeshin në rrezik. Mbi këtë perceptim, serbët filluan të vepronin konkretisht për të ashtuquajturin shpëtim të serbëve dhe ndërmorën masa sulmuese. Kjo praktikë, poashtu nuk kishte se si të mos e nxiste ndjenjën e frikës edhe te grupet e tjera, e më së tepërmi te shqiptarët etnik në Kosovë. Thënë me fjalë tjera, dilema e sigurisë tanimë ishte diçka krejt reale. Ajo u konkretizua edhe më tepër, kur regjimi serb ia suprimoi autonominë kushtetuese të Kosovës, duke ia mohuar karakterin e konstituentit të RSFJ-së. Në vazhdën e këtij epilogu, shqiptarët filluan ta organizonin një jetë paralele institucionale, konformë stilit të dilemës së sigurisë. Krejt këto ngjarje, zgjatën për aq kohë sa mbërriten në masën kritike dhe më vonë u bënë shkaku real i shpërthimit të konfliktit ndër etnik të vitit 1998-1999, për zgjidhjen e të cilit pati një reagim të llojit të veçantë nga bashkësia ndërkombëtare. Me një fjalë, u duk se qasja brenda duke shikuar jashtë po i jepte frytet e saja.

Dimensioni tjetër i delmës së sigurisë, i cili është shumë më i komplikuar dhe kërkon shpjegime më gjithëpërfshirëse, ka të bëjë me interferimin e bashkësisë ndërkombëtare lidhur me trajtesat që iu bënë krizës së Kosovës, në konsideratat që ajo paraqitej si sfidë për sigurinë rajonale dhe ndërkombëtare, ku njëherit nxjerr në pah një numër të mospajtimeve dhe mëdyshjeve për veprim unik në trajtimin e kësaj krize.

Në këtë drejtim, për gjetjen dhe analizimin e shkaqeve potenciale të konflikteve në Kosovë dhe në përgjithësi në Ballkan, realistët u referohen disa faktorëve, duke filluar nga ata individualë e deri te ata sistematikë. Për shembull, në saje të rolit të faktorëve sistematikë, edhe përkundër pretendimeve të teoricientëve liberalë për paqësimin e marrëdhënieve ndërkombëtare në botën e pas Luftës së Ftohtë, realistët mbajnë qëndrim krejt antagonist, dhe se këto zhvillime i përshkruajnë me terma të

[63] Oliver Schmitt, *Kosova-Histori e Shkurtër e një Treve Qendrore Ballkanike*, (Prishtinë: Koha, 2012), f.240.

[64] Po aty, f.240.

pastërta realiste. Realistët mbrojnë idenë dominuese se në fund të Luftës së Ftohtë dhuna ndërmjet shteteve (në formën të luftës civile dhe konfliktit etnik),vetëm sa ishte në rritje e sipër[65]. Këtë fakt, ata e arsyetojnë në saje të faktorëve sistematik e që lidhen me mungesën e patronazhit të supërfuqive ndaj regjimeve të vogla autoritative pas përfundimit të Luftës së Ftohtë. Për shembull, në kontekstin e vendeve të Ballkanit, vdekja e udhëheqësit jugosllav Tito, shembja e Bashkimit Sovjetik, dhe revolucionet demokratike që përfshinin Evropën Lindore dhe të Mesme, do të thonin gjoja se antagonizmat e vjetra etnike të mbytura nën komunizëm tani do të shpërthenin mbi sipërfaqe[66]. Si rezultat i kësaj, ishte shfaqur shkatërrimi i *rendit* që imponoi *shfaqjen e anarkisë* dhe, sipas disave, në kontekst të konceptit realist tradicional, u vë në lojë *dilema e sigurisë*, dhe për pasojë, sipas realizmit, erdhën në shprehje veprimet e *mbijetesës* dhe të *vetëndihmës.*

Mirëpo, këto shpjegime të realistëve për natyrën e sistemit ndërkombëtar, nxisin reagime mjaft konstruktive nga qarqet e liberalistëve. Në kundërshtim me realistët, të cilët e proklamojnë *dilemën e sigurisë*, teoricientët liberalë argumentojnë se sistemi ndërkombëtar funksionon me një hierarki mjaft të qartë dhe me një strukturë organizative mjaft të definuar. Këta teoricientë, sjellin shembullin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara mbi të cilën, rrjedhimisht, biejnë edhe përgjegjësitë e ruajtjes së paqes, që sipas tyre, duhet të realizohen në formë të *sigurisë kolektive*. Madje, disa argumentojnë se koncepti i sigurisë kolektive vitet e fundit është zgjeruar[67]. Aty ka fundi i Luftës së Ftohtë, rrethanat liberale të bashkësisë ndërkombëtare dhe interesat e ndërsjellta, krijuan themelet për një ide të re të quajtur sigurimi i përbashkët (apo kolektiv). Ky është një koncept sipas të cilit sigurimi i të gjithë shteteve, i atyre armiq e miq, është i ndërvarur, në mënyrë të tillë që pasiguria e një shteti i bënë të gjitha shtetet më pak të sigurta[68]. Në këtë drejtim, liberalët, si nga *funksionet, ashtu edhe nga autorizimet,* e shikojnë Këshillin e Sigurimit si organin që mbanë përgjegjësinë

[65] Collins, *Studime Bashkëkohore të sigurisë*…, f. 33-34.

[66] John Baylis and Stive Smith, *The Globalization of World Politics, An introduction to international relations,* (New Nyork: Oxford University Press, Third Edition 2005), p. 161-180.

[67] Joshua Stren, "NATO Collective Security or Defense: The Future of NATO in Light of Expansion and 9/11", *Düsseldorfer Institut für Außen- und Sicherheitspolitik (DIAS)* 32, (2010).

[68] Goldstein, *Marrëdhëniet Ndërkombëtare...,* f. 128.

kryesore për ruajtjen e paqes dhe të sigurisë ndërkombëtare. Për këtë arsye, ai është konstatuar si trup i vogël, që e përbëjnë përfaqsuesit e shteteve të mëdha, gjë që bënë të mundshme të merren vendime efektive për veprim të shpejtë"[69]. Kështuqë, koncepti i sigurisë kolektive, nga liberalizmi konsiderohet se e anashkalon konceptin e dëmshëm realist të *diplomacisë sekrete* nga e cila rrjedhin *aleancat* në mes shteteve apo obligimet tjera strategjike.

Megjthatë, shpjegimet që vijnë për rastin e Kosovës nga teoria realiste, tregojnë për pamundësinë e mënyrës së veprimit kolektiv për garantimin e sigurisë përmes institucioneve, siç është Këshilli i Sigurimit i OKB-së. Dhe rrjedhimisht, për realistët, ishte e domosdoshme që kriza e Kosovës të trajtohej njëanshëm përmes veprimeve strategjike të aleancës së NATO-s dhe diplomacisë sekrete. Thënë thjeshtë, ngjarjet që ndodhën në Kosovë dhe veprimet e bashkësisë ndërkombëtare në lidhje me këto ngjarje, vetëm sa i riafirmuan qëndrimet realiste, duke e mbajtur realizmin në piedestal të padiskutueshëm.

Shikuar në mënyrën se si u trajtua kriza e Kosovës nga Këshilli i Sigurimit, tregon qartë për joefikasitetin e ruajtjes së paqes përmes mekanizmave të sigurisë kolektive, term i cili proklamohet nga liberalizmi. Për shembull, kur Këshilli i Sigurimit i OKB-së, pasi që shprehu brengen e tij për krizën humanitare, u detyrua që me 23 shtator të vitit 1998, të miratojë Rezolutën 1199, nën Kapitullin VII të Kartës së OKB-së. Megjithatë, kjo rezolutë (UNSCR 1199)[70] nuk ishte autorizim për ndërhyrje ushtarake, në përputhje me Kartën e OKB-së, por ishte vetëm kërcënim me masa ushtarake. Së këndejmi, për një autorizim konkret për përdorimin e forcës nga ana e OKB-së, duhej një rezolutë e re e Këshillit të Sigurimit, ku pritjet për kundërshtim nga ana e Rusisë dhe Kinës ishin reale. Veprime të tilla dëshmuan qartë dilemën e fuqive të mëdha në mënyrën e trajtimit të situatës së sigurisë në Kosovë, përmes mekanizmave të sigurisë kolektive. Kjo ishte sfidë për liberalët, dhe si pasojë i përligjin mjetet dhe veprimet realiste.

Për më tepër, këto zhvillime brenda Këshillit të Sigurimit, i shtyen ShBA-të dhe aleatët tjerë perëndimorë si Britania, Franca, Italia dhe Gjermania, i ashtuquajturi "Quint", të kërkonin rrugë alternative jashtë këtij forumi ndërkombëtar të sigurisë.

[69] Zejnullah Gruda, *E Drejta Ndërkombëtare Publike, botimi i plotësuar dhe i përmirësuar*, (Prishtinë: UP, 2003), f.334.

[70] Resolution 1199 (1998), Adopted by the Security Council at its 3930th meeting on 23 September 1998.

Ata, aktivitetet e veta i zhvendosen në Këshillin e NATO-s, si një forum rajonal, ku Rusia dhe Kina nuk ishin të përfaqësuara[71]. Zhvendosja e aktiviteteve të shteteve perëndimore nga Këshilli i Sigurimit, e bëri të qartë joefikasitetin e koncepteve liberaliste të sigurisë dhe pëgjegjësisë kolektive. Kjo, madje i hoqi të gjitha dilemat, duke e bërë një gjë shumë të qartë: qarqet e ngushta ushtarake dhe diplomatike, siç ishin Këshilli i NATO-s, ishin mënyra e vetme për ta kthyer rendin në Kosovë, dhe se kjo totalisht u arrit në saje logjikës dhe mjeteve realiste. Kjo ngase i gjithë aktiviteti u krye nga NATO-ja që veproi me mjete të kulluara dhe tipike të një aleance të përshkruar nga realizmi. Madje, disa nga protagonistët kryesorë të drejtimit të aktiviteteve të NATO-s, argumentojnë se mënyra realiste e *diplomacisë sekrete* ndaj trajtimit të krizës në Kosovë ishte efikase. Madje, ka nga ata që argumentojnë se "kriza u trajtua sipas skenarit të diplomacisë së kabinetit nga shekulli XIX. Sipas tyre, fuqitë e mëdha u inkuadruan duke i shtyrë interesat e tyre vetjake nëpërmjet politikës tradicionale që udhëhiqej nga vetinteresi"[72].

Përveç kësaj, ish ministri gjerman i punëve të jashtme, Joschka Fischer, shkon edhe më tej në argumentin e tij për aplikimin e njëfarë forme të diplomacisë sekrete (veprimtari diplomatike e proklamuar nga realizmi) në drejtimin e aktiviteteve të shteteve perëndimore gjatë kampanjës së bombardimeve të NATO-s. Ai pohon se "Quint-i" ishte qendra drejtuese dhe vendimmarrëse politike në menaxhimin e luftës në Kosovë, e jo Këshilli i NATO-s. Sipas tij, "në "Quint" mirreshin vendimet joformale, dhe mbase kjo formë koordinimi ishte tejet efikase"[73].

Një tjetër dimension i trajtimit të rastit të Kosovës nën prizmin e realizmit, ka të bëjë me rolin e shteteve më të fuqishme apo hegjemoniste* në menaxhimin dhe zgjidhjen e kësaj situate konfliktuale.

---

[71]Joschka Fischer, *Vitet kuq-gjelbër: Politika e jashtme gjermane-nga Kosova e deri më 11 shtator* (Prishtinë, Koha, 2007), f. 101.

[72] Weller, *Shtetësia e kontestuar…*, f.34.

[73]Fischer, *Vitet kuq-gjelbër...*, f.165-166.

*Këtu termit "hegjemoni", nuk përdoret në konotacionin negativ, e që nënkupton përpjekjen e një subjekti për t'ia imponuar vullnetin e vet subjekteve tjera përkundër dëshirës së tyre. Këtu me termin hegjemoni, do t'i referohemi një situate në marrëdhëniet ndërkombëtare, ku pozita e një subjekti është aq e fuqishme, saqë ajo e bënë përfshirjen e këtij subjekti të domosdoshme për ta menaxhuar dhe zgjidhur një problem.

Sipas realizmit, pavarësisht rolit të rëndësishëm që luajnë institucionet ndërkombëtare në ngritjen dhe forcimin e normave dhe ligjeve, prapë se prapë, këto janë më pak domethënëse sesa shtetet e fuqishme të cilat i krijojnë ato dhe për interesin e të cilave ato shërbejnë në rend të parë. Ky konstatim, më së miri ilustrohet me shembullin vijues.

Siç dihet, me përfundimin e Luftës së Ftohtë, *Rendi i Ri Ndërkombëtar* u shpallë nga presidenti amerikan Xhorxh Bush, i cili i përfshinte katër parime: "zgjidhjen paqësore të grindjeve, solidaritetin kundër agresionit, rezerva të zvogëluara e të kontrolluara të armëve dhe trajtimin e barabartë të të gjithë njerëzve"[74]. Siç vërehet qartë, këto katër parime kanë elemente liberale, dhe si të tilla këtë koncept e bëjnë të përkrahur nga liberalizmi, gjë që ngjalli shpresën për një rend me zhvillime më paqësore në skenën e marrëdhënieve ndërkombëtare në botën e pasluftës së Ftohtë. Megjithë këtë, po qe se ky veprim shikohet nga perspektiva e një realisti, do të duhej të shtrohej pyetja se përse pikërisht presidenti Amerikan e shpalli këtë "Rend"?

Një përgjigjje përkon me atë që Kissinger pohon se në botën pas Luftës së Ftohtë, "ShBA-të janë e vetmja superfuqi që ka mbetur me kapacitetin për të ndërhyrë në cilëndo pjesë të globit"[75], dhe se ky pozicion mbizotërues i saj e ka kthyer atë në faktorin e domosdoshëm për stabilitetin botëror[76]. Në këtë kuptim, me një ton realisti, poashtu edhe Brzezinski pohon se "pozita e ShBA-së në botë historikisht është e pa shoqe"[77]. Por, disa studiues, megjithë këtë skicë të Brzezinskit me një pikë në fund, sjellin shpjegime për një arkitekturë të re të rendit botëror, duke sqaruar se trajektorja e përgjithshme e lëvizjes së marrëdhënieve ndërkombëtare në dy dekadat e fundit nga përfundimi i Luftës së Ftohtë dëshmoi për rrëshqitjen e peshës globale nga bipolariteti në unipolaritet, dhe së voni nga unipolariteti në multipolaritet[78].

Sido që të jetë, roli që kanë luajtur ShBA-të në menaxhimin e fushatës bombarduese të NATO-s në Kosovë, është treguesi më i saktë i pozitës së saj prej

---

[74] Goldstein, *Marrëdhëniet Ndërkombëtare...*, f.284.

[75] Henry Kissinger, *Diplomacia* (Tiranë: 1999), f. 805.

[76] Henry Kissinger, *A ka nevojë Amerika për një politikë të jashtme* (Tiranë: Plejad, 2003), f.12.

[77] Zbigniev Brzezinski, *Jashtë Kontrollit: Trazira që e përfshin botën në prag të shekullit XXI* (Tiranë: Elena Gjika, 1993), f.8.

[78] Blerim Reka, *The Geopolitics and Techniques of EU Enlargement* (Brussels: Aapect, 2010), p. 26.

hegjemoni. Për shembull, edhe pse Këshilli i Sigurimit nuk e kishte autorizuar intervenimin, është sygjeruar që aksioni ushtarak i NATO-s të përfaqësojë vendosjen e një modeli të ligjit ndërkombëtar për të parandaluar shkelje të mëdha të të drejtave të njeriut[79]. Sidoqoftë, sipas realizmit, kur Shtetet e Bashkuara, Britania dhe Franca vendosën që intervenimi duhet të ndodhte, gjasat për ta parandaluar këtë intervenim nga sistemi i dobët i institucionalizuar i OKB-së ishin pothuajse të pamundura. Kjo situat dëshmoj qartë se ligji është produkt i politikës, dhe *politika e fuqishme e mbizotëron* sistemin anarkik ndërkombëtar të shteteve[80]. Shikuar nga kendi i një realisti, intervenimi në Kosovë, demonstroj pozitën hegjemonike globale të ShBA-ve. Ai gjithashtu konsolidoi këndvështrimin realist se në sistemin ndërkombëtar forca ende mbetet arbitër i fundit[81].

Një konstatim shtesë për fuqinë e padiskutueshme hegjemoniste të ShBA-ve në lidhje me trajtimin dhe zgjidhjen e krizës në Kosovë, mund të nxirret nga një analizë statistikore. Në qoftë se krahasojmë se cili nga anëtarët e NATO-s ka kontribuar më shumë në raport me njëri tjetrin, qoftë me resurse njerëzore, qoftë me ato logjistike, vërejmë se ShBA-të kanë kryesuar në çdo aspekt, madje edhe duke i kundërbalancuar komplet njëmbëdhjetë anëtarët e tjerë që morën pjesë në këtë fushatë bombarduese. Një pasqyrim real është dhënë në tabelën 3.

Tabela 3. Përqindja e fluturimeve dhe e bombardimeve të kryera nga 12 anëtarët pjesëmarrës në fushatën e NATO-s.

Gjithësej mësymje: 38.400	Vetëm ShBA-të i realizuan: 23040 apo 60% të tyre	11 anëtarër tjerë i realizuan së bashku 40% të totalit apo 15360.
Mësymje sulmuese: 10.484	Vetëm ShBA-të i realizuan: 8387.2 apo 80% të tyre	11 anëtarër tjerë i realizuan së bashku 20% të totalit apo 2096.8
Municion e ajrore: 26.614	-	-

Burimi: John Baylis and Stive Smith, *The Globalization of World Politics, An introduction to international relations,* Oxford University Press, Third Edition, New York 2005, p. 161-180.

[79] Baylis and Smith, *The Globalization of World Politics…*, p. 161-180.

[80] Po aty, p.161-185.

[81] Po aty, p.161-185.

Megjithatë, edhe pse një akter me fuqi hegjemoniste ka potencial për t'i imponuar vendimet dhe veprimet e tij, ashtu siç vepruan ShBA-të në rastin e Kosovës, prapë se prapë, ata përdorin strategji dhe veprime të tjera taktike për t'i arritur objektivat e tyre. Ky fakt madje, i ka dhëne luftës në Kosovë epitetin e një "lufte moderne", ashtu siç e cilëson edhe vet gjenerali amerikan i NATO-s, Wesley Clark. Ai argumenton se "çdo ngjarje në luftën moderne (përfshirë këtu edhe të Kosovës), "ka katër komponente të veçanta dhe jo të barabarta: taktike, operacionale, strategjike dhe politike"[82]. Kjo si duket ka bërë që, përveç akterëve hegjemonë, gjithashtu edhe akterët tjerë të përdorin veprime strategjike për t'i konkretizuar interesat e tyre. Me një fjalë, sipas logjikës realiste, mund të thuhet se kriza si në rastin e Kosovës ishte arenë e involvimit dhe përplasjes së interesave dhe veprimeve strategjike të akterëve dhe entiteteve të brendshme dhe atyre të jashtme. Mbi këtë bazë, shpeshherë janë krijuar argumente në favor të ndërhyrjes strategjike të bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë, të kryesuara nga ShBA-të. Kjo mund të justifikohet sidomos në kontekstin kur për ShBA-të, i tërë rajoni i Evropës Juglindore shikohej si me rëndësi strategjike[83].

Sipas kësaj logjike, fillesat e para të vështrimit amerikan ndaj zgjidhjes së çështjes së Kosovës, si problem me interes strategjik, duhet kërkuar më herët. Për shumë studiues, ky fillim përkon me të ashtuquajturën "*Vërejtje të Kështëndellave"*, të drejtuar nga presidenti George Bush, në dhjetor të vitit 1992, në të cilën thuhej: "Në rast të shpërthimit të një konflikti në Kosovë, të provokuar nga aksionet serbe, ShBA-të do të jenë të gatshme të përdorin forcën ushtarake kundër serbëve në Kosovë dhe në territorin e Serbisë"[84].

Në favor të arsyetimeve strategjike të përfshirjes së ShBA-ve në zgjidhjen e krizës së Kosovës, vijnë edhe shpjegimet e autorëve serbë. Sipas tyre, rajoni i Evropës Juglindore mori një rëndësi strategjike për ShBA-të që prej hyrjes së forcave amerikane në Bosnjë-Hercegovinë. Meqenëse ShBA-të ishin përfshirë në hartimin dhe implementimin e procesit paqësor të Dejtonit, ishte e vetëkuptueshme që interesat amerikane për këtë pjesë të Evropës, do të mbeteshin aktuale për një kohë të gjatë. Kurse, në anën tjetër përfshirja amerikane përmes diplomacisë preventive në

[82] Wesley K.Clark, *Të bësh luftë moderne, Libri 2*.(Prishtinë: ZËRI, 2003), f. 37.

[83] Rory J.Conces, "Justifying Coercive and Non-Coercive Intervention, Strategic and Humanitarian Arguments", *Acta Analytica*, University of Nebraska at Omaha 16 (2001).

[84] Clark, *Të bësh luftë moderne...*, f.140.

Maqedoni, e kishte bërë këtë vend po ashtu një vatër strategjike nga e cila koordinoheshin pjesa më e madhe e veprimeve në lidhje me menaxhimin e krizës në Kosovë[85].

Me gjithë këto konstatime, trajektorja e arsyeshmërisë strategjike të përfshirjes së ShBA-ve, shtrihet akoma më gjerë. Një tjetër fakt relevant që është vlerësuar ta ketë shtyer administraten e presidentit amerikan Clinton ta përfshinte Kosovën në interesat e saj kombëtare, nuk lidhej vetëm me elementët humanitare. Më tepër ajo kishte ngjyrime strategjike. Në radhë të parë, ajo i referohej rrezikut të efektit domino të rrëshqitjes së konfliktit në tërë rajonin e Ballkanit, e që madje do të përfshinte edhe anëtar të NATO-s, si Turqinë dhe Greqinë[86]. E përveç kësaj shtrirje të trajektores së arsyeshmërisë strategjike në Ballkan, disa studiues tjerë, operacionin e NATO-s në Kosovë e shpjegojnë si me elemente të vazhdueshmërisë së strategjisë amerikane të Eurazisë. "ShBA që e zhvilloi Luftën e Gjirit me parimin e sigurisë kolektive të OKB-së, edhe operacionin e Kosovës e kreu me ekuilibrin e aleancave të NATO-s, që u pranua si përkufizim i misionit të ri të mbrojtjes së ekuilibrit strategjik të Evropës"[87].

Së fundi, lidhur me atë se edhe Kosova edhe rajoni ishin me shumë rëndësi strategjike për ShBA-të, dhe se mbi këtë interes ishin iniciuar edhe veprimet, nuk mungojnë as deklarimet publike të ish- zyrtarëve të lartë të shtetit amerikan. Në këtë drejtim, janë me rëndësi deklarimet e Sekretares Amerikane të Shtetit, Medleine Albright (Medlin Olbrajt), në përgjigje të kritikave ndaj disa zyrtarëve të lartë të shtetit.

Kur sekretarja Albright, akuzohej se po i orientonte politikat e jashtme më tepër drejt "parimeve humanitare", duke anashkaluar kështu "parimet strategjike" e që ishin më me shumë interes, atëherë ajo u përgjigj duke deklaruar se "për ShBA-të stabiliteti në Evropë ishte thelbësor dhe se Kosova, po t'i lihej Millosheviçit, mund të kishte destabilizuar tërë Evropën". Madje Ollbrajt u përgjigjet se tre kriteret kryesore të pëfshirjes ishin: "a) moria e pafund e krimeve; b) rëndësia e rajonit për Shtetet e Bashkuara dhe c) prania e një organizate të aftë për të zgjidhur krizën". Në rastin e Kosovës, të gjithë këta faktorë ishin të pranishëm. "Prandaj ShBA-të vendosën të

[85] Vukadinoviç, *Marrëdhëniet...*, f. 351-352.

[86] Po aty, f. 351-352.

[87] Ahmet Davutoglu, *Thellësia strategjike, Pozita ndërkombëtare e Turqisë* (Shkup: LOGOS-A, 2010), faqe 281.

udhëhiqnin dhe shumica e evropianëve vendosën t'u shkojnë pas, disa si Britania me entusiazëm dhe të tjerët me më pak qejf"[88].

Por, pavarësisht faktit që parimet strategjike i kanë ndikuar fuqishëm sjelljet e fuqive të mëdha në përfshirjen e tyre në trajtimin e krizës së Kosovës, megjithatë, një pjesë dërrmuse e autorëve, janë pak a shumë të një linje sa u përket arsyeve që i sjellin ata lidhur me ndëhyrjen e NATO-s në Kosovë. Edhe pse ata shohin se ishin arsyet humanitare ato që e shtyn aleancën të ndëhynte[89], prapë se prapë, nuk mund të anashkalohet fakti që ndëhyrja u arrit përmes mjeteve realiste, d.m.th, politikës së mbështetur te fuqia. Për më tej, arsyet që i ndoqi NATO-ja, kishin të bënin në radhë të parë me një kundërpërgjigje ndaj strategjive që i ndiqnin akterët lokalë të përfshirë në konflikt. Kështuqë, Serbia veprimet e saj i bënte si kundërpërgjigje ndaj strategjive të NATO-s, në kohën kur NATO-ja u kundërpëgjegjej strategjive të regjimit serb në terren. Pra, ashtu siç u tha më lartë, Kosova ishte arenë e përplasjes së interesave strategjke, dhe se këtu kemi të bëjmë me dy relacione të strategjive (nga jashtë drejtuar brenda dhe anasjelltas) të cilat qëndrojnë në lidhje kauzale shkak-pasojë.

Lidhur me këto përpjekje strategjike të palës serbe në njërën anë dhe bashkësisë ndërkombëtare në anën tjetër, mund të thuhet që secila nga këto palë tentonin ta vendosnin njëra-tjetrën para "aktit të kryer".

Në argumentim të këtij konstatimi, Stoessinger do të shprehej se një nxitës përshpejtues për NATO-n drejt fillimit të bombardimeve, ka qenë i justifikuar mbi bazën e dy argumenteve. I pari kishte të bënte me synimin për një reagim imediat në parandalimin e regjimit serb në kryerjen e masakrave të tmerrshme mbi popullatën shqiptare në Kosovë, kurse i dyti, kishte të bënte me përpjekjet e NATO-s në ndalimin e këtij regjimi për ta realizuar një "plan strategjik: të quajtur "Patkoi i Kalit" që synonte spastrimin etnik të shqiptarëve, me qëllim të provokimit të një situate aq të rëndë humanitare, saqë do ta detyronte NATO-n t'i ndalte bombardimet. Siç do të shprehej më tej Stoessinger, "në përputhje me emrin e koduar të tij, Millosheviçi planifikonte t'i mbyllte shqiptarët brenda një patkoi gjigant kali dhe pastaj t'i detyronte ata të iknin nga Kosova. Shkatërrimi i pasurisë së tyre dhe të gjitha

[88] John G. Stoessinger, *Përse Kombet Shkojnë në Luftë,* Instituti i Studimeve Ndërkombëtare (AIIS: Tiranë, 2007), f.159.

[89] Hehir, *Humanitarian Intervention after Kosovo…,*2008; J.L. Holzgrefe & Robert O. Keohane (eds.), *Humanitarian Intervention: Ethical, Legal and Political Dilemmas,* (USA&UK: Cmbridge University Press, 2003), PP.13-90.

dokumenteve të identifikimit do të garantonin që ata të mos ktheheshin dot kurrë. Me dy fjalë, Kosova do të "spastrohej" nga myslimanët me qëllim që të sigurohej *lebensraum* (hapsirë jetsore) për ardhacakët serbë. Adolf Aihmani, njeriu i ngarkuar me dëbimin e hebrenjëve gjatë regjimit nazist, ka gjasa ta kishte vlerësuar madhësinë e Operacionit Patkoi i Kalit"[90].

Këtu vërehen qartë se arsyet që e shtynë NATO-n të reagonte, ishin me karakter humanitar, por që u realizuan me mjete realiste, e që gjithashtu, e kundërshtuan një veprim tjetër realist të përdorimit të mjeteve të dhunshme, por që ky i fundit ishte amoral.

Shikuar në planin strategjik të përdorimit të realpolitikës, Stoessinger bën të qartë se "fushata çnjerzore e Millosheviçit kishte tre qëllime kryesore". Fillimisht synohej demolmimi dhe defaktorizimi i UÇK-së, pastaj deballancimi etnik në Kosovë në favor të serbëve, dhe përfundimisht, mposhtja e NATO-s [91].

Përveç këtyre dy elemnteve, në kontekstin e rastit të Kosovës, realistët janë shumë të interesuar edhe për rolin e *luftës dhe përdorimit të forcës ushtarake në sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare.*

Lidhur me rolin dhe karakteristikat evoluese të luftës dhe fuqisë ushtarake, studiuesi Brezezinski, thekson se "në kontrast me epokën tradicionale ndërkombëtare, kur luftërat deklaroheshin në mënyrë formale dhe ndaleshin po në të njejtën mënyrë, sot ato shikohen si një sjellje abnormale, më shumë si kriminalitet i brendshëm". Ky realitet i ri në skenën e politikës ndërkombëtare sipas Brezezinskit, paraqet njëfar lloj të progresit. Megjithatë, sipas tij "në epokën e globalizimit "lufta" ia ka lëshuar vendin konflikteve joformale, të gjera dhe shpesh anonime, përgjigjja ndaj të cilave nganjëherë përfshin reagime të tipit "polic", siç ndodhi në Kosovë në vitin 1999"[92].

Sipas realizmit, u bë mëse e vërtetë që intervenimi i NATO-s në Kosovë, nënvizon lidhjen e vazhdueshme, në vend të vjetërsimit të përdorimit të forcës ushtarake në zgjidhjen dhe parapërcaktimin e shumë situatave konfliktuale në skenën e marrëdhënieve ndërkombëtare.

Për shembull, gjenerali Clark, hedhë prognoza lidhur me mundësitë reale të rishfaqjes së luftërave në të ardhmen (edhe pse në trajta moderne). Për Clark, mbetet

---

[90] Stoessinger, *Përse Kombet Shkojnë në Luftë...*, f.154-155.

[91] Po aty, f.156.

[92] Brzezinski, *Zgjedhja...*, f.28.

fakt i pa kontestueshëm që forca ushtarake do vazhdojë të mbetet arbitër në çështjet ndërkombëtare. Ai sjellë dëshminë "që diplomacia dhe procesi i marrëdhënieve ndërkombëtare, gjithmonë ka kërkuar përdorimin e influencës dhe të forcës, të përdorura për të realizuar fitim apo për t'u mbrojtur nga humbjet"[93].

Duke u nisur nga fakti se realistët nuk shqetësohen aq tepër për parimet morale, ata zakonisht nuk janë mbështetës të intervenimit humanitar. Siç dihet, para vendimit të NATO-s për të filluar bombardimet në Kosovë, ish Sekretari i Shtetit të SHBA-ve, dhe njëri nga realistët më prominent të politikës së jashtme, Henry Kissinger, ishte kundër intervenimit të NATO-s[94]*. Ai madje kishte argumentuar në disa qarqe mediale se asnjë interes vital politik apo strategik i Shteteve të Bashkuara nuk ishte rrezikuar në konfliktin e Ballkanit. Sipas tij, përfshirja e Shteteve të Bashkuara do të kushtonte shumë dhe do të merrte kohë[95]. Dhe, sipas Kissingerit, edhe kur, më në fund NATO ndërhyri, ajo e bëri këtë me të njejtën ambivalencë që kishte karakterizuar sjelljen e saj të mëparshme. Sipas tij, "propozimet e Rambujesë nuk lanë zgjidhje tjetër përveç luftës. Në të njëjten kohë, NATO mbeti mjaft e angazhuar në nocionet vestfaliane të sovranitetit për të përsëritur që ajo e konsideronte Kosovën si pjesë e Jugosllavisë. Dhe ajo e përfundoi këtë luftë duke mishëruar këtë angazhim preciz në rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, që i dha fund luftës"[96]. Për më tej, me një gjuhë të ashpër realiste, Kissinger argumenton se "realitetet e Ballkanit kanë imponuar në vetvete një bravado morale të diplomacisë së re". Ai shton më tej, se sa i përket rolit të NATO-s në Bosnje dhe Kosovë, pas përfundimit të futës në këto vende, mund të tërhiqet një paralele krahasimi me pozicionin e mëparshëm të perandorive Austriake dhe Osmane në këtë rajon. Madje sipas tij, ky rol ka të bëjë me përpjekjet për impononinin, një armpushim ndërmjet fraksioneve etnike rivale. Madje, përveç kësaj, vlerësimi i tij më ekstrem i referohet pranisë së NATO-s, me synimin parësor për të

[93] Clark, *Të bësh luftë moderne...*, f. 38.

[94]* Kissinger shtonte se "Dokumenti i Rambujesë, e cili i bëri thirrje Serbisë që të pranojë trupat e NATO-së në të gjithë Jugosllavinë, ishte një provokim, një justifikim për të filluar bombardimet (...) Rambujeja ishte një dokument i tmerrshëm diplomatik që asnjëherë nuk do të duhej paraqitur në atë formë". Shih më tej në: *Daily Telegraph*, 28 June 1999. Avaliable: http://www.david-morrison.org.uk/kosovo/kosovo-humanitarian-catastrophe.htm

[95] Baylis and Smith, *The Globalization of World Politics…*, p. 161-185.

[96] Kissinger, *A ka nevojë Amerika për një politikë të jashtme...*, f.409-410.

“imponuar një protektorat tradicional në këto zona që ajo qeverisë, sesa të vërë në zbatim një moralitet të ri”[97].

Realizmi dhe realistët, gjithnjë janë më të gatshëm për të përdorur forcën në marrëdhëniet ndërkombëtare, dhe kryesisht këtë forcë këta e shohim si mjetin më adekuat (një e keqe e domosdoshme) për realizimin e qëllimeve të caktuara, madje edhe për hir të ruajtjes apo kthimit të paqes.

Se sa ka rëndësi përdorimi i forcës dhe se sa aktual është përdorimi i saj në sjelljet e akerëve ndërkombëtarë, shihet qartë edhe nga gatitshmëria e entiteteve dhe e akterëve më pak të fuqishëm për ta përdorur atë në mënyrë që t’i realizojnë objektivat e tyre. Madje, shpeshherë ndodhë që edhe të pafuqishmit e kanë njëfarë fuqie ndikuese mbi akterët më të mëdhenjë dhe më të fuqishëm. Ata e fuqizojnë “pafuqishmërinë” e tyre duke e shfrytëzuar një lloj “vlerë bazë” (për shembull stabiliteti dhe paqja rajonale dhe ndërkombëtare) që për të fuqishmit është shumë e rëndësishme. Ky është konceptimi i fuqisë së të pafuqishmëve.

Për shembull, përgjatë luftës në Kosovë, shikuar nga indikatorët tradicionalë të fuqisë, Serbia ishte një akter shumë i fuqishëm përballë Kosovës, ku kjo e fundit, rrjedhimisht ishte në pozitën e të pafuqishmit. Por, sipas po këtyre indikatorëve, në krahasim me fuqitë tjera si ShBA, BE Rusi etj., të dy palët, si Serbia ashtu edhe Kosova ishin në pozitën e akterëve të pafuqishëm. Por, situata u bë e ndryshme kur u kalkulua përmes indikatorëve tjerë, siç ishin “vlerat bazë”, e që lidheshin me paqën dhe stabilitetin rajonal dhe më gjerë. Mundësia e kalkulimit me këtë vlerë bazike nga këta aktorë ballkanikë, ishte një mundësi e mirë për t’u dhënë atyre një lloj fuqie ndikuese ndaj akterëve tjerë ndërkombëtarë më të fuqishëm. Kështu, meqenëse prej Kosovës dhe Serbisë, nga të fuqishmit kërkohej ruajtja e paqes në rajon si “vlerë bazë”, atëherë kjo do të thoshte se këto vende kishin një lloj ndikimi mbi ata më të fuqishmit, sepse fundja, ata mund të prishnin paqen në këtë rajon. Kjo lloj fuqie tanimë ishte edhe në duart e palës kosovare dhe mund të shihej si një mjet ndikimi për të. Kjo ngase, “për aq kohë sa mendohej se këtë vlerë e kishte në dorë Serbia, por jo Kosova, pazaret zhvilloheshin me të dhe të fuqishmit i ofronin ruajtjen e sundimit mbi Kosovën (vlerë që e kërkonte Serbia), ndërsa vetë marrin paqen (vlerë që dëshironin të fuqishmit). Me fillimin e veprimtarisë ushtarake të shqiptarëve në Kosovë (UÇK-së) u tregua se edhe ajo mund të prishë paqen, vlerën që dëshironin të fuqishmit. Prandaj

[97] Po aty, f. 409-410.

nëse duan të marrin nga kjo vlerë, duhet t'i japin Kosovës diçka nga vlera që e dëshironte dhe që gjendej nën kontrollin e të fuqishmëve: diçka si pavarësia prej Serbisë". Prandaj, mund të nxirret një konstatim i thjeshtë logjik që në indikatorët tradicionalë të fuqisë, Kosova nuk ishte e fuqishme, por fillimi i aplikimit të strategjisë ushtarake nga pala kosovare, dhe frika e e përhapjes së luftës edhe jashtë kufijve të Kosovës në vendet tjera të Ballkanit, i bënë fuqitë e mëdha më të interesuara për zgjidhjen e problemit të Kosovës. "Nga ky interes i të fuqishmëve, Kosova dilte si një akter "i fuqishëm" përballë Serbisë"[98].

Rasti i Kosovës në teorinë e liberalizmit: Liberalizmi është teoria më e vjetër e studimit të MN. Ajo është po aq e vjetër sa edhe vetë realizmi. (Natyrisht, vetë idealistët apo liberalistët nuk e shikojnë përvojën e tyre si joreale). Kjo pikëpamje optimiste mbi Marrëdhëniet Ndërkombëtare, është formuluar dhe sistemuar me emërtime si: "liberalizëm", "idealizëm", "alternativë e realpolitikës", "moralizëm", dhe shpeshherë edhe si "utopizëm"[99].

Epistemologjia e dhënë për liberalizmin, ka të bëjë me atë se idealizmi e vë theksin më shumë te e drejta ndërkombëtare, morali dhe organizatat ndërkombëtare, sesa vetëm te pushteti, duke i vështruar ato si faktorë kyç në ngjarjet ndërkombëtare. Idealistët e vështrojnë sistemin ndërkombëtar si të mbështetur mbi një bashkësi shtetesh, të cilat kanë mundësinë të punojnë së bashku për të kapërcyer problemet e përbashkëta, "po ashtu siç do të bënin fqinjët e një qyteti të vogël"[100].

Nga këtu buron optimizmi për paqe dhe përparim njerëzor në organizimin e marrëdhënieve ndërmjet kombeve, synim i cili është në qendër të fjalorit të liberalizmit. Mbi këtë bazë, liberalistët promovojnë tregtinë e lirë, lirinë e individit, rendin botëror e shohin të funksionojë si hierarkik, urdhërojnë për diplomaci të hapur dhe siguri kolektive. Demokracia, sipas tyre, është forma ideale e qeverisjes, për të gjitha shtetet e botës, në mënyrë që nga kjo të arrihet paqja universale[101]*. Pra, përfaqësuesit kryesorë të liberalizmit janë kosmopolitan[102].

---

[98] Feraj, *Shkenca Politike...*, f 151.

[99] Goldstein, *Marrëdhëniet Ndërkombëtare…*, f. 117.

[100] Po aty, f. 67.

[101]* Këto premisa janë esenciale për konsolidimin e platformës ideore të teorisë së Paqës Dekokratike, sipas së cilës teori, Demokracitë e pjekura nuk shkojnë në luftë me njëra-tjetrën, për faktin që duke qenë në esencë demokratike, ato antagonizmat e tyre i

Në anën tjetër, qëndrimet ontologjike të liberalizmit janë shumë të ndryshme me ato të realizmit. Për dallim nga realizmi, bazën ontologjike të të cilit e paraqesin sistemi anarkik ndërkombëtar dhe shteti si subjekti kryesor apo i vetëm i këtij sistemi, për liberalizmin këto qëndrime janë shumë relative.

Tradicionalisht, liberalët kanë ofruar katër drejtime kryesore kritike kundër këtyre tezave të realistëve, drejtime të cilat paraqesin njëherit qëndrimet *ontologjike* të liberalizmit. Për shembull: a) "Teza themelore e *anarkisë* ndërkombëtare është pjesërisht e vërtetë[103]; b) Liberalët kritikojnë idenë për shtetet si *akterë të vetëm*, të cilët kanë vetëm një grup interesash të lidhura me njëra-tjetrën; c) Koncepti i *arsyeshmërisë*[104]* është problematik; d) Së fundi *forca ushtarake* si një formë ndikimi nuk duket pothuaj po aq e rëndësishme sa mendon realizmi"[105].

Liberalizmi e përqendron theksin më shumë te e drejta ndërkombëtare, morali dhe organizatat ndërkombëtare, sesa vetëm te pushteti, duke i vështruar ato si faktorë kyç në ngjarjet ndërëkombëtare. Sa i përket studimit të rastit të Kosovës, liberalistët kanë qëndrime radikalisht të kundërta me realistët. Këta e koncetojnë në mënyrë krejt të kundërtë nga realizmi mënyrën e organizimit dhe ruajtjes së sigurisë ndërkombëtare. Në tjetër mënyrë e shjegojnë edhe ndërhyrjen humanitare dhe doktrinën e sovranitetit shtetëror, i japin tjetër kuptim përdorimit të forcës, dhe poashtu, flasin për natyrën bashkëpunuese të shteteve dhe akterëve të tjerë ndërkombëtarë që funksionojnë në formë kolektive.

Rrjedhimisht, liberalizmi edhe rastin e Kosovës e trajton me termat që i qaset studimit të marrëdhënieve ndërkombëtare në përgjithësi. Por, lidhur me studimin e këtij rasti, këtu fokusohemi kryesisht në tri pika: në *rëndësinë e normave ndërkombëtare rreth intervenimit humanitar*, në *rëndësinë e sistemit të sigurisë*

---

tejkalojnë me anë të bashkëbisedimit dhe mirëbesimit reciprok. Kjo pikëpamje zhvillohet në linjën "Brenda duke shikuar jashtë".

[102] Gerald F.Gaus, *Justificatory Liberalism*: *An essay on Epistemology and Political Theory* (USA: Oxford University Press, 1996), p.296.

[103] David Fidler, "A Theory of Open-Source Anarchy*", Indiana Journal of Global Legal Studies* 15 (2008).

[104] Asryeshmëria paraqet një koncept, i cili sipas realistëve, i justifikon veprimet e shteteve si aktor racional. Por, lireralistët e kritikojnë një koncept të tillë, sepse sipas tyre, shtetet nuk bëjë edhe aq punë të mira në përpjekje për ti realizuar interest e tyre objective.

[105] Goldstein, *Marrëdhëniet Ndërkombëtare…*, f.118.

kolektive dhe të veprimit të koordinuar shumëpalësh, si dhe në *rëndësinë e ligjit ndërkombëtar në përgjithësi*.

Është mëse e qartë se zhvillimi i *normave lidhur me intervenimin humanitar* mund ta mbështesë liberalizmin dhe ta bëjë atë një sfidë serioze për shpjegimet realiste dominante të politikës botërore. Kjo është pika që u theksua më lartë, e që ka të bëjë me pretendimet e teorive për t'i arsyetuar qëndrimet e tyre në mënyrë vlerore. Për shembull, realistët i shikojnë pikëpamjet e tyre si shumë ideale, në të njejtën kohë kur liberalët i konsiderojnë qëndrimet e tyre si tejet reale.

Megjithatë, sado që liberalët e proklamojnë avancimin dhe maturinë e normave dhe institucioneve ndërkombëtare në lidhje me rregullimin e marrëdhënieve ndërkombëtare, megjithatë, rrethanat reale flasin për jo efikasitetin e tyre në zgjidhjen e shumë situatave, sidomos ato me karakter problematik siç është rasti i Kosovës. Ka mjaft shembuj ku tregohet pafuqia e institucioneve dhe rregullave të tyre në zgjidhjen e disa kontesteve politike. Dhe si pasojë e kësaj, veprimet realiste kanë ardhur shpeshherë në shprehje dhe janë treguar si mjeti i vetëm vendimtar dhe efikas. Në këtë drejtim, ka shumë autorë që sjellin prova se veprimet realiste kanë qenë të vetmet mjete që kanë treguar efikasitet në zgjidhjen e problemeve, dhe që njëkohësisht kanë treguar për paefektshmërinë e institucioneve dhe normave apo parimeve ndërkombëtare në lidhje me zgjidhjen e këtyre problemeve.

Edhe lidhur me rastin e Kosovës, Fischer për shembull, argumenton se bombardimet e NATO-s ishin mjeti i fundit dhe i domosdoshëm për ta zgjidhur krizën e Kosovës. Këtë konstatim ai e mbështetë nga përvojat e mëparshme në terren, ku sipas një prononcimi të tij në një forum, me të cilin u drejtohej atyre zërave që ishin pro ndërprerjes së bombardimeve të NATO-s, ai deklaroi se ishte një qasje e gabuar ajo për çka ata bënin thirrje. Duke u sjellur argumente në shifra, ai përmendi faktin që udhëheqësi jugosllav, Millosheviç, nuk i përfillte fare rrugët dhe presionet diplomatike në pothuajse as njërën prej krizave të shpërbërjes së Ish-RSFJ-së. Fisher shprehej më tutje se: "kam shikuar se nga tetëdhjet e një (81) armëpushimet e nënshkruara nga Millosheviçi që nga viti 1993, ai ka respektuar vetëm të fundit (atë pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Dejtonit)! I tërë ky epilog u ka kushtuar me jetë qindra mijëra njerëzve në Bosnjë-Hercegovinë dhe në rajonet e tjera". Përveç kësaj, Fischer numëronte "të shtatëdhjetë e tri (73) rezolutat që OKB-ja, i kishte aprovuar", duke përfshirë këtu edhe Rezolutat 819 (1993) dhe 824 (1993), përmes të cilave OKB-ja i kishte shpallur gjashtë zona të mbrojtura për refugjatët myslimanë në Srebrenicë,

Zhepë, Gorazhd, Tuzëll, Sarajevë, Bihaq, dhe brenda të cilave u kryen masakrat më të tmerrshme kundër njerëzimit, pas Luftës së Dytë Botërore[106].

Së këndejmi, liberalistët argumentojnë se edhe pse pavarësisht asaj që kishte skepticizëm të arsyeshëm lidhur me aftësinë e normave dhe institucioneve ndërkombëtare, për ta zgjidhur krizën e Kosovës me anë të mjeteve të diplomacisë së hapur, megjithatë ka vend për optimizëm në lidhje me mundësinë për përsosjen e mëtutjeshme të së drejtës ndërkombëtare, e veçanërisht të asaj humanitare. Gjithashtu, liberalët argumentojnë se pa marrë parasyshë mënyrën se si u reagua ndaj menaxhimit të krizës së Kosovës, u vërejt se u krijua një koncept i ri i së drejtës ndërkombëtare në favor të avancimit të doktrinave dhe normave të së drejtës ndërkombëtare në përgjithësi.

Në lidhje me këtë pritje optimiste, nga disa qarqe, studiuesit pohojnë me një ton liberal, se me fitoren e NATO-s kundër regjimit serb gjatë luftës në Kosovë, "në mënyrë vendimtare u krijua një koncept i ri i së drejtës ndërkombëtare". Ai mbështetej në faktin se "jo vetëm që nuk do të tolerohej persekutimi i njerëzve nga një diktator, por atij do t'i kundërviheshin". Në vazhdën e këtij argumenti, ata vlerësojnë se Rasti i Kosovës e bëri promovimin e një parimi të ri të ndërhyrjes humanitare, që pavarësisht faktit se ishte ende larg të qenit universal, megjithatë ai ishte në një fillim të mbarë. Përveç kësaj, këta studiues argumentojnë se "në agim të mijëvjeçarit të ri, ky parim ishte një pohim kumbues i Deklaratës Universale të të Drejtave të njeriut, të miratuar më shumë se një gjysmë shekulli më parë nga Kombet e Bashkuara"[107].

Pa dyshim që liberalizmi e konsideron formën *e sigurisë kolektive* si mënyrën më të mirë të mundshme për të reaguar ndaj situatave konfliktuale, të cilat e kërcënojnë paqen dhe stabilitetin ndërkombëtar. Mirëpo, ashtu si në shumë raste tjera, edhe në rastin e Kosovës, u vërejt qartë se sistemi i sigurisë kolektive, i proklamuar sipas liberalizmit, nuk funksionoi si duhet dhe për atë se kjo çështje u bllokua në Këshillin e Sigurimit për shkak të raportit të forcave në mes anëtarëve të përhershëm. Por, prapë se prapë, edhe pse nuk ishte vepruar në formën e sigurisë kolektive - në kuptimin që e proklamon liberalizmi - përgjigjja e bashkësisë ndëkombëtare në zgjidhjen e krizës në Kosovë, në njëfarë mënyre, u realizua në formën e veprimit shumëpalësh dhe pak a shumë kolektiv.

---

[106] Fischer, *Vitet kuq-gjelbër...*, f. 221.

[107] Stoessinger, *Përse Kombet Shkojnë në Luftë...*, f.168-169.

Siç vërejtëm deri tani, fakti që në ndërhyrjen ushtarake si në rastin e Kosovës ishin involvuar institucione ndërkombëtare të karakterit global si OKB-ja dhe atij rajonal si NATO-ja, krijohet nevoja për të bërë një sqarim konceptual krahasues në mes të një sistemi të sigurisë kolektive, në njërën anë, dhe një aleance ushtarake, në anën tjetër. Në këtë drejtim, Kissinger ofron një shpjegim shumë të qartë, i cili ka shumë rëndësi në kontekstin e shpjegimit të reagimit të bashkësisë ndërkombëtare në sanimin e situatës konfliktuale si në rastin e Kosovës. Në këtë drejtim, Kissinger argumenton që "(...) gjatë epokës së Klintonit, pohimet e Aleancës kishin një cilësi liturgjike që hap pas hapi e përafruan konceptin origjinal të Aleancës si kurrë më parë me doktrinën e sigurisë kolektive"[108]. Për më tepër, kjo çështje, sipas Kissingerit, nuk është vetëm një kompleks fjalësh, më tepër ajo paraqet një dallim esencial filozofik. Siç dihet, në terma konvencionalë, një aleancë ushtarake krijohet me synimin parësor të mbrojë një kauzë të caktuar, siç është një territor, dhe se ajo kufizohet brenda këtij perimetri të synuar. Në anën tjetër, "një sistem i sigurisë kolektive nuk përcakton as territorin që do të mbrohet dhe as mjetet dhe makineritë për të realizuar atë; ai është, në thelb, një koncept juridik. NATO është një aleancë; Kombet e Bashkuara janë një sistem i sigurisë kolektive". Pra, këtu vërejmë se një aleancë vepron në mënyrë aktive, duke treguar një lloj lojaliteti juridik në trajtimin e një rreziku konkret që shfaqet, kurse një sistem i sigurisë kolektive, vepron në mënyrë pasive dhe është disi më neutral nga pikëpamja juridike. Kështuqë ky i fundit, "duke mos e përcaktuar kërcënimin, ai është i detyruar që të presë derisa të shfaqet përpara veprimi e mund të merret në konsideratë"[109].

Shikuar sipas këtij kuptimi që Kissinger ofron për një aleancë dhe për arsyet që e involvojnë atë në luftë, ndëhyrja e NATO-s, si në rastin e Kosovës, në esencë përbën një përjashtim, për faktin se asnjë shtet anëtar i NATO-s nuk ishte sulmuar direkt, e që do të thotë se nuk ishte justifikuar direkt reagimi aktiv i saj. Atëherë, në bazë të këtyre interpretimeve lidhur me këtë çështje, mund të shtrohen pyetje të tilla si: Përse u involvua NATO-ja në këtë konflikt, përderisa nuk u prekën direkt interesat e saj?

Zakonisht, përgjigjet që vijnë nga liberalët lidhur me këtë pyetje, fokusohen kryesisht në argumentet, se kjo ndodhi për shkak të rritjes së intersimit të bashkësisë ndërkombëtare për të avokuar në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe

[108] Kissinger, *A ka nevojë Amerika për një politikë të jashtme...*, f. 54.

[109] Po aty, f.54.

çështjeve tjera humanitare. Edhe pse liberalët e pranojnë faktin se mënyra e reagimit ndaj shkeljes së të drejtës humanitare si në rastin e Kosovës, ishte paraqitur si një sfidë vendimtare për ta, prapë se prapë, liberalët nuk e minimizojnë angazhimin e bashkësisë ndërkombëtare për të avokuar në të mirë të mbrojtjes së të drejtës humanitare në përgjithësi.

Madje, këta argumentojnë se ishte pikërisht rasti i Kosovës, ai i cili bëri që të ndryshojnë shumë doktrina dhe parime ndërkombëtare. Rrjedhimisht, liberalët argumentojnë se ishte rasti Kosovës, ai që e bëri NATO-n të zgjedhë midis dy parimeve të intervenimit ushtarak ndërkombëtar, pra atij të *legjitimitetit* human dhe parimit klasik të *legalitetit*. NATO zgjodhi të parin, edhe pse nuk e kishte mbështetjen e ndonjë vendimi legal të Këshillit të Sigurimit.

Duke u nisur nga fakti, që sa u përket çështjeve të sigurisë, realizmi e minimizon rëndësinë e institucioneve ndërkombëtare, duke favorizur kështu një unilateralizëm në raport me multilateralizmin, liberalitët argumentojnë se shenjat e një reagimi të organizuar dhe multilateral, u dështmuan atëherë kur një koalicion më i mirë ndërkombëtar i vullnetit u bashkua dhe vendosi të veprojë për ta parandaluar situatën katastrofike humanitare në atë kohë në Kosovë. Por, veprimi multilateral në Kosovë, nga radhët e komunitetit euro-atlantik, e promovoi një dobësi të konsiderueshme të institucionalizimit të Politikës së Përbashkët Evropiane të Jashtme dhe të Sigurisë. Siç do të argumentonin disa studiues, rasti i Kosovës i nxiti lëvizjet pasuese në radhët e evropianëve "për të themeluar Forcën Evropiane të Reagimit të Shpejtë me mundësi të veprojë pa mbështetjen e Shteteve të Bashkuara"[110]. Këto masa, sipas mbështetësve të Forcës Evropiane, dështmuan një hendek shumë të thellë ndërmjet të dyja anëve të Atlantikut, përsa i përket potencialeve ushtarake. Madje, "sjellja e pakoordinuar e Aleancës, që më shumë anonte nga dominimi (hegjemonia), kontribuoi në vendimin për të rifituar disa mjete për të përligjur në mënyrë të saktë interesat evropiane"[111].

Për më tepër, shumë teoricientë liberalë, (Ramesh Thakur and Albrecht Schnabel), duke argumentuar në favor të avancimit të arkitekturës së sigurisë kolektive, argumentojnë se edhe pse "aksioni ushtarak i NATO-s u bë jashtë kornizës së Kombeve të Bashkuara, sidoqoftë, ky aksion nuk ishte opcion i pëlqyer i zgjedhjes nga

[110] Baylis and Smith, *The Globalization of World Politics…*, p. 185-204.

[111] Kissinger, *A ka nevojë Amerika për një politikë të jashtme...*, f.79.

NATO-ja”[112]. Në lidhje me këtë situatë, studiues tjerë theksojnë se ky hap u bë pasiqë Rusia dhe Kina me fuqinë e vetos në Këshillin e Sigurimit, mund ta kufizonin apo ta pengonin ndërhyrjen humanitare. Kjo madje shpjegon se pse Washingtoni dhe Londra kanë favorizuar “koalicionet e vullnetit”, jo vetëm në rastin e Kosovës, por edhe në disa raste tjera[113]. Në fakt, ata pohojnë që “edhe pse ende mungon një konsensus i plotë i anëtarëve të përhershëm të Këshillit të Sigurimit, lidhur me ndërhyrjet humanitare, aktualisht ky konsensus është shumë më i lartë në krahasim me periudhën e Luftës së Ftohtë, e po ashtu argumentojnë se ndërhyrjet humanitare janë veprimtari të pas Luftës së Ftohtë”[114].

Në saje të përpjekjeve të liberalistëve për të argumentuar në favor të avancimit të normave në lidhje me veprimin multilateral humanitar, si në rastin e Kosovës, mund të veçohet edhe potencimi i studiuesit Chandler, sipas të cilit, edhe pse pati një përdorim të forcës nga NATO-ja, jashtë kornizave institucionale të OKB-së, megjithatë kjo mund të vlerësohet si “një përpjekje për t’a kthyer autoritetin e Kombeve të Bashkuara në Ballkan, që ishte shkatërruar nën kundërshtimin e pandërprerë nga Serbia”[115]. Përballë këtyre rrethanave, OKB-ja zgjodhi që përmes funksionit të saj legjitimues *post festum*, ta mbronte autoritetin e saj si mekanizmi i vetëm ndërkombëtar i autorizuar për përdorimin e forcës. Kjo u pa qartë në rastin e Kosovës ku “konflikti në Kosovë përfundoi me rezolutën e Kombeve të Bashkuara, që duket se bëri të lajë çdo paligjshmëri të NATO-së sikurse vala në det”[116].

Një kontribut i çmuar i shpjegimeve liberaliste në lidhje me rastin e Kosovës, është përqendruar në analizimin e *rëndësisë të së drejtës ndërkombëtare në përgjithësi*, në trajtimin dhe zgjidhjen eventuale të situatave problematike dhe konfliktuale në skenën e marrëdhënieve ndërkombëtare.

Një pikë e fortë argumentuese ku mbështeten studimet liberale, sidomos përballë kritikave që vijnë nga realizmi, u referohet disa ndërrimeve në radhët e faktorëve

---

[112] Ramesh Thakur and Albrecht Schnabel, (eds.), *Kosovo and the Challenge of Humanitarian Intervention: Selective Indignation, Collective Action, and International Citizenchip* (Tokyo, New York, Paris: United Nations University Press, 2000), pp. 496-505.

[113] Chandler, *Kosovo and the Remaking of International Relations…*, pp.110-118.

[114] Shih më tej në: John Baylis et al, *Strategjia në botën bashkëkohore…*, f. 376.

[115] Chandler, *Kosovo and the Remaking of International Relations…*, pp.110-118.

[116] Po aty, pp. 110-118.

sistematik në shoqërinë ndërkombëtare të pas vitit 1945. Për shembull, së pari, fakti që ishte diskredituar sundimi kolonial me idetë e superioritetit të madh të pushtetit, dhe së dyti, pasi ishte tejkaluar nevoja për t'u përmbajtur nga konfrontimet e Luftës së Ftohtë, u bë e qartë që këta dy faktorë qendror, nuk ishin më relevantë në fillim të viteve 1990. Sipas liberalizmit, "këta faktorë reflektuan direkt në institucionalizimin e barazisë ligjore dhe politike të shteteve sovrane dhe në kufizimin e përdorimit të forcës në rastet ku konsensusi do mund të arrihej në Këshillin e Sigurimit"[117].

Në këto rrethana, Chandler thekson se meqë u shemb balanca e fuqisë e Luftës së Ftohtë, u krijua nevoja për një kornizë të re ligjore, ku reagimi ndërkombëtar si në rastin e Kosovës, kontriboj efektshëm në këtë drejtim[118]. Pra, rasti i Kosovës u bë një pikë referuese në riformulimin e linjave ndërmjet së drejtës ndërkombëtare në njërën anë, dhe fuqisë politike në anën tjetër. Përveç kësaj, siç argumenton Bell, reagimi si në rastin e Kosovës ka nxjerrë në dukje një lloj konfrontimi ndërmjet "normave të vjetra" të shoqërisë ndërkombëtare, të bazuara në balancin politik të vitit 1945 dhe të ruajtura në Kartën e OKB-së, dhe ndërmjet "normave të reja" të apeluara nga fuqitë anëtare të NATO-së [119].

Lidhur me çështjen që u theksua më lart e që ka të bëjë me faktin se rasti i Kosovës ishte katalizator në transformimin e politikave të NATO-s, dhe të transformimit të doktrinave klasike të së drejtës ndërkombëtare, mund të ofrohen shpjegime edhe në kuadër të të ashtuquajturave "tendencat supranacionale të luftës"[120]. Këto tendenca kanë të bëjnë me praktikën e ndërhyrjes së një komuniteti të jashtëm (siç është p.sh. NATO) në "punët e brendshme" të një shteti të caktuar (siç është p.sh. Serbia) dhe duke e bërë thyerjen e sovranitetit të tij, e që vjen në shprehje në disa rrethana specifike (siç janë p.sh. shkeljet e të drejtat e njeriut, si në rastin e Kosovës).

Në fakt, shikuar nga anë vepruese, tendencat supranacionale të luftës, erdhën në shprehje, vetëm atëherë kur erdhi në pyetje faktorizimi i disa mekanizmave rajonalë të sigurisë, siç ishte NATO-ja. Madje, duke pasur parasysh paaftësinë vepruese të "tendencave supranacionale të paqes" që i atribuoheshin autoritetit supranacional

[117] The Kosovo Report Conflict, *International Response...*, pp. 195-198.

[118] Chandler, *Kosovo and the Remaking of International Relations…*, pp.110-118.

[119] Cituar nga Chandler, *Kosovo and the Remaking of lR*, 2002, pp.110-118.

[120] Shih më tej në: Blerim Reka, *E Drejta e Unionit Evropian* (Prishtinë: Instituti i Kosovës për Integrime Euro-Atlantike KIEAI, 2000), f.77.

botëror, që pas LIIB-së mendohej se ishte OKB-ja, nevoja për përfshirjen e NATO-s në sanimin e krizës, në rastin e Kosovës u bë *sine qua non*.

Në këtë stad, mund të thuhet se pavarësisht të metave dhe kufizimeve në arritjen e një kompromisi politik në mes pesë anëtarëve të përhershëm të Këshillit të Sigurimit, intervenimi i NATO-s kundër Serbisë, dha edhe provën praktike se NATO-ja, si një organizatë rajonale, në disa raste mundet që "obligimet nga Kapitulli i VII i Kartës së OKB-së, t'i zbatojnë jo vetëm në rast të rrezikimit të paqes dhe sigurisë botërore a rajonale, nga konfliktet e armatosura midis shteteve por, edhe në rast të shkeljes masive dhe sistematike - të të drejtave të njeriut - deri në gjenocid, brenda një shteti"[121]. Rasti i Kosovës imponoi nevojën e rishikimit të së drejtës tradicionale ndërkombëtare në drejtim të relativizmit të parimit të sovranitetit absolut klasik shtetëror, në të mirë të mbrojtjes së sovranitetit njerëzor"[122].

Duke shikuar edhe thellë, vlerësimet për suksesin e tendencave supranacionale të luftës në mbrojtje të paqes dhe sigurisë, në disa drejtime janë vlerësuar aq lartë, saqë thuhet se ndërhyrja e NATO-s në Kosovë, e barti një mesazh të ri te hartuesit e së drejtës ndërkombëtare te cilët duhej të fillonin ta shkruanin këtë të drejtë konformë disa parimeve dhe normave të reja. Në këtë aspekt, aludohej që e parimet dhe normat e reja do të nënkuptonin shmangjen nga parimet klasike të rendit vestfalian, të cila deri në këtë rast i mbështetnin ekskluzivisht interesat e shteteve si subjektet kryesore në të drejtën dhe marrëdhëniet ndërkombëtare. Për dalim, parimet dhe normat e reja, ndër të tjera, do të mbështesnin edhe "integritetin biologjik të një kombi dhe ekzistencën fizike të qenies njerëzore"[123]. Së fundi, në këtë drejtim mund të sillen fakte se ndërhyrja ushtarake e NATO-s si në rastin e Kosovës, provoi se autoritetet dhe tendencat supranacionale (të paktën në rrafshin rajonal), po vinin duke u forcuar hap pas hapi me kalim nga shekulli XX në atë XXI.

Siç dihet, ligji ndërkombëtar ka shumë për të thënë në lidhje me rastin e Kosovës, por fokusi kryesisht bie në disa doktrina specifike të saj. Për shembull, *doktrina e luftës së drejtë*, mund të ofrojë një kontribut të rëndësishëm në shpjegimin e disa çështjeve që doktrinat dhe teoritë e tjera i lënë të mjegullta. Në të vërtetë, duke pasur parasysh shpjegimet që u ofruan më lartë, sidomos në mënyrën se si u bë përdorimi i

[121] Po aty, f.77-78.

[122] Po aty, f. 78.

[123] Po aty, f 78-79.

forcës dhe se si u realizuan veprimet luftarake të NATO-s kundër Serbisë, u vërejt se kishte pikëpamje mjaft radikale.

Për t'i nxjerrur në shesh këto pikëpamje radikale, dhe për t'i zbërthyer më tej, është e rëndësishme të përgjigjemi në pyetjen më të komplikuar që e kanë shtruar disa autorë: A ishte i drejtë dhe moral aksioni i NATO-s kundër Serbisë?[124] Përgjigjet që vijnë për këtë pyetje e që argumentojnë se aksionet luftarake të NATO-s ishin të ligjshme dhe të moralshme, qëndrimet e tyre i justifikojnë përmes doktrinës së luftës së drejtë.

Në kontekstin historik, kjo fushë e së drejtës është zhvilluar me bazë në shkrimet fetare si ato të Augustinit dhe Akuinit, të cilët kanë shkruar për teorinë e luftës së drejtë. Mirëpo, sot ligjshmëria e luftës përcaktohet nga Karta e OKB-së, e cila agresorin e nxjerrë jashtë ligjit. Kundërpërgjigjja ndaj një agresioni është i vetmi rast kur lejohet përdorimi i forcës ushtarake në përputhje me doktrinën e luftës së drejtë[125]. Ashtu si në rastin e Kosovës, edhe në shembujt e shumtë të konflikteve dhe të luftës, kategoritë tradicionale të etikës së luftës së drejtë (të zhvilluar me burime të kombinuara të bindjes fetare dhe analizës psikologjike) ende janë mjeti më i përshtatshëm i analizës morale. Forca e etikës shtrihet në kompleksitetin e vetë, në metodën shumëdimensionale të analizimit të përdorimit të forcës. Po ky kompleksitet shpeshherë e bënë të vështirë të ketë njëzëshmëri të konkludimeve. "Parimet e qëndrueshme duhet të japin zgjedhje specifike, madje edhe në pëlhurën e dendur të çështjeve morale që përbën enigmën e Kosovës"[126]*.

---

[124] Laura Wise, *Was NATO's Intervention in Kosovo in 1999 'Just'?*, e-International Relations, the world's leading website for students of international relationas, June 21, 2013: http://www.e-ir.info/2013/06/21/was-natos-intervention-in-kosovo-in-1999-just/ (Qasur me 21.08, 2012).

[125] Christine Chinkin, "The legality of NATO's action in the former republic of Yugoslavia (FRY) under international law", *International & comparative law quarterly* 49 (2000), pp. 910-925.

[126]* J. Bryan Hehir, "Kosovo: A War of Values and the Values of War", *America* 180 (1999): pp.7-12. Hehir shton se "Kosova kërkon një etikë shumëdimensionale, sepse moraliteti nuk shtrihet në një vend në këtë konflikt, të cilin disa studiues e kan quajtur "luftë e vlerave. Sfida morale për politikë ngrihet nga ndërprerja e konkurrencës së kërkesave morale. Çështja e parë e etikës tradicionale përcaktohet vetëm si çështje se: A janë vlerat në rrezik në një konflikt të veçantë të një karakteri të tillë që ndërgjegjja, marrja sistematike e jetës (dhe jetët e rrezikuara) mund të kërkohet që t'i ruajmë ato? Në

Kurse, sa u përket përkrahësve të doktrinës së luftës së drejtë, ata mbështeten në disa argumente specifike. Për shembull, studiuesi Beach, fokusohet kryesisht në tri pika argumentuese që përbëhen nga *kauza e drejtë*, ku forca mund të përdoret vetëm ndaj të keqës publike, që nënkupton, agresionin apo dhunën masive të të drejtave themelore të të gjithë popujve; *autoriteti legjitim*, ku vetëm autoritetet publike të konstituara siç duhet mund ta përdorin forcën vdekjeprurëse apo të përfshihen në luftë; dhe *qëllim i drejtë*, ku forca mund të përdoret vetëm në një çështje vërtetë të drejtë dhe vetëm për atë qëllim[127].

Prandaj, shikuar me logjikën e kauzës së drejtë, përdorimi i forcës nga ana e NATO-s, ishte i drejtë dhe i justifikueshëm, sepse ishte bërë në emër të mbrojtjes së një vlere shumë të lartë, siç është integriteti dhe dinjiteti njerëzor nga shtypja sistematike që erdhi prej regjimit serb. Me një fjalë ishte mbrojtur një kauzë e drejtë.

Për më tepër, analizuar konformë kësaj logjike, aksioni i NATO-s, bëri që të ndeshen disa nga parimet fundamentale të së drejtës ndërkombëtare me disa *opinoi juris* të teoricienëve më në zë të kësaj fushe. Siç dihet, edhe pse e drejta ndërkombëtare moderne vazhdon të thirret në parimet fundamentale të saj, të mosndërhyrjes në çështjet e brendshme të shteteve, megjithëkëtë, disa juristë sjellin mendimet se duhet të ekzistojnë limite për lirinë e veprimit në konteksin e brendshem të këtyre shteteve. Siç theksonte Oppenheim, "kur bërësit e shtetit janë vetë fajtorë për mizoritë dhe persekutimin e kombeve të tyre në atë mënyrë sa që t'i mohojë të drejtat e tyre themelore dhe ta shokojë ndërgjegjen e njerëzimit, intervenimi në të mirë të njerëzimit ligjërisht është i lejueshëm"[128].

Rasti i Kosovës në teorinë kritike: Pa dyshim, mund të thuhet se përmes kontributit të tij teorik, Marksi mbetet frymëzuesi më eminent i orientimeve ontologjike dhe epistemologjike të teorisë kritike. Ai, duke e pasuar Hegelin, i dha

---

një shkallë, tregimi i Kosovës jep një po bindëse në këtë pyetje: mbi një milion njerëz të larguar nga shtëpitë e tyre me metoda brutale të vrasjes, dhunimit, djegia dhe grabitja e fshatrave të tyre": Shih më tej në Hehir, 1999, p.7-12.

[127] James Pattison, *Humanitarian Intervention and the Responsibility to Protect Who Should Intervene?* (New York: Oxford University Press, 2010), pp. 101-112.

[128] Lassa Francis Lawrence Oppenheim: Cituar nga Nicholas Greenwood Onuf, *Humanitarian intervention: the early years*, on: http: //www. cgpacs.uci. edu/files/cgpacs/docs/2010/ working_papers/nicholas_onuf_humanitarian_intervention.pdf (Qasur me 24.08.2012).

"ngarkesë normative" aspekteve teorike për studimin e botës politike dhe sociale[129]*. Por, megjithatë, në shekullin e njëzet, teoria kritike u bë më së shumti e njohur me një trup të dalluar të të menduarit, i njohur me emrin *Shkolla e Frankfurtit*[130].

Edhepse në përgjithësi, vlerësohet se teoria kritike (në hapat fillestar të saj) ka qenë e preokupuar më tepër rreth trajtimit të çështjeve politike dhe sociale brenda shoqërive dhe shteteve të caktuara, ajo, kohë pas kohe, ka trajtuar edhe çështjet dhe problematikat edhe në nivel ndërkombëtar. Pra, duhet theksuar se përderisa teoria kritike nuk iu ka drejtuar nivelit ndërkombëtar në mënyrë direkte, kjo në asnjë mënyrë nuk do të thotë se marrëdhëniet ndërkombëtare kanë qenë ngelur jashtë sferës së saj të studimit. Në këtë drejtim, mund t'iu referohemi shkrimeve të filozofëve gjermanë, e në veçanti, Kantit dhe Marksit, të cilët kanë argumentuar se krejt çka ndodhë në nivel ndërkombëtar ka rëndësi tejet të madhe për arritjen e emancipimit universal. Pra, për teorinë kritike ndërkombëtare, megjithatë, "detyra është të shtrihet trajektorja e teorisë së *Shkollës së Frankfurtit* edhe jashtë sferës së brendshme në drejtim të asaj ndërkombëtare, ose më saktë në sferën globale"[131].

Teoria kritike ndërkombëtare, duke u mbështetur nëpër të ashtuquajturën linjë e *politikës emancipuese*, e që kryesisht kalon nëpër një stad tri pikësh, duke filluar nga Kanti te Marksi, dhe në fund deri te Habermasi, në vetvete përmban një lloj përpjekje transformuese të marrëdhënieve ndërkombëtare. Kjo lloj politike, këtë synim e orienton drejt evitimit të mundshëm "të pengesave të panevojshme për arritjen e lirisë dhe barazisë universale"[132]. Krejt këtë ndërmarrje, politikat emancipuese të teorisë

---

[129]* Nuk është vështirë që këtu të vërehet prania e temës së avancuar nga Marksi në tezën e tij të njëmbëdhjetë për Foierbahun (Feuerbach): "se filozofët vetëm e kanë interpretuar botën në mënyra të ndryshme; derisa qëllimi është të ndryshohet ajo". Shih në: http://www.marxists.org/archive/marx/works/1845/theses/theses.htm (Qasur me 23.11.2013).

[130] Scott Burchill et al., *Theories of International Relations...*, 2001, p.155. Vetëm me punën e Max Horkheimer, Theodor Adorno, Wealter Benjamin, Herbert Marcuse, Erich Fromm, Leo Lowenthal dhe më vonë të Jürgen Habermas teoria kritike fitoi një fuqi të përtërirë dhe me të cilën termi *teori kritike* filloi të përdoret si emblemë e filozofisë e cila i më pikëpyetje jetës bashkëkohore shoqërore dhe politike përmes metodës së kritikës imanente apo të brendshme: Shih në: Steven C.Roach, editor, *Critical theory and internacional relations* (Taylor & Francis Group, 2008), pp. 131-161.

[131] Roach, *Critical theory and internacional relations*,…, p. 230.

[132] Po aty, pp.155-161.

kritike e shohin si të mundur, pasiqë ato i kundërshtojnë fuqishëm pretendimet e kampit teorik pozitivist, për një dallim ndërmjet faktit dhe vlerës, si dhe objektit dhe subjektit. Pra, për dallim nga teoritë pozitiviste, teoria kritike ndërkombëtare e sheh një lidhje të afërt mes jetës shoqërore dhe proceseve njohëse. Kështuqë, "analizat origjinale të mendimit post-pozitivist të teorisë kritike të shoqërisë, duhet të na shtyjnë që të ridefinojmë se çka kuptojmë me "Teori Kritike të MN", pasi që tregon se atribuimi i post-pozitivizmit në shumë prej tyre mund të merret si *cum grano salis* (term që shënon një pikë me të cilën identifikohet diçka)"[133]. Këto kontradikta të thella që vijnë nga teoria kritike në lidhje me qëndrimet themelore të pozitivizmit, e bëjnë teorinë kritike të mbajë pozicion krejt post-pozitivist[134].

Në rafshin analitik të ngjarjeve në marrëdhëniet ndërkombëtare, është vlerësuar se synimet parësore të teorisë kritike, dhe sidomos në dallim prej teorive pozitiviste, "është të përmirësohet ekzistenca njerëzore duke hequr apo shfuqizuar padrejtësinë"[135]! Madje, ashtu siç kanë sqaruar disa studiues si Horkheimer, kjo teori nuk përfaqëson thjeshtë një shprehje të "situatës konkrete historike", por ndër të tjera, ajo e luan edhe rolin veprues si një "forcë përbrenda (asaj situate) për të stimuluar ndryshimet. Kjo e lejon intervenimin e njerëzve gjatë sajimit të historisë së tyre"[136].

Është pikërisht rasti i Kosovës ajo ngjarje në marrëdhënie ndërkombëtare mbi të cilën kursi i teorisë kritike gjen një bazë të mirë për t'i proklamuar qëndrimet e veta specifike pët të cilat edhe interesohet. Njëkohësisht, teoria kritike kontribuon fuqishëm edhe në analizimin dhe shpjegimin e një sërë çështjeve që lidhen me zhvillimet e rastit të Kosovës.

Për shembull, teoria kritike ndërkombëtare, shkaqet e krizës së Kosovës të vitit 1998-1999, i kërkon në reterospektivë, dhe përmes qasjes kritike të saj zbulon disa të meta të bashkësisë ndërkombëtare në trajtimin e ngjarjeve të marrëdhënieve

---

[133] Eduardo S. Neves-Silva, *Critical Theory and Post-positivism: IR and the significance of Philosophy*, Paper prepared for the SGIR Sixth Pan-European Conference on International Relations, Section 2, Central Concepts in IR: a meta-theoretical conversation Panel 7, Meta-theory of IR Theory Panel, Turin, 12-15 September 2007, f.1.

[134] Po aty, p. 1.

[135] Scott Burchill et al., *Theories of International Relations...*, p.157-158.

[136] Po aty, p. 157-158.

ndërkombëtare. Por, përveç qasjes retrospektive, ajo sygjeron edhe alternativa të reja të orientuara drejt politikave të emancipimit në planin perspektiv.

Për dallim nga pozitivistët, teoria kritike ndërkombëtare fillon nga bindja, se vetë proceset ndërlidhëse të jetës shoqërore janë të varura nga interesat politike dhe në saje të kësaj duhet të vlerësohen në mënyrë kritike. Mbi këtë bazë, teoria kritike pohon se marrëdhëniet ndërkombëtare janë domosdoshmërisht të kushtëzuara nga ndikimi shoqëror, kulturor dhe ideologjik, dhe njëra prej detyrave kryesore të teorisë kritike është të zbulojë efektin e këtij kushtëzimi, ashtu siç ka porositur Richard Ashley, kur theksonte se "dija gjithmon formohet si reflektim i interesave"[137].

Në lidhje me qendrimet me element kritik, të mbrojtura nga Ashley, vlen të analizohet Marrëveshja e Paqës në Dejton (1995), si një rast me të cilën iu dha fund luftës në Bosnje dhe e cila do të vendoste për shpërbërjen e Jugosllavisë. Sipas tij, mënyra se si u vendos për statusin e ardhshëm të konstituentëve të Jugosllavisë në këtë marrëveshje, nga teoria kritike ndërkombëtare, shikohet me qasje si të gabuar, dhe lidhur me këtë, qasja e teorisë kritike arrin që t'i shpalojë dhe argumentojë qëndrimet e veta kritike[138]. Pa dyshim, kritika më e madhe që i bëhet Marrëveshjes së Dejtonit (ashtu siç është vlerësuar edhe nga një pjesë e konsiderueshme e politikë -bërësve botëror), ka të bëjë me mënyrën se si ajo e trajtoi çështjen e Kosovës.

Siç do të shkruante në memoaret e tij, ministri i jashtëm gjerman Joschka Fischer, (....) gabimi më i madh që reflektoi Marrëveshja e Dejtonit në lidhje me përpjekjet për ta zgjidhur krizën politike në ish-Jugosllavi, ka të bëjë me faktin që ajo nuk e përfshiu Kosovën në agjendën e saj. Por, në saje të arsyetimeve për këtë mospërfshirje të Kosovës në trajtesat e Marrëveshjes së Dejtonit, "përkrahësit e marrëveshjes argumentojnë edhe sot e kësaj dite me të drejtë, se po të ishte përfshirë Kosova në negociata, nuk do të arrihej kurrë marrëveshja me Millosheviçin dhe Serbinë". Mirëpo, edhe kritikët, në anën tjetër të spektrit, argumentojnë gjithashtu me të drejtë, se mospërfshirja e Kosovës[139] "vetëm sa e ka hapur rrugën për luftën e ardhshme". E nga tërë kjo çka tregohet këtu në mes këtyre dy kampeve, bën të qartë se "nganjëherë

[137] Po aty, pp.160-161.

[138] Po aty, pp. 160-170.

[139] James Pettifer, *Ushtria Çlirimtare e Kosovës: Nga një luftë e fshehtë në një kryengritje të Ballkanit, 1948-2001* (Tiranë: Onufri, 2013), f. 95

diplomacia ishte përballur me detyra që nuk mund t'i zgjidhë, me situata tragjike, dhe sipas Fischer, Dejtoni ishte një situatë e tillë"[140].

Teoria kritike ndërkombëtare, duke bërë të dukshme disa neglizhime dhe paaftësi të bashkësisë ndërkombëtare në menaxhimin e krizave si ajo e Kosovës, në mënyrë të tërthortë e fajson vetë bashkësinë ndërkombëtare për shkaktimin e rrethanave që çuan në krizën e Kosovës. Kjo do të thotë se shqiptarëve në Kosovë, lufta iu është imponuar, përderisa ata nuk kishin zgjedhje tjetër alternative. Madje, kjo çështje e fuçizon argumentin e teoricientëve kritikë se "njerëzit shpeshherë nuk e bëjnë historinë sipas zgjedhjes së tyre".

Për më tepër, teoria kritike ndërkombëtare, duke u interesuar për emancipimin e sistemit ndërkombëtar, është e përkushtuar gjithashtu ta shtrijë organizimin racional, të drejtë dhe demokratik të jetës politike përtej nivelit të ngushtë shoqëror në tërë njerëzimin. [141] Sipas kësaj logjike, kjo teori gjithsesi argumenton për mos gatitshmërinë e bashkësisë ndërkombëtare për t'u përballur me sfidat e trajtimit dhe zgjidhjes së çështjes së Kosovës. Ky ngurrim ishte disi më i theksuar në lidhje me ndërhyrjen ushtarake, që dukej se ishte mjeti i fundit për sanimin dhe zgjidhjen me situatën konfliktuale në Kosovë. Këto qëndrime të akterëve dhe qendrave kryesore vendimmarrëse, në mënyrë mjaft të qartë i paraqet gjenerali amerikan Wesley Clark, duke u shprehur se kishte hezitime të hapura të disa shteteve demokratike dhe liderëve të tyre në "marrjen e hapave për përdorimin e forcës dhe rrezikimin e jetës së njerëzve" [142]. Por, përveç këtyre rrethanave, ajo çka e bënte edhe më të thellë ambivalentën e aksionit ushtarak të NATO-s në Kosovë, ishte fakti i disa zërave hezitues në radhët e aleancës, të cilët madje insistonin ta braktisnin aksionin në fjalë "në gjysmën e rrugës".

Megjithë këtë, një shpjegim i pashmangshmërisë së ndërhyrjes së NATO-s për ta menaxhuar situatën konkliktuale si në rastin e Kosovës, "kushtëzohej" direkt dhe indirekt nga dy faktorë. Faktori i parë i atribuohet efektit *domino* të kësaj situate konfliktuale; kurse i dyti ka të bëjë me vizionin *strategjik* të aleancës për t'u përshtatur me natyrën e zhvillimeve të reja në sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare.

---

[140] Fischer, *Vitet kuq-gjelbër...*, f.100.

[141] Tim Dunne et al., *Teori të Marrëdhënieve Ndërkombëtare, disiplina dhe shumëllojshëria* (Tiranë: UET Press, 2010), f.199, 211, 212.

[142] Clark, *Të bësh luftë moderne...*,f.465-466.

Në këtë drejtim, studiuesit sjellin qartësimin se paqëndrueshmëria në rajonin e Ballkanit, paraqiste një sfidë fundamentale për synimin e NATO-s në lidhje me dimensionet e sigurisë në periudhën e pas Luftës së Ftohtë. Kjo gjë bëri që, në një farë mënyre, NATO-ja të mos kishte edhe shumë alternativa për t'iu shmangur ndërhyrjes. Sipas tyre, çështjet si spastrimet etnike (siç ishte rasti me luftërat në hapësirën e ish-Jugosllavisë dhe brenda Evropës), përbënin një kërcënim të drejtepërdrejtë ndaj misionit të ri të NATO-s i cili mbështetej në vlerat. Në anën tjetër, në planin strategjik, studiuesit theksojnë se aktivitetet e programuara si zgjerimi i NATO-s ishin tërheqëse dhe të rëndësishme për këtë aleancë. Por, sipas tyre, nëse NATO-ja do t'i integronte vetëm pjesët më stabile të Europës (si Polonia, Hungaria, dhe Republika Çeke), dhe përderisa nuk bënte asgjë për ta zbutur spastrimin etnik dhe gjenocidin në Ballkan, atëherë do të kërcenohej legjitimiteti institucional i saj[143].

Shikuar nga një këndvështrim kritik, studiuesit theksojnë se fakti që NATO kishte gabuar në katër vitet e para të saj të plogështisë në Bosnje, gjithashtu kishte ndikuar tek vendimëmarrësit të cilët ishin ndeshur me çështjen e Kosovës në vitin 1998. Kjo potencohej edhe nga lidershipi ndërkombëtar i asaj kohe. Këtu vlejnë të përmenden disa nga deklarimet më të qarta të këtij lidershipi dhe për këtë kontekst. Për shembull, ish-Sekretarja Amerikane e Shtetit Albright, kishte pohuar në Mars të vitit 1998 se: "ne nuk do të qëndrojmë duar kryq duke shiquar autoritetet Serbe të bëjnë në Kosovë ato gjëra të cilat nuk mund t'i bëjnë më në Bosnje". Poashtu, deklarimet e tjera, e veçanërisht ato të kryeministrit britanez Blair dhe presidentit amerikan Clinton, ishin mjaft të gjallëruara për krijimin e normativave dhe shkakut themelor për një ndërhyrje në Kosovë. Gjatë luftës, Blair kishte deklaruar se "kjo është luftë, jo e bazuar në ambicie territoriale, por në vlera"; kurse Presidenti Clinton kishte konkluduar pas luftës, gjatë një fjalimi në Maqedoni, se konflikti i Kosovës ka treguar se: "pa marrur parasysh nëse jetoni në Afrikë apo Evropë Qendrore, apo në çfarëdo vendi tjetër, nëse ndonjëri perndjekë civil të pafajshëm dhe tenton t'i vrasë ata në masë për shkak të racës së tyre, prejardhjes, etnisë apo fesë së tyre, dhe është brenda fuqisë sonë për ta ndaluar, ne do ta ndalojmë atë"[144].

---

[143] Sean Kay, "Nato, the Kosovo war, and neoliberal theory", *Contemporary Security Policy* 25 (2004) , pp. 252-279.

[144] Po aty, pp. 252-279.

Megjithatë, edhe kur NATO intervenoi në Kosovë, teoricienët kritikë nuk heshtën. Ata tanimë ishin të përqendruar në kritikën ndaj mënyrës dhe qëllimit të intervenimit. Rrjedhimisht, për këtë teori dhe teoricientët e saj, nuk është edhe aq e rëndësishme nëse ky intervenim ka qenë legal apo jo (me këtë çshtje janë marrur liberalët, sidomos në dritën e së drejtës ndërkombëtare), se sa është me rëndësi të analizohet dhe kuptohet se cila është arsyeja dhe qëllimi i intervenimit. Pra, të qartësohet se mbi bazën e cilave parime dhe interesa është bërë ndërhyrja ushtarake e NATO-s në Kosovë.

Një pikë startuese e trajtimit të ndërhyrjes së një shteti apo komplet bashkësisë ndërkombëtare në çështjet e brendshme të një shteti tjetër sovran, mund të shenjohet nga praktikat e shpeshta deklaruese të liderëve të caktuar politikë, të cilët asnjëherë nuk kanë hezituar që të vënë në përdorim argumentet e llojeve nga më të ndyshmet. Madje ata e kanë bërë këtë me qëllimin e vetëm të justifikimit së intervenimeve në çështjet e "shteteve tjera, sesa në ato të vetë shteteve të tyre"[145]. Kjo ka qenë e domosdoshme, për faktin që një lider politik, sado të jetë legjitim brenda vendit të tij, rregullat e sistemit ndërkombëtar vestfalian bëjnë që autoriteti i tij të mbetet vetëm në suaza brenda shtetërore. Por, çka mund të thuhet për ndërhyrjen e NATO-s dhe përdorimin e forcës nga ana e saj, si në rastin e Kosovës, të cilës i mundonte autorizimi i organit kryesor supranacional të botës-OKB-së?

Ndër këto argumente që më së shumti janë përdorur për të justifikuar ndërhyrjet e faktorëve të jashtëm në çështjet e brendshme sovrane, ai strategjik, edhe ai humanitar, kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë më të debatueshmit. Kjo ngase që të dyja këto argumente "ndryshojnë jo vetëm nga objektivat që ata servojnë me njëri-tjetrin, por ato ndryshojnë edhe në kuptim të "logjikës së brendshme" të tyre[146].

Është e logjikshme se një përpjekje për ta arsyetuar ndërmarrjen e një veprimi me natyrë strategjike, subjektet e caktuara, po ashtu u referohen faktit se këtë e bëjnë me synimin për t'i shërbyer interesave po ashtu strategjike. Këto lloj interesash, për nga përmasat mund të jenë të nivelit kombëtar, rajonal apo edhe ndërkombëtar, kurse për nga natyra, ato mund të jenë kryesisht konkrete, të tilla si: politike, ekonomike, apo edhe të një natyre më të gjerë e që lidhen me çështje si paqeruajtja, pasat preventive

[145] Rory J.Conces, "Justifying Coercive and Non-Coercive Intervention, Strategic and Humanitarian Arguments", *Acta Analytica* 16 (2001), p.148.

[146] Po aty, p.148.

ndaj akteve të agresionit, etj[147]. Mirëpo, në përpjekje për ta justifikuar një veprim mbi bazën e argumentave strategji, sygjerohet se duhet pasur parasysh një numër variablash specifike e që lidhen me shtetet që janë përfshirë në veprim. "E këto variabla mund të lidhen me gjëra të cilat janë politikisht të paqëndrueshme, siç mund të jenë treguesit ekonomik dhe stabiliteti rajonal"[148]. Në vazhdën e gjithë kësaj, mund ta shohim shembullin e intervenimit në Kosovë nën dritën e argumentit strategjik.

Do të ishte shumë relative ideja, nëse do të thoshim se argumenti strategjik i ndërhyrjes në Kosovë justifikohet përmes interesit ekonomik. Por, nëse argumenti strategjik justifikohet me logjikën se ishte në interes për bashkësinë ndërkombëtare ruajtja e stabilitetit në rajon, atëherë kjo do të ishte më e qëndrueshme, sidomos nëse paqja dhe stabiliteti konsideroheshin si vlera bazë nga vendet perëndimore.

Shikuar nga prizmi i argumenteve strategjike, mund të thirremi në "Konceptin e Ri Strategjik (New Strategic Concept-NSC) të NATO-s, e cila gjatë Samitit të Washingtonit në Prillin e vitit 1999, si dhe dokumenteve tjera përcjellëse të saj, deklaroi se në të ardhmen NATO-ja ia kishte rezervuar vetës të drejtën e përdorimit të forcës sa herë që e kërkonte nevoja, madje edhe pa ndonjë autorizim formal të OKB-së[149]. Në fakt, shikuar nga prizmi strategjik, këto synime të NATO-s, si dhe vetë ndërhyrja si në rastin e Kosovës, ishin bërë me qëllimin e krijimit të një precedenti në të drejtën ndërkombëtare pa autorizimin e OKB-së dhe pa bashkëpunimin me Rusinë[150].

Atëherë, duke pasur në konsideratë edhe vetë deklarimet formale të NATO-s, nuk mbeten pa jehonë thirrjet që aksioni ushtarak i NATO-s në rastin e Kosovës ishte kryer me motive strategjike. Sidoqoftë, një skemë e argumenteve strategjike të ndërhyrjes është dhenë nga juristi Conces.

Sipas tij, nëse kriza në Kosovë paraqiste kërcënim për paqen në Evropë, atëherë ekzistimi i një Evrope stabile ishte në interesin e dyanshëm për komunitetin evropian dhe atë tej atlantik. Përveç kësaj, nëse kriza në Kosovë nuk sanohej, ajo mund të destabilizonte Maqedoninë e cila, rrjedhimisht, mund ta destabilizonte pjesën tjetër të

---

[147] Po aty, p.148.

[148] Po aty, p.148.

[149] Clara Portela, *Humanitarian Intervention, NATO and International Law: Can the Institotion of Humanitarian Intervention Justify Unauthorised Action?* Research Report 00.4, December, Berlin 2000, p. i.

[150] Po aty, p. i.

Evropës, të përbërë nga anëtarët e NATO-s, si Greqia dhe Turqia. Kjo sepse po të përfshiheshin këto dy vende në një konflikt të armatosur, apo nëse ndonjëri prej tyre do të kundërshtonte veprimin ushtarak, atëherë do të kërcënohej direkt mundësia e NATO-s për ta stabilizuar Evropën. E tërë kjo situatë e kalkuluar, ka prodhuar nevojën për një veprim ushtarak të unifikuar nga NATO-ja. Prandaj NATO-ja duhej që domosdo të merrte masa duke ndërhyrë ushtarakisht që ta kthejë rendin në Kosovë[151].

Në rastin e Kosovës, argumenti strategjik i ndërhyrjes mund të argumentohet edhe duke e analizuar në kuadër të disa faktorëve specifikë. Për shembull, për nga mënyra ai ishte *sui generis*, në aspektin kohor ishte *ad hoc*, kurse nga nevoja *sine qua non*. Argumenti strategjik i ndërhyrjes si në Kosovë, nuk është përsëritur asnjëherë dhe në asnjë situatë që madje ka mundur të jetë shumë analoge. Kjo d.m.th, që ndërhyrja ka qenë selektive. Këto rrethana e vendosën Kosovën në pozitën e subjektit që përfitoi në *kohë* dhe *hapësirë*.

Se ndërhyrja ishte selektive sa i përket rastit të Kosovës, këtë e dëshmon shumë mirë mënyra e operacionalizimit me koncepte dhe variabla[152]. Kështu për shembull, nëse variablat apo ndryshoret e rëndësishme mbesin konstante (p.sh: vendosmëria për të mbrojtur rendin dhe stabilitetin) nga një situatë ***X*** (si rasti i Kosovës) tek tjetra që involvon shtetin apo subjektin ***A*** (p.sh: ShBA-të ose NATO-n) e që ndërhynë në shtetin ***B*** (p.sh:në Serbi) në kohën ***t1*** (p.sh: me 1999), por që në situatën e njejtë ***Y*** (p.sh: në rastin e Çerçenisë) që poashtu do të duhej të involvohej subjekti ***A*** (sepse vet subjekti ***A*** deklaron se mbrojtja e rendit dhe stabilitetit është variabël konstante), por që tani nuk ndërhyn në shtetin ***C*** (p.sh: në Rusi) në kohën ***t2*** (p.sh: me 1999-2000), atëherë ndërhyrja në rastin e Kosovës ishte selektive nga ana e subjektit ***A.*** Një kalkulim i tillë me variabla, figurativisht është paraqitur në figurën 2.

[151] Conces, *Justifying Coercive and Non-Coercive Intervention...*, p.149.

[152] Kjo skemë është ndërtuar sipas modelit të paraqitur nga Conces. Shih më tej në: Conces, *Justifying Coercive and Non-Coercive Intervention...*, p.149.

Figura 2. Qasja selektive e ndërhyrjes humanitare.



Shikuar nga këndi etik, kjo nënkupton që të gjitha variablat duhet të mbesin konstante nga një situatë tek tjetra, por që kjo nuk ka të ngjarë të ndodhë gjithëherë. Shpjegimin për këtë, për teoricienët kritikë si post-pozitivistë, do të gjindej tek argumenti se edhe për këtë çështje, shkaku qëndron tek natyra evoluuese e sistemit ndërkombëtar, që vie si pasojë e ndryshimit të normave dhe parimeve të konstruktuara nga njerëzit në bazë të ineresave të tyre, interesa prej të cilave kushtëzohen edhe veprimet e tyre.

Në anën tjetër, sa i përket argumentit humanitar të ndërhyrjeve ushtarake, poashtu rasti i Kosovës paraqitet si shembull shumë i përshtatshëm. Edhe në këtë rast, skema logjike e Conces paraqitet mjaft adekuate. Intervenimi sipas kësaj skeme, mund të interpretohet në aspektin e lidhjes kauzave shkak pasojë. Për shembull, sipas kësaj skeme, pasiqë një subjekt ishte përfshirë në shkeljen flagrante të së drejtës ndërkombëtare humanitare, në veprime të tilla spastrimi etnik të një populli (ashtu siç ishte përfshirë Serbia në Kosovë), atëherë shtetet që më së shumti i promovojnë vlerat morale (siç janë ShBA-të) parimisht duhej të ndërhynte edhe ushtarakisht që ta ndalonte veprimin amoral të Serbisë[153].

Lidhur me motivet e ndërhyrjes ushtarake të NATO-s për sanimin e krisës në Kosovë, pavarësisht linjave teorike të debateve dhe argumentimeve, mund të shohim edhe qëndrimin e vetë opinionit kosovarë, i cili është matur përmes një hulumtimi empirik në terren. Shih më tej në figurën 3.

[153] Po aty, p.150.

Figura 3. Për çfarë motivesh mendoni se u realizua kjo ndërhyrje?



Përveç ballafaqimit të këtyre dy linjave paralele të parimeve ndërhyrëse, nga interpretimet kritike mund të shtrohet edhe pyetja nëse është çliruar Kosova me intervenimin e NATO-s, apo është ruajtur integriteti dhe sovraniteti territorial i Jugosllavisë?

Përgjigjjet që vijnë për këto pyetje janë shumë interesante dhe mjaft të argumentuara. Para së gjithash, ato u adresohen një numri të ekspertëve të së drejtës ndërkombëtare dhe të protagonistëve kryesorë vendimmarrës të bashkësisë ndërkombëtare lidhur me intervenimin si në rastin e Kosovës. Për shembull, ata argumentojnë se aksioni i NATO-s ishte destinuar për të bërë presion ndaj qeverisë Jugosllave që të pranonte "planin e paqes" (që parashihte Marrëveshja e Rambujesë) për Kosovën. Këtë e argumenton edhe vetë gjenerali Clark, ku sipas tij, fushata ajrore filloi me një objektiv- kthimi i serbëve prapa në negociatat e Rambujesë. Për më tepër, Clark pohon se sikur të ishte nisur që në fillim me përgatitje për intervenim tokësor, do të ishin shpëtuar shumë njerëz të pafajshëm. Ai është i bindur se "përgatitjet për intervenim tokësor e kanë bërë Millosheviçin që të dorëzohet"[154].

Në të vërtetë, NATO nuk ka qenë edhe aq e shqetësuar për të zmbrapsur sulmin e armatosur të forcave serbe mbi popullatën civile shqiptare. Edhe këtë e dëshmon Clark i cili thotë se ashpërsimi i dhunës dhe mizorive të forcave serbe pas fillimit të bombardimeve të NATO-s ka qenë krejt i parashikueshëm[155]. Andaj, Noam Chomsky

[154] Clark, *Të bësh luftë moderne...*, f.471.

[155] Po aty, faqe 400-410.

ka të drejtë kur thotë se në rast të paraqitjes së krizës humanitare, bota e jashtme ka tri mundësi: a) të veprojë për ta rënduar katastrofën; b) të mos veprojë fare; dhe c) të veprojë për ta zbutur katastrofën; Kosova i takon kategorisë së parë për arsye se: shpërngulja e afërsisht një milion njerëzve ka ndodhur pas fillimit të intervenimit të NATO-s dhe se pjesa dërrmuese e vrasjeve kudër civilëve ka ndodhur po ashtu pas fillimit të intervenimit të NATO-s[156].

Përveç këtyre trajtimeve që iu bënë rastit të Kosovës nga këndvështrimi i teorisë kritike, dhe atë përmes logjikës së politikave emancipuese, po ashtu mund të thuhet se trajektorja e politikave emancipuese të kësaj teorie, është e interesuar ta zgjerojë sa më shumë mundësinë e njerëzve për vetëvendosje[157]. Një shtytje e përbashkët e këtyre arsyetimeve është se emancipimi nënkupton kërkesën për autonomi. "Të jesh i lirë", thotë Linklater, është "të vendosësh për vete ose të kesh kapacitet për të iniciuar veprime". Qëllimi i teorisë kritike ndërkombëtare prandaj është të zgjerohet kapaciteti i njerëzve për vetëvendosje[158].

Së këndejmi, teoria kritike ndërkombëtare, rastin e Kosovës e trajton edhe në prizmin e së drejtës për vetëvendosje, duke e kritikuar njëkohësisht mënyrën se si u trajtua Kosova në raport me përpjekjen e saj për realizimin e saj. Nëse e shikojmë këtë çështje me anë të konceptimeve të teorisë kritike, vërejmë se Kosova u anashkalua nga bashkësia ndërkombëtare në shfrytëzimin e kësaj të drejte (në atë kuptim që Kosovës nuk iu mundësua të vepronte për statusin e saj, ashtu siç bënë disa nga njësitë tjera konstituive të ish-Jugosllavisë). Kritikat kryesisht fokusohen në lidhje me imponimin e vetëvendosjes së brendshme për Kosovën dhe pamundësinë e saj për vetëvendosje të jashtme, edhe përkundër faktit që në terren ishin krijuar rrethana të reja që erdhën pas ndërhyrjes së NATO-s.

Në frymën e gjithë kësaj, ka vlerësime se intervenimi i NATO-s nuk është bërë për ta çliruar Kosovën, por për ta shtrënguar palën serbe ta pranojë planin e paqes (dokumenti i Rambujesë), i cili ka garantuar edhe mbrojtjen e integritetit dhe sovranitetit territorial të Jugosllavisë (qëllimi ka qenë të ruhet paqja dhe stabiliteti

---

[156] Noam Chomsky, "Crisis in the Balkans" Z Magazine (1999): Chomsky.info. Avaliable: http://www.chomsky.info/articles/199905--.htm; Noam Chomsky, *The New Military Humanitarism: Lesson from Kosovo*, Common Courage Press, 1999, ch.4.

[157] Jill Steans et al., *An Introduction to International Relations Theory: Perspectives and Themes, Third Edition* (London%New York: Routledge, 2013), p. 121.

[158] Burchill at al., *Theories of International Relations...*, p.163.

ndërkombëtar) dhe këtë më së miri e dëshmon dokumenti i 3 qershorit i vitit 1999 (Ahtisari dhe Çernomerdini). Për më tepër, këto vlerësime shkojnë edhe më lartë në konstatimin se rezultati përfundimtar i bombardimeve të NATO-s ka qenë ruajtja e integritetit territorial të Jugosllavisë dhe si rrjedhojë Kosovës iu është imponuar "vetëvendosja e brendshme"[159]. Por, studiues tjerë si Linklater, argumentojnë të kundërtën. Ata pohojnë se duhet të pranohet se madje edhe një rezultat i negociuar i arritur nga diplomacia e NATO-së, ende do ta kishte lënë mbi 90 për qind të popullsisë së Kosovës në sundimin shtypës dhe diskriminues nën Republikën Federale të Jugosllavisë. Sipas tij, fushata ushtarake e NATO-së, jo vetëm që e çliroi shumicën e popullatës, por në njëfarë mënyre ajo kontribuoj edhe në krijimin e disa rrethanave të favorshme për shqiptarët e Kosovës, saqë ato nuk do mund të arriheshin as në kushtet e kthimit të autonomisë së para vitit 1989[160].

Sidoqoftë, pavarësisht se mund të sillen vlerësime të ndryshme në lidhje me atë se cili ishte epilogu përfundimtar i ndërhyrjes ushtarake të NATO-s, një konstatim më i qëndrueshëm mund të nxirret duke e interpretuar bazën juridike e cila solli edhe zyrtarisht fundin e luftës në Kosovë.

Siç dihet, NATO e ndërpreu fushatën ushtarake kundër RFJ-së me nënshkrimin e Marrëveshjes Tekniko-Ushtarake në Kumanovë. Kjo marrëveshje i kufizoi kompetencat sovrane të RFJ-së (apo më konkretisht të Serbisë) në Kosovë, dhe në njëfarë mënyre i riafirmoi synimet e Marrëveshjes së Rambujesë[161]. Marrëveshja e Kumanovës, përveç që shërbeu si bazë juridike për tërheqjen e forcave ushtarake të RFJ-së nga Kosova dhe vendosjen e atyre të KFOR-it, ajo njëkohësisht luajti edhe rolin e qenësishëm të një dokumenti që i parapriu nxjerrjen e një rezolute të re për Kosovën nga Këshilli i Sigurimit[162]. Pra, ashtu siç parashihej edhe në këtë marrëveshje, Këshilli i Sigurimit e miratoi Rezolutën 1244, përmes së cilës edhe zyrtarisht iu dha fund luftës në Kosovë dhe njëkohësisht Kosova u vendosë nën një

[159] Enver Hasani, *Self Determination, Territorial Integrity and International Stability: The Case of Yugoslavia* (Vienna: National Defence Academy, Institute for Peace Support and Conflict, Management), p.236-248; Enver Hasani, *How much the international law can impact in resolving of Kosovo's issue?*, Authorial article**,** 2006.

[160]Chandler, *Kosovo and the Remaking of International Relations*…, p. 115.

[161] Jure Vidmar, "International Legal Responses to Kosovo's Declaration of Independence", *Vanderbilt Journal of Transnational Law* 42 (2009), pp. 795-796.

[162] Po aty, pp. 796.

prani efektive ndërkombëtare civile të OKB-së, që u quajt Misioni i Përkohshëm Civil i Kombeve të Bashkuara në Kosovë-UNMIK. Në fakt, duke u bazuar në këto rrethana specifike, shpeshherë është vlerësuar se komplet procesi politik dhe juridik i krijimit dhe vendosjes së UNMIK-u, ka qenë karakterizuar nga një qasje imponuese:

> "UNMIK-u, ardhja e të cilit ishte rezultat i një rezolute të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, e cila ishte në fakt kompromisi në mes të NATO-s dhe Millosheviqit, dhe nga e cila u përjashtua plotësisht vullneti i popullit shqiptar, përfaqësonte organizmin institucional të neo-kolonializmit që po i ndodhte Kosovës"[163].

Bazuar në këto zhvillime që e kanë karakterizuar menaxhimin e krizës si në rastin e Kosovës, mund të themi që mënyra se si iu dha fund luftës në Kosovë dhe veçanërisht se si u bë vendosja e saj nën administrimin e OKB-së, është shembulli më unik në historinë e marrëdhënieve ndërkombëtare. Veçantia e këtij shembulli qëndron në dy karakteristika kryesore. Së pari, veçantia qëndron në faktin e lidhshmërisë së këtyre dy situatave të veçanta politike përmes një akti të përbashkët juridik ndërkombëtarë siç ishte Rezoluta 1244, kurse veçantia e dytë, lidhet me faktin që këto ngjarje qëndrojnë në lidhje kauzave të tipit shkak-pasojë. Sa i përket karakteristikës së parë, kjo u dëshmua më sipër te roli i Rezolutës 1244 në përmushjen e atyre dy funksioneve lidhur kthimin e rendit në Kosovë. Por, sa i përket faktit që këto ngjarje qëndrojnë në lidhje kauzale, kjo do të kuptohet përmes një shpjegimi shkencor të konceptit shkak, të ofruar nga Popper.

Popper sugjeron një përkufizim të *shkakut* mbi themelin e *Semantikës së Traskit*, sipas linjave që pasojnë: Ngjarja e veçantë (**A**) quhet *shkak* i ngjarjes së veçantë (**B**) atëherë dhe vetëm atëherë kur prej një bashkësie pohimesh universale të *vërteta* rrjedhë një ndodhi e materializuar, zanafilla e së cilës shënon (**A**)-në dhe ajo që vjen prej saj shënon (**B**)-në. Në mënyrë të ngjashme mund të përcaktohet koncepti i "shkakut shkencërisht të pranuar".[164] Mirëpo, lidhja e situatave të veçanta shkakësore nuk përfundon vetëm me këto dy stade (**A** dhe **B**), sepse, sipas këtij shpjegimi të ofruar nga Popper, p.sh. situata e veçantë (**B**), bëhet shkaku i një situate tjetër të

[163] Albin Kurti, Intervistë e realizuar me shkrim, "Levizja Vetëvendosje", Prishtinë, 24.02.2014.

[164] Popper*: Mjerimi i Historicizmit*...,f.124; Karl Popper, *The Logic of Scientific Discovery* (London & New York: Routledge, 2005), pp. 68-69, 318, 273-378.

veçantë (**C**), e kështu me radhë, por që p.sh. (**C**) nuk e humbë lidhjen me shkakun e parë **A**. Kjo skemë shërben për t'i shpjeguar lidhjet shkakësore edhe në rastin e Kosovës. P.sh. shpërthimi i luftës së Kosovës si ngjarje e veçantë (**A**) u bë shkak për lindjen e situatës tjetër të veçantë (**B**), që ka të bëjë me ndërhyrjen ushtarake të NATO-s, dhe pastaj vetë situata e veçantë (**B**)**,** u bë shkak për lindjen e situatës tjetër të veçantë (**C**) që i atribuohet vendosjes së Kosovës nën administrimin territorial ndërkombëtar përmes misionit të OKB-së të quajtur UNMIK.

Por, para se të analizohet rasti i Kosovës nën administrimin e UNMIK-ut (që paraqet një ngjarje të veçantë), do të bëhet një vështrim teorik ndaj sistemit të administrimit territorial të Kombeve të Bashkuara.

1.2 Vështrim i përgjithshëm mbi sistemin e Administrimit Territorial Ndërkombëtar të OKB-së dhe misioneve të saja paqëruajtëse

Studimi i rastit të Kosovës nën administrimin e përkohshëm territorial ndërkombëtar, poashtu është bazuar në logjikën shpjeguese të relacioneve fakte-teori. Siç u theksua më lart, sipas kësaj logjike, rasti i Kosovës është studiuar edhe në prizmin e atyre rrethanave që i paraprinë vendosjes së këtij territori nën administrimin e OKB-së përmes misionit të saj-UNMIK. Madje, para se të analizohet natyra e UNMIK-ut, kjo logjikë studimore është me rëndësi të përvijohet edhe në kontekstin e analizimit të fenomenit dhe modeleve të administrimit territorial ndërkombëtar. Dhe përveç kësaj, relacionet fakte-teori, janë përdorur edhe në studimin e fenomenit të paqeruajtjes në përgjithësi, si njëra nga veprimtaritë më të rëndësishme të OKB-së për krijimin e një ambienti më paqësor në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Në sfondin e të studiuarit të doktrinës së administrimit ndërkombëtar në përgjithësi, do të duhej nisur nga një premisë e thjeshtë. Kjo premisë, do ta konsideronte këtë doktrinë si një veprimtari të veçantë në kuadër të një rrjeti tejet kompleks të aktiviteteve dhe ngjarjeve në skenën e marrëdhënieve ndërkombëtare. Duke qenë se është kështu, kjo do të sqaronte se kjo doktrinë ka lindur dhe është zhvilluar në bashkëjetesë me fenomene dhe praktika të ndryshme të zhvillimeve në politikën botërore, krahas së cilave manifestohet edhe sot. Andaj, ky fenomen është shfaqur si një praktikë e re e organizimit të aktiviteteve në mes aktorëve të marrëdhënieve ndërkombëtare. Shfaqja e saj ka ardhur në një stad të caktuar të

evoluimit të rendit dhe shoqërisë ndërkombëtare të shteteve, dhe ka qenë e kushtëzuar të marrë trajta të ndryshe, në varësi nga raporti i forcave që e kanë përshkuar këtë evoluim.

Atëherë, shikuar nga një vështrim i përgjithshëm, të studiuarit e doktrinës së administrimit ndërkombëtar, do të duhej të përgjigjej në një sërë pyetjesh të tilla si: Si konceptohet ky problem i marrëdhënieve ndërkombëtare? Cili është përvijimi historik i tij? Cili ka qenë roli i tij në paqeruajtjen ndërkombëtare dhe? Si kategorizohet ai?, etj.

Shtjellimi i çështjes se çka është dhe kur paraqitet administrimi ndërkombëtar, kalon nëpër një përvijim kronologjik mjaft të gjatë. Poashtu, në planin terminologjik ka një larmi nocionesh rreth përkufizimit të këtij fenomeni.

1.3 Teoria dhe historiku i Administrimit Territorial Ndërkombëtar

Një shqyrtim teorik rreth problematikës së administrimit ndërkombëtar do të konsistonte në definimin e këtij termi (në raport me koncepte pak a shumë të ngjashme), sipas teorive të së drejtës dhe marrëdhënieve ndërkombëtare[165]. Ky shqyrtim bëhet në mënyrë që të krijohet një qartësi më e madhe në përdorimin e tij, sidomos kur dihet se një sërë konceptesh tjera janë mjaft të ngjashme dhe përdoren ndërkëmbyeshëm me këtë term.

Si nocione më të përafërta me administrimin ndërkombëtar konsiderohen të jenë: protektorati ndërkombëtar, administrimi (okupimi) ushtarak, etj. Që të dy këto koncepte janë shfaqur dhe karakterizuar si komponente përbërëse, ose si anë funksionale, që e kanë shoqëruar procesin e administrimit ndërkombëtar të Kosovës nga OKB-ja përmes misionit të saj-UNMIK.

Termi "administrim ndërkombëtar" ka qenë përdorur shpesh si zëvendësim i koncepteve tjera, të tilla si: "kujdestari" dhe "protektorat". Përderisa këto institucione janë përdorur për të përshkruar praktikën bashkëkohore të administrimeve territoriale, megjithëkëtë, secila ndryshon në drejtim të kuptimit të saktë të tyre ligjor dhe qëllimit

[165] Reth konceptimit të administrimit ndërkombëtar, shih më tepër në: Lindsey Cameron and Rebecca Everly, *Conceptualizing the Administration of Territory by International Actors*, Global Law Books- www.globallawbooks.org.

të deklaruar[166]. Termi protektorat është përdorur në mënyrë të ngjashme për të përshkruar praktikat bashkëkohore të administrimit territorial nga organizatat ndërkombëtare[167]. Megjithatë, në të drejtën ndërkombëtare, protektorati vlen vetëm në raportin shtetet protektor dhe shtet nën protektorat, ku ky i fundit me traktat i dorëzon protektorit menaxhimin e kompetencave të tij në lidhje me punët e jashtme dhe të mbrojtjes. Për shembull, rasti i Bosnjës ka qenë i përmendur si një formë e re e protektoratit, sepse sovraniteti i saj i brendshëm është i kufizuar rëndë nën prezencën ndërkombëtare[168].

Atëherë, ku dallon administrimi ndërkombëtar nga "pushtimi ushtarak"? Edhe pse të dyja këto operacione ndërmerren dhe mbështeten nga këto autoritete përkatëse dhe që njëkohësisht, secila nga këto i kanë qëllimet e tyre, megjithatë, dallimi është në atë se çfarë statusi ka njësia ndaj së cilës iniciohet administrimi përkatësisht pushtimi. Nga pikëpamja e politikës ndërkombëtare, megjithatë, ka një ndryshim të rëndësishëm: pushtimi ushtarak nënkupton pushtimin e territorit sovran nga një shtet apo grup shtetesh, që veprojnë bashkërisht dhe pa autorizimin e Kombeve të Bashkuara ose të një organi tjetër të ngjashëm[169]. Sipas Caplan, përfundimisht, administrimi ndërkombëtar dallon nga okupimi ushtarak. Por, për Caplan, vendosja e një administrate nga OKB-ja, e mbështetur nga NATO si në rastin e Kosovës-mundet të dalloj vetëm pak nga një okupim i jashtëm ushtarak[170]. Ndoshta një konstatim i tillë mund të vijë për shkak se vetë natyra e misionit të përkohshëm të OKB-së në Kosovë-UNMIK, ka qenë një model unik i kombinuar me asistencë ushtarake të trupave rajonal. Ky mision ishte vendosur *post festum*, pasi që në terren ishin krijuar rrethana

---

[166] Joseph B. Coelho, "Building stable and effective states through international governance: the politics of technocratic interventions" (PhD diss., Northeastern University Boston, Massachusetts, 2008), p.41.

[167] Richard Caplan, *A New Trusteeship? The International Administration of War-Torn Territories* (New York: Oxford University Press for International Institute for Strategic Studies, 2002, pp. 13-29.

[168] Coelho, "Building stable and effective states through international governance"..., p.42.

[169] Adam Roberts, "What is a Military Occupation"?, *British Year Book of International Law* 55 (1984), p.249-305; Një shembull klasik mund të jetë pushtimi i Gjermanisë dhe Italisë pas Luftës së Dytë Botërore nga aleatët e udhëhequr nga ShBA.

[170] Caplan, *A New Trusteeship?...*, p.3.

të favorshme. (Kjo çështje do të trajtohet më vonë tek klasifikimi i administratave ndërkombëtare).

Së fundi, tanimë kur i kemi më të qarta kuptimet e këtyre nocioneve të lartpërmendura, atëherë krijohet edhe mundësia e një definimi më të saktë se çka është vetë administrimi ndërkombëtar.

Ka mjaft kundërthënie rreth definimit të konceptit të administrimit territorial ndërkombëtar. Teoricienët kanë përshtatur qasje të ndryshme ndaj kësaj doktrine. Për shembull, në një kuptim të përgjithshëm, përderisa një organizatë ndërkombëtare, qoftë OKB-ja apo ndonjë organizatë tjetër, ushtron pushtet administrativ dhe/ose vendimmarrje të drejtpërdrejtë në një territor, atëherë themi se misioni i saj është një administratë ndërkombëtare[171]. Sipas Chopra, administrimi ndërkombëtar definohet si ushtrim i autoritetit civil ndërkombëtar mbi një territor[172]. Kurse Wilde, këtë paradigmë e shpjegon si "konstituim formal, bazuar në menaxhimin e strukturave lokale duke operuar në lidhje me një njësi të veçantë territoriale, ku ai mund të ketë fushëveprim të plotë ose të kufizuar"[173]. Në anën tjetër, Caplan administrimin ndërkombëtar e definon "si një operacion qëllimi i të cilit është që të lehtësojë shfaqjen e shtetit të ri, ose të paktën për të promovuar autonomi substanciale"[174]. Ndërsa, Chesterman e përdor konceptin e "administrimit tranzicional" për të përshkruar një operacion në të cilin subjektet ndërkombëtare ndjekin "aktivitete si asistenca elektorale, të drejtat e njeriut dhe asistencë teknike në sundimin e ligjit, reforma në sektorin e sigurisë dhe reforma të caktuara zhvillimore", duke supozuar me disa ose të gjitha fuqitë e shtetit në baza të përkohshme[175].

---

[171] Lindsey Cameron, *Accountability of International Organisations Engaged in the Administration of Territory* (University Centre for International Humanitarian Law, 2006), p. 16.

[172] Carsen Stahn, *The Law and Practice of International Territorial Administration: Versailles to Iraq and beyond* (New York: Cambridge University Press, 2008), pp. 43-44.

[173] Ralph Wilde, "From Danzing to East Timor and Beyond: The Role of International Territorial Administration", *The American Journal of International Law* 95 (2001), p 385.

[174] Richard Caplan, A *New Trusteeship?...*, pp.12-17.

[175] Simon Chesterman, *You, the People: The United Nations, Transitional Administration, and State-Building,* A Project of the International Peace Academy, (New York: Oxford University Press, 2004), p.5-6.

Në anën tjetër, termi “administrim ndërkombëtar” përfshin një gamë të gjerë përvojash, historike dhe bashkëkohore[176].

Kronologjia niset nga forma historike e administrimit ndërkombëtar: “Protektoratet”; “Sistemi i Mandateve të Lidhjes së Kombeve”; “Sistemi i Kujdestarisë së OKB-së”; “Administratat civile të OKB-së”; “Administrata tranzicionale të OKB-së”; “Administratat transnacionale”[177]; e deri tek konceptet më të reja të “Administaratave territoriale ndërkombëtare (ATN)”, apo ai i “Qeverisjes ndërkombëtare të një shoqërie”[178]. Megjithëkëtë, sado që të ketë evoluar natyra e kësaj doktrine, ajo prapë se prapë ruan disa tipare të kursit fillestar e që kanë të bëjnë me relacionet e së paku dy subjekteve, ku njëri subjekt drejton subjektin tjetër.

Siç do të theksonte Macmillan: “Vetë ideja e të fortit në mbrojtje të të dobtit, nuk ishte diçka e re”[179]. Ndër këto njihet edhe "Traktati i Aleancës së Shenjtë" i vitit 1815, përmes të ashtuquajturit “Koncerti Evropian”. Për shembull, përgjatë shekullit XIX, fuqitë kryesore evropiane në disa raste u paraqiten si protektorë për të qeverisur ose mbrojtur një entitet të caktuar. Në shekullin e XIX-të, fuqitë evropiane ndërhynë në një rast për të mbrojtur qytetarët e krishterë të Perandorisë Osmane[180]* prej barbarive

---

[176] Richard Caplan, *International Governance of War-Torn Territories: Rule and Reconstruction* (New York: Oxford University Press, 2005), p.17.

[177] Matthew Willner-Reid, *Post-Colonial Governments of Leading Strings: The Legitimacy and Accountability of International Transitional Administrations* (Portugal, 2005), p.3.

[178] Reka, *UNMIK as an international governance...*, pp.97-103.

[179] Macmillan, *Paris 1919...*,2006, f.129.

[180]* Në maj 1860, kishte shpërthyer një konflikt në mes të Druzëve dhe popullsisë Maronite që tani është në Liban, por që në atë kohë ishte Siria nën sundimin osman. U bë masakra ndaj Maronitëve, së pari nga Druzët dhe më vonë nga trupat turke. Shih më tepër: Martha Finnemore, *Constructing Norms of Humanitarian Intervention, The Culture of National Security*: *Norms and Identity in World Politics*, edited by Peter J. Katzenstein, 2002, pp.1-25; Më 3 gusht, 1860, gjashtë Fuqitë e Mëdha (Austria, Franca, Britania e Madhe, Prusia, Rusia dhe Turqia) kishin nënshkruar një protokoll që autorizonte dërgimin e 12 mijë trupave evropiane në rajon për të ndihmuar sulltanin në ndalimin e dhunës dhe vendosjen e rendit. Një letër komunikimi ndërmjet ministrit të jashtëm francez Thouvenal dhe ambasadorit francez në Turqi, theksoi se "objekt i misionit është për të ndihmuar ndalimin e gjakderdhjes, me masa të menjëhershme dhe energjike, dhe për t’i dhënë fund mizorive të kryera kundër të krishterëve, të cilat nuk mund të mbeten pa u ndëshkuar". Protokolli theksonte më tej mungesën e ambicieve strategjike dhe

çnjerëzore. Viktimat jo krishtere të këtyre keqtrajtimeve u lanë përgjithësisht mënjanë nga qeveritë e shteteve evropiane (të cilat kishin kryer vetë keqtrajtime). Siç thekson Goldstein, "shpjegimi konstruktivist do të vinte në dukje ndryshimin e normave në lidhje me llojin e popujve që duhet mbrojtur"[181].

Njëra prej praktikave të hershme të "territoreve të ndërkombëtarizuara", ishte operacioni ndërkombëtar në Shqipëri, i cili pas Luftërave Ballkanike 1912-1913, qe themeluar për Shqipërinë si një vend neutral nën administrimin e fuqive të mëdha evropiane të përbërë nga Austro-Hungaria, Franca, Britania e Madhe, Italia, Rusia dhe Turqia[182].

Por, forma e qeverisjes ndërkombëtare, në formën e një administrimi territorial ndërkombëtar nën autorizimin e një organizate ndërkombëtare është dukuri e re në marrëdhëniet ndërkombëtare. Në thelb, ajo është një zhvillim i shekullit të njëzetë[183]. Sipas disa studiuesve (Reka, Caplan, Stahn, Wilde, Morgenthau), praktika e administrimit territorial nga një organizatë ndërkombëtare shkon prapa në periudhën midis dy luftërave botërore, kur Komisioni Drejtues i Lidhjes së Kombeve administronte drejtpërdrejt Qytetin e Lirë të Danzigut dhe Territorin e Sarit në vitin 1920[184]. Ndërsa, pas Luftës së Dytë Botërore, në kuadër të kapitullit XII dhe XIII të kartës së OKB-së u inaugurua Sistemi i Kujdestarisë Ndërkombëtare me një Këshill të Kujdestarisë "UN Trusteeship", me qëllimin e administrimit të territoreve jo-vetë të administruara. Megjithatë, mund të përfundohet se Sistemi i Kujdestarisë dhe Këshilli, kanë provuar të jenë të suksesesshëm. Në total, Sistemi i Kujdestarisë ka administruar

---

politike të fuqive që vepruan në këtë çështje. Shih më tepër në: Louis B. Sohn and Thomas Buergenthal, *International Protection of Human Rights*, Indianapolis: Bobbs-Merrill, 1973, pp. 156-60.

[181] Goldstein, *Marrëdhëniet Ndërkombëtare*, f.149.

[182] Erwin A. Schmidl, *The International Operation in Albania, 1913-14, International Peacekeeping,* 6/3 (1999), 1-10.

[183] Carsten Stahn, "International Territorial Administration in the Former Yugoslavia: Origins, Development and Challenges Ahead", *Heidelberg Journal of International Law,* 61 (2000), p. 114.

[184] Ralph Wilde, "From Danzing to East Timor and Beyond: The Role of International Territorial Administration", *American Journal of International Law* 95 (2001), p. 586. Po ashtu, shih më tepër në: Nele Matz, "Civilization and the Mandate System under the League of Nations as Origin of Trusteeship", *Max Planck Yearbook of United Nations Law* 9 (2005), p. 47-95.

njëmbëdhjetë territore, të cilat të gjitha arritën pavarësinë. Të fundit ishin Ishujt Palau që u pavarësuan më 10 nëntor 1994, që praktikisht shënuan ndërprerjen e veprimtarisë së Këshillit të Kujdestarisë, edhe pse ky ende ekziston në ditët e sotme në letër[185].

Përveç kësaj, një formë tjetër e administrimit ndërkombëtar pas Luftës së Dytë Botërore ishte Sistemi Paqëruajtës i OKB-së "UN Peacekeeping Missions", që mbështetej në kapitujt VI dhe VII të Kartës së saj. Pas Luftës së Dytë Botërore, komuniteti ndërkombëtar ia besoi Kombeve të Bashkuara qeverisjen e territoreve të ish-kolonizuara të Japonisë dhe Italisë, dhe të hapësirave të tyre të kontestuara, siç ishte qyteti i Trieshtës, dhe së fundi me rastet e viteve 1980 të cilat shënuan fillimin e një epokë të re të misioneve paqeruajtëse [186]. Kurse ndër rastet e fundit të administrimeve territoriale të fundviteve '90 -ta, e që i referohen Kapitullit VII të Kartës së OKB-së janë: Kamboxhia, Sllavonia Lindore, Guinea e Re Perëndimore ose Mostari dhe Bosnje-Hercegovina, ku mandatet e këtyre misioneve jo vetëm që synonin të vendosnin paqen në rajon, por ata përbënin, një preludi për shtetndërtim, qoftë kjo e deklaruar apo e pa deklaruar qartë në mandatet e tyre[187].

---

[185] Stijn van Hoff, *UN Transitional Administrations, Creating Legitimate Government,* Utrecht, July 2011, pp. 19-20.

[186] Reka, *UNMIK as an international governance...*, pp 98-99.

[187] Antonia Zervaki, "UN at crossroad: International Administration of Territories and Domestic Political Culture, The Kosovo and East Timor Experience", *UNISCI Discussion Papers* 18 (2008), p. 10; Richard Caplan, *International Governance...*,p. 18.

KREU II:
SISTEMI I MISIONEVE PAQERUAJTËSE TË OKB-së DHE REFORMAT TRANSFORMUESE TË TIJ

2.1 Praktikat e misioneve paqeruajtëse të OKB-së: 1 948-2013: pozita e UNMIK-ut

Të shpjeguarit e veprimtarisë dhe misioneve paqëruajtëse në kuadër të një organizate ndërkombëtare siç është OKB-ja, do të duhej të fokusohej në analizimin e një sërë variablash specifike, që të marrura së bashku do ta paraqisnin një hartë më komplete të kësaj veprimtarie. Para së gjithash, do të duhej fokusuar në analizimin e misionit, veprimtarisë si dhe rrethanave ku realizohen ato. Në planin teorik, kjo do të mund të arrihej në kuadër të teorive të Marrëdhënieve Ndërkombëtare, veçanërisht nga teoritë post-pozitiviste.

Post-pozitivistët (Shkolla angleze, Konstruktivizmi, Postmodernizmi) e vënë theksin kryesisht tek ato çështje që ata mendojnë se janë të margjinalizuara nga teoritë tjera. Në grupin e çështjeve që sipas post-pozitivistëve duhet t'i kushtohet tretman më i veçantë, janë ato që kanë të bëjnë me çështje të tilla si: politikat e etnicitetit, kulturës, identitetit, pastaj ato të natyrës së regjimeve politike, organizimit territorial, evoluimit të normave dhe institucioneve ndërkombëtare, rendin dhe drejtësinë ndërkombëtare, studimet për konfliktet dhe paqen etj. Kjo nënkupton që ky kuadër teorik është mjaft i përshtatshëm për analizimin dhe shpjegimin e doktrinës së administrimit ndërkombëtar dhe funksioneve të tij.

Post-pozitivistët zhvillimin e ngjarjeve në politikën botërore e shpjegojnë si të pandashme nga evoluimi i *faktorëve sistematik*. Rrjedhimisht, edhe fenomeni i administrimit dhe paqëruajtjes në sistemin ndërkombëtar, si një veprimtari komplekse, ndikohet fuqishëm nga faktorët dhe rrethanat sistemike, ashtu siç ndikohen pjesa dërrmuese e ngjarjeve në marrëdhëniet ndërkombëtare. Kjo do të thotë se në varësi të natyrës së ndryshueshme të shoqërisë ndërkombëtare të shteteve, do të përcaktohet edhe natyra e veprimtarisë së caktuar, e që në këtë rast i referohet paqëruajtjes. Dhe meqenëse komplet kjo ndërmarrje është realizuar në saje të raportit evolues luftë-paqe, atëherë të dyja këto variabla, sipas teorive post-pozitiviste, kanë qenë të kushtëzuara nga natyra evoluese e kësaj shoqërie.

Për shembull, lidhur me analizimin e raportit luftë-paqe, teoria e shkollës angleze bëhet një lente shumë efikase për ta studiuar këtë problematikë. Racionalistët tërhiqen kah elementet e realizmit dhe idealizmit, edhe pse ata zënë tokën e mesme midis të dyjave, asnjëherë nuk pajtohen plotësisht me ndonjërën pikëpamje[188]. Lidhur me këtë raport, siç dihet, realistët konstatojnë se gjendja e luftës është dukuri e përhershme në një sistem *anarkik* të dhënë, dhe që vetëm kohë pas kohe do të ketë paqe ndërmjet aktorëve në këtë sistem. Në anën tjetër, liberalizmi këtë sistem e koncepton si *hierarkik*, duke argumentuar se paqja është permanente në sistemin ndërkombëtar, e cila kohë pas kohe kërcënohet nga konfliktet.

Martin Wight, argumentoi se racionalizmi ishte "*via media"* në mes realizmit dhe liberalizmit, e që Wight e përdorte këtë term për ato perspektiva që ishin armiqësore ndaj rendit aktual dhe që ishin të përkushtuara në transformimin e tij[189]. Madje qëllimi kryesor i racionalistëve është të *shpjegojnë* nivelin befasisht të lartë të rendit që ekziston në mes bashkësive të pavarura politike në kushtet e anarkisë, dhe se ky *rend* mund të ekzistojë edhe midis shteteve që nuk kanë ndjenja për përkatësinë e një civilizimi të përbashkët[190].

Lidhur me qëndrimet se racionalizmi është "*via media"* në mes të realizmit dhe liberalizmit, mund të konstatojmë se kjo gjë vërehet qartë sidomos kur racionalizmin e shikojmë në retrospektivë. Për shembull, konceptet dhe idetë mbi të cilat është ndërtuar dhe me të cilat operon racionalizmi, janë me bazë filozofike e që shtrihet nga Hobsi, përmes Grocit deri te Kanti[191].

Por, për dallim nga racionalizmi, konstruktivizmi thekson se lufta apo paqja do të marrë karakter më të zhvilluar në raport me njëra-tjetrën në varësi nga evoluimi i standardeve dhe normave që mund ta ndryshojnë strukturën e sistemit ndërkombëtar, duke e bërë atë ose më konfliktual ose më paqësor. Prandaj konstruktivistët, pikë së pari, kur i studiojnë ngjarjet në MN, nisen nga premisa të tilla si: shkaku dhe rrjedha e ngjarjeve të caktuara varen direkt nga evoluimi i sistemit ndërkombëtar në atë kuptim që

[188] Scott Burchill et al., *Theories of International Relations...*, p.104.

[189] Po aty, p 104.

[190] Po aty, p. 104-105.

[191] Barry Buzan, *From International to World Society? English Scool Theory and the Social Structure of Globalisation* (UK: Cambridge University Press, 2004), p. 6-10.

ai avancohet. Konstruktivistët argumentojnë se me kalimin e shekujve, institucionet dhe rregullat ndërkombëtare janë bërë më të forta, më të ndërlikuara dhe më të rëndësishme.

Andaj, kjo konkurrencë teorike, lidhur me shpjegimin e fenomenit të paqëruajtjes ndërkombëtare dhe doktrinës së administrimit territorial ndërkombëtar, do të mbetet prezent gjatë gjithë kohës. Për shembull, çështjet rreth misionit, funksioneve, rëndësisë, si dhe natyrës evoluese të kësaj doktrine, do të mbeten detyra paqësore e projektit analitik post-pozitivist.

Nëqoftëse nisemi me analizimin e faktorëve që ndikuan në lindjen dhe funksionimin e OKB-së, atëherë konstatimi i parë që mund të bëhet, ka të bëjë me faktin se OKB-ja ishte produkt i dalë nga lufta dhe për t'i shërbyer paqes. Pra, misioni i saj ishte krijimi dhe ruajtja e një ambienti më paqësor dhe bashkëpunues, nga ku edhe buron filozofia e veprimtarive paqeruajtëse.

Sipas logjikës shpjeguese të liberalizmit, kushti i anarkisë i proklamuar nga realizmi mund të sfidohet me fuqizimin e normave dhe organizatave të cilat e nxisin bashkëpunimin ndërmjet akterëve ndërkombëtare[192], duke bërë që ky bashkëpunim të bëhet substart i një rendi gjithnjë e më hierarkik. Në fakt, kjo u bë bindje e rrënjosur thellë në ndërgjegjen e shteteve, të cilat sapo kishin dalë nga tmerret e Luftës së Dytë Botërore, duke i dhënë kështu atribute supranacionale kësaj organizate me qëllim krijimin e një forumi të përhershëm ku shtetet do t'i adresonin për zgjidhje problemet e tyre dhe eventualisht të hiqnin dorë nga lufta. Andaj, qëllimet kryesore të tanishme të OKB-së janë po ato që ajo ka pasur kur u themelua.[193]

Por, si duket ideja e bashkëpunimit dhe zgjidhjes paqësore të konflikteve, e proklamuar nga liberalizmi, u gjend përballë një sfide serioze. Kjo ngase menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, u ri aktualizuan kushtet e anarkisë nga e cila u prodhuan vazhdimisht konflikte dhe luftëra. Bashkëpunimi u zbeh me ndarjen ideologjike bipolare të sistemit ndërkombëtar[194], kurse siguria kolektive u përballë me kërcënime serioze nga shumëfishimi i konflikteve ndër etnike dhe luftërave civile, duke ndikuar kështu fuqishëm në transformimin e natyrës klasike të konflikteve ndërkombëtare, për të argumentuar se

[192] Shih më tej në: Goldstein, *Marrëdhëniet Ndërkombëtare*..., f.281-286.

[193] Po aty, f.286-288.

[194] Shih më tepër: Lisen Bashkurti, *Kombet e Bashkuara dhe Rendi i ri Botëror*, (Tiranë: GEER, 2010), f.315-327.

"problemi kryesorë i luftës që nga viti 1945 ka qenë brenda dhe rreth shteteve, jo midis shteteve”[195].

Që prej Luftës së Dytë Botërore, periudha 1990-1995 ishte dy herë më vdekjeprurëse se çdo dekadë, duke përfshirë 93 luftra në 70 vende. Në fakt, rreth 22 milionë njerëz, vlerësohen të kenë vdekur në konfliktet që nga viti 1945, një e katërta e këtyre vdekjeve ndodhën në fillim të viteve 1990 [196].

Vetëm në vitin 1997, 2005 dhe 2011, janë regjistruar rritje të përkohshme të numrit të konflikteve të armatosura[197]. Një paraqitje grafike është dhënë në figurën 4.

Figura 4. Luftërat dhe konfliktet e armatosura që nga viti 1945-2012.



Burimi: Instituti për Politika dhe Konflikte të armatosura (AKUF), Analiza Nr. 11, Dhjetor 20102, f.1.

[195] Paul R. Hensel, *The More Things Change...:Recognizing and Responding to Trends in Armed Conflict* (USA: Florida State University, 2001), p.4.

[196] United States Institute of Peace, *Certificate Course in Conflict Analysis*, Produced by the Education and Training Center, Version date: January 30, 2008, p4.

[197] Wolfgang Schreiber, *Kriege und bewaffnete Konflikte 2012* (Ein erster Überblick), Institut für Politikwissenschaft Arbeitsgemeinschaft Kriegsursachenforschung (AKUF), Nr. 11, Analysen Dezember 2012, s.1.

Andaj duke u gjendur përballë një gjendje anarkike të tillë, OKB-ja me kohë filloi të ndërmarrë një sërë rolesh aktive në paqëruajtjen në zonat më kritike konfliktuoze në botë. Aktivitetet e saja paqeruajtëse, OKB-ja i ndërmori përmes "misioneve apo operacioneve paqëruajtëse". Andaj, misionet paqëruajtëse që nga atëherë e deri tani, paraqesin njërin nga aktivitetet kryesore të OKB-së në krijimin dhe ruajtjen e paqes në botë, veprimtari të cilat në fakt edhe e justifikojnë ekzistencën e kësaj organizate.

Për ta implementuar këtë qëllim, OKB-ja ka përdorur forma të ndryshme funksionale, ndër të cilat edhe më të rëndësishmet "sistemi i kujdestarisë" dhe "administrimet territoriale ndërkombëtare", të cilat kanë operuar përmes "administratave ndërkombëtare" si trupa teknike punuese në terren, e që veprojnë në një territor të caktuar që vihet nën administrim të përkohshëm, duke marrur statusin e "territorit të ndërkombëtarizuar". Një skemë e përshkallëzimit të veprimtarisë paqëruajtëse është dhënë në figurën 5.

Figura 5. Përshkallëzimi i veprimtarisë paqëruajtëse të OKB-së.



Këto aktivitete të OKB-së dolën nga nevoja praktike në terren, ngase që kur u themelua kjo organizatë, rreth 700 milionë njerëz apo rreth një e treta e popullsisë së

botës në atë kohë, jetonin nën kontroll të huaj. Deri në vitin 2010, vlerësohet se numri i njerëzve që jetojnë në territoret që nuk vetëqeverisën, është më shumë se 700,000[198].

Një vlerësim që është dhënë për operacionet paqeruajtëse të OKB-së, tregon se që prej operacioneve të para e deri tani, 67 prej tyre janë vendosur nëpër vatra të ndryshme të krizës nëpër botë. Ndër këto, 54 prej tyre janë vendosur që nga viti 1988. Në të gjitha këto misione kanë qenë të përshirë një numër enorm, me personel tw madh, qoftë ushtarak apo edhe civil. Ata kanë qenë nga më shumë se 120 shtete nga më të ndryshmet të OKB-së. Në përpjekje të paqeruajtjes botërore, vlerësohet se më shumë se 3.100 paqeruajtës të OKB-së, prej këtyre 120 vende kanë vdekur përderisa shërbenin nën flamurin e OKB-së[199]. Këto shifra, shikuar nga një këndvështrim liberalist, do të mund të konsideroheshin si tregues i një roli aktiv të OKB-së në kontributin e vazhdueshëm të saj paqëruajtës për ta sfiduar kushtin e anarkisë ndërkombëtare. Por, nga përspektiva realiste, këta tregues do të shërbenin si adut shtesë për të argumentuar se pikërisht këto operacione janë ndërmarrë kohë pas kohe nga OKB-ja, ngase situatat konfliktuale kanë qenë dhe do të mbeten përherë prezente, si një gjuhë komunikuese në mes akterëve ndërkombëtar. Përveç kësaj, siç argumenton Bull, me një ton realisti, "nga pikëpamja e shoqërisë ndërkombëtare, lufta e ruan aspektin e saj të dyfishtë: nga njëra anë ajo ruan kufizimin dhe frenimin e një kërcënimi; nga ana tjetër lufta përbën një instrument, që mprehë qëllimet e shoqërisë ndërkombëtare. Por, sot dominon perceptimi i luftës si kërcënim për shoqërinë ndërkombëtare; perceptimi i luftës si mjet i imponimit të ligjit, duke ruajtur ekuilibrin e forcës dhe duke realizuar një ndryshim të drejtë, është i kufizuar tashmë nga ndjesia e nevojës thelbësore për ta përmbajtur luftën brenda kufijve të tolerueshëm"[200].

Konkretisht, për të shpjeguar se konfliktet sipas realistëve janë pjesë normale e zhvillimeve në politikën botërore, atëherë mundemi që periudhën paqëruajtëse 65 vjeçare ta pjesëtojmë me numrin e 67 misioneve, që i bije të kemi pak më shumë se një konflikt gjatë çdo viti të kësaj periudhe (saktësisht 1.03 konflikte për çdo vit). Në anën tjetër, konstruktivistët do të argumentonin se me ndërrimin e rrethanave dhe

---

[198] Simon Chesterman, *Review Essay: International Territorial Administration and the Limits of Law* (New York: University School of Law, 2010), p.2.

[199] United Nations Peacekeeping, *peacekeeping operations, history of peacekeeping*: http://www.un.org/en/peacekeeping/operations/history.shtml

[200] Hedley Bull, *Shoqëria Anarkike: Një studim i rendit në politikën botërore* Tiranë: AIIS, 2010), faqe 239.

raportit të forcave në sistemin ndërkombëtar, ka ndryshuar edhe trajta e paqëruajtjes si fenomen dhe formave të administrimit si operacione të saj. Konstruktivistët poashtu argumentojnë, se në varësi të raportit luftë-paqe që ka mbizotëruar në këtë sistem, ka evoluar edhe trajta e administrimeve ndërkombëtare, duke u nisur me sistemin e kujdestarisë për të kaluar tek administratat tranzicionale, pastaj tek ato territoriale, e kohëve të fundit, deri te qeverisja ndërkombëtare e një shoqërie.

Por, para se të paraqitet një kronologji e të gjitha operacioneve paqëruajtëse të OKB-së, është shumë me rëndësi të sqarohet burimi i autoritetit dhe mandatit të këtyre misioneve dhe atë në saje të peshimit ndërmjet parimeve të legjitimitetit (apo politike) dhe të legalitetit (apo juridike). Meqenëse tani e kemi të qartë bazën legjitime apo politike të kësaj veprimtarie, atëherë lind nevoja e sqarimit të bazës legale të këtyre misioneve.

Një konstatim i bazës legale të veprimtarisë paqëruajtëse të OKB-së mbështetet në faktin se edhe kjo veprimtari sikurse edhe veprimtaritë tjera të OKB-së bazën legale e kanë në Kartën e saj. Ndonëse Karta e OKB-së nuk parashikon në mënyrë specifike krijimin e operacioneve paqeruajtëse, megjithatë GJND-ja në Opinionin e saj Këshillues të vitit 1962[201] theksonte se operacionet e tilla janë brenda kompetencave të nënkuptuara të organizatës dhe si pjesë e detyrimit të saj për të siguruar paqen dhe sigurinë ndërkombëtare[202]. Karta e Kombeve të Bashkuara i jep përgjegjësinë primare Këshillit të Sigurimit për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare. Në përmbushjen e kësaj përgjegjësie, Këshilli i Sigurimit mund të miratojë një sërë masash, duke përfshirë ngritjen e një operacioni paqeruajtës të Kombeve të Bashkuara. Baza ligjore për një veprim të tillë është gjetur në kapitujt VI, VII dhe VIII të Kartës. Gjersa Kapitulli VI merret me "Zgjidhjen Paqësore të Mosmarrëveshjeve", Kreu VII përmban dispozita që lidhen me "Veprimin ndaj kërcënimit të paqes, prishjen e paqes dhe akteve të agresionit". Kapitulli VIII i Kartës parashikon edhe përfshirjen e marrëveshjeve dhe agjencive rajonale në ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, me kusht që aktivitetet e tilla të jenë në përputhje me qëllimet dhe parimet e

[201] Advisory Opinion of 20 July 1962, I.C.J.

[202] Lindsey Cameron, *Accountability of International Organisations Engaged in the Administration of Territory* (University Centre for International Humanitarian Law, 13 February 2006), p. 17.

përshkruara në Kapitullin I të Kartës[203]. Madje, sipas mendimeve të disa autorëve, misionet paqeruajtëse "bien diku midis mekanizmave të zgjidhjes paqësore (Kapitulli VI) dhe veprimeve të zbatimit, (Kapitulli VII), apo si ato ishin përshkruar nga ish-Sekretari i Përgjithshëm i OKB Dag Hammarskjöld "Kapitullin Gjashtë-e-gjysmë"[204].

Operacioni i parë paqëruajtës i OKB-së u quajt Organizata e Mbikëqyrjes së Armëpushimit e Kombeve të Bashkuara (UNTSO), e dislokuar në Lindjen e Mesme në vitin 1948 pas luftës së parë arabo-izraelite. Si i pari i llojit të tij, ai në mënyrë të qartë ka kontribuar shumë në formësimin e karakteristikave themelore të operacioneve paqeruajtëse të Organizatës. Së bashku me Grupin e Vëzhguesve Ushtarak të Kombeve të Bashkuara në Indi dhe Pakistan (UNMOGIP, 1949) dhe Forcat e Para Emergjente të Kombeve të Bashkuara (UNEF I, 1956-1967), ai formoi "Triadën" themelues të operacioneve paqeruajtëse[205]. Këto misione u pasuan nga Grupi Vëzhgues i Kombeve të Bashkuara në Liban (UNOGIL: Qershor-Dhjetor 1958)[206]. Operacioni i OKB-së në Kongo (ONUC, 1960-1964), ishte i pari mision në shkallë të gjerë që kishte rreth 20.000 personel ushtarak. ONUC demonstroi shkallë të lartë rreziku duke u përpjekur për të sjellë stabilitet në rajonet e shkatërruara nga lufta - 250 pjesëtar të personelit të OKB-së vdiqën derisa shërbenin në atë mision, duke përfshirë edhe ish Sekretarin e Përgjithshëm Dag Hammarskjöld[207].

Në vitet 1960 dhe 1970, OKB-ja themeloi misione afatshkurtra si: në Republikën Domenikane - Misioni i Përfaqësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm në Republikën Domenikane (DOMREP, 1965-1966)[208], në Guinenë e Re Perëndimore (Iriani Perëndimor) - Forca e Sigurisë së OKB-së në Guinenë e Re Perëndimore (UNSF, 1962-1963), dhe në Jemen - Misioni Vëzhgues i OKB-së në Jemen (UNYOM, 1963-1964), dhe pastaj filluan vendosjet e misioneve afatgjata në Qipro - Forca paqeruajtëse e OKB-së në Qipro (UNFICYP, 1964) dhe në Lindjen e Mesme - Misioni Vëzhgues i Kombeve të Bashkuara për Indi dhe Pakistan (UNIPOM, 1965-1966), pastaj, Forca e

[203] United Nations Peacekeeping Operations Principles and Guidelines, UN/ DPO & DFS, New York, January 2010, p. 13.

[204] Reka, *UNMIK as an international governance...*, p.105.

[205] Jocelyn Coulon, *Whatever Happened to Peacekeeping? The Future of a Tradition* (Canadian Defence & Foreign Affairs Institute, 2010), p.2.

[206] UNSCR 128 (1958).

[207] United Nations Peacekeeping Operations: 1948-2013, UNO, official web page.

[208] UNSCR 203 (1965).

Dytë Emergjente e OKB-së (UNEF II, 1973-1979), Forca Observuese e KB për Liri (UNDOF, 1974)[209]. Të gjitha këto misione që u përmendën këtu, sipas studiuesve të kësaj problematike, në përgjithësi mund të konsiderohen si misione paqeruajtëse të hershme[210], apo klasike ose të gjeneratës së parë[211].

Në vijim, sipas Stahn, rastin e parë të vërtetë të misioneve paqeruajtëse të gjeneratës së dytë e paraqet Misioni Paqeruajtës i OKB-së në Guinenë e Re Perëndimore - (UNTEA)[212] UNTEA është themeluar mbi një bazë kontraktuale dhe jo në bazë të një rezolute të Këshillit të Sigurimit nën Kapitullin VII të Kartës së OKB-së, nganjëherë me pëlqimin e shtetit përkatës, e ndonjëherë pa të [213]. Në fakt, UNTEA bazohej në një marrëveshje paqësore në mes të Holandës dhe Indonezisë, përmes së cilës merrte pushtetin e plotë për emërimin e zyrtarëve qeveritar për të garantuar rend dhe ligj.[214] Si misione pasuese të OKB-së ishte edhe Forca e Përkohshme e OKB-së në Liban - (UNIFIL, 1978), pastaj Misioni i Zyrave të Mira të Kombeve të Bashkuara në Afganistan dhe Pakistan- (UNGOMAP, 1988-1990), si dhe Grupi i Vëzhguesve Ushtarak në Iran-Irak- (UNIMOG, 1988-1991)[215].

Një pjesë e aktivitetit vijues paqeruajtës i OKB-së mund të shpjegohet nën dritën e shpjegimeve konstruktiviste, sipas së cilës zhvillimet në sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare shpjegohen si të ndërlidhura me karakterin evolues të këtij sistemi. Në bazë të këtij perceptimi, shpjegimi konstruktivist e konsideron edhe fundin e Luftës së Ftohtë si një ngjarje që kontribuoi dukshëm në evoluimin e natyrës së sistemit ndërkombëtar modern, duke ndikuar direkt kështu edhe në natyrën e misioneve paqëruajtëse të OKB-së.

---

[209] United Nations Peacekeeping Operations: 1948-2013, UNO, official w.p.

[210] Caplan, *International Governance of War-Torn Territories* ...,2005, 18.

[211] Stahn, "International Territorial Administration in the Former Yugoslavia"...,2000, p. 124.

[212] Po aty, p. 124.

[213] Rüdiger Wolfrum, *"International Administration in Post-Conflict Situations"...*, 2005, p. 649-696.

[214] Shih më tepër në: Agreement between the Republic of Indonesia and the Kingdom of the Netherlands concerning West New Guinea (West Irian), arts IV to VI, see Annex of the contribution of D. Gruss, in this Volume and A/RES/1752 (XVII) of 21 September 1962.

[215] Reka, *UNMIK as an international governance...*, p. 109.

Pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, OKB-ja i modifikoi modelet tradicionale paqeruajtëse, gjë që dërgoi në operacionet paqeruajtëse shumëdimensionale [216]. Prandaj, në këtë periudhë, ka pasur një rritje të shpejtë në numrin e operacioneve paqeruajtëse. Me një konsensus të ri dhe një ndjenjë të qëllimit të përbashkët, Këshilli i Sigurimit autorizoi një total prej 20 operacionesh të reja në mes të viteve 1989 dhe 1994, duke rritur numrin e paqeruajtësve nga 11 mijë në 75 mijë[217]. Gjatë kësaj periudhe, Këshilli i Sigurimit e përshpejtoi ritmin e punës së tij, duke adoptuar 185 rezoluta, kundrejt 685 në 46 vitet e mëparshme të historisë së OKB-së, dhe nisjen e 15 operacioneve paqeruajtëse të reja në krahasim me 17 në 46 vitet e kaluara[218].

Sot, këto operacione paqeruajtëse shumëdimensionale janë më të zakonshme[219]. Në fakt, si operacione shumëdimensionale të ndërmarrura nga OKB-ja janë konsideruar disa modele specifike të administrimit ndërkombëtar që njihen si "Administrata Transnacionale (UNTA)", apo misione të përkohëshme. Modeli i parë[220] i këtij lloji ishte aplikuar praktikisht në Kamboxhia, i njohur zakonisht si Autoriteti i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kamboxhia (UNTAC, 1992-1993). Në rrethana të një shteti të dështuar (failed state), OKB-ja mori administrimin *iner alia* të fushave klasike shtetërore, duke përfshirë këtu mbrojtjen, punët e jashtme, financat, rendin, informimin, që u vendosen direkt nën UNTAC-un[221].

Gjatë kësaj kohe, Kombet e Bashkuara themeluan edhe disa misione paqëruajtëse si në: Angola - Misioni Verifikues i OKB-së për Angolën I (UNAVEM I, 1989-1991); Namibi - Grupi i Asistencës Tranzicionale i OKB (UNTAG, 1989-1990)[222]. UNTAG-u ishte mandatuar për të siguruar transferimin paqësor të pushtetit nga qeveria e Afrikës së Jugut për popullin e Namibisë. Poashtu ajo do ta monitoronte tërheqjen e trupave të Afrikës së Jugut dhe do të mbikqyrte procesin zgjedhor në mënyrë që të

[216] Jürgen Friedrich, "UNMIK in Kosovo: Struggling with Uncertainty", *Max Planck Yearbook of United Nations Law* 9 (2005), p. 225-293, p.238.

[217] United Nations Peacekeeping Operations: 1948-2013, UNO, official web page.

[218] David M. Malone, *The UN Security Council: From the Cold War to the 21st Century*, Lynne Rienner Publishers website, 2004. p.6.

[219] Quynh-Nhu Vuong, *U.S. Peacekeeping and Nation-Building: The Evolution of Self-Interested Multilateralism*, Berkeley Journal of International Law, Volume 21/ Issue 3 Article 15, 2012, p.4.

[220] Më vonë e kemi rastin e UNTAB-it dhe të UNTAES-it.

[221] Friedrich, "UNMIK in Kosovo: Struggling with Uncertainty"..., p.238.

[222] United Nations Peacekeeping Operations: 1948-2013, UNO, official web page.

krijojë një qeveri për një shtet të pavarur. Operacione u ndërmorën edhe në Amerikën Qendrore - Grupi i Vëzhguesve në Amerikën Qendrore (ONUCA, 1989-1992)[223]. Përveç kësaj veprimtarie, në këtë kohë, OKB iu përgjigj edhe konfliktit Irak-Kuvajt, duke dërguar atje- Misionin Vëzhgues të Kombeve të Bashkuara për Irak-Kuvajt (UNIKOM, 1991-2003). Kurse, sa i përket problemit të Saharës, si mision paqëruajtës u themelua- Misioni i Kombeve të Bashkuara për Referendumin në Saharën Perëndimore (MINURSO, 1991)[224]. Operacionet paqeruajtëse u vendosën edhe në vende të tilla si: Angola - Misioni Verifikues i OKB për Angolën II (UNAVEM II, 1991-1995), në El Salvador - Misioni Vëzhgues i OKB-së në El Salvador (ONUSAL, 1991-1995), pastaj në Kamboxhia - Misioni Avancues i Kombeve të Bashkuara në Kamboxhia (UNAMIC in Cambodia 1991-1992); në Ish-Jugosllavi - Forca Mbrojtëse e Kombeve të Bashkuara (UNPROFOR 1992-1995); në Somali - Operacioni i Kombeve të Bashkuara në Somali (UNOSOM 1992-1993); në Mozambik - Operacioni i OKB-së në Mozambik (ONUMOZ, 1992-1994); prapë në Somali - (UNOSOM II 1993-1995); në Ugandë-Ruandë - Misioni Observues në Ugandë-Ruandë (UNOMUR 1993-1994); në Gjeorgji - Misioni Observues i Kombeve të Bashkuara në Gjeorgji (UNOMIG 1993-2009); në Liberi - Misioni Observues në Liberi (UNOMIL 1993-1997); në Haiti - Misioni i Kombeve të Bashkuara në Haiti (UNMIH 1993-1996); në Ruandë - Misioni Asistues i Kombeve të Bashkuara në Ruandë (UNAMIR 1993-1996); Grupi Vëzhgues i OKB-së për Rripin Ozu (UNASOG 1994); në Taxhikistan - Grupi i Monitoruesve i Kombeve të Bashkuara në Taxhikistan (UNIMOT 1994-2000)[225].

Në kuadër të këtyre misioneve, ndoshta një vëmendje më e veçantë do të duhej kushtuar UNOSOM-it, UNTAC-ut dhe UNPROFOR-it për shkak të disa specifikave që përmbajnë dhe që dallojnë nga misionet tjera të kësaj periudhe, sidomos në kontekstin e transformimit të misioneve paqeruajtëse të OKB-së. Për shembull, UNOSOM II dhe UNPROFOR-i, përfshinin një numër shumë më të madh të personelit të armatosur shumë më fuqishëm sesa misionet paqeruajtëse tradicionale. Këto operacione ishin të autorizuara sipas Kapitullit VII të Kartës së OKB-së për të

[223]UN SC Resolution 644/1989.

[224] UNSC Resolution 690/1991.

[225] Quynh-Nhu Vuong, "U.S. Peacekeeping and Nation-Building: The Evolution of Self-Interested Multilateralism", *Berkeley Journal of International Law* 21 (2012), p.14; shih më tej: http://www.un.org/en/peacekeeping/operations/past.shtml

marrë të gjitha masat e nevojshme për të përmbushur objektivat e misioneve të tyre. Për më tepër, këto duket se e kanë zgjeruar "zonën gri" në mes të zbatimit të paqes- dhe paqëruajtjes [226]. Që nga viti 1990, OKB-ja ka qenë e ballafaquar me disa fenomene të reja, të tilla si: gjendja e një "shteti të dështuar", (siç ishte rasti me Kamboxhian para themelimit të UNTAC-ut), situata e një "shpërbërjes së një shteti" (siç ishte rasti me ish-RSFJ-në para themelimit të UNPROFOR-it), ose gjendja e "kolapsit shtetëror", (siç ishte rasti në Somali para themelimit të UNOSOM-it).

Për shembull, nën UNOSOM II, OKB operonte me supozimin se nuk kishte asnjë autoritet sovran në Somali. Por, megjithëkëtë, ky nuk ishte rasti i vetëm. Kështu ishte edhe rasti i UNMIK-ut, ku misioni i OKB-së ishte themeluar në supozimin e njëjtë se nuk kishte asnjë autoritet sovran në Kosovë. Megjithatë, Kosova ishte edhe rasti kur administrata e OKB-së u krijua pas përdorimit të forcës ushtarake ndërkombëtare[227].

Përveç kësaj, këto operacione shënuan disa dështime të papërsëritshme dhe kompromettuese për komplet ndërgjegjen e bashkësisë ndërkombëtare[228]. Kjo ngase rrethanat konfliktuale në terren ishin aq të ashpra dhe palët në konflikt nuk treguan një vullnet të mirë për ta implementuar paqen atje, ose siç thoshin disa zyrtarë të OKB-së, "ata shkuan ta ruanin paqën, atje ku nuk kishte paqe për t'u ruajtur"[229].

Këto tri operacione paqeruajtëse të profilit të lartë, u ndodhën nën kritikat se paqeruajtësit ishin përballur me situatat ku palët ndërluftuese kishin dështuar t'i përmbahen marrëveshjeve të paqes, dhe ku paqeruajtësit vetë nuk kishin siguruar burime adekuate apo mbështetje politike. Kjo bëri që luftimet të vazhdojnë duke e rritur kështu numrin e viktimave civile dhe njëkohësisht duke e ulur reputacionin e forcave paqëruajtëse. Ndoshta këto ngjarje më së miri i ka përshkruar njëri nga komandantët e UNPROFOR-it në përgjigje ndaj kritikave për mosveprim. Ai shprehej se "unë nuk mund të bëjë luftë me tanke të bardha"[230]. Megjithëkëtë, ky operacion

---

[226] *Yuji Uesugi,* Chapter 4 The Nexus between UN Peacekeeping and Human Security: Reviewing the Functions of UN Peacekeeping from a Perspective of Human Security, IPSHU English Research Report Series No.19 *Conflict and Human Security: A Search for New Approaches of Peace-building,* 2004, p.103.

[227] Reka, *UNMIK as an international governance...*, p.101.

[228] Shih më tepër në: David Armstrong et al., *Organizatat Ndërkombëtare në Politikën Botërore (*Tiranë: AIIS, 2010), f.137-146.

[229] Goldstein, *Marrëdhëniet Ndërkombëtare…*, f. 292

[230] Po aty, f. 301.

ishte më i madhi për nga personeli dhe për nga kostoja në historinë paqëruajtëse të OKB-së. Ai përfshinte rreth 24 mijë anëtarë të personelit ushtarak dhe civil, prej të cilëve rreth 14 mijë në Kroaci; mbi 9.200 në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe 720 në Maqedoni[231].

Edhe pse disa misione, si këto të cekura më lartë, nuk treguan një preformancë të suksesshme në paqëruajtje, prapë se prapë, OKB-ja ishte e vëmendshme përballë krizave të ndryshme që përfshinë shumë shtete dhe rajone gjithë andej globit. Duke u gjendur përballë një situate të tillë të rënduar konfliktuale, OKB ndërmori masa energjike për të menaxhuar me situatat konfliktuale. Në kuadër të këtij aktiviteti, Këshilli i Sigurimit autorizoi një sërë operacionesh pas gjysmës së dytë të viteve 1990 në rajonet e Afrikës, ish-Jugosllavisë dhe Amerikës Qendrore.

Në rajonin e Afrikës ishin vendosur misione në vendet si: Angola - Misioni Verifikues i Kombeve të Bashkuara në Angolë III (UNAVEM III, 1995-1997) dhe Misioni Monitorues i Kombeve të Bashkuara në Angolë (MONUA, 1997-1999), pastaj Misioni i OKB-së për Republikën e Afrikës Qendrore (MINURCA, 1998-2000), si dhe misionet në Siera Leone- Misioni Observues i Kombeve të Bashkuara në Siera Leone (UNOMSIL, 1998-1999) dhe Misioni i Kombeve të Bashkuara në Siera Leone (UNAMSIL, 1999-2005).

Sa i përket rajonit të ish-Jugosllavisë, kemi misionet në Bosnje dhe Hercegovinë - Misioni i OKB-së në Bosnje dhe Hercegovinë (UNMIBH 1995-2002); në Kroaci - Operacioni i OKB-së për Restaurimin e Besimit në Kroaci (UNCRO, 1995-1996); Administrata kalimtare e OKB-së për Sllavoninë Lindore, Baranjën dhe Siriumin Perëndimor (UNTAES, 1996-1998), si dhe Grupi Mbështetës i Policisë Civile të OKB-së (UNCPSG, 1998). Për rajonin e ish-Jugosllavisë ishte edhe Forca Zbarkuese e OKB-së për Parandalim në Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë (UNPREDEP, 1995-1999) dhe Misioni i Vëzhgueseve të OKB-së në Prevllakë (UNIPOM, 1996-2002)[232].

Përveç këtyre rajoneve, OKB ka ndërmarrë edhe disa misione tjera në Amerikën Qendrore si: Misioni Verifikues i Kombeve të Bashkuara në Guatemalë (MINUGUA, 1997), pastaj edhe tri misione tjera në Haiti - Misioni Mbështetës i Kombeve të Bashkuara në Haiti (UNSMIH, 1996-1997), Misioni Transitor i Kombeve të

[231] Reka, *UNMIK as an international governance...*, p.109.

[232] United Nations Peacekeeping Operations: 1948-2013, UNO, official web page.

Bashkuara në Haiti (UNTMIH, 1997), dhe Misioni i Policisë Civile të Kombeve të Bashkuara në Haiti (MIPONUH, 1997-2000)[233].

Pas këtyre misioneve të viteve ’90-ta, OKB po e përmbyllte shekullin 20-të të veprimtarisë së saj paqeruajtëse për të filluar me operacione të reja. E vetëdijshme për sfidat që mund t’i haste në vijim, OKB në vitin 2000, filloi reformat për avancimin e veprimtarisë dhe misioneve të saj paqeruajtëse[234]. Por, para se të futej në shekullin XXI, ajo ndërmori edhe tri misione paqeruajtëse: në Kosovë, Timorin Lindor dhe në Kongo. Përmes këtyre misioneve, OKB-ja u tregua e gatshme të ndërmarrë operacione edhe më të komplikuara dhe me një fushë të veprimit shumëdimensionale. Në Kosovë, si një rajon post-konfliktual, OKB vendosi Misionin e saj të përkohshëm (UNMIK, 1999), në Timorin Lindor u vendos Administrata Tranzicionale e Kombeve të Bashkuara (UNTAET, 1999-2002), dhe në Republikën Demokratike të Kongos - Misioni i OKB-së në Republikën Demokratike të Kongos (MONUC, 1999-2010).

Shekulli i XX-të agoi me ndërmarrjen e një sërë orepacionesh paqeruajtëse shumë komplekse nga ana e Këshillit të Sigurimit në disa vende të Afrikës si: Eritrea dhe Ethiopi - Misioni i Kombeve të Bashkuara në Eritre dhe Etiopi (UNMEE, 2000-20008), në Timorin Lindor - Misioni Mbështetës i Kombeve të Bashkuara në Timorin Lindor (UNMISET, 2002-2005), në Liberi - Misioni i Kombeve të Bashkuara në Liberi (UNMIL, 2003), pastaj Misioni i Kombeve të Bashkuara në Côte d’Ivoire - Misioni i Kombeve të Bashkuara në Côte d'Ivoire (UNOCI, 2004); në Haiti - Misioni Stabilizues i Kombeve të Bashkuara në Haiti (MINUSTAH, 2004), në Burundi - Operacioni i Kombeve të Bashkuara në Burundi (ONUB, 2004-2006)[235], po ashtu edhe në Çad dhe Republikën e Afrikës Qendrore - Misioni i Kombeve të Bashkuara në Çad dhe Republikën e Afrikës Qendrore (MINURCAT, 2007-2010), pastaj Misioni Stabilizues i OKB-së në Republikën Demokratike të Kongos (MONUSCO, 2010), në Sudan Misioni i Kombeve të Bashkuara në Sudan (UNMIS, 2005-2011), përsëri në Timorin Lindor të sapo pavarësuar - Misioni i Integruar i Kombeve të Bashkuara në Timorin Lindor (UNMIT, 2006), në Darfur - Operacioni i Kombinuar i Unionit

[233] Louise Andersen, *UN Peace Operations in the 21st Centyry: State-Building and Hybridity*, DIIS REPORT 2007:11. p.41.

[234] Shih më tepër në: A new partnership agenda: Charting a New Horizon for UN Peacekeeping, Department of Peacekeeping Operations and Department of Field Support New York, July 2009.

[235] United Nations Peacekeeping Operations: 1948-2013, UNO, official web page.

Afrikan dhe Kombeve të Bashkuara në Darfur (UNAMID, 2007), në Afrikë- Forcat e Përkohshme të Sigurisë të Kombeve të Bashkuara për Abyei (UNISFA, 2011) si dhe në Sudanin Jugor - Misioni i Kombeve të Bashkuara në Republikën e Sudanit Jugor (UNMISS, 2011), në Siri - Misioni Mbikëqyrës i Kombeve të Bashkuara në Siri (UNSMIS, 2012), dhe i fundit - Misioni Stabilizues i Integruar Shumëdimensional i Kombeve të Bashkuara në Mali (MINUSMA, 2013)[236].

MINUSMA paraqet shembullin e misionit më të ri të OKB-së në bashkëpunim me akterët tjerë rajonalë (trupat franceze) që ka një mandat dhe autorizim shumëdimensional. Konkretisht ky mision shtrihet në fushat si: stabilizimi i qendrave kyçe të popullatës dhe mbështetja për rivendosjen e autoritetit shtetëror në të gjithë vendin, mbështetja për zbatimin e planit të tranzicionit, duke përfshirë dialogun politik kombëtar dhe procesin zgjedhor, mbrojtjen e civilëve dhe personelit të Kombeve të Bashkuara, promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut, mbështetje për ndihmë humanitare, mbështetje për ruajtjen e trashëgimisë kulturore, si dhe mbështetje për drejtësi kombëtare dhe ndërkombëtare[237].

Por cilat ishin mësimet e ofruara nga kjo praktikë më shumë se gjysmëshekullore e misioneve paqeruajtëse të OKB-së? Çka arriti të qartësohet si kusht për suksesin apo dështimin e një misioni në terren, pra cilët faktorë dhe elemente duhen pasur në konsideratë?

Mësimet e nxjerra gjatë gjashtë dekadave të fundit tregojnë se një operacion paqeruajtës i Kombeve të Bashkuara nuk ka gjasa të ketë sukses kur një ose më shumë nga kushtet e mëposhtme nuk janë plotësuar. Së pari, po qe se mungon një vlerësim i saktë i rreziqeve që lidhen me vendimin ku pretendohet të vendoset një operacion paqeruajtës, së dyti, nëse nuk ka një paqe për t'u ruajtur, së treti, nëse mungon një angazhim pozitiv i rajonit ku ndodhet kriza përkatëse, së katërti nëse nuk ka një mbështetje unike dhe e plotë e Këshillit të Sigurimit, së gjashti, nëse mungon një mandat i qartë dhe burime të përshtatshme për arritjen e tij[238], si dhe nëse mungojnë një sërë fatorësh tjerë si qeverisja e mirë, raportet e mira me popullatën vendore, dhe strategjia dalëse.

---

[236] Po aty.

[237] UNSCR 2100 (2013).

[238] United Nations Peacekeeping Operations Principles and Guidelines, UN/ DPO & DFS, New York, January 2010, pp.49-51.

Një pikë tjetër me rëndësi, në lidhje me studimin e praktikave të misioneve paqeruajtëse të OKB-së, në kontekstin e përgjithshëm, është edhe kategorizimi i tyre në bazë të disa specifikave dalluese, siç janë ato kohore, funksionale, strategjike, etj.

Sa i përket klasifikimit të misioneve paqeruajtëse të OKB-së, në përgjithësi, në teorinë e së drejtës dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare hasen mjaft klasifikime të ndryshme nga autorë të ndryshëm, por që në njëfarë mënyre secili nga këta nuk i anashkalon disa elemente esenciale që njëherësh janë kritere bazë për klasifikim. Para së gjithash, këtu kemi të bëjmë me elementet si: baza juridike e tyre, mandati, kohëzgjatja, numri i personelit, lloji i personelit, shkalla e autorizimit, etj.

Disa nga autorët klasikë (Stahn, Zimmerman, Wilde) të gjitha misionet paqëruajtëse i ndajnë në dy grupe madhore: *Grupi i parë* përbëhet nga paqëruajtja klasike apo paqeruajtja e gjeneratës së parë, (1945-'80-të). Kjo gjeneratë e misioneve bazohej në një formë konsensuale të menaxhimit të krizave, ku roli i OKB-së kufizohej në vendosjen e forcave të saj në mes të dy palëve, (ose si një ndërmjetës, sipas kreut VI të Kartës së OKB-së), që kishin vendosur t'i ndërpritnin armiqësitë dhe se kishin rënë dakord për një prani ndërkombëtare për ruajtjen e paqes[239]. Këto operacione ushtarake "tradicionale" përfshinin detyra të tilla si monitorimin e armëpushimeve dhe patrullimin e "tampon zonave" midis palëve armiqësore nga paqeruajtësit e OKB-së të cilët janë të njohur gjerësisht si "helmetat blu" [240].

Grupin tjetër të misioneve paqeruajtëse e përbëjnë gjenerata e dytë, (që nga vitet '80-ta, deri në fillim të viteve 1990-të). Operacionet e kësaj gjenerate të re ishin më shumë një mekanizëm i bazuar në Kapitullin VII, të Kartës dhe me një ngjashmëri me mekanizmin e ngritur nën kapitujt XII dhe XIII, se sa me një sfond konsensual të palëve në konflikt[241]. Këto operacione paqeruajtëse të OKB-së kanë ushtruar veprimtari "shumëdimensionale", të përbërë nga një gamë e gjerë e komponentëve, duke përfshirë policinë ushtarake, çështjet politike, çështjet civile, çështjet humanitare,

[239] Stahn, "International Territorial Administration in the Former Yugoslavia"...,2000, p. 114.

[240] Handbook on United Nations, *Multidimensional Peacekeeping Operations*, Peacekeeping Best Practices Unit, Department of Peacekeeping Operations, United Nations December, 2003, p. 1.

[241] Stahn, "International Territorial Administration in the Former Yugoslavia"...,p. 114.

sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut, etj[242]. Disa prej këtyre veprimeve nuk kanë pasur një komponentë ushtarake, por kryenin mandatin e tyre së bashku me një forcë paqeruajtëse rajonale apo shumëkombëshe.

Në aspektin funksional, këto misione kanë shërbyer për qëllime të ndryshme të tilla si monitorimin e zgjedhjeve, çmobilizimin dhe ri-integrimin e ish-luftëtarëve, monitorimin e të drejtave të njeriut, pastrimin e minave, etj. Operacionet shumëdimensionale të paqes shpesh përbëhen prej komponenteve ushtarake, ekspertëve civil dhe policisë civile. Si shembuj mund të merren: (UNTAG, 1989-1990), (UNTAC, 1992-1993), (ONUSAL, 1991-1995)[243].

Përveç këtij klasifikimi dy grupor, studiuesi Kondoch, operacionet paqeruajtëse të OKB-së i ndan në katër lloje apo breza[244]. Përveç dy brezave të mëparshme, ai ofron edhe brezin e tretë dhe të katërt.

Brezi i tretë i operacioneve paqeruajtëse të OKB-së kombinon komponentet ushtarake dhe humanitare. Këto operacione janë quajtur edhe si të fuqishme, të zgjeruara, paqeruajtëse kuazi-detyruese ose paqeruajtëse muskulore. Si shembuj të këtyre operacioneve janë: (UNOSOM II, 1992-1994) dhe (UNPROFOR, 1992-1995). Ndryshe nga paraardhësit e tyre, këto janë të autorizuara për të ndërmarrë veprime të zbatimit nën kapitullin VII të Kartës së OKB-së dhe nuk janë më të bazuara në pëlqimin e palëve në konflikt. Megjithatë, para se të vendosë për një veprim të zbatimit, Këshilli i Sigurimit është i obliguar për të përcaktuar ekzistencën e "çdo kërcënimi ndaj shkeljes së paqes, thyerjes të paqes, ose aktit të agresionit" sipas nenit 39 të Kartës[245].

Lloji më i ri i misioneve paqeruajtëse të OKB-së (brezi i katërt), përfaqësohet nga disa shembuj të hershëm të operacioneve paqeruajtëse si në rastin e UNTAC-ut dhe UNTAES-i, pastaj nga UNMIK-u dhe UNTAET-i. Mirëpo, ndryshe nga përvojat e mëparshme të Kombeve të Bashkuara, në qeverisjen e një territori si në rastin e UNMIKU-t, ashtu edhe në atë të UNTAET-it, të dyja rastet ishin krijuar në bazë të

[242] Handbook on United Nations, p. 1-2; United Nations Peacekeeping Operations Principles and Guidelines, UN/ DPO & DFS, New York, January 2010, pp. 25-27.

[243] Boris Kondoch, *Human Rights Law and UN Peace Operations in Post Conflict Situations*, edited by Nigel D. White and Dirk Klaaskn, Manchester University Press 2005, Chapter 2, pp. 1-19.

[244] Po aty, pp. 1-19.

[245] Po aty, 1-19.

kapitullit VII nga Këshilli i Sigurimit[246]. Përveç detyrave politike dhe administrative, këto paraqiten si misione me fuqi të plota ekzekutive, d.m.th me autorizime për qeverisje. Edhepse nuk ka një përkufizim të qartë në terminologjinë e paqëruajtjes, studiuesi Kuhne, e ka përcaktuar për këtë kategori të misioneve paqeruajtëse, pra si "operacione të mbështetjes së paqes dhe të qeverisjes"[247]. Në fakt, angazhimi i OKB-së me një qasje shumëdimensionale në administrimin e këtyre territoreve, ka ardhur si rezultat i një reforme mjaft të thellë transformuese që e ka pësuar vetë sistemi paqëruajtës i OKB-së. Më vonë, pas këtij transformimi, OKB-ja duke ushtruar një qasje të zgjeruar në paqëruajtje, ka përdorur gjithashtu strategji të reja dhe unike në administrimin e këtyre territoreve, duke i dhënë administratave të saj, atribute të qeverisjes ndërkombëtare dhe agjentit shtetndërtues.

Për ta kuptuar këtë praktikë evoluese të misioneve paqeruajtëse të OKB-së, në vijim do të analizohen në detaje të gjitha ato specifika dhe elemente që e kanë karakterizuar këtë zhvillim.

2.2 **Faktorët kontekstual dhe reformat transformuese në sistemin e paqeruajtjes së OKB-së**

Lidhur me reformat transformuese dhe natyrën e operacioneve të paqes së OKB-së, duhet cituar deklarimin e ish-Sekretarit të Përgjithshëm Annan, i cili në raportin e tij të vitit 2000: "Ne popujt", e paraqiti një dallim të qartë në mes operacioneve tradicionale të paqes dhe atyre moderne apo komplekse dhe shumëdimensionale. Ai shprehej se "Përderisa paqeruajtja tradicionale ishte e fokusuar kryesisht në monitorimin e armëpushimeve; operacionet e sotme komplekse të paqes kanë objektiva shumë të ndryshme"[248]. Atëherë, në vazhdën e kësaj analize, mund të shtrohen një sërë pyetjesh si: Cilët ishin faktorët kontekstual që ndikuan në lindjen e

[246] Po aty, 1-19.

[247] Winrich Kühne, *UN-Friedenseinsätze verbessern - Die Empfehlungen der Brahimi-Kommission*, in: Sabine von Schorlemer (Hrsg.), Praxishandbuch UNO. Die Vereinten Nationen im Lichte globaler Herausforderungen, Springer-Verlag Berlin u.a. 2003, S.71: Cituanr nga: Bekim Baliqi, "Externes State- Building durch die Vereinten Nationen: Am Fallbeispiel des Kosovo" (PhA diss., Wien, 2008, s. 47.

[248] Kofi Annan, *We the Peoples, The Role of the United Nations in the 21st Century* (New York: United Nations, 2000), p. 48.

gjeneratave të reja të operacioneve të paqes? Cilat ishin objektivat që pretendoheshin të arriheshin? Çfarë qasje u përdorë në arritjen e këtyre objektivave, etj?

Duke u gjendur përballë rrethanave të reja evoluese në mjedisin ndërkombëtar të sigurisë, *via á vis*, OKB-ja ndërmori hapa konkretë në marrjen e përgjegjësive të reja për adresimin dhe menaxhimin e situatave me elemente konfliktuale. Rrjedhimisht, u imponua nevoja për t'i zgjeruar instrumentet dhe qasjet vepruese me qëllim që në terren të krijoheshin kushte më të favorshme për të ndërtuar një paqe të qëndrueshme. Kurse sa i përket faktorëve konceptual dhe strategjik, në këtë drejtim janë ndërmarrur disa iniciativa, përmes të cilave tentohej krijimi i një plani më efikas, i cili eventualisht do të mundej ta përmirësonte veprimtarinë e operacioneve të paqes. Është fjala për doktrinën e paraqitur nga ish-Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara Boutros Boutros Ghali në të ashtuquajturën "Agjenda për Paqe"[249], e cila përmbante katër koncepte, ku secila prej tyre shënonin një përpjekje specifike në përmirësimin e paqëruajtjes, dhe që të marrura së bashku, paraqesin një sistem të ri të sigurisë kolektive. Poashtu, në saje të këtyre përpjekjeve, rëndësi të veçantë ka edhe Raporti i Panelit të Operacioneve të Paqes të Kombeve të Bashkuara, i njohur si "Raporti Brahimi", i cili poashtu ishte një plan strategjik për reforma në sistemin e paqëruajtjes së OKB-së.

Agjenda e Ghalit ishte një pikë momentale e daljes nga shekulli XX dhe vendosjes së disa linjave të orientimeve të reja drejt avancimit të sistemit paqeruajtës të OKB-së. Kjo agjendë përmbante katër premisa si: "Diplomacia Preventive"; "Paqëruajtja"; "Paqëbërja"; dhe "Paqëvendosja" [250]. Sipas definimit të këtyre koncepteve nga vetë Ghali: *Diplomacia Preventive* nënkupton veprimin për të parandaluar konfliktet që lindin në mes palëve, për të parandaluar përshkallëzimin e mosmarrëveshjeve ekzistuese në konflikte, si dhe për të kufizuar përhapjen e këtyre të fundit, kur ato ndodhin[251]. *Paqëruajtja* si një mjet i projektuar për ruajtjen e paqes, është e kushtëzuar direkt nga përfundimi i konfliktit, ku zakonisht kushtet për paqe janë shumë të paqëndrueshme. Në këto rrethana, veprimtaria paqeruajtëse, në një masë të konsiderueshme orientohet drejt ofrimit të ndihmës teknike për palët në zbatimin e marrëveshjes që kanë arritur. Shikuar për nga synimet dhe përmasat, paqeruajtja ka

[249] Boutros Boutros Ghali, *"Agenda for Peace",* UN Document (New York: 1992).

[250] Yuji Uesugi, *The Nexus between UN Peacekeeping and Human Security*…, 2004, p. 101.

[251] Po aty.

pësuar ndryshime gjatë gjithë kohës[252].Kohëve të fundit, përveç rolit tradicional që e realizonte përmes vëzhguesve ushtarak, ajo gjithnjë ka përfshirë një bashkërendim të veprimtarive më komplekse të përbërë, përveç elementeve ushtarake, edhe nga ato policore dhe civile, me synimin për t'i kontribuar sa më efektshëm krijimit të një ambienti për një paqe më të qëndrueshme. - duke punuar së bashku për të ndihmuar në hedhjen e themeleve për një paqe të qëndrueshme. *Paqëbërja,* për dallim nga paqeruajtja, ka për synim marrjen e masave preventive për parandalimin e një konflikti potencial. Ndër masat më karakteristike të paqebërjes janë ato që përpiqen t'i shtyejnë palët në konflikt, t'i përdorin rrugët diplomatike për tejkalimin e armiqësive dhe përafrimin e qëndrimeve për zgjidhjen eventuale të konfliktit përmes një marrëveshje të negociuar[253]. Paqëbërja do të mund të përfshinte tri lloje të veprimeve tjera: *së pari* procedurën para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, *së dyti,* asistencën ndërkombëtare dhe organizmat për kontribut në çdo mënyrë të mundshme për paqën dhe *së treti*, përdorimin e forcës ushtarake të OKB-së[254]. *Paqëvendosja,* shikuar në prizmin krahasues në raport me tri premisat e lartpërmendura, ka natyrë shumë më imponuese. Siç kuptohet nga emërtimi i saj, ajo në radhët e veta përfshin aso lloj veprimesh dhe masash shtrënguese, saqë ato shkojnë edhe deri te përdorimi i forcës së armatosur konformë dispozitave të Kapitullit VII të Kartës së OKB-së. Këto masa mund të mirren vetëm nëse Këshilli i Sigurimit e bënë konstatimin e ekzistencës së një rreziku serioz të paqes, të një thyerje të paqes, apo edhe të një akti të agresionit[255].

Me gjithëkëtë, përveç katër koncepteve të Ghalit, në literaturën dhe studimet për veprimtarinë paqëruajtëse ndërkombëtare, gjithashtu, si komponent i rëndësishëm është edhe koncepti i *Paqëndërtimit*[256]. Paqëndërtimi zakonisht

---

[252] United Nations Peacekeeping Operations Principles and Guidelines, UN/ DPO & DFS, New York, January 2010, p. 17.

[253] Reka, *UNMIK as internacional governance...*, 2003, p. 111.

[254] Po aty,p. 111.

[255] Yuji Uesugi, *The Nexus between UN Peacekeeping and Human Security*…, 2004, pp. 101.

[256] United Nations Peacekeeping Operations Principles and Guidelines, UN/ DPO & DFS (New York: 2010), p. 18; Boutros Boutros-Ghali, "Improving the Capacity of the United Nations for Peacekeeping: Report of the Secretary-General (A/48/403, S/26450)" in Paul Taylor, Sam Daws, and Ute Adamczick-Gerteis (eds.), *Documents on Reform of*

përfshin një sërë masash disi më afatgjate, që poashtu kanë karakter preventiv. Ato ndërmerren me qëllim që t'i eliminojnë apo të paktën t'i zvogëlojnë ato parakushte që mund të shpiejnë drejt rikthimit në konflikt. Këto masa ndërmerren në koordinim me mekanizmat e brendshëm institucional të shoqërisë apo territorit me problem të paqendrueshmerisë së paqes. Ato shkojnë drejt forcimit të kapaciteteve vendore në të gjitha nivelet lidhur me menaxhimin e konflikteve, si dhe për të krijuar parakushte për një paqe të qëndrueshme në planin sa më afatgjatë[257].

Por, sidoqoftë, tani për tani konsiderohet se kufijtë në mes të këtyre koncepteve të paqes janë bërë gjithnjë e më të ndërlidhur dhe të paqartë, ashtu siç tregohet në figurën 6.

Figura 6. Elementet dhe konceptet e paqes: Lidhjet dhe Fusha e Hirtë.



Burimi: United Nations Peacekeeping Operations Principles and Guidelines, UN/ DPO & DFS, New York, January 2010, p. 17.

---

the United Nations (Aldershot: Dartmouth, 1997), p. 68. See also Boutros Boutros-Ghali, *An Agenda for Peace: Preventive Diplomacy, Peacemaking and Peace-keeping* (A/47/277, S/24111) (New York: United Nations, 1992), p. 11 (para. 20-21), and Boutros Boutros-Ghali, *Building Peace and Development 1994* (New York: United Nations, 1994), pp. 147-278 (para. 397-787).

[257] United Nations Peacekeeping Operations Principles and Guidelines, UN/ DPO & DFS, New York, January 2010, p. 18; Yuji Uesugi, *Nexus between UN Peacekeeping and Human Security*…, 2004, pp. 101.

Megjithëkëtë, instrumentet e propozuar nga Ghali për ruajtjen e paqes dhe sigurisë botërore, u bënë objekt i kritikave të shumta, sidomos kur ato u treguan joefikase në menaxhimin e konflikteve ndër etnike si në Somali, Ruanda dhe në Bosnjë e Hercegovinë[258], të cilat zhvilloheshin në të njëjtën kohë kur diskutimet për reformën e operacioneve të paqes të OKB-së të parashtuar nga Ghali ishin në proces e sipër. Përballë këtyre rrethanave, Ghali, në njëfarë forme u detyrua të shkruante një raport shtesë rreth angazhimeve të reja të OKB-së lidhur me paqeruajtjen, në një mjedis ku rrethanat konfliktuale po ashpërsoheshin gjithnjë e më tepër .

Ky raport strategjik shtesë, u shfaq në vitin 1995 në 50 vjetorin e themelimit të OKB-së. Raporti bëri një paraqitje vlerësuese të projektimeve të "Agjendës për Paqe", e paraqitur dy vjet më parë, dhe ishte fokusuar në dy drejtime. Së pari, në lidhje me atë çka ishte bërë, Ghali theksoi se shumica e rekomandimeve dhe koncepteve të projektuar në "Agjendën për Paqe" në përgjithësi ishin zbatuar. Së dyti, në lidhje me atë se çka mbetet për t'u bërë, Ghali arriti në përfundim se, megjithatë, akoma nevojiten ndryshime rrënjësore operacionale dhe strukturore drejt përpjekjeve të ardhshme të OKB-së për të siguruar një ambient ndërkombëtar më paqësor[259].

Një përpjekje tjetër për reforma transformuese në rritjen e efiqencës së paqeruajtjes së OKB-së, lidhet ngushtë me Raportin e Panelit të Operacioneve të Paqes (i njohur si Raporti Brahimi), përmes të cilit, simbolikisht u shënua hyrja në shekulli e XXI-të.

Duke hyrë në shekullin e XXI-të , Kombet e Bashkuara u përballën më një mori problemesh, të cilat paraqiteshin si sfida shumë serioze për të ardhmen e sistemit të paqëruajtjes, gjë që i shtyen zyrtarët dhe mekanizmat brenda vetë OKB-së, të ndërmerrnin masa për evitimin e të metave dhe avanimin e mëtejmë të këtij sistemi paqeruajtes. Të metat, kryesisht i atribuoheshin disa dështimeve të operacioneve paqeruajtëse të OKB-së në Somali, Ruanda dhe Bosnjë e Hercegovinë, e që e kishte

---

[258] Edward Luck, *The Secretary-General in a unipolar world,* in *Secretary or General? The UN Secretary-General in the World Politics*, Edited by Simon Chesterman (New York: Cambridge University Perss, 2007), p. 206.

[259]Boutros Boutros-Ghali, *Supplement to An Agenda for Peace. Position Paper of the Secretary General on the Occasion of the Fiftieth Anniversary of the United Nations*, S/1995/1, 3. Januar 1995.

.

dobësuar tej mase kredibilitetin e paqëruajtjes së OKB-së. Në përpjekje për t'iu përgjigjur këtyre sfidave dhe për ta rritur efikasitetin e paqeruajtjes në të ardhmen, në gusht të vitit 2000, u hodh në diskutim raporti Brahimi, i cili në njërën anë paraqiti një kritikë të rreptë të operacioneve të OKB-së dhe në anën tjetër, bëri rekomandime specifike për ndryshime ldhur me këto operacione. Ndër të tjera, në këtë panel u argumentua se vetëm në saje të bërjes së këtyre ndyshimeve që rekomandohen këtu, Kombet e Bashkuara do të kenë mundësi t'i realizojnë pritjet e tyre në përmbushjen e atyre sfidave kritike, si në paqeruajtje, ashtu edhe në paqëndërtimi përgjatë shekullit 21.[260] Raporti në fjalë hartoi një vizion për ta përtërirë paqeruajtjen e OKB-së në mënyrë që ta bëjë një paqeruajtje të fortë, më efektiv dhe krahasimisht me kosto efikase. Raporti Brahimi bëri thirrje për përmirësime të thella në strategjinë dhe doktrinën e operacioneve të paqes. Në total, ai përbëhej nga 57 rekomandime, të cilat mund të fokusohen në katër kategori përmbajtësore: Së pari, jepeshin rekomandime për doktrinën, strategjitë dhe vendimmarrjen për operacionet e paqes, së dyti, për planifikimin dhe rritjen e kapacitetit për vendosjen e shpejtë dhe efektive të trupave paqeruajtëse në terren, së treti, për përmirësimin e strukturave dhe burimeve të vetë selisë së OKB-së, dhe së katërti, rekomandimet ishin lidhur me zbatimin e operacioneve komplekse të paqes, sidomos rreth strategjive në fushën e teknologjisë së informacionit dhe për "misionet paqeruajtëse në epokën e informacionit" [261].

Në përmbledhjen e raportit, Komisioni përcaktoi vetë fokusin e propozimeve të tyre si më poshtë: "Rekomandimet tona fokusohen jo vetëm në nivel politik dhe strategjik, por ndoshta edhe në një masë më të madhe, lidhur me kërkesat operacionale dhe organizative". Poashtu, raporti tregon se, megjithatë, rekomandimet mund të jenë efektive vetëm nëse shtetet anëtare të OKB-së do të veprojnë duke ndihmuar politikisht, financiarisht dhe me personel mbështetës në zbatimin e propozimeve[262].

Por, me të hyrë në shekullin e XXI-të, veprimtaria paqeruajtëse e Kombeve të Bashkuara u gjend në një udhëkryq duke u përballur me shumë sfida të reja të natyrës politike, ushtarake dhe financiare, ku që të gjitha kërcënonin direkt unitetin e vizionit dhe qëllimin e partneritetit paqeruajtës global. Prandaj, është vlerësuar se, në

[260] William J. Durch et al., *The Brahimi Report and the Future of UN Peace Operations*, The Henry L. Stimson Center, 2003, Executive Summary.

[261] Report of the Panel on United Nations Peace Operations, A/55/305 S/2000/809, 21 August 2000, pp. 1-58.

[262] Po aty, p.iii.

përballimin e këyre sfidave, është mëse i domosdoshëm një partneritet dhe axhendë e përbashkët me qëllim që paqeruajtja e OKB-së të mund t'i përmbushë sfidat me të cilat ndeshet në moment dhe ato që e presin në perspektivë. Në këtë drejtim, riorganizimi i modeleve të operacioneve të paqes së OKB-së për në shekullin XXI, shkoi nga ato paqëruajtëse në paqendërtuese, që do të thotë se u fillua një proces transformues.

2.3 **Modeli i operacioneve të paqes së OKB-së në shekullin XXI: nga paqeruajtëse në paqendertuese**

Procesit të transformimit të koncepteve të paqes dhe sigurisë në përgjithësi, i ka kontribuar fuqishëm organizimi i rendit të ri ndërkombëtar që erdhi pas shpërbërjes së rendit të vjetër bipolar. Ky riorganizim ka reflektuar direkt edhe në transformimin e sistemit paqëruajtës të OKB-së. Madje, ky transformim ka qenë i karakterizuar me aplikimin e disa qasjeve të reja unike të përshtatura konform natyrës së re të situatave konfliktuale në terren. Meqenëse, siç theksuam më lartë, pas Luftës së Ftoftë, konfliktet kanë qenë më të theksuara brenda shteteve sesa në mes tyre, rrjedhimisht ishin krijuar me dhjetëra situata të rënda humanitare për sanimin e të cilave kërkohej një qasje "ndërhyrëse direkte" nga bashkësia ndërkombëtare dhe OKB-ja në "çështjet e brendshme të këtyre shteteve". Në këso situata, përpjekjet e OKB-së nuk ishin më të përqendruara vetëm në parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve, tanimë ato synonin edhe gjetjen e shkaqeve të tyre me qëllim që të krijonin rrethana për një paqe të qëndrueshme. Zgjerimi i qasjeve për të ndërtuar një *"paqe të qëndrueshme"*, ishte objektivi kryesor strategjik që synohej të arrihej nga OKB-ja dhe bashkësia ndërkombëtare.

Megjithëkëtë, pas parashtrimit të këtij objektivi strategjik, në planin veprues, kishte diçka që paraqitej si pengesë. Ishin parimet e vjetra, që për çudi ende e përbënin sistemin modern të marrëdhënieve ndërkombëtare. Është fjala për binomin e *"sovranitetit dhe mosndërhyrjes në punët e brendshme"*, i cili tanimë, përballë rrethanave të reja, do të duhej t'i nënshtrohej një riinterpretimi dhe rikonceptimi, në mënyrë që të mos paraqitej si pengesë në arritjen e kësaj objektive strategjike për mijëvjeçarin e ri.

Në vijim do të analizohen këto dy fenomene se si e kanë ndikuar njëri-tjetrin, dhe si kanë ndikuar më vonë këto të dyja, si të marrura së bashku, në transformimin e misioneve të paqes në ditët e sotme.

Meqenëse kemi të bëjmë me natyrën evoluese të një parimi dhe praktike të organizimit të marrëdhënieve ndërkombëtare, aplikimi i teorisë konstruktiviste dhe postmoderniste, do të ishte me mjaft interes, për faktin që të dyja këto teori janë mjaft të përshtatshme në analizimin dhe shpjegimin e fenomeneve të tilla.

Është fakt i pakontestueshëm se sistemi modern i marrëdhënieve ndërkombëtare, praktikisht ka qenë ngritur dhe formësuar rreth parimit të sovranitetit. Thënë ndryshe, parimi i sovranitetit është shfaqur në njërën anë si një gurëthemel në organizimin e brendshëm të shteteve, dhe në anën tjetër, si një nyje neuralgjike e rrjetës së sistemit ndërkombëtar deri në ditët tona. Edhe në planin studimor është imponuar si një paradigmë për analizimin e pjesës dërmuese të zhvillimeve në skenën e politikës botërore. Për shembull, parimi i sovraniteti dhe çështjet që ndërlidhen me të, e kanë shoqëruar komplet epilogun e evoluimit të sistemit të marrëdhënieve ndërkombëtare.

Sistemi modern ndërkombëtar, ashtu siç u përcaktua në *Traktatin e Vestfalisë*, ka lindur nga *Lufta Tridhjetëvjeçare,* ku parimet bazë të të cilit, vlerësohet se i kanë formësuar marrëdhëniet ndërkombëtare deri më sot[263]. Nga ky parim kishte lindur koncepti i mosndërhyrjes në punët e brendshme të shteteve të tjera, por sipas Kisiinger, këto konceptime sot nuk janë edhe aq relevante, dhe se herë pas here ato sot mund hidhet poshtë[264]. Në këtë drejtim, Kissinger thekson se aktualisht rendi Vestfalian ndodhet përballë një krize sistematike, ku parimet e tij po sfidohen në mënyrë të pariparueshme, në favor të një koncepti të ndërhyrjes universale humanitare ose justifikimit universal, nga shumica e komunitetit perëndimor, e madje edhe nga një numër i madh shtetesh të tjera anë e mbanë botës[265]. Kjo ndoshta mund të jetë një tregues për karakterin evolues të normave dhe parimeve në sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare.

Duke parafrazuar Hadely Bull-in, i cili vështroi se idetë e drejtësisë njerëzore, historikisht i kanë paraprirë zhvillimit të ideve edhe për drejtësinë ndërshtetërore ose ndërkombëtare, mund të thuhet se këto konceptime edhe sot përbëjnë themelet

[263] Kissinger, *A ka nevojë Amerika për një politikë të jashtme...*, f. 358-359.

[264] Po aty, f. 359.

[265] Po aty, f. 18.

parimore intelektuale mbi të cilat janë ngritur ide të fundit për drejtësi ndërkombëtare[266]. Kissinger këtë evoluim të shoqërisë moderne të shteteve dhe këtyre relacioneve të drejtësisë, i shpjegon përmes mënyrës së funksionimit të sistemit ndërkombëtar Vestfalian dhe sfidave para të cilave ai gjendet sot. Më tej, ai thekson se sistemi Vestfalian, ofronte zgjidhje për dhunën ndërmjet shteteve, "por nuk ofroi zgjidhje për dhunën *brenda* shteteve të shkaktuar nga luftërat civile, konfliktet etnike, dhe gjithë rrezen e atyre që sot quhen dhunime të të drejtave të njeriut"[267]. Sipas Kisiinger, në ditët tona, mbështetësit e të drejtave të njeriut argumentojnë në mënyrë të kundërt. Ata vlerësojnë se nëse ka drejtësi, paqja do të rrjedhë në mënyrë të natyrshme prej saj, dhe sipas tyre, nuk mund t'i besohet çdo shteti dhënia e drejtësisë. Si alternativë, ata vlerësojnë se "drejtësia duhet të vendoset nën njëfarë autoriteti supranacional me të drejtën për të përdorur forcën për ta bërë këtë vendim të funksionojë"[268].

Lidhur me natyrën evoluese të fenomeneve dhe koncepteve në MN, kritikët postmodern të realizmit nuk shohin asgjë objektive në lidhje me interesat shtetërore e, sigurisht, asgjë universale[269]. Ashtu siç Richard Ashley, thekson për një dimension të boshtit fuqi-dije dhe domosdonë se si "paradigma e sovranitetit" në mënyrë stimultante ngre disa dispozita të caktuara epistemologjike të jetës politike moderne, gjithashtu, Cynthia Weber ofron një shpjegim se si konfiguracionet e ndryshme të fuqisë dhe dijes i japin shtytje konceptimeve të ndryshme të *sovranitetit, shtetësisë dhe intervenimit*[270].

Këto ngjarje praktike, sipas teorisë postmoderniste të MN, dëshmojnë se rikonceptimi i sovranitetit shtetëror nuk varet nga prezenca e politikës themeluese (siç thonë realistët), por nga praktikat evoluese të fuqisë dhe dijës, dhe ai konceptohet varësisht nga rrethanat në sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare.

---

[266]Scott Burchill et al., *Theories of International Relations*..., 2001, p.107.

[267] Kissinger, *A ka nevojë Amerika për një politikë të jashtme*..., 2003, f. 360.

[268]Po aty, f. 360-361.

[269] Po aty, f.144.

[270] Cynthia Weber & Thomas J. Biersteker, *Reconstructing the Analysis of Sovereignty:* Concluding Reflections and Direc-tions for Future Research, in STATE SOVEREIGNlY AS SOCIAL CONSTRUCT, supra note 8, at 278, 278; cit pipas John H. Jackson, Sovereignty - Modern: A New Approach to an Outdated Concept, Georgetown University Law Cente, 2003, p. 787.

Në anën tjetër, në vend të konceptimit të shteteve si subjekte me interesa të paradhëna, për shembull, konstruktivistët argumentojnë se bërja e identiteteve shtetërore, duke përfshirë edhe atë të sovranitetit, arrihet nëpërmjet procesit të një debati socializimi dhe ndërveprimi të vazhdueshëm shoqëror. Si rezultat i kësaj, një koncept i tillë si sovraniteti, nuk mund të mbetet përgjithmonë statik, për shkak se ai është një krijimtari intersubjektive e përbashkët e një komuniteti që i shërben legjitimimit të autoritetit shtetëror, dhe në momentin kur rrethanat shoqërore ndryshojnë, sovraniteti nuk mbetet asgjë më tepër sesa një "e vërtetë intersubjektive"[271].

Lidhur ngushtë me zhvillimet rreth rikonceptimit të sovranitetit dhe mosndërhyrjes nga jashtë, është edhe koncepti gjithnjë e më popullor i "sigurisë njerëzore". Si një nga prezantimet e para që e kishte futur edhe idenë e sigurisë njerëzore ishte Agjenda për Paqe e Ghalit. Në këtë raport ai shtoi se pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, njerëzit iu kishin ekspozuar rreziqeve shumë më tepër në krahasim me shtetet, gjë që ishte imponuar nevoja për ti mbrojtur në përputhje me mundësitë dhe rrethanat[272]. Pas këtij raporti, disa institucione dhe organizata kanë vazhduar ta përdorin këtë koncept, dhe se me publikimin e "Përgjegjësisë për të Mbrojtur" në vitin 2001 nga Komisioni Ndërkombëtar për Intervenimin dhe Sovranitetin Shtetëror (ICISS), koncepti duket të jetë rrënjosur mjaft mirë në arenën ndërkombëtare, megjithëse ende me një përkufizim mjaft të paqartë[273]. Ky komision e ka ripërcaktuar sovranitetin më shumë si një e drejtë për vetëqeverisje (sovraniteti negativ), dhe i ka dhënë më tepër atributet e një institucioni të "përgjegjësisë" që i detyron qeveritë e shtetve t'i udhëheqin qytetarët mbi parime porale dhe të jenë në shërbim të tyre (sovraniteti pozitiv)[274].

---

[271] Alexander Wendt, "Anarchy is What States Make of It: The Social Construction of Power Politics", *International Organization* 46 (1992), pp. 391-425; Kathryn Sikkink, "Human Rights, Principled Issue-Networks, and Sovereignty in Latin America", *International Organization* 47 (1993), p. 413-441.

[272] Nina Wilén, *Paradoxes or Strategies in International Governance? The Case of Kosovo*, Paper presented at REGIMEN Conference 'Le nouveau système international' in Mons, 7 March 2007.

[273] Coelho, "Building stable and effective states through international governance"..., 2008.

[274] Po aty, 2008, p.20.

Pavarësisht problemit të përkufizimit, koncepti përfshin një riinterpretim të sovranitetit dhe e vendos idenë e "ndërhyrjes humanitare" pranë terrenit të detyrës morale, duke minuar kështu parimin e sovranitetit klasik. Futja e sigurisë njerëzore i bënë ndërhyrjet disi më pak të diskutueshme, dhe më pas lehtëson ndërmarrjen e aktiviteteve për ndërtimin e shteteve nga forcat e jashtme[275].

Megjithëkëtë, duke u përpjekur ta kontestojnë natyrën statike të sovranitetit dhe duke e justifikuar ndërhyrjen nga jashtë në favor të mbrojtjes të së drejtës humanitare, qëndrimet radikale të postmodernizmit paraqiten në atë masë sa ata e vënë në dyshim jo vetëm kuptimin e sovranitetit, por dhe gjithë kuptimin e shtetit si akter. Për ta, shtetet nuk janë objekte reale të prekshme dhe si të tilla nuk ekzistojnë. Ato janë "shpikje" që njerëzit i krijojnë për t'i bërë të qarta dhe për t'u dhënë kuptim sjelljeve të grupeve të mëdha të njerëzve.

Lidhur me këtë, disa studiues si Weller, argumentojnë se rasti i Kosovës zbuloi se shtetet nuk mund të thirren në autoritetin e tyre për ta përborur si justifikim në cenimin e të drejtave dhe privilegje të qytetarëve të tij, nga të cilët përbëhet vet shteti si autoritet politik. Rrjedhimisht, pasi që shteti ta ketë marrur autoritetin e sovranit nga vetë qytetarët, ai nuk mund të përdorë këtë si preludi për të ushtruar masa represive ndaj tyre, në emër të parimit të këtij sovraniteti. Prandaj, shikuar nga kjo perspektivë, aksioni i NATO-s në raport me Kosovën shërbeu si një referencë "për ta udhëzuar praktikën ndërkombëtare, në lindje e sipër, të aksionit humanitar, për t'i mbrojtur popullatat e rrezikuara". Së këndejmi, sipas Weller, "Kosova shënon nismën e një forme të re më të avancuar të politikës ndërkombëtare-episodi shërben si burim i një rendi të ri ndërkombëtar, e jo i shuarjes së tij"[276].

Postmodernistët, duke kundërshtuar pretendimet e realistëve se shtetet janë akterë të vetëm, këta arrijnë të vështrojnë realitete dhe përvoja të shumëfishta që qëndrojnë nën sipërfaqen e tërësive joreale që realistët i krijojnë (shtetet). Kështu, duke ndjekur strategjitë tekstuale të postmodernizmit, kuptojmë se edhe vetë bota është "tekst" dhe nuk mund t'i referohemi si e "vërtetë" përveç duke e interpretuar. Për shprishjen e këtij interaksioni tekstual, postmodernizmi përdorë strategjitë e dekonstruksionit dhe të leximit të dyfishtë në mënyrë që të bëjë të ditura ato gjëra që janë të fshehura[277].

---

[275] Wilén, *Paradoxes or Strategies in International Governance?...*,2007.

[276] Weller, *Shtetësia e kontestuar...*, faqe 35-36.

[277] Goldstein, *Marrëdhëniet Ndërkombëtare*, f.144.

Jugosllavia, për shembull, prej realistëve ka qenë trajtuar si një akter i vetëm më një tërësi të vetme interesash objektive. Në dukje të parë, Jugosllavia ishte vështruar si shteti më stabil i Evropës dhe më gjerë. Por, realistët u gjenden "para aktit të kryer" dhe ishin të habitur kur shteti i quajtur Jugosllavi u shpërbë në pesë pjesë (republika) në fillim, e më pas në gjashtë me Malin e Zi me 2006 dhe në shtatë me Kosovën me 2008, dhe se secila nga to kishte grupe dhe elemente të veta konfliktuale. Më në fund u bë e qartë se "shteti i vetëm" i quajtur Jugosllavi shërbente vetëm si maskë për përvojat e ndryshme të republikave, grupeve etnike e individëve përbërës[278]*.

Një tjetër moment i rëndësishëm në përpjekjet e OKB-së për ta përmirësuar sistemin paqeruajtës në fillim të shekullit XXI, përveç rikonceptimit të parimit të sovranitetit dhe mosndërhyrjes, është edhe ai i dimensioneve të zgjeruara në ndërtimin e paqes së qëndrueshme.

Në procesin evolues të veprimtarisë paqëruajtëse të OKB-së, zgjerimi i qasjes në ndërtimin e një paqeje të qëndrueshme, paraqet reformën më të rëndësishme dhe njëkohësisht më transformuese të këtij procesi. E ndërmarrur nga lidershipi më i lartë i OKB-së, kjo qasje e zgjeruar, tregon se ishte një objektivë e lartë strategjike që me çdo kusht duhej arritur, në mënyrë që sistemi paqëruajtës i OKB-së të ishte më efiqient përballë situatave sfiduese konfliktuale në rrethana të reja. Në fakt, duke rishikuar në Agjendën e Ghalit, mund të gjinden konceptet dhe masat e para konkrete që u ndërmorën nga OKB-ja, me qëllim që të krijoheshin kushte për një paqe të qëndrueshme. Në këtë Agjendë, kjo parashihej të arrihej në saje të një bashkërendimi të aktiviteteve post-konfliktuale, që kishin për qëllim të "identifikonin dhe mbështetnin ato struktura të cilat kanë tendencë për të forcuar dhe vendosur paqen, në mënyrë që të shmanget rikthimi i konfliktit"[279]. Kjo objektivë, nga Departamenti i OKB-së për Çështje Politike (DPA), që ishte paraardhësi i Komisionit për Ndërtimin e Paqes në sistemin e OKB-së, përkufizohet si një veprim "harmonik dhe i integruar në

[278] *Kjo bënë të kuptojmë se sipas postmodernistëve, koncepte të tilla si shteti sovran janë labile (të paqëndrueshme) dhe jo realitete objektive, të cilat ndryshojnë vazhdimisht sepse janë të shtyra nga konfiguracione të fuqisë dhe dijës. Këto kategori analitike të fuqisë dhe dijës të aplikuara nga postmodernizmi, shërbejnë si "standard i artë" për të analizuar rastin e Kosovës, sidomos në kontekstin e përdorimit të forcës dhe të ndërhyrjes humanitare, në atë kuptim që tregon se parimet e mosndërhyrjes në sovranitetin e një shteti në periudhën moderne janë të thyeshme.

[279] Boutros-Ghali, *An Agenda for Peace*, p. 11.

shumë fronte të ndryshme: ushtarake, diplomatike, politike, ekonomike, sociale, humanitare". Me fjalë të tjera, përtej detyrës së ndërtimit të institucioneve kombëtare, ndërtimi i paqes mund të përfshijnë asistencën humanitare, riatdhesimin e refugjatëve, dhe demobilizimin ushtarak, etj.[280]

Lidhur me ndërveprimin e këtyre komponentëve, rendësi të veçantë ka edhe riafirmimi që iu bë tyre në "Raportin Brahimi", i cili inicioi edhe krijimin e "Njësisë Paqëndërtuese" për një koordinim më të mirë të operacioneve të paqes. Përveç kësaj, raporti theksoi se forcimi i mëtejmë i kapaciteteve për ndërtimin e paqes, në kuptimin e gjerë, duhet të mbetet preokupimi kryesor për OKB-në [281]. Pastaj, konform përpjekjeve për krijimin e mekanizmave në shërbim të paqëruajtjes ndërkombëtare, në vitit 2004, Raporti i Panelit të Nivelit të Lartë mbi Kërcënimet, Sfidat dhe Ndryshimet të Sekretarit të Përgjithshëm, e këshilloi themelimin e një "Komisioni Paqëndërtues" për të mbikëqyrur administrimin ndërkombëtar të shteteve post-konfliktuale dhe të dështuara[282].

Si pjesë e procesit të zgjerimit të kapaciteteve për ndërtimin e paqes së qëndrueshme, në vitin 2008, Departamenti i Mbështetjes Fushore (DFS) u krijua në mënyrë që të përqëndrohet në përmirësimin e kapaciteteve administrative dhe logjistike. DPKO dhe DFS, gjithashtu morën mbështetje nga Departamenti i Çështjeve Politike (DPA), i cili ka për mandat që të bëjë monitorimin dhe vlerësimin e evoluimit të situatës politike në botë, duke ofruar këshilla për Sekretarin e Përgjithshëm, menaxhimin e emisarëve special dhe misionet politike. Por, sado që të gjitha këto reforma u ndërmorën për t'i rritur aftësitë e OKB-së, prapë se prapë OKB-ja ende hasë pengesa serioze në vendosjen e operacioneve të paqes[283].

Siç vërehet, ndërtimi i paqës së qëndrueshme, përmes një qasjeje të zgjeruar, është një proces mjaft kompleks dhe shumëdimensional. Ky shumëdimensionalitet krijohet nga kombinimi i faktorëve dhe koncepteve tekniko-procedurale dhe atyre ideologjiko-

---

[280] Coelho, "Building stable and effective states through international governance"..., pp.70-71.

[281] Baliqi, "Externes State-Building durch die Vereinten Nationen"..., 2008, s. 66.

[282] David Chandler, *The State-Building Dilemma: Good Governance or Democratic Government?*, at: *State-Building theory and practice,* Routledge, Edited by Aidan Hehir & Neil Robinson, 2007, pp. 70-88..

[283] Jocelyn Coulon, *Whatever Happened to Peacekeeping? The Future of a Tradition*, Canadian Defence & Foreign Affairs Institute, 2010, p. 17.

politike. Faktorët e parë konsistojnë në bashkërendimin e procedurave administrative dhe logjistike nën ombrellën e faktorëve të dytë dhe për shërbimin e tyre.

Andaj, operacionet e paqës që u ndërmorën nga OKB-ja, u bazuan edhe në disa teori politike si ajo e *"paqës liberale"* që u shfaq si pikë konceptuale e fillimit të ndërtimit të paqës. Kjo teori fillon nga supozimi se demokracia liberale dhe ekonomia e tregut, janë garantuesi më i mirë i paqes dhe premisa më e mirë për t'i zgjidhur konfliktet e dhunshme në mënyrë paqësore[284]. Sipas torisë së paqës liberale, në ndërtimin e paqes, shumë struktura të ndryshme shoqërore përpiqen të veprojnë në aspektin politik dhe ekonomik. Prandaj, zgjerimi i detyrave, ndikoi në rritjen e bashkëpunimit ndërmjet Kombeve të Bashkuara dhe qeverive të ndryshme si dhe Organizatave Joqeveritare, Institucioneve Financiare Ndërkombëtare, por sidomos me Organizatat Rajonale në zbatimin e detyrave të sigurisë[285]. Andaj, duke pasur parasysh këtë qasje të zgjeruar në ndërtimin e paqës së qëndrueshme, OKB-ja ka marrur përsipër një shkallë të gjerë të detyrave dhe e ka rritur rrejtin e bashkëpunimit me më shumë mekanizma tjerë ndërkombëtar dhe rajonal.

Ky karakter shumëdimensional i misioneve të gjeneratës së katërt, që erdhi në saje të një procesi të reformave transformuese, gjatë dekadës së fundit, sipas një raporti të Institutit Danez për Studime Ndërkombëtare (DIIS)[286], ka qenë i karakterizuar me disa fenomene, si të nënkuptuara, në evolucionin kryesor në operacionet e paqes. Para së gjithash, ato përshijnë detyra si: "Mbrojtja e civilëve, Shumëdimensionaliteti, Ringjallja e OKB-së, Kujdestaria Virtuale, Mos lënia e asnjë organizate anash, Paqeruajtja Aparteid"[287].

2.4 Misionet shumëdimensionale paqëndërtuese: qeverisja dhe shtetndërtimi ndërkombëtar

[284] Chandler, *The State-Building Dilemma...*, p.74.

[285] Oliver P. Richmond, *Understanding the Liberal Peace*, University of St Andrews, p.11, This essay is based in part upon his new study, *The Transformation of Peace*, Palgrave, forthcoming 2005. Avaliable: http://www .academia.edu/2974440/ Understanding_the_Liberal_Peace

[286] Andersen, *UN Peace Operations in the 21st Centyry...*, p. 5.

[287] Po aty, p. 20.

Një përkufizim disi më i qartë për karakterin shumëdimensional të ushtruar nga administratat ndërkombëtare moderne transitore, është ofruar nga Coelho, sipas të cilit, këto administrata efektivitetin e tyre e manifestojnë duke kryer përgjegjësi të dyfishtëa: si *qeverisje ndërkombëtare të përkohshme* dhe si *agjent shtetndërtues*[288]. Ky mandat i dyfishtë, i ushtruar nga një administratë ndërkombëtare, konsiston dhe ka për synim rritjen e sovranitetit empirik të territorit nën administrim - me fjalë të tjera, që autoriteti shtetëror në mënyrë efektive të mund të kontrollojë tërë territorin e tij dhe të ofrojë siguri themelore fizike dhe ekonomike të qytetarëve të tij [289]. Si pjesë e mandatit të dyfishtë, administratat ndërkombëtare zakonisht janë të ngarkuara me përgjegjësinë e rindërtimit të institucioneve të qeverisjes në territoret nën kontrollin administrativ të tyre.

Duke pasur parasysh këto praktika, politikë-bërësit dhe studiuesit kanë bërë thirrje për një shtim të kategorive konceptuale për të përshkruar këto aktivitete apo praktika të administratave ndërkombëtare si operacione shumëpalëshe (dhe ndërhyrjeve të tjera ndërkombëtare), që i zhvillojnë në shoqëritë postkonfliktuale [290].

Si rezultat i këtyre zhvillimeve, administratat ndërkombëtare kanë qenë të lidhura me një varg të kategorive të ndërhyrjes ndërkombëtare, duke përfshirë konceptet si: ndërtimi i paqes, kombndërtimi, shtetdërtimi, etj. Në mënyrë të dukshme, shumë prej këtyre koncepteve të ndryshme janë përdorur për të përshkruar aktivitete të ngjashme, dhe në varësi prej autorëve, i njëjti mision ndërkombëtar mund t'i përket një kategorie të ndryshme. Për shembull, ajo çfarë është llogaritur si shtetndërtim për një autor, mund të jetë llogaritur si paqëndërtim për një autor tjetër[291]. Siç ka vërejtur Caplan, ka vështirësi në kapjen e kompleksitetit të këtyre aktiviteteve në një mënyrë kuptimplote teorike. Megjithatë, ajo çfarë ai vëren te këto operacione paqeruajtëse-shumëdimensionale, është përgjegjësia e tyre për funksionalizimin e territorit apo vetë shtetit. Karakteristikë e tyre më unike është "vendosja e strukturave të përkohshme me përgjegjësi të gjera për menaxhimin e aseteve publike dhe ofrimin e shërbimeve

[288] Coelho, "Building stable and effective states through international governance"..., p. 70.

[289] Po aty, p. 18.

[290] Ralph Wilde, "Taxonomies of International Peacekeeping: An Alternative Narrative", *ILSA Journal of International & Comparative Law* 9 (2003).

[291] Tansey, *International Administration and Democratic Regime-Building...*, p. 2.

publike – thjesht ato ushtrojnë disa nga funksionet thelbësore të një qeverie moderne"[292].

Si shembujt më tipik të misioneve shumëdimensionale, që mund të kategorizohen në gjeneratën e katërt (disa madje i kanë quajtur si misione shtetndërtuese), mund të konsiderohen UNMIK-u në Kosovë dhe UNTAET-i në Timorin Lindor. Për më tepër, siç do të mund të vërejmë në vijim, operacionet e paqes të ndërmarrura nga OKB-ja, si në këto dy raste, kanë qenë tejet më shumëdimensionale në krahasim me misionet e tre brezave të mëparshëm. Ky shumë dimensionalitet ka qenë i karakterizuar nga bashkëpunimi i OKB-së me *shumë mekanizma* tjerë ndërkombëtar dhe rajonal, në kryerjen e *shumë funksioneve*.

Në përpjekje për të kuptuar agjendat qeverisëse dhe shtetndërtuese të misioneve të raja të OKB-së të fillim shekullit XXI, është e rëndësishme të nisemi nga dy praktikat e para, të cilat binin nën Kapitullin VII të Kartës së OKB-së, pra nga UNMIK-u dhe UNTAET-i.

Padyshim që krahas paraqitjes së Deklaratës së Mijëvjeçarit, një tjetër ngjarje madhore që e ka shënuar fillimi i shekullit XXI për OKB-në, në vazhdën e procesit të reformave dhe shfaqjes së sfidave të reja të sigurisë, është edhe miratimi nga Këshilli i Sigurimit i dy rezolutave shumë të rëndësishme nën Kapitullin VII të Kartës së OKB-së. Është fjala për Rezolutën 1244 dhe 1272 për administrimin e territoreve, siç ishte rasti me Kosovën dhe Timorin Lindor. Kapitulli VII, megjithatë, ka qenë i thirrur vetëm dy herë për krijimin e administratave ndërkombëtare territoriale, në Kosovë dhe Timorin Lindor[293]. Por, pavarësisht që të dyja këto misione u miratuan nën Kapitullin VII, ato dallojnë nga administratat tjera më të fundit të OKB-së si në Kamboxhia, Sllavoninë Lindore, Guinenë e Re Perëndimore ose në Mostar dhe Bosnje-Hercegovinë. Kjo ngase mandatet e tyre nuk kanë një qëllim të vetëm, pra atë që të krijojë paqen në rajon, por, ato përmes një veprimi shumëdimensional, qoftë deklaruar qartë në mandatet e tyre apo jo, përbëjnë një preludi edhe për shtetndërtim[294].

---

[292] Caplan, *International Governance*..., p. 86.

[293] Zervaki, "UN at crossroad: International Administration of Territories and Domestic Political Culture"..., p. 10.

[294] Po aty, p. 10.

Meqenëse Kosova është dhe ka qenë në qendër të vëmendjes viteve të fundit lidhur me zhvillimet rreth shtetndërtimit dhe sovranitetit, është një rast me vend për të analizuar si shembull praktik, ku UNMIK-u ka ushtruar mandatin e dyfishtë, si qeverisje ndërkombëtare dhe si agjent shtetndërtues. Kjo e ka bërë UNMIK-un një rast të veçantë në marrëdhëniet ndërkombëtare [295].

Në vazhdën e këtyre shpjegimeve, për të kuptuar se si funksionon efektivisht në praktikë një administratë ndërkombëtare, sidomos në realizimin e këtij mandati të dyfishtë si në rastin e UNMIK-ut, paraprakisht është e nevojshme të bëhet një sqarim konceptual i termave që mbajnë prapashtesën "ndërtim". Përveç termave qeverisje ndërkombëtare dhe shtetndërtim ndërkombëtar, në literaturën dhe studimet rreth administrimit ndërkombëtar, përdorën ndërkëmbyeshëm edhe një sërë termash si: paqendërtim, regjimndërtim, dhe kombndërtim.

Një sqarim efektiv i këtyre koncepteve do të ishte i mundur në saje të një kriteri klasifikues që i referohet shkallës së varësisë në mes tyre. Premisa e parë është që të gjitha këto koncepte qëndrojnë në një shkallë të lartë të varësisë reciproke. Por, megjithëkëtë, ato mund të radhiten sipas një skeme piramidale në bazë të asaj që secili prej tyre, në aspektin funksional, është në një shkallë më të ulët të supremacionit në raport me njëri-tjetrin. Për shembull, *paqendërtimi* qëndron në maje të piramidës. Siç u vërejt më sipër, ai paraqitet si një objektivë afatgjate e një administrate ndërkombëtare, dhe se konceptet tjera paraqesin mekanizma për arritjen e kësaj të parës. Pastaj, për t'u arritur kjo objektivë, këto administrata aplikojnë qasje të ndryshme teknike, ku ajo e *shtetndërtimit* dhe e *qeverisjes* janë më të rëndësishmet.

Po ashtu, këto komponente përdorin qasje tjera specifike për t'u bërë sa më funksionale, duke bërë kështu ndërtimin e institucioneve apo *regjimndërtimin*, dhe njëkohësisht, duke zhvilluar një shkallë sa më të lartë të kohezionit kombëtar, pra *kombndërtimin*. Një skemë e ndërlidhjes dhe funksionimit të aktiviteteve dhe objektivave të një administrate ndërkombëtare është dhënë në figurën 7.

[295] Nina Wilén, *Paradoxes or Strategies in International Governance*?..., chapter II.

Figura 7. Dallimi konceptual i shtetndërtimit me konceptet tjera të përafërta.



Së pari është me rendësi të bëhet dallimi konceptual në mes termave qeverisje ndërkombëtare dhe shtetndërtim ndërkombëtar. Dallimi fokusohet në aspektin funksional dhe kohor.

Kur jemi te definimi konceptual, komplikushmëria më e theksuar shfaqet te sqarimi i termit "qeverisje ndërkombëtare", apo siç e quajnë disa autorë "qeverisja globale". Në fakt, qeverisja ndërkombëtare i atribuohet shkallës së autorizimit dhe funksioneve të një administrate ndërkombëtare të vendosur në një territor. Në këtë rast, autoritetet ndërkombëtare ushtrojnë kontroll të plotë, formalisht ose jo formalisht, për të transferuar ose për t'i dhënë përgjegjësi për qeverisje autoriteteve lokale, të cila ende janë të pa përgatitura për sfidat e vetëqeverisjes[296]. Për më tepër, administratat bashkëkohore ndërkombëtare menaxhojnë në mënyrë tipike një fushë më të gjerë të kompetencave të shtetit. Në kushtet e formave bashkëkohore të intervenimit ndërkombëtar, administratat ndërkombëtare ngjajnë me misionet e brezit multi-dimensional të paqeruajtjes në atë se ato angazhohen në aktivitete të ngjashme në

[296] Caplan, *International Governance*..., pp.109-110.

terren, duke përfshirë shtetndërtimin dhe/ose duke marrë përsipër disa kompetenca shtetërore[297].

Në kryerjen e funksioneve të tilla, administratat ndërkombëtare, si pasojë, marrin ingerenca të autoritetit shtetëror, duke u bërë të barasvlershme me një qeveri tipike të shtetit. *Inter alia*, këto administrata, kanë autoritet në nxjerrjen dhe shfuqizimin e ligjeve, në emërimin dhe shkarkimin e zyrtarëve publik, pastaj ato kanë përgjegjësitë e drejtpërdrejta për sigurinë publike, ofrimin e shërbimeve publike, gjenerimin e të ardhurave nga doganat dhe tatimet, dhe formimin e një buxheti dhe politike fiskale[298].

Thënë me fjalë tjera, qeverisja ndërkombëtare paraqitet si njëra nga veprimtaritë kryesore në administrimin e një territori, krahas veprimtarisë tjetër ekuivalente-shtetndërtimit. Të dyja këto veprimtari qëndrojnë në lidhje të pandashme, edhepse qeverisja paraqet një koncept më të gjerë se shtetndërtimi. Në raport me shtetndërtimin, qeverisjen ndërkombëtare e karakterizon aktiviteti i saj imediat, i cili ka synim për të krijuar institucione tranzitore që do të shërbejnë më vonë si substrat për shtetndërtim. Në anën tjetër, shtetndërtimi përfshin krijimin e institucioneve për një qeverisje efektive afatgjate. Sidoqoftë, të dyja këto funksione të një administrate ndërkombëtare shumëdimensionale, paraqiten si elemente esenciale për një paqëndërtim të qëndrueshëm.

Në literaturë mund të ndeshen emërtime variabile edhe për konceptin e shtetndërtimit. Disa autorë e përdorin termin "shtetndërtimi eksternal", disa termin "shtetndërtimi nga ndërhyrjet", e disa "shtetndërtimi ndërkombëtar". Ideja është e njëjtë. Këto prapashtesa i vihen me qëllim që të tregohet se në procesin e shtendërtimit janë involvuar faktorët e jashtëm, dhe njëkohësisht bëhet dallimi nga procesi i formimit të shtetit nga faktorët e brendshëm që kryesisht i takojnë kontekstit evolutiv historik [299]. Poashtu, sa i përket anës konceptuale, para se të merremi me shtetndërtimin, është e nevojshme ta bëjmë një shpjegim të shkurtër se çfarë nënkupton termi shtet në kuptimin konvencional.

Ka shumë mënyra për ta përdorur termin shtet dhe për të kuptuar teoritë e ndryshme të shtetndërtimit. Mirëpo, në kontekstin e shtetndërtimit nga faktorët e jashtëm siç janë administratat ndërkombëtare, sikur është bërë traditë përdorimi i

[297] Coelho, "Building stable and effective states through international governance"..., p.43.

[298] Po aty, p. 16.

[299] Andersen, *UN Peace Operations in the 21st Centyry...*, p.22.

termit shtet sipas kualifikimit që i bëri Max Weber në terma klasikë. Sipas konceptimit Weberian, shteti është i përbërë nga komuniteti njerëzor, i cili brenda një zone të caktuar, e ka monopolin e përdorimit legjitim të forcës fizike mbi këtë komunitet. Në këtë kuptim, shtetin e përbëjnë tërësia e institucioneve publike (burokracia) brenda një territori të definuar, të cilat ofrojnë shërbime tipike të një shteti modern [300]. Rrjedhimisht, koncepti Weberian i shtetit, e ka ndikuar fuqishëm edhe konceptimin modern të shtetndërtimit.

Siç shkruan Chesterman, shtetndërtimi përbën një përfshirje të zgjeruar ndërkombëtare "drejtuar në ndërtimin apo rindërtimin e institucioneve të afta qeverisëse për t'iu garantuar qytetarëve siguri fizike dhe ekonomike" si dhe mbështetje në zhvillimin e një varg fushash ekonomike, politike dhe të sigurisë[301]. Përveç tij, një definicion tjetër që më shumë shtetndërtimin e vlerëson si proces të brendshëm dhe të ndërvarur në relacionin shtet-shoqëri vije nga Whaites, sipas të cilit shtetndërtimi është "proces përmes të cilit shtetet rrisin aftësinë e tyre për të funksionuar". Kjo mënyrë e konceptimit, shtetndërtimit e sheh si një proces kombëtar të brendshëm të varur direkt nga marrëdhëniet shtet-shoqëri. Natyrisht që një konceptim i tillë nuk e përjashton as ndikimn e faktorëve të jashtën siç është tregtia, media apo asistenca, por i cili është formuar kryesisht nga dinamikat lokale[302]. Siç mund të shohim, përkufizimi i Wates më tepër i atribuohet procesit të shtetndërtimit nga faktorët lokal, dhe që rrjedhimisht ka logjikë konceptuese të ndryshme nga procesi i shtetndërtimit nga faktorët e jashtëm, për të cilin përkufizimi i Chesterman-it është më adekuat. Megjithatë, ballafaqimi i të dyjave këtyre koncepteve, ndihmon për tu konceptuar më mirë secila formë e shtetndërtimit në raport me tjetren.

Duke u nisur nga qasjet që Chesterman i promovon për ta përshkruar shtetndërtimin si një agjendë që ka për qëllim parësor "krijimin apo funksionalizimin e institucioneve të qeverisjes", mund të thuhet se shtetndërtimi paraqitet si një koncept më i gjerë sesa regjimndërtimi. Koncepti i regjimndërtimit kap vetëm përpjekjet e bashkësisë ndërkombëtare për të krijuar një sistem të veçantë politik, dhe jo elemente të gjera të kapaciteteve dhe të performancës shtetërore. Në veçanti, kjo ka të bëjë me

[300] Baliqi, "Externes State-Building durch die Vereinten Nationen"..., p. 74.

[301] Simon Chesterman, *You, the People…,*2004, p.5; Oisín Tansey, *International Administration and Democratic Regime-Building*….,2006, p.3.

[302]Alan Whaites, *States in Development: Understanding State-building*, Governance and Social Development Group Policy and Research Division, 2008, p. 4.

një përpjekje për të zhvilluar një regjim demokratik, në të cilin rregullat, procedurat dhe institucionet lejojnë një konkurrencë të rregullt dhe të hapur për qasje ndaj pushtetit politik, dhe garantojnë gamë të gjerë të lirive politike dhe civile që janë të nevojshme për konkurrencë të tillë të hapur[303].

Së fundi, mund të bëhet edhe definicioni i konceptit të kombndërtimit. Ky koncept, përfshinë veprime të ndërmarra, zakonisht nga akterët kombëtarë, për të krijuar një ndjenjë të kombësisë së përbashkët[304]. Për më tepër, kombndërtimi është një projekt që kërkon të zhvillojë aspekte "psikologjike" dhe "baza kulturore". Kjo është një ndërmarrje e veçantë nga ajo e shtetndërtimit. Por, megjithatë, këto dy koncepte, kanë lidhshmëri të madhe mes vete. Shtetndërtimi nuk mund të ketë sukses pa kombndërtimin; struktura dhe institucionet e shtetit nuk mund të funksionojnë në mënyrë efektive pa një shkallë të kohezionit kombëtar[305].

---

[303] Tansey, *International Administration and Democratic Regime-Building...*, p.4.

[304] OECD/DAC Discussion Paper, "Concepts and Dilemmas of State Building in Fragile Situations", *From Fragility to Resilience* 9 (2008), p. 14.

[305] Coelho, "Building stable and effective states through international governance"..., p.70.

KREU III:
FORMATI ORGANIZATIV DHE FUNKSIONAL I UNMIK-ut NË BAZË TË REZOLUTËS 1244: ROLI I UNMIK-ut NË QEVERISJEN NDËRKOMBËTARE TË KOSOVËS

3.1 Baza legale dhe specifikat politike të UNMIK-ut në bazë të Rezolutës 1244

Në studimin e veprimtarisë së UNMIK-ut si një mision unik paqëruajtës i OKB-së, aplikimi i një qasjeje analitike dhe krahasuese do të ishte mëse e domosdoshme. Kjo, ngase të kuptuarit e natyrës dhe veprimtarisë së tij, arrihet më mirë përmes një krahasimi me natyrën dhe veprimtarinë e misioneve tjera paqeruajtëse të përafërta me të.

Duke u nisur nga definimi dhe kategorizimi i natyrës së UNMIK-ut, mund të konstatohet se në doktrinën e së drejtës dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare nuk ka një qëndrim unik lidhur me këtë çështje. Vlerësimet për UNMIK-un fillojnë prej atyre më standarde dhe shkojnë deri tek ato më specifike. Për shembull, disa autorë e përshkruajnë UNMIK-un si një "mision normal paqeruajtës të OKB-së", si një "operacion i zbatimit të paqes", si një "model i moderuar i sistemit të kujdestarisë së OKB-së"[306], si një "administratë territoriale direkte e OKB-së", ose si një "qeverisje ndërkombëtare me një shoqëri të tërë"[307]. Disa autorë të tjerë, UNMIK-ut i kanë dhënë cilësinë e një "agjenti territorial"[308], e disa të tjerë UNMIK-ut, sidomos për rolin mbrojtës, i kanë dhënë epitetin e një "protektori modern"[309]. Përveç kësaj, UNMIK-u është konsideruar si një "eksperiment unik"[310], i cili duke ushtruar autorizime të gjera nën Kreun VII të Kartës së OKB-së, promovoi një "dimension të ri" të qeverisjes ndërkombëtare[311].

---

[306] Reka, *UNMIK as an international governance...*, p. 98.

[307] Caplan, *A New Trusteeship?...*, p. 18.

[308] Bernhard Knoll, "From Benchmarking to Final Status? Kosovo and The Problem of an International Administration's Open-Ended Mandate", *The European Journal of International Law* 16 (2005), p.642.

[309] Friedrich, "UNMIK in Kosovo: Struggling with Uncertainty"..., p. 243.

[310] Wolfgang Petrisch, *Forward in, Human Rights in Bosnia and Herzegovina after Dayton: From Theory to Practice*, edited by Wolfgang Benedek, Hague 1999, p.1

[311] Stahn, International Territorial Administration in the Former Yugoslavia"..., p. 109.

Por, në të vërtetë çka është UNMIK-u? Është mjaft paradoksale, që madje kësaj pyetje nuk i përgjigjet në mënyrë të qartë as vetë Rezoluta 1244, në bazë të cilës është vendosur ky mision! Lidhur me këtë, ndoshta një përgjigjje do të duhej kërkuar nga të vështruarit e formatit të UNMIK-ut në kontekstin e specifikave që e kanë karakterizuar këtë mision. Kanë qenë pikërisht disa elemente specifike që i atribuohen natyrës së UNMIK-ut, e që e përbëjnë veçantinë e këtij misioni në raport me misionet tjera të administrimit territorial të ndërmarra nga OKB-ja. Si elemente të veçanta, para së gjithash, mund të konsiderohen: roli, mandati, objektivat, struktura, kompetencat, përmasat, dhe qasjet, duke e bërë këtë mision shumë unik në krahasim me të gjitha misionet paraprake dhe pasuese.

Sipas Stahn, UNMIK-u ka demonstruar ushtrimin e një shkalle shumë më të gjerë të autoritetit dhe fuqisë, se sa ndonjë mision tjetër paqeruajtës i mëparshëm i OKB-së, si për shembull ai i autoritetit të Përfaqësuesit të Lartë në Bosnjë dhe Hercegovinë[312]. Madje, nga UNMIK-u, OKB-ja u inspirua edhe në themelimin e UNTAET-it në Timorin Lindor. Kështu, sipas Zimmermann, UNMIK-u u bë një nga "ndërmarrjet më të mëdha dhe më sfiduese të OKB-së në fushën e administrimit territorial"[313].

Një aspekt që i referohet veçantisë së UNMIK-ut, ka të bëjë me shkallën e përmasave bashkëpunuese me organizatat dhe mekanizmat tjerë ndërkombëtar. Në këtë kontekst, UNMIK-u mund të konsiderohet se ka shërbyer si precedent për misionet tjera të OKB-së, sepse për herë të parë në historinë e paqeruajtjes, katër organizata bashkëpunuan në kuadër të një operacioni të udhëhequra nga OKB-ja. Pra, siç detajohet në "Konceptin Preliminar të UNMIK-ut"; Kosova është administruar përkohësisht nga OKB-ja, dhe nën-administruar nga UE-ja, OSBE-ja dhe UNHCR-i, pastaj, është mbrojtur nga NATO. Si prania civile, edhe ajo ushtarake, funksionojnë në një mënyrë reciprokisht mbështetëse në drejtim të qëllimeve të njëjta. Ky mision është mbështetur edhe nga organizata dhe institucione të ndryshme ndërkombëtare[314]. Përveç, OKB-së, janë përfshirë edhe një numër i madh i agjensive dhe departamenteve të specializuara si: UNHCR, WFO, PIC i përbërë nga 55 qeveri dhe organizata

[312] Po aty, p.111.

[313] Andreas Zimmermann and Carsten Stahn, "Yugoslav Territory, United Nations Trusteeship or Sovereign State? Reflections on the Current and Future Legal Status of Kosovo", Nordic Journal of International Law, 70 (2001), p.424.

[314] Report of UN Secretary General to UN Security Council pursuant paragraph 10 of UNSC Resolution 1244/1999, (S/1999/672), p.2.

ndërkombëtare, WFP, UNICEF, UNHRO, UNDP, WHO, DPKO, OCHA. Po ashtu, edhe organizata tjera rajonale kanë luajtur një rol të madh mbështetës: Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, ICTY, ICRC, ILO, etj[315].

Një interpretim analitik i rezolutës 1244/1999 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, do të duhej të vihej ndërmjet një vështrimi juridik dhe politik. Kjo, ngase kjo rezolutë ka qenë hartuar dhe implementuar duke u ndikuar fuqishëm ndërmjet parimeve juridike dhe atyre politike të së drejtës dhe marrëdhënieve ndërkombëtare.

Përderisa është e qartë se Rezoluta 1244 përbën bazën juridike dhe politike për instalimin dhe funksionimin e UNMIK-ut, atëherë shtrohet pyetja se ku e ka bazën legale vetë kjo Rezolutë? Juridikisht, kjo rezolutë është adoptuar në kuadër të Kreut VII të Kartës së OKB-së[316]. Por, miratimit të kësaj rezolute dhe instalimit të UNMIK-ut, i ka paraprirë një proces i gjatë dhe tejet kompleks, i dominuar nga parime të politikës ndërkombëtare. Kjo ka bërë që UNMIK-u të promovojë atë dimensionin e ri të misioneve paqëruajtëse (në krahasim me misionet tjera), në kuptimin që vendosjes së tij i ka paraprirë një ndërhyrje humanitare ndërkombëtare përmes mekanizmave rajonalë (siç ishte NATO). Po ashtu, kësaj ndërhyrje humanitare i ka paraprirë një proces tjetër politik,-Konferenca e Rambujesë. Për këtë arsye, Rezoluta 1244, gjatë hartimit të saj i ka marrë në konsideratë edhe ata faktorë që kanë qenë pjesë e këtij procesi.

Shikuar në sfondin e rezolutës 1244, sidomos nga një interpretim politik, duket se korniza politike e kësaj rezolute ishte koncepti i Rambujesë i krijimit të një "autonomie substanciale për Kosovën". Por, procesi negociator i Rambujesë, nuk e ka zgjidhur çështjen e Kosovës, por ai vetëm ka hapur proceset tjera për zgjidhjen e saj. Në këtë drejtim, është vlerësuar se me miratimin e Rezolutës 1244, vetëm sa janë hapur shtigjet e vendimmarrjes nën administrimin ndërkombëtar të Kosovës[317].

Shikuar në prizmin se parashihej realizimi konkret i kësaj autonomie për Kosovën, vërehet se Marrëveshja e Përkohshme e Rambujesë, këtë synonte ta bënte në saje të kombinimit të tre mekanizmave kryesorë. Së pari, parashihte krijimin e

---

[315] Caplan, *International Governance*...,p.34-35.

[316] Dominik Zaum, *The Authority of International Administrations in International Society*, University of Oxford, 2006, p. 12.

[317] Esat Stavileci, "UNSC Resolution 1244 me një vështrim të vaçantë në kornizën kushtetuese", *Kosova Law Review*, 6 (2001), f. 13; Esat Stavileci, *Kosova nën Administrimin Ndërkombëtar*, Gjakovë, 2000.

institucioneve vetëqeverisëse për Kosovën, së dyti, parashihte një mekanizëm për një zgjidhje përfundimtare të statusit politik në fund të tri vjetëve, dhe së treti, riafirmonte sovranitetin jugosllav dhe përfshinte vendosjen e një force të NATO-s për t'i zbatuar këta mekanizma[318]. Por, siç dihet, të gjitha këto përpjekje diplomatike dështuan, pasi Serbia nuk e pranoi këtë marrëveshje. Si rezultat i këtij refuzimi, filloi fushata ajrore e NATO, që zgjati deri më 8 qershor 1999, e që detyroi Serbinë ta pranonte një plan paqeje[319] i hartuar nga G8, si dhe të nënshkruante dhe miratonte Marrëveshjen Tekniko-Ushtarake me KFOR-in (e njohur si marrëveshja e Kumanovës)[320]. Andaj, shikuar kontekstualisht, duke marrur në konsideratë të gjithë këta faktorë dhe rrethana politike, mund të themi që hartimi dhe miratimi i Rezolutës 1244 ishte një kompromis në mes pesë anëtarëve të përhershëm të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, në një moment shumë të komplikuar në kohë[321].

Nëse shikohet për nga ana e objektivave dhe funksioneve, Rezoluta 1244, rezulton të ketë qenë një dokument me një gjuhë mjaft të koduar, sidomos lidhur me zhvillimet që do të pasonin pas vendosjes së UNMIK-ut. Si pasojë e kësaj, gjatë gjithë procesit të administrimit të Kosovës nga UNMIK-u, kjo rezolutë është interpretuar në varësi të kaheve që kanë marrë zhvillimet në terren. Prandaj, tanimë është e qartë se kjo rezolutë u përgjigjej më qartë zhvillimeve në momentin kur u hartua, gjë që e sanoi mjaft efektshëm situatën konfliktuale të atëhershme, se sa zhvillimeve në perspektivë.

Ndër objektivat e njohura që sanksionoheshin në dispozitat e Rezolutës 1244, dy ishin më të rëndësishmet dhe njëkohësisht më urgjente për t'u implementuar. Mund të themi se ato kanë pasur për qëllim sanimin e menjëhershëm të situatës post-konfliktuale në Kosovë. Objektiva e parë e njohur e Rezolutës 1244, ka qenë legalizimi i fushatës së NATO-s. Kjo objektivë, sipas studiuesit Ansola është arritur përmes një legalizimi retroaktiv. Ansola, duke baraspeshuar në mes koncepteve legale dhe ilegale të intervenimit, prodhoi një opinion të ri të mesëm, atë të "legalizimit retroaktiv" të intervenimit, si në rastin e Kosovës, e që erdhi nga Rezoluta 1244[322], i

[318] Friedrich, "UNMIK in Kosovo: Struggling with Uncertainty"..., p. 232.

[319] Vidmar, "International Legal Responses to Kosovo's Declaration of Independence"..., pp. 794-795.

[320] Po aty, p. 232

[321] Reka, *UNMIK as internacional governance...*, p. 133.

[322] Jose-Luis Herrero Ansora, *The United Nations in Kosovo: Finding the Path throught the Maze*, in: Favorita Papers, 04/2001 of Diplomatiche Akademie,Vienna, p.9.

cili bëri diskontinuitetin faktik të sovranitetit Jugosllav në Kosovë (edhe pse-në letër ai ekzistonte akoma)[323]. Kurse objektiva e dytë e njohur për Rezolutën 1244 ishte inaugurimi i një misioni të madh paqeruajtës të OKB-së, më vonë UNMIK[324].

Në anën tjetër, sa u përket atyre objektivave që ishin më të panjohura për rezolutën 1244, u paraqiten ato që kishin të bëjnë me zhvillimet në perspektivë. Andaj, në këtë kontekst, sidomos në një "kuptim metaforik", mund të themi se Rezoluta 1244, paraqitej si një "lloj ekuacioni me dy të panjohura". E panjohura e parë, ishte paqartësia e mandatit, duke mos i dhënë UNMIK-ut një objektivë të qartë politike lidhur me zgjidhjen e statusit politik të Kosovës[325], për dallim nga Rezoluta 1272/1999, e cila i jepte mandat të qartë UNTAET-it në përgatitjen e shoqërisë së Timorit Lindor për pavarësi. Kurse e panjohura e dytë (y), i referohet paqartësisë apo mungesës së strategjisë dalëse.

3.2 Nomenklatura organizative dhe funksionale e UNMIK-ut

Në përgjithësi, bashkësia ndërkombëtare synonte që përmes UNMIK-ut të realizonte një sërë të objektivave madhore, ku disa nga to duhej arritur në planin afatshkurtër, dhe disa të tjera në planin afatgjatë. Lidhur me këtë, menjëherë pas vendosjes së UNMIK-ut në Kosovë, Sekretari Anann kishte deklaruar se "detyra që ka përpara bashkësia ndërkombëtare është që të ndihmoj popullin e Kosovës për t'i rindërtuar jetët e tyre dhe t'i shërojnë plagët e luftës"[326]. Për më tej, në raport parashihej që UNMIK-u do të duhej t'i realizonte pesë objektiva kryesore:

- Demilitarizimin e Kosovës, proces i cili u udhëhoq nga NATO-KFOR, që u arrit me tërheqjen e strukturave ushtarake të Jugosllavisë, pastaj me demobilizimn e UÇK-së dhe transformimin e saj në TMK;
- Kthimi i refugjatëve në Kosovë, i udhëhequr nga UNCHR;

[323] Reka, *UNMIK as an international governance…,*p. 134.

[324] Po aty, p. 134.

[325] Coelho, "Building stable and effective states through international governance"..., p. 179.

[326] Report of UN Secretary General to UN Security Council on UNMIK, (S/1999/779, 12 July 1999).

- Rindërtimin e Kosovës, procesi i udhëhequr nga UE-ja;
- Ndërtimin e një administrate civile, proces i udhëhequr nga OKB-ja;
- Demokratizimin e shoqërisë Kosovare, duke përfshirë ndërtimin e institucioneve dhe zgjedhjet, procesi u udhëhoq nga OSBE-ja[327].

Rrjedhimisht, duke shikuar në përmbajtje këto objektiva të UNMIK-ut, rezulton që administrata ndërkombëtare në Kosovë përbëhej nga komponentet si në vijim:

Komponenti mbrojtjes dhe ushtarak; i administratës civile; i sundimit të ligjit; i të drejtave të njeriut; i rindërtimit; i riatdhesimit; i zgjedhjeve; dhe ndërtimit të institucioneve demokratike të vetëqeverisjes [328]. Një skemë organizative e strukturës së UNMIK-ut është dhënë në figurën 8.

Figura 8. Struktura e UNMIK-ut me 1999.



Burimi: Dominik Zaum, *The Sovereignty Paradox: The Norms and Politics of International Statebuilding*, NY, Oxford University Press, 2007, p.133.

[327] Po aty.

[328] Reka, *UNMIK as an international governance…,* p. 140-141.

Në vazhdën e zhvillimeve në terren, OKB-ja ndërmori masa për hartimin e një plani strategjik për implementimin praktik të këtyre objektivave. Në raportin e tij të parë për UNMIK-un, Sekretari i Përgjithshëm paraqiti një plan strategjik implementues që përbëhej nga pesë "faza integruese"[329].

- Së pari: vendosja dhe konsolidimi i autoritetit të UNMIK-ut dhe krijimi i strukturave të menaxhuara nga UNMIK-u;

- Së dyti: administrimi i shërbimeve sociale dhe shërbimeve tjera si dhe konsolidimi i sundimit të ligjit;

- Së treti: finalizimi i përgatitjeve për mbajtjen e zgjedhjeve;

- Së katërti: ndihmesa në zgjedhjen e përfaqësuesve të Kosovës për themelimin e institucioneve të përkohshme për një vetëqeverisje demokratike dhe autonome;

- Së pesti: ndërmarrja e masave për zgjidhjen përfundimtare, sipas paragrafit 11(f) të Rezolutës 1244/99, ku thuhej: UNMIK-u do të mbikëqyrë transferimin e autoritetit nga institucionet e përkohshme të Kosovës në institucionet e themeluara për gjetjen e një zgjidhje politike[330].

3.3 Mandati i UNMIK-ut dhe statusi juridik i Kosovës sipas Rezolutës 1244

Një premisë e thjeshtë logjike nga e cila do të duhej nisur për të analizuar faktorët dhe rrethanat që e kanë formësuar dhe udhëhequr komplet veprimtarinë e administratës ndërkombëtare në Kosovë, ka të bëjë me faktin që komuniteti ndërkombëtar, politikat e veta rreth kësaj çështje i ka nisur mbi bazën e disa supozimeve mbi gjendjen faktike-juridike në këtë territor.

Siç do të shkruante Stahn, ngjashëm me operacionin UNOSOME II në Somali, Kombet e Bashkuara, po ashtu e instaluan edhe funksionalizuan misionin e tyre në Kosovë mbi bazën e të njëjtit supozim se atje nuk ekzistonin autoritete faktike

[329] Report of UN Secretary General to UN Security Council on UNMIK, S/1999/779, 12 July 1999.

[330] Reka, *UNMIK as an international governance…*, p. 144.

sovrane[331]. Këto supozime si duket i kanë shtyrë Kombet e Bashkuara që të përcaktojnë komplet natyrën e mandatit të UNMIK-ut. Madje, lidhur me këtë çështje, Yannis do të bënte një përshkrim të gjerë dhe shumë origjinal rreth specifikave të administratës ndërkombëtare në Kosovë. Ai theksonte se ndër tiparet më specifike të UNMIKu-t janë të lidhura drejt për së drejti me veçantinë e natyrës së mandatit të tij, i cili duke marrur përsipër administrimin e plotë të Kosovës, inauguroi shumë sfida të reja, si për nga dimensioni konceptual, ashtu edhe për nga ai operacional. Pastaj, natyra e veçantë e mandatit të tij, ka prodhuar edhe një sërë sfidash të reja, që binin në sferat e legjitimitetit, kompetencave, si dhe mënyrës së funksionimit të sovranitetit në rrethana të tilla. Por,pavarësisht kësaj, Yanis vlerëson se sfida më komplekse që ka qenë lidhur me mandatin e UNMIK-ut, ka të bëjë me paqartësinë rreth zgjidhjes së statusit final të Kosovës[332]. Një specifikë tjetër komplekse që e ka karakterizuar mandatin e UNMIK-ut, konsiston në kontradiksionin në mes interpretimt juridik të Rezolutës 1244, ndaj ruajtjes së sovranitetit të RFJ-së mbi Kosovën, dhe interpretimit politik që bëhej nga shumica e popullatës vendore të Kosovës, e që kërkonin pavarësimin e plotë nga RFJ- përkatësisht Serbia[333].

Siç dihet, Rezoluta 1244, në preambulën e saj e riafirmonte zotimin e të gjitha shteteve anëtare ndaj sovranitetit dhe integritetit territorial të RFJ-së. Ajo në mënyrë specifike thekson se administrata e përkohshme për Kosovën ka për qëllim:

> "(...) ta krijojë një prani civile ndërkombëtare në Kosovë në mënyrë që të vendosë një administratë të përkohshme për Kosovën nën të cilën populli i Kosovës mund të gëzojë autonomi përmbajtësore në kuadër të RFJ-së, dhe e cila do të sigurojë administrim kalimtar gjersa themelon dhe mbikëqyr zhvillimin e institucioneve të përkohshme demokratike vetëqeverisëse për të siguruar kushte për një jetë normale dhe të qetë për të gjithë banorët e Kosovës"[334].

---

[331] Stahn, "International Territorial Administration in the Former Yugoslavia"..., p. 108, cit. 3.

[332] Alexandros Yanis, "The UN as Government in Kosovo", *Global Governance* 10 (2004), pp. 67-81.

[333] Stefan Lehne, *Resolving Kosovo's Status*, Austrian Institute for International Affairs, Policy Paper Juni 2009, pp. 1-14.

[334] Rezoluta 1244 (1999), Paragrafi 10.

Shikuar nga këndi analitik, dhe specifikisht këtë dispozitë, vërehet se Rezoluta 1244 ofronte një kornizë gjenerale për garantimin e një vetëqeverisjeje për shoqërinë kosovare, dhe paralelisht me këtë, ofronte edhe bazë juridike për ruajtjen e sovranitetit jugosllav mbi Kosovën.

Thënë thjesht, kjo dispozitë, sipas Yanis, ka prodhuar një "situatë hibride" duke bërë një ndarje në mes sovranitetit *de jure* nga ai *de facto*[335]. Për më tepër, Yanis thekson faktin që kjo "situatë hibride" ka sjelluar vështirësi konceptuale, e cila nuk mund të përshkruhet as nga një terminologji e përbashkët, e as nga ajo krahasuese. Po ashtu, kjo situatë ka bërë që modeli i administrimit si në rastin e Kosovës, të jetë i dallueshëm me çfarëdo praktike administruese paraprake, dhe njëkohësisht edhe me çfarëdo tjetër të mëvonshme[336]. Një kriter dallues i praktikës së administrimit të Kosovës nga UNMIK-u, në raport me praktikat tjera para dhe pas tij, mund të përqendrohet te kriteri i natyrës së statusit të tyre, për aq kohë sa ato ishin nën administrimin territorial të misioneve të OKB-së. Në rastin e krahasimit Kosovë me atë të Kamboxhias dhe të Bosnje-Hercegovinës, Kosova dallon për faktin që, përderisa të dyja këto vende mbeten shtete sovrane, përkundrazi Kosova vazhdoi të administrohet nga UNMIK-u pa një status të qartë të definuar. Por, përveç këtyre dy rasteve, Kosova dallon edhe nga Timori Lindor. Pavarësisht faktit që fuqitë qeveritare të UNTAET-it në Timorin Lindor ishin po aq të gjera dhe të përqendruara, sa edhe ato të UNMIK-ut, megjithatë, territori i Timorit Lindor ishte krejtësisht i ndërkombëtarizuar dhe se misioni i UNTAET-it kishte për qëllim përgatitjen e këtij territori për t'u pavarësuar nga Indonezia[337].

Për më tepër, në lidhje me statusin e Kosovës, sidomos në krahasim me atë të Kamboxhias, Timorit Lindor dhe Bosnjë e Hercegovinës, Friedrich thekson se "në kërkim të një terminologjie të saktë, sidomos shikuar nga funksioni mbrojtës i bashkësisë ndërkombëtare-prej të cilit Kosova varet tërësisht, duhet sygjeruar një klasifikim siç është ai i një "protektorati modern"[338]. Mbi bazën e kësaj terminologjie, disa raporte ndërkombëtare madje këtë formë të "protektoratit modern" e kërkojnë te

[335] Yanis, "The UN as Government in Kosovo"..., pp. 67-81.

[336] Po aty, pp. 67-81.

[337] Friedrich, "UNMIK in Kosovo: Struggling with Uncertainty"..., p. 243; United Nations Development Programme, Position Paper Policy, Vancouver Model United Nations, The 13th Annual Conference, February 14-16, 2014, pp. 20-22.

[338] Friedrich, "UNMIK in Kosovo: Struggling with Uncertainty"..., p. 243.

disa praktika më të hershme në Ballkan. Siç do të theksonte një Raport i Grupit Ndërkombëtar të Krizave, Traktati i Berlinit i vitit 1878 e vendosi Bosnjën dhe Hercegovinën nën protektoratin e Austro-Hungarisë (e cila formalisht u aneksua në vitin 1908). Bosnjë-Hercegovina, edhe pse *de jure* nën sovranitetin Osman, *de facto* u bë pjesë politike dhe ekonomike e protektoratit të Austro-Hungarisë[339].

Përveç këtij krahasimi, shikuar nga këndi i dominimit të parimeve të politikës ndërkombëtare ndaj atyre juridike, sidomos në lidhje me përcaktimin e mandatit të UNMIK-ut dhe statusit juridik të Kosovës nën këtë mandat, studiuesit kanë ardhur në përfundimin se kanë dominuar parimet politike mbi ato juridike. Duke analizuar zhvillimet politike në radhët e anëtarëve të Këshillit të Sigurimit, është argumetuar se anëtarët perëndimorë të Këshillit, pashmangshëm kanë shfaqur një simpati politike ndaj Moskës dhe një ndjenje miqësie historike me Beogradin. Këto kondita, i kanë shtyer anëtarët perëndimorë që t'i akomodojnë interesat e Rusisë në këtë konflikt. Ky qëndrim i këtij lloji që erdhi nga perëndimorët në raport me Rusinë, u bazu detyrimisht në qëndrimet që mbajti Rusia, sidomos kur ajo kërcënoi se do ta përdorte të drejtën e vetos për ta bllokuar Rezolutën 1244, apo çfarëdo rezolute tjerër, e cila nuk përmbante ato dispozita të cilat do ta kushtëzonin UNMIK-un që gjatë ushtrimi të mandatit të tij, t'i ndalojë autoritetet ndërkombëtare të paragjykonin statusin politik të Kosovës. Kështuqë, duke pasur parasysh të gjitha këto zhvillime, "paqartësia e mandatit të UNMIK-ut ishte një pasqyrim i pasigurisë së vet bashkësisë ndërkombëtare rreth statusit të ardhshëm të Kosovës" [340]. Ky fakt ka bërë që pastaj komuniteti ndërkombëtar të ndjekë një politikë të balancuar me shumë kujdes, ndërmjet respektimit *de jure* të sovranitetit jugosllav mbi Kosovën, dhe *de facto* në ushtrimin e sovranitetit faktik përmes administrimit[341]. Kësi soji, u konsiderua se statusi juridik i Kosovës ishte një lloj i "sovranitetit të pezulluar", madje ajo u përshkrua si një "shtet

[339] ICG, *The New Kosovo Protectorate*, Balkans Report N°69, Sarajevo, 20 June 1999, p. 2.

[340] Coelho, "Building stable and effective states through international governance"..., p. 179.

[341] Wim van Meurs, "Kosovo's Fifth Anniversary-On the Road to Nowhere?" Center for Applied Policy Research, *The Global Review of Ethnopolitics* 3 (2004), pp. 60-74

sorogat"[342]. Një paqartësi, që ishte rezultat i këtij balanci politik, do të vazhdonte deri me definimin e statusit përfundimtar, e madje kjo frymë e ka karakterizuar komplet procesin diplomatik negociator për zgjidhjen e statusit të Kosovës.

Në fakt sfida e madhe filloi me përpjekjet e bashkësisë ndërkombëtare për zgjidhjen e statusit final të kosovës. Që nga viti 2001, UNMIK-u mori udhëzime nga OKB-ja që të fillonte ndërtimin e një politike për zgjidhjen e statusit të ardhshëm të Kosovës. Siç thekson Knoll, përcaktimi i statusit të ardhshëm të Kosovës u bë konform parimeve të së drejtës ndërkombëtare, me idenë se duhej të arriheshin disa standarde të caktuara. Në mënyrë që të bëhej transferimi i kompetencave nga UNMIK-u tek institucionet e reja të Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ), PSSP-ja, në vitin 2001, krijoi një politikë të "standardeve në etapa të caktuara" (ang. benchmarking), të cilët do të ishin tregues për zhvillimet në tetë fusha të qeverisjes. Siç deklaronte PSSP-ja i atëhershëm, prapa kësaj qasje fshihej qëllimi që Kosova mund të ecte përpara drejt një shoqërie demokratike dhe tolerante vetëm pas përmbushjes të disa standardeve[343].

Të gjitha këto specifika lidhur me mandatin e UNMIK-ut, mund të sqarohen vetëm kur analizohen nga prizmi i implementimit të tij në praktikë. Siç theksuam më lartë, UNMIK-u kishte edhe planin e vet strategjik për implementimin e objektivave të tij, që marrë së bashku, e përbëjnë vetë mandatin e këtij misioni. Në fakt, ky plan synonte të realizohej në saje të një procesi tranzitor, duke kaluar nga faza në fazë. Në kuadër të këtij plani, disa nga fazat e implementimit, sidomos e para dhe e dyta, përbënin objektiva disi më afatshkurtra në krahasim me tri fazat tjera të cilat përbënin objektiva shumë më afatgjate.

Pjesa e studimit vijues të veprimtarisë së UNMIK-ut, teknikisht do të jetë e organizuar konform një ndarje që i përgjigjet realizimit të objektivave në planin kohor dhe përmbajtësor. Një pjesë do të merret me analizimin e objektivave afatshkurtra që planifikoheshin të realizoheshin në kuadër të dy fazave të para. Pjesa tjetër do të fokusohet në realizmin e objektivave që ishin më afatgjatë dhe që binin në kuadër të tri fazave tjera.

Në fakt, duke përvijuar një organizim të tillë, edhe pse e pa thënë shprehimisht, do të vërejmë se UNMIK-u në Kosovë ka realizuar një mandat të dyfishtë. Këtu, mandati

---

[342] Lenard Cohen, "Kosovo: From Interim Status to Enhanced Sovereignty", *Strategic Insights* 5 (2006), p. 3.

[343] Bernhard Knoll, "From Benchmarking to Final Status?"..., pp.639-640.

i parë ka të bëjë me paraqitjen e UNMIK-ut si qeverisje ndërkombëtare; kurse mandati i dytë i referohet rolit të UNMIK-ut si agjent shtetndërtues[344].

3.4 Komponentët emergjent të qeverisjes së UNMIK-ut: fuqitë komplete qeveritare të UNMIK-ut

Shtjellimet në vijim fokusohen kryesisht në trajtimin e veprimtarisë së UNMIK-ut në periudhën e menjëhershme të menaxhimit me situatën e pas konfliktit. Kjo veprimtari paraqet komponentin qeverisës të UNMIK-ut që është arritur përmes ushtrimit të autoritetit të tij ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor. Kjo nënkupton se veprimtaria imediate e UNMIK-ut i referohet detyrave që ai kishte për të vendosur dhe konsoliduar autoritetin e tij dhe krijimin e strukturave të veta të menaxhimit, në mënyrë që të kishte mundësi logjistike dhe aftësi efektive në menaxhimin e situatës post-konfliktuale, që nënkuptonte ofrimin e shërbimeve sociale dhe shërbimeve tjera rreth konsolidimit të rendit dhe drejtësisë. Duke e analizuar se si ka vepruar faktikisht administrata ndërkombëtare në Kosovë, do të mund të nxjerrim përfundime që e mbështesin tezen se misionet e reja, si ky i UNMIK-ut, e kanë promovuar *ipso facto* doktrinën e qeverisjes direkt ndërkombëtare mbi një territor. Mbi këtë bazë, do të shohim se UNMIK-u, duke e përcjellë trajektoren e tranzicionit, përmes ushtrimit të autoritetit të tij, ka poseduar të gjitha rolet dhe funksionet tipike të një shteti modern. Në realizimin e mandatit të tij, përveç komponentës civile, ai ka bashkëpunuar ngushtë edhe me strukturat ndërkombëtare politike dhe të sigurisë e veçanërisht KFOR-in, OSBE-në, UE-në dhe një numër të madh të organizatave ndërkombëtare qeveritare dhe jo qeveritare.

Është me rëndësi të veçantë, që para se të bëhet analizimi i komponentës qeveritare të UNMIK-ut, fillimisht të bëhet një shqyrtim i rolit dhe funksioneve të fenomenit të qeverisjes ndërkombëtare në makronivel në kontekstin e fillim shekullit XXI.

Tanimë është relevant fakti se me fillimin e shekullit XXI, bota ka hyrë në një epokë ku qeverisja ndërkombëtare është duke marrë një rol më të madh, gjë e cila në njëfarë forme i ka detyruar shtetet që t'i riformatizojnë funksionet e tyre të

[344] Joel C. Beauvais, *Benevolent Despotism: A Critique of UN State-Building in East Timor*, 2001, pp. 1101-1178.

zakonshme[345]. Shikuar nga këndvështrimi i doktrinës së administrimit territorial ndërkombëtar, logjika e qeverisjes ndërkombëtare ose e autoritetit administrativ ndërkombëtar, i referohet autorizimeve të administratave ndërkombëtare në kontrollin e drejtpërdrejtë të trajektores së procesit të tranzicionit. Zakonisht kjo qasje e tillë aplikohet me qëllim që në territorin nën administrim të krijohen kushte politike për një stabilitet dhe bazë për zhvillim të qëndrueshëm[346]. Në planin kohor, përvijimi i kësaj trajektore nga administratat ndërkombëtare konsiston në dy momente dhe i detyron ato që në praktikën e tyre të inkorporojnë një sërë aktivitetesh. Disa prej këtyre aktivitete ndërmirren në përpjekje për t'iu përgjigjur sanimit të nevojave të menjëhershme, e që përfshijn marrjen e masave për garantimin e një mjedisi të sigurt, në sajte të të cilit bëhet i mundur edhe ofrimi i ndihmës humanitare. Pasi të jenë realizuar këto synime, këto administrata ndërmarrin veprime disi më afatgjata dhe orientohen në përpjekjet për të konsoliduar paqen, përmes ngritjes dhe forcimit të komponentëve në rindërtimin ekonomik dhe ndërtimin e institucioneve politike. Ky lloj binomi, në vetvete paraqet një kompleksitet në kuptimin që shpeshherë interesat e e secilës nga këto dy lloje veprimtarish nuk harmonizohen plotësisht me njëra-tjetrën[347]. Me këto lloj sfidash ka qenë ndeshur edhe UNMIK-u, gjë që përveç autorizimeve formale, atij edhe në mënyrë të nënkuptuar i kanë dhënë një kontroll të plotë mbi trajektoren e tranzicionit në Kosovën e pasluftës.

Gjatë dhe pas përfundimit të luftës në qershor të vitit 1999, bashkësia ndërkombëtare u përballë me një situatë të rëndë humanitare në Kosovë. Mekanizmat ndërkombëtarë që u përfshinë të parët në menaxhimin me këtë situatë të pas konfliktit, ishin po ata që menaxhuam me të edhe gjatë konfliktit. Është fjala për NATO-n dhe UNHCR-n, të cilat *ipso facto,* u përfshin për sanimin e situatës emergjente në Kosovë, sepse ato tanimë vetëm sa ishin të përfshira në këtë proces, dhe rrjedhimisht duhej ta përcillnin kontinuitetin e krijuar. Për shembull, UNHCR kishte menaxhuar me krizën humanitare në kampet e refugjatëve në Shqipëri dhe Maqedoni. Por, para se të fillonte punën çfarëdo organizate në Kosovë, së pari duhej krijuar një ambient i sigurt në një

[345] Nina Wilén, *Paradoxes or Strategies in International Governance? The Case of Kosovo*, Paper presented at REGIMEN Conference 'Le nouveau système international' in Mons, 7 March 2007.

[346] Coelho, "Building stable and effective states through international governance"..., p. 227.

[347] Caplan, *International Governance...*, 2005, 43.

territor të sapo dalë nga lufta e që pritej të realizohej nga prania ushtarake ndërkombëtare (më vonë KFOR) në bazë të dispozitave të Rezolutës 1244.

Pasi u krijua një mjedis pak a shumë i sigurt dhe një lloj rendi publik, u krijuan edhe rrethana të favorshme për vendosjen e pranisë civile ndërkombëtare. Në këto rrethana filloi implementimi i fazës së parë dhe të dytë, gjegjësisht, vendosja dhe konsolidimi i autoritetit të UNIMIK-ut dhe krijimi i strukturave të menaxhuara prej tij. Më pas ky mision filloi edhe me administrimin e shërbimeve sociale dhe konsolidimin e sundimit të ligjit. Në implementimin e këtyre dy fazave, UNMIK-u ka ushtruar autoritet të plotë qeverisës.

UNMIK-u në Kosovën e pasluftës (faza emergjente), e ushtroi autoritetin primar qeverisës të drejtuar nga Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP). Por, pavarësisht këtij fakti, ajo çka është me rëndësi të dihet, ka të bëjë me përpjekjet për ta gjetur burimin e autoritetit të UNMIK-ut (respektivisht i PSSP-së) si administratë ndërkombëtare? Pastaj të gjejë se në çka konsistonte ky autoritet? Sa ka qenë legjitim?, etj. Në përgjigjjen e këtyre pyetjeve, përvijimi i shpjegimit që vjen nga Zaum lidhur me autoritetin e administrimit ndërkombëtar, është mjaft adekuat.

Zaum sqaron se për të analizuar autoritetin e administratave ndërkombëtare duhet të shikojmë në qëllime sociale dhe procesin që e legjitimon ushtrimin e pushtetit të tyre. Ai shton se administratat ndërkombëtare në Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë, dhe në Timorin Lindor, ishin të themeluara me qëllimet dhe pretendimet për të qeverisur[348].

Sipas Zaum, duke pasur parasysh tri burimet më të rëndësishme juridike nga ku buron autorizimi i administratave ndërkombëtare, siç janë rezolutat e Këshillit të Sigurimit, pastaj traktatet e paqes, si dhe rregulloret e nxjerra nga vetë këto administrata, përgjithësisht mund të numërohen pesë burime të ndryshme në të cilat mbështeten këto administrata për t'i realizuar funksionet e tyre. Shikuar në planin formal-procedural, dy nga këto burime mund të jenë si pëlqim, dhe si delegim i autoritetit për një administratë. Në anën tjetër, shikuar në planin justifikues-politik, tri të tjerat përfshijnë thirrje për promovim të parimeve humanitare si ruajtja e paqes dhe sigurisë; mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe demokracisë; si dhe nevojën për promovimin e vetëqeverisjes në një shoqëri apo territor të caktuar[349].

---

[348] Zaum, *The Authority of International...*, 2006, p.6-7.

[349] Po aty, 2006, p.7.

Por, cili ishte dhe në çka konsistonte autoriteti i UNMIK-ut/PSSP-së në administrimin e Kosovës?

Bazuar në autorizimet e një shkalle të paprecedent në krahasim me misionet paraprake dhe ato pasuese, shpeshherë PSSP është krahasuar me pozitën e monarkëve të Evropës Mesjetare; madje edhe me atë të më të fuqishmin: Luigjin e XIV-të!

PSSP-ja ka qenë autoriteti suprem dhe përfundimtar vendimmarrës i UNMIK-ut dhe se ky autoritet asnjëherë nuk është kontestuar nga askush. Ndoshta në një shprehje metaforike, PSSP-ja ka qenë një "L'Etat c'est moi"(Shteti jam unë)! Ky autoritet suprem i PSSP-së buronte nga Kapitulli VII i Kartës së OKB-së; nga Rezoluta 1244; si dhe nga Rregulloret e para operative të UNMIK-ut: 1999/1 dhe 1999/9[350]. Ndonëse i pa precizuar shprehimisht në Rezolutën 1244, autoriteti i PSSP-së mori trajtë vetëm pas vendosjes së UNMIK-ut, dhe atë përmes aktivitetit të tij legjislativ. Andaj, për ta ushtruar komplet autoritetin administrativ apo pushtetin qeveritar, PSSP normalisht do të duhej t'ia atribuonte vetës komplet pushtetin me të trija degët e tij.

Siç thuhet në Rregulloren e UNMIK-ut 1999/1 të datës 25 korrik 1999, (e njohur si nëna e të gjitha rregulloreve)[351], i gjithë autoriteti legjislativ dhe ekzekutiv në lidhje me Kosovën, duke përfshirë administrimin e gjyqësorit, i mvishej UNMIK-ut dhe ushtrohej nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) [352]. Për më tepër, rregulloret e nxjerra nga UNMIK-u kanë pasur përparësi mbi ligjet e aplikueshme në territorin e Kosovës para datës 22 mars 1999, dhe PSSP-ja mundte të caktonte ose shkarkote çdo person që ishte emëruar për të kryer funksione në administratën civile në Kosovë, përfshirë edhe gjykatësit. Përveç kësaj, PSSP ka qenë i autorizuar edhe në nxjerrjen e akteve tjera nënligjore dhe administrative, si: Direktivat Administrative dhe Urdhëresa Ekzekutive[353]. Në një situatë të tillë, përballë një autoriteti të pakontestuar, tensionet demokratike janë pothuajse të pashmangshme, dhe që jo rastësisht ky fakt i ka shtyer disa studiues ta etiketojnë UNMIK-un si një "shtet surrogat"[354].

---

[350] Reka, *UNMIK as an international governance…*, p. 145.

[351] Alexandros Yanis, *The UN as Government in Kosovo*, Global Governance 10 (2004), p. 69.

[352] UNMIK Regulation 1999/1, 25 July 1999.

[353] Reka, *UNMIK as an international governance…,* p. 175.

[354] Didier Pascquée & Stewen Dewulf, "International Territorial Administrations and the Rule of Law: The Case of Kosovo", *Essex Human Rights Review* 4 (2007), p. 2.

Në lidhje me shkallën e gjerë të kompetencave të ushtruara nga UNMIK-u/PSSP-ja, ka pasur reagime të shumta si nga shumica e popullatës (Shqiptarët e Kosovës), ashtu edhe nga RFJ-ja. Kosovarët, të cilat shpesh paraqiteshin si një rezistencë lokale, i dhanë UNMIK-ut një status të neo-kolonializmit. Në anën tjetër, RFJ insistonte se fuqitë e plota legjislative, duke përfshirë të drejtën për shfuqizimin e ligjeve në fuqi të RFJ-së të viteve '80-të, shkonin përtej autorizimit nën Rezolutën 1244, e cila mund të shihet si thjesht përshkruese e detyrave administrative për UNMIK-un. Prandaj, RFJ-ja ka argumentuar se në fazat fillestare të misionit, PSSP-ja kishte "uzurpuar pushtetin më shumë sesa që iu ishin dhënë në bazë të Rezolutës 1244"[355].

Në këtë drjetim, vlerësimet e opinionit kosovar, kanë treguar se pikërisht kjo strategji e UNMIK-ut në raport me menagjimin e autoritetit qeverisës, ka ndikuar direkt në zbehjen e karakterit të tij demokratik të tij. Të dhënat në vijim, paraqesin vlerësime për peshën e secilit nga faktorët që kanë ndikuar në imazhin demokratik të UNMIK-ut. Shih në grafikun 9.

Figura 9. Çka ka ndikuar më tepër në zbehjen e karakterit demokratik të UNMIK-ut?



Tipari më i spikatur që mund të haset në këtë ushtrim të koncentruar të pushtetit është ai i mungesës së ndarjes së pushtetit, i cili njëkohësisht e promovon edhe

[355] Memorandumi i qeverisë së RFJ-së mbi Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së (1999), Pjesa II, i datës 5 nëntor 1999, para. 6.

dilemën e legjitimitetit të autoritetit të UNMIK-ut, respektivisht PSSP-së. Por, pavarësisht kësaj, UNMIK-u kishte një justifikim për ushtrimin e pretenduar të autoritetit suprem dhe final administrativ.

Për përmbushjen e objektivave për të cilat UNMIK-u kishte mandat nga Këshilli i Sigurimit, duheshin kompetenca të plota ekzekutive dhe legjislative dhe të paktën fillimisht kontrollin mbi gjyqësinë. Promovimi i të drejtave të njeriut, si dhe rindërtimi dhe demokratizimi i tërësishëm i një shoqërie, e cila kishte qenë e dominuar nga një sistem juridik diskriminues dhe shtypës, kërkon reforma të gjera ligjore.

Në përgjithësi mund të konstatohet që UNMIK-u, menjëherë pas vendosjes së tij në Kosovë dhe përballë një mjedisi kompleks politik dhe ligjor, është përballur me tri probleme të karakterit politik dhe juridik mjaft sfiduese:

a) Problemin e ligjit të aplikueshëm në Kosovë;

b) Problemin e transferimit të pushtetit te institucionet e vetëqeverisjes në Kosovë;

c) Problemin e ndërtimit të sistemit të gjyqësisë në Kosovë[356].

Zgjidhja e problemit lidhur me ligjin e aplikueshëm, konsistonte në sferën e pushtetit legjislativ; ai i transferimit të pushtetit, konsistonte në sferën e pushtetit ekzekutiv; dhe ai i problemit të ndërtimit të sistemit të gjyqësisë, konsistonte në atë të pushtetit gjyqësor.

Pushteti legjislativ: Çështja më problematike dhe njëkohësisht më sfiduese në sferën e autorizimeve legjislative të UNMIK-ut ka qenë dilema në përcaktimin se çfarë legjislacioni duhej aplikuar në Kosovën e pasluftës. Në këtë drejtim, UNMIK-u mori masa imediate të njëanshme në caktimin e këtij legjislacioni përmes rregulloreve të tij të para operative. Përmes Rregullores 1999/1 PSSP precizoi, sidomos në kuptimin juridik, se legjislacioni i aplikueshëm në Kosovë është si vijon:

a) Ligji i aplikuar në Kosovë deri më 22 mars 1989;

b) Rregulloret e UNMIK-ut;

[356] Shih më tej: Reka, *UNMIK as an international governance…,* p. 176.

c) Ligji i aplikuar në Kosovë midis 22 marsit 1989 dhe 12 dhjetor 1999 (data kur Rregullorja 1999/24 hyri në fuqi); dhe
d) Standardet dhe ligjet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut[357].

Qasja e parë: Ky përcaktim i UNMIK-ut për vendosjen e ligjit të aplikueshëm në Kosovë përbënte qasjen e parë të tij, e cila ishte e një anshme dhe në kundërshtim me vullnetin e akterëve lokal. Disa autor, madje këtë qasje e kanë quajtur si "hegjemonia graduale e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtar"[358]. Kjo qasje u shikua gjerësisht si e imponuar, gjë që nxiti reagime të theksuara në radhët e ekspertëve juridik Kosovar dhe më vonë edhe të shoqërisë civile dhe më gjerë. Kundërshtimet e vendorëve vinin kryesisht si rezultat i aplikimit të ligjit të ish Jugosllavisë, që në pjesën më të madhe kishte qenë represiv.

Qasja e dytë: Përballë një situate të tillë, PSSP-ja i atëhershëm Kouchner, në Gusht të vitit 1999 kishte kërkuar një zgjidhje kompromisi me vendorët, duke aplikuar një qasje të re legjislative e cila ishte përfshirëse dhe parashihte rishqyrtimin e kornizës ligjore dhe hartimin ligjeve të reja penale për Kosovën e pasluftës. Në vazhdën e kësaj qasje, u themelua Këshilli i Përbashkët Konsultativ për Çështje Legjislative (KPK ÇL)[359]*. Për më tepër, problemi i ligjit të aplikueshëm nuk ishte zgjidhur deri në fund të vitit 1999. Pasi miratoi Rregulloren 1999/24 (e cila bërë rishqyrtimin e parë të Rregullores 1999/1), PSSP vendosi që ligjet e aplikueshme në Kosovë do të ishin: rregulloret e UNMIK-ut dhe ligji në fuqi në Kosovë deri me 22 Mars 1989, por gjatë gjithë kohës në përputhshmëri me konventat dhe instrumentet relevante ndërkombëtare[360].

---

[357] Pascquée & Dewulf, "International Territorial Administrations and the Rule of Law: The Case of Kosovo"..., p. 4.

[358] Adam Day, "No Exit Without Judicary: Learning a Lesson from UNMIK's Transitional Adminstration in Kosovo", *Wisconsin International Law Journal* 23 (2006), p. 185.

[359] Shih më tej: Reka, *UNMIK as an international governance…*, pp. 189-190. *Profesor Reka kishte qenë njëri nga ideatorët e formimit të këtij Këshilli dhe njëri nga ekspertët Kosovarë më promovent për çështje legjislative në këtë Këshill.

[360] Shih më tej në: Blerim Reka, "New Legislation in Post War Kosova: The sui generis Model of National and International Co-Participation on the Exercise of Soveregnity", *Kosova Law Riview* 4 (1999).

Si pjesë e qasjes së dytë në procesin e hartimit të legjislacionit në Kosovën e pas luftës, rol tejet të rëndësishëm kishte edhe Këshilli i Përbashkët Konsultativ për Çështje Legjislative (KPK ÇL), i cili ishte i përbërë nga ekspert vendor të së drejtës dhe akter të tjerë ligjor, Zyra Këshilluese Ligjore e OSBE-së (ZKL), Këshilli i Evropës (KE) dhe Organizata e Juristëve Amerikan (OJA), Iniciativa Ligjore e Evropës Qendrore dhe Euro-aziatike (ILEQE). Ky organ konsultativ dhe bashkëpunues ishte menduar që të këshillonte PSSP-në mbi ligjin e zbatueshëm dhe të ishte një forum në të cilin kryesisht do të zhvillohet procesi i reformës legjislative. Edhe pse OKB-ja asnjëherë nuk lëshoi asnjë rregullore në lidhje me autoritetin e saj, ajo ishte supozuar se të gjitha rregulloret e UNMIK-ut do të rishikoheshin nga KPK ÇL dhe komentet do të dërgoheshin tek PSSP, përmes ZKL[361].

KPK ÇL, u bë pikë përqendrues për legjislacionin e ri[362]. Në Kosovë, përpjekjet për të rivendosur një gjyqësor funksional, në shkallë të parë, kanë qenë të përqendruara në sistemin e të drejtës penale[363]. Në shtator 1999, KPK ÇL kishte marrë përsipër një projekt mjaft ambicioz për të hartuar një Kod të ri Penal dhe Kodin e Procedurës Penale për Kosovën. Pas përfundimit të këtyre dy kodeve në nëntor 2001[364], ato hynë në fuqi vetëm në prill 2004[365]. Mirëpo, përveç këtyre kodeve penale, Këshilli kishte hartuar edhe disa ligje tjera për Kosovën, duke e përmbyllur kështu edhe veprimtarinë e tij.

Një pikë e rëndësishme në kuadër të funksioneve legjislative të UNMIK-ut, ka të bëjë me sistemin e rregulloreve të tij. Sistemi i rregulloreve të UNMIK-ut u aplikua për herë të parë në Kosovë në historinë operacioneve të paqes të OKB-së dhe pas rastit të Kosovës, ai ka qenë i aplikuar vetëm në rastin e Timorit Lindor nga UNTAET-i[366]. Por, çka në të vërtetë janë rregulloret e UNMIK-ut? Për nga natyra

---

[361] David Marshall & Shelley Inglis, "The Disempowerment of Human Rights–Based Justice in the United Nations Mission in Kosovo", *Harvard Human Rights Journal* 16 (2003), p. 115.

[362] Reka, *UNMIK as an international governance…*, p. 190.

[363] Stahn, International Territorial Administration in the former Yugoslavia", 2001, p. 154.

[364] Reka, *UNMIK as an international governance…,*pp 189-201.

[365] Human Right Watch, Askund *në agjendë Dështimi i vazhdueshëm për të kërkuar përgjegjësi në Kosovë pas marsit 2004*, Vëllimi 18, Nr. 4(D), Maj 2006, f.11.

[366] Reka, *UNMIK as an international governance…,* p. 202.

juridike, rregulloret e UNMIK-ut ishin akte me fuqi ligjore edhe pse kjo nuk thuhej shprehimisht prej tij.

Në qoftë se shikohet nga ana hierarkike, autoriteti legjislativ i UNMIK-ut, i ushtruar drejtpërdrejtë nga PSSP-j, buron nga Kreu VII i Kartës së OKB-së në nivelin primar, pastaj nga Rezoluta 1244 në atë sekondar. Aktiviteti i fillestar legjislativ i UNMIK-ut ishte lëshimi i rregulloreve për interpretimin e Rezolutës 1244 nga ku edhe e kishin burimin. Ndërkohë, praktika e Rregulloreve u përcoll përmes Direktivave Administrative, që në raport me rregulloret ishin akte nënligjore dhe shërbenin për shpjegimin e rregulloreve.

Karta e OKB-së: Kreu VII;

Rezoluta 1244;

Rregulloret;

Direktivat Administrative dhe Urdhëresat Ekzekutive

Aktiviteti kryesor legjislativ, si njëra nga kompetencat ekskluzive të PSSP-së, është manifestuar në kuadër të sistemit të rregulloreve të UNMIK-ut.

Këto aktivitete legjislative të UNMIK-ut kanë qenë mjaft të gjëra, me 27 rregullore të miratuara në vitin 1999, e ndjekur nga 69 në vitin 2000, 41 në vitin 2001, 23 në vitin 2002, 41 në vitin 2003 dhe 56 në vitin 2004. Rreth gjysma e rregulloreve janë të plotësuara nga Direktivat Administrative. Shumë prej rregulloreve fillestare ishin të përshtatura në kategori të njohura, të tilla si në ngritjen e kompetencave themelore, të sigurisë, në ndryshimin ose shfuqizimin e ligjeve të mëparshme diskriminuese, duke siguruar funksionimin efektiv të sistemit të drejtësisë. Një seri e dytë e rregulloreve i adresoheshin reformës ekonomike dhe financiare, si dhe sistemit bankar dhe investimeve të huaja[367]. Por, marrë në përgjithësi, nga viti 1999 deri me 2008, UNMIK-u ka miratuar 443 rregullore dhe 212 direktiva[368]. Një pasqyrim më i gjerë është dhënë në figurën 10.

[367] Kristen Boon & Kristen Boon, "Legislative Reform in Post-conflict Zones: Jus Post Bellum and the Contemporary Occupant's Law-Making Powers", *McGill Law Journal* 50 (2005), p. 293.

[368] Të dhënat janë marrur nga: http: //www. unmikonline. org/regulations/ unmikgazette/ 02english/ Econtents.htm (Qasur me 12.08.2013).

Figura 10. Trendet e numrit të rregulloreve dhe direktivave administrative të nxjerrura nga UNMIK-u përgjatë viteve.



	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Rregullore	27	69	41	23	41	56	56	61	35	34	
Direktiva Administrative	4	29	26	27	32	31	23	18	14	7	1

Burimi: Paraqitja grafike është bërë duke u mbështetur në të dhënat e "Gazetës Zyrtare të UNMIK-ut".

Pushteti ekzekutiv i UNMIK-ut/PSSP: Fillimisht, autoriteti ekzekutiv i PSSP-së ka konsistuar në menaxhimin e situatës emergjente humanitare, përfshirë këtu krijimin e rendit dhe drejtësisë, si dhe demokratizimin e shoqërisë Kosovare dhe rindërtimin ekonomik të saj.

Me tu vendosur në Kosovë, UNMIK-u e kishte të qartë se objektivat e tij nuk mund të ushtroheshin në praktikë pa poseduar pushtet të plotë qeveritar. Ky argument në të njëjtën kohë shpreh kufizimet funksionale që UNMIK-u kishte në ushtrimin e kompetencave të tij të gjera. Ushtrimi i fuqive qeveritare ishte i kufizuar më tej nga burime të tjera të ligjit ndërkombëtar, si sovraniteti dhe integriteti territorial i Serbisë dhe Malit të Zi, të cilat duhet të respektoheshin nga UNMIK-u aq kohë sa statusi përfundimtar nuk ka qenë i determinuar[369].

Rezoluta 1244, si një projekt i OKB për paqen e Kosovës, ka pasur dy objektiva kryesore: ato që ishin të menjëhershme dhe ato që janë afatgjata[370]. Me qëllim që t'i përmbushte në mënyrë sa më efektive këto objektiva të shumta dhe me qëllim që t'i koordinonte veprimet e organizatave tjera ndërkombëtare,[371] si dhe për t'iu shmangur

[369] Friedrich, "UNMIK in Kosovo: Struggling with Uncertainty"... ,pp. 241-242.

[370] The Kosovo Report Conflict..., p. 106.

[371] Friedrich, "UNMIK in Kosovo: Struggling with Uncertainty"..., p. 237.

inkoherencës që doli nga mësimet e administrimit në Bosnjë e Hercegovinë[372], UNMIK-u strukturën operacionale e organizoi në katër shtylla themelore[373]. Këto shtylla menaxhoheshin nga PSSP-ja, i cili asistohej nga Zëvendës PSSP-ja i parë. Pastaj secila shtyllë kryesohet nga një Zëvendës i PSSP-së [374].

Kjo strukturë organizative i ka shërbyer PSSP-së për ta ushtruar autoritetin e tij ekzekutiv fillestar. Praktikisht këto veprime në Kosovë u realizuan në mënyrë mjaft të efektshme. Për shembull, lidhur me veprimet më emergjente ekzekutive që duhej ndërmerreshin për lehtësimin e krizës humanitare, ishte kthimi i refugjatëve. Në fakt kthimi i refugjatëve ishte njëri prej objektivave kryesorë që duhej përmbushur nga misioni i OKB-së[375]. Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjat u kujdes për Koordinimin dhe ofrimin e asistencës humanitare (Shtylla I). Brenda muajve të parë, më shumë se 700.000 refugjatë u kthyen në shtëpitë e tyre, rindërtimi kishte filluar dhe përgatitjet për dimër ishin në rrugë të mirë[376]. Pasi nevojat e ndihmës emergjente u plotësuan me sukses, Shtylla e Çështjeve Humanitare ka pushuar së ekzistuari në fund të qershorit 2000, si një komponent formal i strukturës së UNMIK-ut. UNHCR-i prapë vazhdoi të mbetet i angazhuar thellësisht në Kosovë. Si një koordinator humanitar, ai ndihmoi në lehtësimin e tranzicionit drejt një rindërtimi dhe zhvillimi afatgjatë[377].

Pas kalimit të fazës emergjente 1999-2000, në vitin 2001, UNMIK-u e ndryshoi strukturën e tij operancionale në bazë të prioriteteve që duheshin arritur. Tanimë nga Maji i vitit 2001, krijimi i një policie shumëkombëshe dhe i strukturave të sistemit të gjyqësisë, si dhe një administrate efikase u panë si çështje shumë të rëndësishme për ushtrimin e autoritetit ekzekutiv të PSSP-së.

Një problem gjeneral me të cilin janë ndeshur pothuajse të gjitha misionet e paqes në shoqëritë e pasluftës ka të bëjë me përpjekjet e tyre për ta kthyer rendin e publik përmes funksionalizimit të një shërbimi administrativ, përfshirë këtu forcat e rendit dhe sistemin e gjyqësisë. Rrjedhimisht, një nga funksionet ekzekutive emergjente të

---

[372] Coelho, "Building stable and effective states through international governance"..., p. 180.

[373] Hooff, *UN Transitional Administrations...*, p. 78.

[374] Friedrich, "UNMIK in Kosovo: Struggling with Uncertainty"..., p. 237.

[375] Po aty, p. 107.

[376] Po aty, p. 107.

[377] Po aty, p, 119.

UNMIK-ut, gjatë fazave fillestare të tranzicionit në Kosovë, po ashtu, ka qenë orientuar në përmbushjen e një funksioni administrativ dhe pastaj përgatitjen e strukturave vendore për marrjen e kësaj përgjegjësie. Çështjet që kanë përfshirë këtë fushë, pas riorganizimit të strukturës operacionale të UNMIK-ut, kanë rënë në kuadër të dy shtyllave të para: Policia dhe Drejtësia (Shtylla e I) dhe Administrata Civile (Shtylla II), të udhëhequra nga vet OKB-ja.

Këto veprime u ndërmorën si rezultat i boshllëkut ekzekutiv që u krijua nga tërheqja e sistemit administrativ serb pas përfundimit të luftës dhe shkatërrimit të mëvonshëm ose "konfiskimit" të dokumentacionit zyrtar (të dhënat dhe arkivat) nga Serbia. UNMIK-u u detyruar për të filluar praktikisht nga zeroja në menaxhimin e ndërtimit të një administrate efikase. UNMIK-u mori përsipër funksionet administrative ekzekutive në nivel qendror dhe në nivel lokal, të cilat përbëheshin nga të gjitha llojet e detyrave që duheshin menaxhuar. Duke filluar me asgjësimin e mbeturinave, lëshimin e dokumenteve të identitetit, sistemin e arsimit dhe të shëndetësisë, e deri te politikat e taksave[378] dhe detyrave tjera tipike për një organ ekzekutiv siç është qeveria e shtetit.

Kjo ishte periudha e parë e ushtrimit të autoritetit ekzekutiv, ku kompetencat e PSSP-s ishin absolute dhe të pacenueshme si në nivelin lokal ashtu edhe në atë qendror. Në këtë periudhë UNMIK-ut iu deshtë të rindërtoj të gjitha institucionet e vetëqeverisjes, të emëroj stafin ndërkombëtar dhe atë vendor, të menaxhoi me shpenzimet dhe të pajiste objektet. Megjithëkëtë, UNMIK-u është vlerësuar të ketë qenë i ngadalshëm në themelimin e pranisë së tij në terren[379]. Duke u përballur me detyrën masive të rekrutimit dhe zbarkimit të një administrate të tërë civile, ai është kritikuar shpesh për pasivitetin e tij fillestar. Bernard Kushner u emërua Përfaqësues Special i OKB-së me 2 Korrik 1999 dhe mori përsipër detyrat e tij më 15 Korrik. Deri në qershor 2000, administrata civile ndërkombëtare e kishte rritur në 292 numrin e personelit profesional nga një total i autorizuar prej 435. OSBE-ja, me një total të stafit të autorizuar prej 751, kishte 564 anëtarë të stafit ndërkombëtar në vend, UNHCR-ja ka pasur 78, dhe Shtylla për ekonomi dhe rindërtim 63. Përveç kësaj, ka pasur 547 vullnetarë të OKB nga 83 vende[380].

---

[378] Baliqi, "Externes State-Building durch die Vereinten Nationen"..., s. 126.

[379] ICG, *Waiting for UNMIK: Local Administration in Kosovo,* Ballkan Report, N° 79 Prishtinë/Priština, 18 October 1999.

[380] The Kosovo Report Conflict..., p. 107.

Kur jemi te analizimi i veprimtarisë qeverisëse ekzekutive emergjente të UNMIK-ut, përveç kësaj që u tha deri tani, po ashtu duhet theksuar se në rolin e UNMIK-ut në administrimin e shërbimeve sociale dhe konsolidimit të sundimit të ligjit, rëndësi të madhe ka edhe përpjekja e tij për ndërtimin e institucioneve dhe demokratizimin e shoqërisë kosovare (Shtylla III-OSBE), si dhe përpjekjet që ka bërë në menaxhimin e sektorit të rindërtimit dhe zhvillimit ekonomik (Shtylla IV-UE).

Ndërtimi i institucioneve dhe demokratizimi i shoqërisë kosovare, ndër të tjera, ka qenë objektivë parësore për UNMIK-un. Administrata ndërkombëtare vlerësonte se në saje të përmbushjes së kësaj objektive, rrjedhimisht do të krijoheshin kushte më të mira për UNMIK-un që të ushtronte autoritetin efektiv ekzekutiv për forcimin e rendit publik. Andaj, me kohë, UNMIK-u e ngarkoi OSBE-në që të përmbushte një numër të madh të detyrave që binin në kuadër të fushave të administrimit civil dhe rendit e drejtësisë. Me fjalë tjera, OSBE-ja ishte ngarkuar me detyrën e krijimit të kushteve për një transformim socio-politik drejt një sistemi pluralist dhe demokratik.

Disa nga prioritetet e OSBE-së si: demokratizimi, të drejtat e njeriut, sundimi i ligjit, synoheshin të arriheshin nga ndërtimi i kapaciteteve lokale me akter politik dhe me OJQ të ndryshme; një shkollë trajnuese të policisë; si dhe ndarjet e specializuara në fushën e sundimit të ligjit dhe të drejtave të njeriut[381]. Përveç kësaj, OSBE-ja ka përmbushur një funksion në zhvillimin e medieve dhe organizimin e zgjedhjeve[382].

Një tjetër objektivë dhe funksion i autoritetit ekzekutiv i UNMIK-ut që u shndërrua në prioritet, ka qenë rindërtimi dhe zhvillimi ekonomik dhe infrastrukturor. Është vlerësuar se një paqe e qëndrueshme në rajonin e Kosovës mund të qëndronte në saje të prosperitetit të saj të ardhshëm. Rimëkëmbja ekonomike është një parakusht i qetësisë shoqërore dhe bashkëjetesës ndërmjet komuniteteve. Ajo kërkon, megjithatë, fonde ndërkombëtare të vazhdueshme, si për misionin e OKB-së, ashtu edhe për rindërtimin e territorit [383]. Kjo bëri që një gamë e gjerë e agjencive ndërkombëtare qeveritare dhe jo qeveritare të financonin përpjekjet për rindërtimin e Kosovës. Ato u fokusuan në fusha si: riparimin e infrastrukturës fizike, sektorin energjetik, dhe shërbimet e ujit; shërbimet administrative, etj. Rigjallërimi i aktiviteteve erdhi edhe si

[381] Richmond & Franks, *Co-opting the Liberal Peace...*, p. 4.

[382] Jens Narten, "Assessing Kosovo's Postwar Democratization Between External Imposition and Local Self-Government", *Taiwan Journal of Democracy* 5 (2009), pp. 127-162.

[383] The Kosovo Report Conflict..., p. 123.

rezultat i bashkëpunimit të UNMIK-ut me FAO-n dhe Bankën Botërore, pastaj edhe me instalimin e një sektori bankar, etj[384].

Pushteti gjyqësor: Përveç autorizimeve legjislative dhe ekzekutive, sferat e autoritetit qeveritar të UNMIK-ut binin edhe mbi çështjet e gjyqësorit. Siç u tha më lartë, menjëherë pas vendosjes në Kosovë, UNMIK-u u përballë me një situatë anarkike në fushën e rendit dhe drejtësisë. Për administratën ndërkombëtare ishte një fakt evident se pa një gjyqësi efikase dhe profesionale nuk mund të krijohej rendi publik dhe të sigurohej drejtësia për shoqërinë kosovare. Kjo lloj drejtësie, në literaturën e së drejtës ndërkombëtare nga disa autorë njihet si *Jus Post Bellum*[385] (drejtësia pas lufte).

Kjo bëri që misioni ndërkombëtar ushtarak dhe civil në Kosovë, që në fillim, të vepronte në një atmosferë të paqartësisë ligjore, veçanërisht në lidhje me atë se cilat ligje duhet të aplikohen. Në një atmosferë të tillë, nuk ekzistonte asnjë lloj infrastrukturë mbështetëse ligjore për atë kohë. Kjo situatë i detyroi trupat e KFOR-it që të merren me raste në bazë të ligjeve të veta vendore, sepse ajo çfarë mund të bënin policët ndërkombëtarë në një situatë të tillë komplekse ishte që të veprojnë "si munden më së miri" [386]. Andaj, kur kemi të bëjmë me zbatimin e përgjithshëm të sundimit të ligjit në Kosovë, KFOR-i ishte duke u ballafaquar më pengesa të mëdha. Përkundër faktit se qysh herët NATO-ja vendosi t'ia japë COMKFOR-it komandën dhe kontrollin mbi të gjitha forcat në Kosovë, akoma mungonte një koordinim (i vogël në mes të brigadave kombëtare) me përjashtim të forcave britanike që ishin në dispozicion për COMKFOR-in në raste të dërgimit të trupave jashtë sektorit të kësaj brigade. Çdo forcë tjetër kombëtare e kishte rrugën e vet, pa marrë parasysh se çfarë kërkohej, që rezulton në metoda shpesh konfliktuoze të operimit dhe programe kundërshtuese[387].

---

[384] Po aty, p. 121.

[385] Kristen Boon, "Legislative Reform in Post-conflict Zones"..., p. 293.

[386] KIPRED&CASIN, Administrimi *dhe qeverisja në Kosovë, Mësimet e mësuara dhe ato që mbeten për tu mësuar, Tërësia e Kompetencave, Rehabilitimi i shoqërive të shkatërruara nga lufta,* Prishtinë/Gjenevë, qershor 2005, faqe 18.

[387] Po aty, f. 19. Po ashtu, shih më tej në: David Marshall & Shelley Inglis, "The Disempowerment of Human Rights–Based Justice in the United Nations Mission in Kosovo", *Harvard Human Rights Journal* 16 (2003), p. 108.

Rrjedhimisht, krijimi i një administrate të duhur gjyqësore në Kosovë ishte një nga objektivat kryesore të UNMIK-ut. Pas përfundimit të konfliktit, infrastruktura fizike e sistemit gjyqësor u shkatërrua në masë të madhe. Si pasojë, autoritetet e OKB-së është dashur të mbështeten në avokatët e huaj dhe njëkohësisht në personelin e gjykatave vendore në mënyrë që të instalonin sistemin e drejtësisë. Rezultati ishte krijimi i gjykatave të përziera, siç janë gjykatat të cilat kanë kompozime të përziera të gjyqtarëve ndërkombëtarë dhe vendorë [388].

3.5 Autoriteti, legjitimiteti dhe llogaridhënia e UNMIK-ut

Fenomeni i përqendrimit të pushtetit në duartë e një personi, si në shembullin e PSSP-së, ka bërë që të ngriheshin pyetje mjaft sfiduese rreth veprimtarisë së administratave ndërkombëtare në lidhje me administrimin e territoreve të caktuara. Ndër çështjet më të diskutuara në teorinë dhe praktikën e administrimit territorial ndërkombëtar kanë qenë ato rreth autoritetit, legjitimitetit, llogaridhënies dhe përformacës së këtyre administratave.

Është evident fakti, që aktualisht, në pjesën dërmuese të debatit akademik lidhur me veprimtarinë e administrimit ndërkombëtar të shoqërive dhe territoreve, dominojnë çështjet rreth autoritetit dhe legjitimitetit të bashkësisë ndërkombëtare, përkitazi me këtë veprimtari.

Lidhur me çështjen e autoritetit dhe të legjitimitetit të bashkësisë ndërkombëtare të përfshira në veprimtari të tilla, Fukuyama pohon se sot debatet e mëdha nuk bëhen për parimin e sovranitetit në vetvete. Sipas tij, jo të gjitha sovranitetet janë të barabarta dhe se qeverisja e dobët kontribuon në mënyrë të drejtpërdrejtë në zhvlerësimin e respektit të komunitetit ndërkombëtar për sovranitetin e një vendi. Ai shton më tej, se sot debati në mes të anëtarëve të bashkësisë ndërkombëtare fokusohet në çështjen se kush do ta marrë vendimin, se cili sovranitet do të cenohet dhe mbi çfarë argumentesh[389]. Në vazhdim, Fukuyama shtron edhe pyetjet se në çfarë shkalle mbetet në prerogativën e shteteve-kombe sovrane dhe deri në ç'masë duhen kufizuar këto

[388] Friedrich, "UNMIK in Kosovo: Struggling with Uncertainty"..., p. 263.

[389] Francis Fukuyama, *Ndërtimi i Shtetit: Qeverisja dhe Rendi Botëror në Shekullin e 21-të* (Tiranë: AIIS, 2010), f, 155-156.

vendime nga ligjet apo normat ndërkombëtare? Këto pyetje, sipas tij janë të fokusuara në çështjet e legjitimitetit demokratik në kuadër të sistemit ndërkombëtar[390].

Në vazhdën e kësaj logjike, Zaum argumenton se në dekadat e pas Luftës së Ftohtë, është dëshmuar një gatitshmëri gjithnjë në rritje nga bashkësia ndërkombëtare për të ndërhyrë në punët e brendshme të shteteve, sidomos me synimet për t'i dhënë fund konflikteve dhe rindërtimin e institucioneve politike dhe administrative në shoqëritë post-konfliktuale. Për shembull, administratat ndërkombëtare, sidomos në Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë, dhe në Timorin Lindor, kanë qenë autoritetet më të larta qeverisëse gjatë administrimit të këtyre territoreve përkatëse. Andaj, debatet dhe dilemat që janë prodhuar lidhur me ushtrimin e këtij autoriteti, kanë qenë ato nëse autoriteti i tyre është në kundërshtim me konceptet bashkëkohore të qeverisjes legjitime demokratike[391]. Edhe në rastin e qeverisjes së Kosovës nga UNMIK-u, Friedrich, rekomandon të shtrohet pyetja nëse përqendrimi i pushtetit, i cili çoi në një kontroll të plotë *de facto* qeveritar nga ana e OKB-së, ishte legjitim nën dritën e mandatit të Rezolutës 1244[392].

Në lidhje me autoritetin e ushtruar nga UNMIK-u në qeverisjen e shoqërisë kosovare, kritika kryesore që UNMIK-ut i dha vlerësimet për një "qeverisje të keqe", ka qenë veçanërisht e ashpër në lidhje me legjitimitetin e qeverisjes së tij. Një pikë ku janë fokusuar kritikat kryesore, ka të bëjë anashkalimin e vullnetit të popullatës shumicë-shqiptarëve të Kosvës. Madje, në këtë drejtim, janë tërhequr paralele krahasimi me raste tjera, si për shembull me UNTAC-un në Kamboxhia, mision i cili ishte inauguruar përmes një marrëveshjes paqesore të palëve të përfshira në konflikt. Për dallim, "UNMIK-u ishte krijua me marrëveshjen në mes NATO-s, Rusisë dhe RFJ-së dhe jo në marrëveshje me shqiptarët e Kosovës". Natyra arbitrare e qeverisjes së OKB-së, gjithashtu ka pasur një efekt të dëmshëm në procesin demokratik dhe inkurajimin e bashkëpunimit me vendorët[393]. Kjo natyrë arbitrare, sipas disa

[390] Po aty, f. 155.

[391] Zaum, *The Authority of International Administrations...*, p.1.

[392] Friedrich, "UNMIK in Kosovo: Struggling with Uncertainty"..., p. 241.

[393] Oliver P. Richmond & Jason Franks, *Co-opting the Liberal Peace: Untying the Gordian Knot in Kosovo*, Centre for Peace and Conflict Studies, University of St Andrews, UK 2007, p. 12.

studiuesve, madje e ka vënë komplet në pikëpyetje legjitimitetin e UNMIK-ut për të ushtruar autoritet qeveritar në Kosovën e pas luftës[394].

Nga shumë qarqe vendore dhe ndërkombëtare, tanimë është argumentuar se procesi i qeverisjes së shoqërisë kosovare nga UNMIK-u ka qenë i karakterizuar me një rënie të vazhdueshme të legjitimitetit të tij qeverisës, duke shkaktuar një tendosje gjithnjë e më të thellë gjatë zhvillimit të trajektores së tranzicionit[395]. Atëherë, mbi bazën e këtyre konstatimeve mund të shtrohet pyetja se përse legjitimiteti i UNMIK-ut ka shënuar rënie të vazhdueshme në opinionin kosovar dhe atë ndërkombëtar?

Kjo pyetje, në dukje të parë është mjaft paradoksale, sidomos duke pasë parasysh faktin që menjëherë pas vendosjes së UNMIK-ut në Kosovë, kjo administratë në opinionin e gjerë kosovar ishte perceptuar si "çlirimtare". Atëherë, paradoksi qëndron në atë se çka ka ndikuar, që kjo administratë të perceptohet ndryshe përgjatë viteve, madje edhe si "regjim kolonial"? Përgjigjen e kësaj pyetje ndoshta duhet kërkuar në dështimin e UNMIK-ut për të qenë efikas në menaxhimin me faktorët dhe problemet standarde të cilat paraqiten si erozion për autoritetin dhe legjitimitetin e bashkësisë ndërkombëtare në administrimin e një territori. Knoll numëron vetëm disa nga arsyet apo faktorët e tillë që e minojnë legjitimitetin e një administrate. Sipas tij, ato janë: korrupsioni, obstruksionizmi lokal dhe ndarjet e brendshme, dështimi për të promovuar transparencën e qeverisjes, një lidhje e parëndësishme ndërmjet administratës civile dhe strukturave të komandës ushtarake, dhe një sërë paaftësish të përgjithshme[396]. Përveç këtyre arsyeve, studiuesit kanë numëruar edhe një sërë çështjesh tjera që tregojnë për dështimet e UNMIK-ut dhe dilemën e legjitimitetit të tij. Ndër këto arsye, mund të numërohen: papërgjegjësia e autoritetit të UNMIK-ut (instalimi i një demokracie të kontrolluar ndërkombëtarisht), jo-uniteti territorial administrativ i autoritetit të tij (problemi i eksterritorialitetit etnik), tendosjet e vazhdueshme të popullatës vendore (shpërthimi i trazirave ndëretnike), paqartësia

[394] Bernhard Knoll, *Legitimacy and UN Administration of Territory*, Journal of International Law & Policy, Vol. IV, 2007, p. 5.

[395] Nicolas Lemay-Hébert, *State-building from the Outside-In:UNMIK and its paradox*, The Journal of Public and International Affairs, Princenton University, Woodrow Wilson School of Public and International Affairs, 20, 2009, pp. 66-85.

[396] Knoll, "Legitimacy and UN Administration of Territory"..., p.2.

kohore e zgjidhjes së statusit final të vendit, dhe në përgjithësi mos realizimi i qeverisjes së mirë demokratike[397].

Një nga shkaqet më të rëndësishme që ka ndikuar në mënyrë vendimtare në dështimin e UNMIK-ut për ta siguruar legjitimitetin qeverisës në shoqërinë kosovare, qëndron direkt i lidhur me shkallën e lartë të autorizimeve të PSSP-së për të qeverisur me këtë shoqëri. Pra, shkalla e ultë e legjitimitetit të UNMIK-ut është në proporcion të zhdrejtë me shkallën e lartë të autorizimeve të PSSP-së.

Sipas liderit të "Lëviza Vetvendosje", "Misioni i UNMIK-ut ishte ruajtja e stabilitetit në vend si dhe përgatitja e Kosovës për një autonomi brenda Serbisë. Si i tillë, ky mision s'kishte se si të mos jetë i imponuar dhe jodemokratik. Ky mision sundonte në mënyrë absolute në Kosovë, ndërkohë që llogaridhënien e zhvillonte jashtë saj, në Këshillin e Sigurimit. Duke qenë mision i imponuar dhe kundër vullnetit të popullit të Kosovës, UNMIK-u nuk ishte aspak i kushtëzuar që t'u jepte llogari atyre. Ai i ishte mbivendosur në mënyrë jodemokratike popullit dhe përfaqësuesve të tij. Në anën tjetër, administratorët e UNMIK-ut sundonin me disa ligje ndaj të cilave vetë ishin imunë dhe të cilat mund t'i shkelnin saherë që të donin"[398].

Siç thekson Hébert, përveç rolit potencial të madh të PSSP-së në jetën dhe proceset politike kosovare, ai gjithashtu u përball me pritje të larta të popullatës vendore. I vendosur në situatën e një qeverie *de facto* të Kosovës, UNMIK-un, *ipso facto* duhej të përballej me të njëjtat kërkesa si çdo qeveri legjitime[399]. Andaj, duke pasur parasysh faktin se UNMIK-u ishte *de jure* në krye të Kosovës, në mënyrë logjike atij iu atribuuan të gjitha ngecjet në proceset politike dhe shoqërore në Kosovë. Pasi që UNMIK-u nuk ishte qeveri e zgjedhur, kosovarët u bënë shumë kritik. UNMIK-u thjeshtë nuk mundi ta bindë popullatën për legjitimitetin e qeverisjes në territorin e Kosovës. Derisa qeverisja e UNMIK-ut gjatë fazës

[397] Shih më tej: Reka, *UNMIK as an international governance…,* pp. 144-174.

[398] Albin Kurti, Intervistë e realizuar me shkrim, "Levizja Vetëvendosje", Prishtinë, 24.02.2014.

[399] Nicolas Lemay-Hébert, *State-building from the Outside-In:UNMIK and its paradox,* The Journal of Public and International Affairs, Princenton University, Woodrow Wilson School of Public and International Affairs, 20, 2009, pp. 67-68.

“emergjente” të intervenimit nga 1999 deri me 2001 ishte mirëpritur, ajo ngadalë filloi të shihej si e bezdisshme dhe imponuese[400].

Studimet e bëra ndër vite, madje nga vetë programet e OKB-ës, në lidhje me përformacën e përgjithshme të UNMIK-ut dhe të institucioneve tjera vendore, paraqesin një hendek të thellë të përformancës së këtij misioni, lidhur me përmbushjen e objektivave të tij afatshkurtra dhe atyre afatgjata. Ashtu siç është treguar në figurën 11, vërehet qartë se që nga viti 2002 deri në vitin 2008, trajektorja e përformancës së UNMIK-ut ka rënë vazhdimisht. Hendeku më i thellë i kësaj trajektoreje është ndjerë në vitin 2004.

Figura 11. Kënaqshmëria me institucionet kryesore të Kosovës: 2002-2008.



Burimi: UNDP & USAID, *Early Warming Report*, No. 19, January 2008, p.1.

[400] Po aty. p. 69.

Sidoqoftë, pavarësisht këtyre statistikave treguese, ngjarjet e trazirave të dhunshme që shpërthyen në muajin mars të vitit 2004, u paraqiten si treguesi më i saktë i shprehjes së pakënaqësisë së popullit të Kosovës (sidomos popullsisë shumicë) si rezultat i frustrimit politik.

Në këto trazira që e zgjuan bashkësinë ndërkombëtare, 20 njerëz u vranë, 800 shtëpi dhe 30 kisha të shkatërruara, dhe më shumë se 4.000 serbë dhe të tjerë jo-shqiptarë u larguan nga shtëpitë e tyre[401]. Shumë shpejt, OKB-ja e bëri të ditur karakterin e motivuar etnikisht të dhunës që ishte si pasojë e dështimeve të UNMIK-ut për tu marrë në mënyrë efektive me çështjen e statusit final[402]. Ndërkohë, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, vuri në dukje dështimin e tyre, duke argumentuar se "ne nuk kemi shkuar mjaft larg", UNMIK-u gjithashtu fajësoi drejtuesit e IPVQ-ve të cilët kishin reaguar si "ambivalentë"[403]. Kjo ngjarje dëshmoi se sa shpejt mund të përshkallëzohej situata në territor. Popullata e Kosovës mbase u dukë se nuk do të tregonte gatitshmëri të mbeste përherë peng i politikës së standardeve para statusit dhe dëshmoi se shumë lehtë do të mund të zgjidhte të ndërmerrte veprime më të drejtpërdrejta[404].

Me gjithë deklarimet e deritanishme lidhur me vlerësimin e rolin qeverisës të UNMIK-ut në Kosovë, si përfundim, mund të sillen edhe opinionet e qytetarëve të Kosovës, të cilët paraqesin matjen empirike të performancës së këtij misioni në këtë kontekst. Këto të dhëna janë paraqitur si në vijim në grafiku 12 dhe 13.



[401] Hoff, *UN Transitional Administrations...*, p.82.

[402] Friedrich, "UNMIK in Kosovo: Struggling with Uncertainty"..., p. 227.

[403] Hoff, *UN Transitional Administrations...*, p. 82.

[404] Weller, *Shtetësia e kontestuar...*, f. 312.

Figura 13. Në cilën nga këto çështje mendoni se UNMIK-u ka pasur më shumë dështime?



KREU IV:

ROLI I UNMIK-ut NË NGRITJEN E KOMPONENTËVE SHTETNDËRTUESE NË KOSOVË

4.1 Strategjitë dhe qasjet e shtetndërtimit ndërkombëtar

Tanimë pothuajse është bërë një praktikë e zakonshme e misioneve të reja të paqes, sidomos atyre të gjeneratës së katërt, që pasi ta kenë përmbushur fazën fillestare të kontrollit mbi trajektoren e tranzicionit, (qeverisja direkte), paralelisht të fillojnë edhe me ndërtimin dhe forcimin e kapaciteteve institucionale vetëqeverisëse të brendshme. Një proces i tillë gjerësisht është vlerësuar si proces i shtetndërtimit ndërkombëtar. Në ndërkohë, është vlerësuar se këto institucione do të shërbejnë si themele të forta për ringjalljen e një regjimi të ri dhe të përgjegjshëm në të cilin qeveritë shtetërore kanë për detyrë të veprojnë si "agjent moral" në sigurimin e standardeve të caktuara të qeverisjes ndaj qytetarëve të tyre, në mënyrë që të njihet si shtet sovran-legjitim e që përbën *sovranitetin pozitiv*.

Mbi bazën e kësaj logjike do të analizojmë se si ka vepruar UNMIK-u në ndërtimin e kapaciteteve vetëqeverisëse vendore, të cilat më vonë kanë shërbyer si një platformë shtetndërtuese në Kosovë, ndonëse kjo nuk ka qenë e specifikuar shprehimisht në mandatin e UNMIK-ut. Ky aktivitet i UNMIK-ut, në aspektin e fazave të implementimit të mandatit të tij, binte brenda tri fazave të fundit dhe që synonin përmbushjen e objektivave afatgjate. Ato përbëheshin nga përgatitjet për mbajtjen e zgjedhjeve, themelimin e institucioneve të përkohshme për një vetëqeverisje demokratike dhe autonome, dhe ndërmarrjen e masave për zgjidhjen përfundimtare të statusit.

Është vlerësuar se ndër sfidat më të mëdha dhe preokupuese në agjendën e qendrave vendimmarrëse botërore në fillim shekullin e 21-të, padyshim vendin kryesor e zënë çështjet që kanë të bëjnë me shtetndërtimin, sidomos në rrethanat post-konfliktuale. Përveç kësaj, pjesë e këtyre agjendave janë edhe përpjekjet ndërkombëtare për të parandaluar dhe për të menaxhuar pasojat e dështimit të një shteti të brishtë[405]. Madje, sa i përket rëndësisë së shtetndërtimit, sidomos në planin strategjik, Fukuyama pohon se, një nga çështjet më sfiduese dhe njëherit më të rëndësishme për bashkësinë ndërkombëtare, aktualisht janë që sillen rreth

[405]Chandler, *The State-Building Dilemma*...,p. 70.

shtetndërtimit.[406]. Kjo rëndësi, sipas këtij plani, mund të shpjegohet përmes qasjes "brenda duke shikuar jashtë", që në rrafshin e sigurisë do të thoshte se një kërcënim eventual për sigurinë ndërkombëtare do të vinte direkt nga pasiguria brenda shteteve, veçanërisht atyre që janë fragjile dhe që priren të jenë të dështuara. Si pasojë, kjo zgjon interesim për ndërhyrje direkte nga bashkësia ndërkombëtare, përmes administrimit të territoreve dhe shoqërive të caktuara.

Duke u gjendur përballë situatave të tilla, bashkësia ndërkombëtare, e ka vlerësuar përdorimin e qeverisjes së drejtpërdrejtë nga jashtë, përmes misioneve të saj paqeruajtëse si një nga qasjet më adekuate, me qëllim që t'u përgjigjet këtyre situatave, sidomos në ato vende ku kapacitetet e autoriteteve vendore kanë qenë të brishta. Zakonisht, praktikat e ndryshme flasin se menjëherë pas instalimit të këtyre misioneve, atyre iu është ngarkuar një përgjegjësi komplekse, duke përfshirë një sërë objektivash dhe veprimtari politike, që në përgjithësi janë të njohura si shtetndërtim ndërkombëtar apo nga jashtë[407].

Por, lidhur me atë se si e ushtron bashkësia ndërkombëtare këtë aktivitet në praktikë, përmes administratave ndërkombëtare, janë ngritur dy pyetje themelore, në përgjigjen e të cilave zhvillohet një debat mjaft i gjallë. Pra: Cilat janë *strategjitë* që i përdor bashkësia ndërkombëtare në procesin e shtetndërtimit përmes administratave ndërkombëtare dhe cilat janë *qasjet* që i aplikon për arritjen e këtyre strategjive?

Mund të thuhet se, marrë në përgjithësi në radhët e komunitetit akademik nuk ka një konsensus të qartë lidhur me atë se cilat strategji dhe qasje mund të konsiderohen si standarde për tu aplikuar në lidhje me shtetndërtimin ndërkombëtar. Për shembull, disa autorë u japin përparësi aplikimit të atyre qasjeve që për autorët tjerë mund të jenë dytësore. Ky mospajtim, në radhë të parë vije si rezultat i asaj që as vetë bashkësia ndërkombëtare nuk ka agjendë të qartë standarde shtetndërtuese që do ta aplikonte në mënyrë uniforme ndaj të gjitha atyre territoreve apo shoqërive që shfaqin nevojën për t'u aplikuar kjo agjendë. Kjo ngase secili rast paraqitet si praktikë unike, që poashtu kërkon aplikimin e strategjive dhe qasjeve unike.

Mirëpo, pavarësisht mungesës së këtij konsensusi, në përgjithësi, konsiderohet se dy strategji dhe qasje madhore, kanë qenë të përfshira në procesin e shtetndërtimit ndërkombëtar gjatë dy dekadave të fundit, e po ashtu dhe sot e përbëjnë debatin

[406] Francis Fukuyama, *Ndërtimi i Shtetit...*,f, 17.

[407] Oisín Tansey, *International Administration and Democratic Regime-Building…*, p.1.

kryesor lidhur me këtë proces. Njëra nga këto strategji njihet si "Së pari Liberalizimi", e cila insiston në vendosjen e liberalizimit para institucionalizimit; kurse strategjia tjetër njihet si "Së pari Institucionalizimi" dhe që pretendon për vendosjen e institucionalizimit para liberalizimit.

Pavarësisht kësaj, disa studiues theksojnë se që nga fundi i Luftës së Ftohtë, megjithatë, qasja e bashkësisë ndërkombëtare e rindërtimit dhe zhvillimit të entiteteve shtetërore, është zhvendosur nga strategjia dominuese e hershme-së pari liberalizimi[408]*; në strategjinë aktuale dhe më të pranuar-së pari institucionalizimi[409].

Strategjia së pari liberalizimi, e cila përbënte paradigmën dominuese të politikës zhvillimore në periudhën e menjëhershme të Pasluftës së Ftohtë, shikon në promovimin e demokratizimit dhe krijimin e ekonomive të tregut (i ashtuquajturi Konsensusi i Washingtonit), si garantuesit më të mirë të paqes dhe stabilitetit në shoqëritë post-konfliktuale[410]. Shtetndërtimi sipas kësaj strategjie, nënkupton një përpjekje të koncentruar ndërkombëtare, që fillimisht ka për synim nxjerrjen e akteve të brendshme juridike, duke përfshirë këtu madje edhe një kushtetutë, përmes së cilës do të krijohej një sistem shoqëror me parime liberale. Kjo do të nënkuptonte se në këtë sistem, në përgjithësi do të instalohej praktika e qeverisjes së mirë dhe të përgjegjshme, ku do të garantoheshin dhe promovoheshin liritë civile dhe politike, pastaj do të kishte një administratë publike efektive, reforma ekonomike gjithëpërfshirëse, mbajtjen e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, etj[411]. Andaj, kjo strategji mbështetet mbi tezën e teorisë së "Paqes Demokratike", e cila sipas

---

[408] *Kjo strategji ka qenë aplikuar nga komuniteti i shteteve perëndimore të udhëhequra nga ShBA-të. Gjatë periudhës së garës ideologjike bipolar me kampin komunist, vendet perëndimore synonin në përhapjen e vlerave liberal-demokratike, në mënyrë që ato të instaloheshin në shoqëritë e caktuara me qëllim që ta kundër balanconin përpjekjen e kampit komunist, i cili gjithashtu synonte në përhapjen e vlerave komuniste. Të dyja kampet i përdornin këto strategji afatgjate, me qëllim që të krijonin rreth vetës sa më shumë vende satelite, dhe kjo tentohej të arrihej duke ua përcaktuar natyrën e regjimit të brendshëm të qeverisjes. Këto përpjekje mund t'i quajmë si "politikat e infektimit".

[409] David Chandler, *Empire in Denial: The Politics of State-Building* (London: Pluto Press, 2006), pp. 54-55.

[410] Achim Wennmann, *Grasping the Strengths of Fragile States: Aid Effectiveness Between 'Top-down' and 'Bottom-up' Statebuilding*, Centre on Conflict, Development and Peacebuilding (CCDP), 2010, p. 6.

[411] Coelho, "Building stable and effective states through international governance"..., p. 76.

konceptimeve Kantiane, argumenton se mënyra më e mirë për paqësimin e kontekstit të marrëdhënieve ndërkombëtare mund të arrihet atëherë kur të gjitha, apo pjesa më e madhe e regjimeve të qeverisjes, do të jenë me natyrë liberal-demokratike. Kjo teori mbështetet në premisën që demokracitë nuk shkojnë në luftë me njëra-tjetrën[412].

Pavarësisht, qëndrimeve të kësaj strategjie, një numër i studiuesve[413] kanë shtruar mjaft dilema nëse strategjia së pari liberalizmi, mund të jetë efektive për të krijuar rrethana për një paqe të qëndrueshme në shoqëritë post-konfliktuale[414]. Ata gjithnjë e më tepër kanë filluar t'i japin prioritet strategjisë, së pari institucionalizimit. Mbështetësit e kësaj strategjie argumentojnë se për të arritur objektiva strategjike për paqe të qëndrueshme, së pari është me rëndësi ndërtimi i institucioneve të forta dhe stabile.

Një shembull kryesor i kësaj qasjeje është ai i Roland Parisit. Paris e kritikon tezën e "paqes liberale" mbi bazën se politika ndërkombëtare, e cila e sheh ekonominë e tregut dhe liberal-demokracinë si dy parakushte për një paqe të qëndrueshme, dhe që e keqkupton procesin e tranzicionit nga lufta në paqe. Paris argumenton se është e nevojshme që të ketë "institucionalizim para liberalizimit", d.m.th, duhet përqendruar në ndërtimin e institucioneve të forta, sundimin e ligjit dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, para se shoqëritë post-konfliktuale të kenë të drejtë në posedimin e një roli në çështjet e tyre. Ai argumenton se procesi politik i garës demokratike në një shtet të dobët ose të dështuar, ose të ndonjërit që bënë një tranzicion nga lufta në paqe, ka të ngjarë të jetë kundër produktiv. Kjo mund të ndodhë sepse konkurrenca e partive politike është e bazuar në idenë e konfliktit të interesave, andaj ky proces ka më tepër tendencë t'i përkeqësojë konfliktet dhe tensionet në këto shoqëri, sesa t'i përmirësoj ato[415].

Lidhur me qasjet që aplikohen për realizimin e këtyre strategjive, në përgjithësi konsiderohet se dy prej tyre janë më të rëndësishme. Njëra qasje njihet si "lartë-poshtë" ose "top-down", (funksionon brenda strategjisë, institucionalizimi para liberalizimit); kurse qasja tjetër është e njohur si "poshtë-lart" ose "buttom-up",

---

[412] Goldstein, *Marrëdhëniet Ndërkombëtare*, f. 190-191.

[413] Oliver Richmond, Roland Paris, David Chandler, etj.

[414] M. A. Mohamed Salih, *A critique of the political economy of the liberal peace: Elements of an African experience*: *New perspectives on liberal peacebuilding*, Edited by Edward Newman, Roland Paris and Oliver P. Richmond (United Nations University Press, 2009), pp. 133-158.

[415] David Chandler, *The State-Building Dilemma...*, p.774-75.

(funksionon brenda strategjisë, liberalizimi para institucionalizimit) [416] . Por, pavarësisht kësaj skeme ndarëse, studiuesi Menocal argumenton se lidhur me procesin e shtetndërtimit, aktualisht fokusi nuk është vetëm në ndërtimin apo forcimin e institucioneve formale dhe kapaciteteve shtetërore, përveç kësaj, bashkësia ndërkombëtare tani është e vetëdijshme se zhvillimi i shtetit nuk mund të jetë i izoluar dhe se marrëdhëniet shtet-shoqëri janë thelbësore për proceset e shtetndërtimit[417]. Kjo do të thotë se shtetndërtimi nuk është i fokusuar thjeshtë vetëm rreth qasjes "top-down" të forcimit institucional (d.m.th, duke u fokusuar në akterët shtetëror dhe/ose elitat kombëtare), por edhe në lidhje me qasjen "buttom-up", d.m.th, në lidhjen e shtetit dhe shoqërisë, duke punuar përmes shoqërisë civile dhe OJQ-ve. Andaj, duhet theksuar se të dyja këto qasje, sado që kanë një shkallë pavarësie, prapë se prapë, ato funksionojnë si të ndërlidhura[418]. Për më tej, aplikimi i ndërlidhur i këtyre dy qasjeve nënkupton që edhe dy strategjitë e lartë cekura janë të ndërlidhura, të paktën në mënyrë implicite.

4.2 Procesi dhe komponentët e shtetndërtimit ndërkombëtar në Kosovë

Në këtë studim, veprimtaria shtetndërtuese e UNMIK-ut në kontekstin e Kosovës, është e përbërë nga dy pjesë. Në pjesën e parë është bërë një analizë e procesit shtetndërtues në Kosovë, d.m.th, në lidhje me atë se në çka konsiston ky proces, kurse në pjesën e dytë është bërë matja e performancës së këtij procesi, pra vlerësimi në praktikë i asaj se sa ka arritur ky mision t'i konsolidoj kapacitetet shtetndërtuese në Kosovë.

Ka një vlerësim të gjerë të faktit se Kosova ka qenë dhe mbetet në qendër të vëmendjes rreth zhvillimeve në lidhje me ndërtimin e shtetit dhe sovranitetin vitet e fundit. Kjo madje bënë që Kosova të jetë një rast me vend për të analizuar. Po ashtu, duhet theksuar se Kosova, shikuar nga ky këndvështrim, paraqet një rast të veçantë në

[416] Achim Wennmann, *Grasping the Strengths of Fragile States...*, 2010.

[417] Alina Menocal, "State Building for Peace: a new paradigm for international engagement in post-conflict fragile states?", Third World Quarterly 32 (2011), pp. 1715-1736.

[418] Roland Paris & Timothy D.Sisk eds, *The Dilemmas of Statebuilding Confronting the contradictions of postwar peace operations* (London&New York: Routledge, 2009), p.15.

marrëdhëniet ndërkombëtare[419]. Kjo ngase, siç ka argumentuar Richmond, UNMIK-u ka qenë projekti më ambicioz shtetndëtues i OKB-së i parë deri më sot[420].

Mirëpo, kur jemi në analizimin e veprimtarisë së UNMIK-ut si agjent shtetndërtues në Kosovë, gjëja e parë që duhet ta bëjmë të qartë është fakti se ky rol i UNMIK-ut nuk ka qenë pjesë e mandatit të tij formal[421], pra nuk ka qenë precizuar shprehimisht në bazën e tij legale-në Rezolutën 1244. Ose, siç argumenton Ignatieff, UNMIK-u ishte në parim një mision shtetndërtues pa e pranuar faktin se qëllimi final ishte pavarësia e Kosovës. Këtë lloj të mandatit paradoksal, Ignatieff e krahason madje edhe me alegorinë e virgjërisë së një nëne[422]. Andaj, komponentët shtetndërtues të UNMIK-ut mund të thuhet se dalin në mënyrë të nënkuptuar nga ushtrimi i mandatit të tij legal që ka qenë ngritja e institucioneve demokratike të vetëqeverisjes[423], të cilat më vonë janë vlerësuar të kenë shërbyer si një bazë për forcimin e shtetësisë empirike në Kosovë[424].

Në të vërtetë, ky paradoks ka bërë që veprimtaria shtetndërtuese e UNMIK-ut të paraqitet si një problem shumë kompleks në agjendën shtetndërtuese nga faktorët e jashtëm. Andaj, për ta sqaruar deri në një shkallë këtë kompleksitet, duhet të përgjigjemi në dy pyetje esenciale: Çfarë elementesh duhet të përmbajë në vetvete një veprimtari për t'u kualifikuar si shtetndërtuese? Dhe cilat janë parakushtet që duhet të arrihen në mënyrë që kjo veprimtari të vlerësohet si e suksesshme?

Në literaturën dhe debatet teorike nuk ka një listë të qartë dhe standarde të prioriteteve dhe komponentëve që duhet të realizohen nga një administratë ndërkombëtare me mision shtetndërtues. Kjo rezulton nga fakti se territoret apo shoqëritë ku realizohen misione të tilla, të karakterizohen me kushtet aq të ndryshme socio-politike dhe rrethana unike historike, saqë asnjëherë nuk mund të flitet për kurrfarë kriteresh standarde shtetndërtuese. Por, megjithëkëtë, disa autorë kanë

---

[419] Nina Wilén, *Paradoxes or Strategies in International Governance?...*, 2007.

[420] Oliver P. Richmond & Jason Franks, *Co-opting the Liberal Peace...*, p. 1.

[421] Shih më tej Carsen Stahn, *The Law and Practice of International Territorial Administration...*, p.310.

[422] Shim më tej në: Michael Ignatieff, *Empire Lite: Nation-Building in Bosnia, Kosovo and Afganistan* (UK: Vintage, 2003), pp. 77-109.

[423] Coelho, "Building stable and effective states through international governance"..., p.295.

[424] Shih më tej në: Dominik Zaum, *The Sovereignty Paradox: The Norms and Politics of International Statebuilding* (New York: Oxford University Press, 2007), pp. 127-140.

qëndrime disi më të përafërta në atë se cilët komponentë mund të bëhen prioritet për t'u realizuar në terren.

Për shembull, studiuesit si: Raris dhe Sisk, Zaum, Chandler, Coelho[425]etj, të cilët kanë promovuar edhe teoritë më moderne lidhur me shtetndërtimin, në përgjithësi përmendin një listë me katër prioritete kryesore. Këto prioritete, përbëhen nga ata komponentë, përmbushja e të cilëve konsiderohet se mund ta prodhojë një mision shtetndërtues të suksesshëm, duke arritur kështu ta bëjë forcimin e shtetësisë empirike në territorin apo shoqërinë nën administrimin ndërkombëtar. Para së gjithash, fushat që konsiderohen më me prioritet nga bashkësia ndërkombëtare e që duhen jetësuar në ato shoqëri që pretendojnë forcimin e shtetësisë empirike, korrespondojnë me detyrat tipike të një shteti modern. Pra, është fjala për komponentët e sigurisë; rendit dhe drejtësisë, ndërtimit të institucioneve, si dhe rindërtimit dhe zhvillimit ekonomik. Prandaj, në përgjithësi është vlerësuar se këta komponentë paraqiten si parakushte esenciale që duhet të jenë funksionale në ato shoqëri që pretendojnë ta konsolidojnë dhe forcojnë shtetësinë e tyre empirike, apo edhe të atyre që rrezikojnë të rrëshqasin në humbjen e kësaj shtetësie, pasi që ajo ka qenë funksionale më parë.

Këta komponentë shtetndërtues, deri në një masë përfshihen edhe në përkufizimin që ofron Chesterman për shtetndërtimin. Sipas tij, shtetndërtimi përbën një përfshirje të zgjeruar ndërkombëtare "drejtuar në ndërtimin apo rindërtimin e institucioneve të afta qeverisëse për t'iu garantuar qytetarëve siguri fizike dhe ekonomike" si dhe mbështetje në zhvillimin e një varg fushash ekonomike, politike dhe të sigurisë[426]. Për më tepër, kësaj skeme mund t'i përgjigjet shumë mirë edhe klasifikimi i Fukuyamës, sipas të cilit "ekzistojnë tri aspekte apo faza të ndryshme të shtetndërtimit". E para ka të bëjë me çështjet e sigurisë dhe rindërtimit imediat në periudhën e pas luftës, siç është rasti me Afganistanin, Kosovën dhe Somalinë. Faza e dytë ka të bëjë me krijimin e institucioneve të qëndrueshme. Kurse faza e tretë ka të bëjë me konsolidimin dhe funksionalizimin e shtetit[427], që nënkupton një ekonomi të qëndrueshme me një shoqëri civile funksionale, etj.

Duke ndjekur këtë linjë pak a shumë konsensuale të kualifikimit të këtyre prioriteteve që përbëjnë një agjendë shtetndërtuese, mund të konstatojmë se po ashtu,

[425] Raris and Sisk, 2009, p. 15; Zaum, 2007, p. 127; Chandler, 2006, pp. 98-101; Coelho, "Building stable and effective states through international governance"..., p. 296

[426] Chesterman, *You, the People...*, p.5.

[427] Francis Fukuyama, *Ndërtimi i Shtetit...*, f, 150.

ndër komponentët kryesorë që e kanë përshkuar procesin e shtetndërtimit në Kosovë të udhëhequr nga UNMIK-u, janë ata që u kualifikuan më lart. Rrjedhimisht komponentët shtetndërtues që do të analizohen në vijim në kontekstin e shtetndërtimit në Kosovë përbëhen nga: Komponentët e sigurisë; rendit dhe drejtësisë, ndërtimit të institucioneve, si dhe rindërtimit dhe zhvillimit ekonomik.

4.3 Komponentët e sigurisë

Njëra nga qëllimet më të rëndësishme të një operacioni të paqes në shoqëritë e pas luftës është vendosja e kushteve për një siguri të qëndrueshme[428]. Andaj, për ndërtimin e një paqeje të qëndrueshme është e domosdoshme ndërtimi i: sigurisë njerëzore, një koncept që përfshinë qeverisjen demokratike, të drejtat e njeriut, rendin dhe drejtësinë, zhvillimin e qëndrueshëm, etj[429]. Për më tepër, rreth rëndësisë që ka parakushti i sigurisë për zhvillimin e një shoqërie, Paris argumenton që sot, më shumë se 70 nga rreth 190 shtete në sistemin ndërkombëtar, janë të prekshme me të ashtuquajturin sindromë e "shtetit të dështuar" si pasojë e një boshllëku të sigurisë që mbretëron brenda tyre[430].

Në vazhdën e këtyre deklarimeve, nuk do shumë mend për të konstatuar që siguria paraqet parakushtin esencial për ndërtimin dhe zhvillimin e kapaciteteve shtetërore në një shoqëri që gjendet nën konditat e brishtësisë së tij. Por, ajo çka mbetet më me rëndësi të analizohet, i referohet mënyrës se si bashkësia ndërkombëtare dhe vetë këto shoqëri, do të jenë në gjendje të menaxhojnë me këtë sektorë, me qëllim që ai të shërbejë si parakusht esencial në zhvillimin e gjithanshëm të këtyre shoqërive.

Kur jemi në kontekstin e shtetndërtimit në Kosovë, është shumë me rëndësi të analizojmë mënyrën se si ka menaxhuar bashkësia ndërkombëtare me sektorin e sigurisë së jashtme dhe asaj të brendshme në Kosovë në periudhën emergjente të pas luftës, dhe se si ajo më vonë ka ndikuar në reformimin e sistemit të sigurisë në përgjithësi. Andaj, në këtë stad, mund të shtrohen disa pyetje që e përshkruajnë komplet këtë proces. Për shembull: Cila ka qenë baza legale për menaxhimin e këtij

[428] Chesterman, *You, the People...*, p. 122.

[429] Raris and Sisk, *The Dilemmas of Statebuilding...*, p. 26.

[430] Po aty, p. 14.

sektori në periudhën afatshkurtër? Cilët mekanizma apo institucione kanë menaxhuar me këtë proces? Cila ka qenë qasja strategjike e bashkësisë ndërkombëtare për ngritjen e kapaciteteve vendore për të menaxhuar në planin afatgjatë me këtë sektor? Dhe së fundmi, sa ka ndikuar ky komponent në ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve shtetndërtuese në Kosovë?

Në të vërtetë, termat dhe objektivat e vendosjes së një pranie ushtarake ndërkombëtare janë përcaktuar në Marrëveshjen Tekniko-Ushtarake (MTA) në mes të Forcës Ndërkombëtare të Sigurisë në Kosovës (KFOR) dhe Qeverive të RSFJ-së dhe Republikës së Serbisë, e nënshkruar më 9 qershor. Më 10 qershor 1999, pas miratimit të Rezolutës 1244, NATO autorizoi dislokimin e trupave të KFOR-it. MTA, e cila hyri në fuqi menjëherë pas nënshkrimit, përmbante dy anekse. I pari përcaktonte tërheqjen graduale të ushtrisë dhe forcave tjera të sigurisë jugosllave; kurse aneksi i dytë përcaktonte mandatin për operacionet e KFOR-it në Kosovë[431]. Në fakt, baza legale e kësaj trupe të sigurisë, gjendet në Rezolutën 1244. Rezoluta e autorizonte këtë prani të sigurisë që ta mbështeste UNMIK-un dhe të ishte i koordinuar ngushtë me të[432].

Korniza ligjore e menaxhimit të sigurisë së Kosovës nga ana e bashkësisë ndërkombëtare është e theksuar në Rezolutën 1244. Rezoluta identifikon bashkësinë ndërkombëtare si entitetin e vetëm legjitim me mandatin e zbatimit të ligjit dhe përdorimit të forcës në rajon[433]. Detyra e ofrimit të sigurisë në Kosovën e pasluftës ka qenë e ndarë në mes katër mekanizmave të sigurisë: Trupave të NATO-s (KFOR), të cilat ishin përgjegjëse për rendin dhe sigurinë e përgjithshme mbi bazën e Rezolutës 1244 dhe të një marrëveshjeje dypalëshe me Beogradin (Marrëveshja Tekniko-Ushtarake e Kumanovës- MTA); Policisë Civile e UNMIK-ut (CIVPOL), në bashkëpunim me strukturën lokale të Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK), si dhe të Trupave të Mbrojtëse së Kosovës (TMK)[434]. Legalisht, si UNMIK-u (prania civile), ashtu edhe KFOR-i (prania ushtarake) kishin fushat e veta të përgjegjësisë. Përderisa KFOR-i vazhdoi të mbetej jashtë strukturës komanduese të OKB-së dhe raporton drejtpërdrejt në selinë e NATO-s në Bruksel, policia e UNMIK-ut dhe SHPK-ja ishin drejtpërsëdrejti përgjegjëse para PPSP-së[435]. Po ashtu, edhe Trupat e Mbrojtjes së

[431] The Kosovo Report Conflict..., pp. 101-102.

[432] Rezoluta 1244, faragrafi 7 dhe 9.

[433] KIPRED& CASIN, Administrimi *dhe qeverisja në Kosovë...*, faqe 18.

[434] Jens Narten, "Assessing Kosovo's Postwar Democratization"..., p. 132.

[435] Richmond & Franks, *Co-opting the Liberal Peace...*, p. 3.

Kosovës ishin në kuadër të Departamentit të UNMIK-ut për Sigurinë e Brendshme dhe të Mbrojtjes Civile, që koordinoheshin nga një zyrë koordinimi, e quajtur Zyra e Koordinatorit të TMK-së (ZKTMK).

Kur jemi te sferat e përgjegjësisë së bashkësisë ndërkombëtare për forcimin e komponentës së sigurisë, mund të thuhet se detyrat e KFOR-it, nga njëra anë, kanë qenë të ngjashme me ato të trupave paqeruajtëse klasike (helmetat blu). Kjo forcë paqeruajtëse në fillim përbëhej nga 50000 trupa. Kjo më vonë u reduktua në 36000[436]. Ato përfshinin ndërprerjen e armiqësive të reja, duke siguruar se refugjatët mund të ktheheshin në mënyrë të sigurt dhe ndihmat humanitare mund të dorëzoheshin me lehtësi, si dhe duke bërë de-minimin dhe monitorimin e kufirit. Në anën tjetër, KFOR-i kishte mandat për zbatimin e paqes-në lidhje me zbatimin e armëpushimit dhe demilitarizimin e UÇK-së. I një rëndësie të veçantë, vlerësojnë studiuesit, sidomos në situatën e menjëhershme të pasluftës, ishte edhe krijimi i një mjedisi të sigurt jo vetëm për kthimin e refugjatëve, por edhe për t'i mundësuar UNMIK-ut dhe organizatave tjera që të jenë në gjendje të fillojnë punën e tyre. Një qasje me faza u aplikua në lidhje me sigurinë publike. KFOR-i mori përsipër detyra policore derisa UNMIK-u kishte ndërtuar policinë e vet dhe atë lokale[437].

Në anën tjetër, lidhur me fazën emergjente dhe krijimin e një ambienti të sigurtë në kuadër të reformave të sektorit të sigurisë që nënkuptonte tranzicionin nga lufta në paqe sipas logjikës së Programit DDR (Demilitarizim, Demobilizim dhe Ri-integrim), Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) u demilitarizua dhe procesi i gjatë i transformimit të ushtarëve në civilë, filloi me formimin e Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK).[438]

Çështjet rreth rendit dhe drejtësisë që binin nën menaxhimin e Shtyllës I, padyshim kanë përbërë sfidën më serioze për praninë ndërkombëtare në Kosovë; si për UNMIK-un, ashtu edhe për KFOR-in. Ky problem, është vlerësuar se ka qenë shkaktuar si pasojë e vakuumit të krijuar si pasojë e mungesës së një autoriteti sovran[439]. Si rrjedhojë, këto çështje u paraqitën edhe si sfida vendimtare imediate për

---

[436] Po aty, p. 1.

[437] Friedrich, "UNMIK in Kosovo: Struggling with Uncertainty"..., p.236.

[438] Sean McFate, *The Link Between DDR and SSR in Conflict- Affected Countries*, Special Report 238, United States Institute of Peace, May 2010, pp. 1-2.

[439] Simon Chesterman, *Justice Under International Administration: Kosovo, East Timor and Afghanistan*, An International Peace Academy Report, September 2002, p. 4.

ushtrimin e autoritetit të UNMIK-ut/PSSP-së, për sanimin e së cilës u morën masa të menjëhershme.

Por, sado që ishte parashikuar që vendosja e shpejtë e 3000 policëve ndërkombëtarë në Kosovë të bëhej menjëherë pas hyrjes së KFOR-it në qershor 1999, megjithatë, KFOR-it i mbeti përgjegjësia kryesore në zbatimin e ligjit dhe rendit edhe për dy-tre muajt tjerë që pasuan. Vendosja e njësiteve të para të 1400 policëve ndërkombëtarë që arritën në Kosovë u bë me 8 gusht[440]. Në ndërkohë, pas kompletimit të saj, shifrat e policisë së UNMIK-ut, e bënë atë të ishte forca më e madhe policore e OKB-së e që ajo kishte mobilizuar ndonjëherë në historinë e saj[441]. Kjo situatë e menaxhimit me këtë vakuum të strukturave të sigurisë, ka treguar jo efikasitetin e OKB-së në dislokimin e shpejtë të Policisë Civile Ndërkombëtare (CIVPOL) në njërën anë, dhe në anën tjetër ka treguar për nevojën e domosdoshme në ngritjen dhe forcimin e strukturave vendore të sigurisë.

Kur jemi te analizimi i çështjeve që ndërlidhen me rolin e administratës ndërkombëtare, e sidomos mekanizmave të saj të sigurisë, në ngritjen e kapaciteteve vendore për të menaxhuar me këtë komponentë kaq esenciale shtetndërtuese, duhet të vëmë në pah se strategjia primare e administratës ndërkombëtare për promovimin e paqes dhe sigurisë afatgjate, ka qenë e drejtuar kah qasja e transferimit të kësaj përgjegjësie drejt autoriteteve vendore pasi që ato të jenë konsoliduar.

Në këtë drejtim, në të dyja rastet, si në Kosovë, edhe në Timorin Lindor, administratorët ndërkombëtarë kishin për detyrë t'i ndërtonin tërësisht strukturat e reja të policisë lokale nga zeroja. Një qasje e tillë është vlerësuar të ketë qenë kushtëzuar nga së paku tre faktorë. Së pari, ardhja me vonesë e policëve ndërkombëtarë pas vendosjes së UNMIK-ut, i detyroi trupat e KFOR-it të kryenin detyra të policisë. Së dyti, edhe pse KFOR-it iu ishin dhënë përgjegjësitë e qarta për zbatimin e ligjit, kontingjentet nacionale refuzuan për të kryer aktivitetet policore, veçanërisht në enklavat serbe. Dhe së treti, krimi dhe dhuna ishte bërë endemike në Kosovë, duke përfshirë edhe sulme hakmarrëse kundër pakicave etnike dhe veprimtari kriminale[442].

Nën këto kushte, ndërtimi i ShPK-së si një shërbim lokal policor filloi nga zeroja në gjysmën e dytë të vitit 1999. Përpjekjet e UNMIK-ut në zhvillimin e SHPK-së u

[440] The Kosovo Report Conflict, 2000, p. 110.

[441] Coelho, "Building stable and effective states through international governance"..., p. 315.

[442] Coelho, "Building stable and effective states through international governance"..., p. 321.

kryen përmes Shtyllës I të Policisë dhe Drejtësisë (trajnimi në terren, mbikëqyrja dhe monitorimi) dhe Shtyllës III të Ndërtimit të Institucioneve, përkatësisht përmes Shkollës Policore të OSBE-së[443]. Shtatë vjet pas vendosjes së UNMIK-ut, akademia policore e drejtuar nga ndërkombëtarët ka prodhuar një forcë lokale policore prej 7.215 policëve, që është konsideruar si një nga institucionet më profesionale dhe më të integruarat në rajon[444]. Në fakt, krijimi i SHPK-së, në përgjithësi është konsideruar si një "histori suksesi" e UNMIK-ut[445], madje raportet ndërkombëtare e kanë vlerësuar SHPK-në të ishte forca policore më së paku e korruptuar në rajon[446]. Gjithashtu, për shkak të madhësisë në rritje dhe efektivitetit të SHPK-së, është shënuar një ulje e konsiderueshme e numrit të krimeve dhe vrasjeve prej vitit 2002 deri në vitin 2005. Në fakt, në të gjithë territorin, situata e brendshme e sigurisë në Kosovë ishte vlerësuar stabile në një nivel të vetëm nën mesataren për Evropën Jug-Lindore[447].

Përveç SHPK-së, roli i administratës ndërkombëtare në ngritjen e kapaciteteve vendore për garantimin e një ambienti më të sigurt, ka qenë mjaft i theksuar edhe në lidhje me ngritjen dhe funksionalizimin e Trupave të Mbrojtjes së Kosovës.

Shikuar nga ana e mandatit dhe autorizimeve, TMK u themelua si një "Gardë Kombëtare" ngjashëm me modelin Francez të Sigurisë Civile[448], që duhej të ishte aktiv në fushën e kontrollit të fatkeqësive natyrore dhe mbrojtjes civile, pastaj në fushën e kërkim-shpëtimit, si dhe në atë të dominimit dhe ndërtimit të infrastrukturës. E përbërë nga një forcë prej 5,000 trupash, nga të cilat vetëm më pak se gjysma e tyre ishin ish-luftëtarë të UÇK-së, TMK-ja fillimisht do të ishte një organizatë që do ta ndihmonte NATO-n në misionin e saj të sigurisë[449]. Mirëpo, fushëveprimi i TMK-së ishte shumë i kufizuar. Vetëm 200 pjesëtarë të saj ishin të autorizuar të mbajnë armë,

---

[443] CASIN, Cluster of Competence, The rehabilitation of war-torn societies, Pristina/Geneva, January 2003, pp. 23-24.

[444] Report the Secretary-General on the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo, UN Doc S/2007/134, 9 March 2007, para. 35.

[445] Richmond & Franks, *Co-opting the Liberal Peace: Untying the Gordian Knot in Kosovo,* 2007, p. 7.

[446] ICG, *Kosova: Sfida e tranzicionit,* Raport për Evropë i Grupit të Krizave numër 170, 17 shkurt 2006, faqe 7.

[447] Coelho, "Building stable and effective states through international governance"..., p. 322.

[448] The Kosovo Report Conflict, 2000, p.118.

[449] Coelho, "Building stable and effective states through international governance"..., p. 309.

dhe se kjo trupë nuk do të përdorej për kontrollin e trazirave, operacioneve anti-terroriste, ose detyra të ngjashme që lidhen me ruajtjen e rendit dhe ligjit[450].

Shikuar për nga qëllimi i themelimit dhe fushëveprimi i saj, mund të thuhet se kontributi i TMK-së në sektorin e paqes dhe sigurisë së brendshme, më tepër ka qenë i orientuar në funksionin e saj rehabilitues dhe ri integrues, se sa që ajo ka kontribuar në mënyrë efektive në garantimin e një ambienti të sigurt. Kjo ngase, siç pamë më lartë, ajo do të duhej të ishte një organizatë, e cila në pajtim me programin DDR për reforma në çështje të sigurisë, do ta bënte rehabilitimin e një numri të konsiderueshëm të ish-luftëtarëve të UÇK-së. Kurse nga ana tjetër, pavarësisht pse kjo trupë u funksionalizua, megjithëkëtë, përgjegjësia kryesore për garantimin e paqes dhe sigurisë në Kosovë i mbeti KFOR-it.

Pavarësisht që të dy mekanizmat vendor të sigurisë, si SHPK-ja ashtu edhe TMK-ja, kanë qenë nën monitorimin total të bashkësisë ndërkombëtare, përkatësisht UNMIK-ut dhe KFOR-it, ato asnjëherë nuk kanë ngurruar së pretenduari për të qenë bazat e institucioneve të ardhshme të sigurisë së shtetit të Kosovës, pavarësisht paqartësisë në lidhje me përcaktimin e statusit që pritej për Kosovën. Në fakt, kështu edhe ndodhi. Pothuajse komplet strukturat e SHPK-së u transformuan në Policinë e Kosovës, kurse një pjesë e konsiderueshme e pjesëtarëve të TMK-së u transformuan në Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe menaxhohen nga Ministria e Punëve të Brendshme, përkatësisht nga Ministria e FSK-së e Republikës së Kosovës.

4.4 Komponentët e rendit dhe drejtësisë

Sa i përket rolit dhe rëndësisë që ka rendi ligjor si komponent shtetndërtues, është vlerësuar se për çdo shtet modern, ai është një element përbërës i domosdoshëm dhe njëkohësisht një parakusht esencial për ushtrimin e autoritetit të shteteve. Madje është konsideruar se ai përcakton edhe përmasat dhe shtrirjen e autoritetit. Po ashtu, Zaum pohon se, për pjesën dërmuese të misioneve të OKB-së me agjendë shtetndërtuese të pas viteve të 1990-të, vendosja e rendit ligjor si dhe reformimi dhe konsolidimi i

[450] The Kosovo Report Conflict, 2000, p. 118.

sistemit të gjyqësorit, kanë qenë preokupimi qendror i tyre.[451]. Rrjedhimisht, siç pohon Sthan, fokusi i dytë më i gjerë i UNMIK-ut ka qenë zbatimi i mandatit në shtetndërtimin në Kosovë, sidomos në forcimin e sistemit të rendit dhe drejtësisë[452].

Pas këtij konstatimi, mund të shtrojmë tri pyetje themelore, në mesin e shumë pyetjeve që e karakterizojnë veprimtarinë shtetndërtuese të UNMIK-ut në Kosovë, sidomos fokusin e saj në ngritjen e komponentës së rendit dhe drejtësisë. Së pari, cilat kanë qenë sfidat kryesore me të cilat është ndeshur UNMIK-u, lidhur me ngritjen dhe funksionalizimin e rendit dhe drejtësisë në Kosovën e pas luftës; së dyti, cila ka qenë qasja strategjike që ka ndjekur ky mision në administrimin e sistemit të drejtësisë në Kosovë, e shikuar sidomos në raportin e parimeve të legjitimitetit dhe efikasitetit? Së treti, sa ka qenë i funksionalizuar në praktikë sistemi i drejtësisë gjatë tetë viteve të administrimit ndërkombëtar në Kosovë?

Siç u konstatua më sipër, përveç problemeve të natyrës teknike, për disa studiues, problemet e vërteta në funksionalizimin e sistemit gjyqësor në Kosovën e pas luftës ishin të natyrës politike. Siç argumenton Chesterman, pengesa kryesore për rivendosjen e rendit dhe drejtësisë nga ana e UNMIK-ut ka qenë e lidhur direkt me kontradiktat e paraqitura si pasojë e respektimit të vazhdueshëm të integritetit territorial të RFJ-së dhe vakuumit që la tërheqja e saj[453]. Ky problem, marrë në përgjithësi, është paraqitur në tri aspekte kryesore: vakuumi i sigurisë së menjëhershme; zgjedhja e ligjit që duhej aplikuar në Kosovë; si dhe reformat që duhej të merreshin për funksionalizimin e sistemit gjyqësor në Kosovë.

Përderisa dy problemet e para mund të thuhet se u sanuan në fazën e hershme të qeverisjes direkte (veprimtaria emergjente legjislative dhe ekzekutive e UNMIK-ut) dhe në bashkëpunim të ngushtë me KFOR-in; zgjidhja e problematikës së tretë, mbeti si njëri nga objektivat afatgjate të UNMIK-ut dhe u realizua përgjatë gjithë mandatit të këtij misioni.

Qasja strategjike e UNMIK-ut, veçanërisht e shikuar ndërmjet parimeve të legjitimitetit dhe efikasitetit, tregon qartë se për UNMIK-un më me prioritet ishte aplikimi i një qasje reformuese që përfshinte forcimin dhe funksionalizimin e sistemit të drejtësisë, se sa mbështetja e parimit të legjitimitetit (pronësisë vendore mbi

[451] Zaum, *The Sovereignty Paradox*, 2007, p. 144.

[452] Stahn, *The Law and Practice of International Territorial Administration: Versailles to Iraq and beyond*, Cambridge University Press, 2008, p. 317.

[453] Chesterman, *Justice Under International Administration...*, p. 4.

sistemin e drejtësisë)[454]. Këto reforma për funksionalizimin e sistemit gjyqësor të ndërmarra nga UNMIK-u, u orientuan në dy drejtime kryesore: në paanshmërinë e gjyqësorit, në njërën anë, dhe në pavarësinë e tij, në anën tjetër [455].

Në Kosovë, reformat për të promovuar paanshmërinë dhe pavarësinë e gjyqësorit ishin fokusuar në gjashtë masa mbrojtëse të këtij sektori nga ndikimet politike. Këto masa konsistonin në: ndërkombëtarizimin, riorganizimin dhe trajnimet ligjore të anëtarëve të gjyqësorit. Kurse, sa i përket pavarësisë, masat që u ndërmorën përbëheshin nga: pavarësia në procesin e emërimit, pavarësia në procesin disiplinor, dhe siguria për gjyqtarët[456].

Fillimisht është vërejtur se për arsye politike dhe pragmatike, bashkësia ndërkombëtare u kishte dhënë mjaft përgjegjësi gjyqësore akterëve vendor, për ta ndërruar më vonë këtë qasje mbi bazën e po të njëjtave arsye politike dhe pragmatike, duke e përqendruar të gjithë aktivitetin gjyqësor në duart e administratës ndërkombëtare në vend.

Siç raportonin disa nga burimet brenda vetë UNMIK-ut, vendorët kishin dështuar që në fillim në promovimin e një sistemi gjyqësor profesional dhe të paanshëm politikisht [457]. Këto shenja të dobësisë, i nxitën autoritetet ndërkombëtare ta rishqyrtonin strategjinë fillestare, duke ia përqendruar të gjitha autorizimet gjyqësore UNMIK-ut[458]. Hapin konkret për një kontroll të plotë mbi sistemin gjyqësor në Kosovë, UNMIK-u e ndërmori menjëherë, që në vitin 1999. Këtë veprim, UNMIK-u e kishte justifikuar mbi tri arsye, që shikuar në esencë ishin tendencioze. Fillimisht UNMIK-u këtë hap e justifikonte mbi bazën se ai ka mandatin për të ndjekur politika neutrale, dhe se ky mandat i buronte atij vetvetiu nga fakti i të qenit një organizatë ndërkombëtare. Pas kësaj, UNMIK-u potenconte faktin se pasiqë në mandatin e tij edhe formalisht parashihej angazhimi i tij në promovimin dhe garantimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, atëherë automatikisht kjo i jepte atij një dorë të fortë të kontrollit

[454] Coelho, "Building stable and effective states through international governance"..., pp. 332-333.

[455] Zaum, *The Sovereignty Paradox...*, p. 145.

[456] Po aty, p. 145.

[457] OSCE (Mission in Kosovo), *Review of the Criminal Justice System (February – July 2000)*, Departmant of Human Rights and Rule of Law, pp. 61-69.

[458] Coelho, "Building stable and effective states through international governance"..., p. 333.

mbi gjyqësorin kosovar. Së fundmi, UNMIK-u pretendonte se ky kontroll, i lejohej atij edhe për faktin që ai kishte treguar efektivitet në sigurimin e sundimit të ligjit[459].

Siç u pa më vonë, të gjitha këto pretendime, UNMIK-u i bëri realitet që në momentin kur u inaugurua Shtylla e re, ajo e Policisë dhe Drejtësisë (Shtylla I) në maj të 2001. Përmes kësaj Shtylle, UNMIK-u shpalli se në vijim i gjithë sistemi i drejtësisë do të mbetej si një pushtet i rezervuar për UNMIK-un. Dhe si duket, kjo u bë me pretendimin e qartë se përmes kësaj strategjie synohej të mbahej larg përfshirja e politikës në drejtësi. Kjo më së miri u vërtetua edhe me faktin që vetëm pas katër viteve, u bë edhe themelimi i Ministrisë së Drejtësisë, gjë që nxori në pah një kompromitim të UNMIK-ut në lidhje me promovimin e vetëqeverisjes në Kosovë.

Por, përveç pretendimit për ta mbajtur nën kontroll sistemin e gjyqësisë të Kosovës, UNMIK-u kishte ndërmarrë një sërë masash, me qëllim që të ngriste kapacitetet vendore, në mënyrë që ato të ishin në gjendje për të menaxhuar efektshëm me këtë sektor në të ardhmen.

Në këtë drejtim, është vlerësuar që hapi më i rëndësishëm ka qenë inaugurimi i Institutit Gjyqësor të Kosovës (IGJK), që u bë në shkurt të vitit 2000, i cili, nën monitorimin e OSBE-së, do të duhej ta bënte ngritjen e kapaciteteve të juristëve vendor në lidhje me njohjen dhe zbatimin e ligjeve në fuqi në atë kohë[460]. Pas funksionimit të tij, në saje të programeve të tij trajnuese, është vlerësuar se IGJK ka treguar një efikasitet të konsiderueshëm në aftësimin e gjyqtarëve vendor në të kuptuarit e hartimit dhe funksionimit të legjislacionit në Kosovë. Për më tepër, kjo punë e IGJK-së ka qenë vlerësuar si e domosdoshme, sidomos duke marrë parasysh faktin që në Kosovë nuk kishte Gjykatë Kushtetuese, përderisa kishte një sistem tejet kompleks të rregulloreve të UNMIK-ut[461].

Përveç këtyre përpjekjeve të brendshme, në lidhje me ngritjen e kapaciteteve të gjyqësorit kosovar, duhet vlerësuar edhe rolin e përpjekjeve të tjera të jashtme në këtë drejtim. Para së gjithash, këtu duhet vlerësuar rolin e disa agjencive të tilla si USAID dhe Agjencia Evropiane për Rindërtim. Që të dyja këto agjenci, përmes programeve të tyre *ad hoc*, kanë mbështetur një larmi të madhe programesh në drejtim të

[459] Zaum, *The Sovereignty Paradox*, 2007, p.147.

[460] OSCE (Mission in Kosovo), *Review of the Criminal Justice System (1999 –2005)*, Departmant of Human Rights and Rule of Law, March 2006. pp. 15-16.

[461] Coelho, "Building stable and effective states through international governance"..., p. 333; OSCE, *Review of the Criminal Justice System (1999 –2005)*,p. 23.

funksionalizimit dhe forcimit të efikasitetit të kapaciteteve vendore. Po ashtu, krahas këtyre agjencive, rol të rëndësishëm në këtë drejtim është dhënë edhe nga sektori i OJQ-ve, përmes grupe të tilla si Qendra Juridike e Kosovës[462].

Në këto rrethana sa i përket masave të emërimit të gjyqtarëve, më shumë se 400 gjyqtarë, prokurorë dhe gjyqtarë laik u betuan gjatë janarit dhe shkurtit të vitit 2000, por, prapë se prapë, procesi gjyqësor vazhdoi të jetë mjaft pasiv. Një Gjykatë Supreme, pesë gjykata të qarkut, 17 gjykata komunale, një gjykatë komerciale dhe 13 Zyre të Prokurorit Publik ishin themeluar. Deri në qershor të vitit 2000, sistemi gjyqësor i Kosovës përbëhet 274 gjyqtarë, 40 prokurorë, dhe 238 gjyqtarë porotë [463].

Pas shpërbërjes së IGJK-së nga PSSP-ja në tetor 2000, ai u zëvendësua gjashtë muaj më vonë me Këshillin Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës (KGJPK). Ky këshill ofronte rekomandime për PSSP-në mbi disiplinën dhe shkarkimin e gjyqtarëve vendorë, si dhe kishte funksionuar në mënyrë mjaft efektive[464]. Nga nëntë anëtarët e tij, pesë ishin ndërkombëtarë dhe vetëm katër vendor. KGJPK kështu përfaqësonte një zhvendosje të qartë të politikës ndaj mbikëqyrjes dhe kontrollit të madh ndërkombëtar ndaj gjyqësorit[465]. Përveç kësaj, u krijua edhe Njësia për Hetimin e Gjyqësorit (NjHGj) në Departamentin e Drejtësisë. Ndërkohë që këta dy organizma mbulonin gjykatësit dhe prokurorët, Oda e Avokatëve të Kosovës ishte përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe disiplinën e avokatëve[466].

Së fundi, pavarësia e gjyqësorit, vlerëson Zaum, është tentuar të promovohet përmes ruajtjes dhe sigurisë së zotërimit të personelit gjyqësor. Kjo, madje është varur totalisht edhe nga çështje të natyrës teknike. Për shembull, vlerëson Zaum, një cenueshmëri direkte e pavarësisë së gjyqësorit në Kosovë, ishte shkaktuar nga kontrolli i UNMIK-ut në përcaktimin kohor të punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve, përmes lëshimit të kontratave vetëm tre mujore, pasi që ata ishin emëruar në vitin 1999. Por, pas disa thirrjeve, UNMIK-u e ndryshoi këtë qasje, dhe që nga janari i vitit

---

[462] Po aty, pp. 333-334.

[463] The Kosovo Report Conflict..., pp. 112-113.

[464] David Marshall & Shelley Inglis, "The Disempowerment of Human Rights–Based Justice in the United Nations Mission in Kosovo", *Harvard Human Rights Journal* 16 (2003), p. 121.

[465] Zaum, *The Sovereignty Paradox*...,p. 146.

[466] ICG, *Arritja e Ekuilibrit: Nivelet e Drejtësisë në Kosovë*, Raporti nr. 134 mbi Ballkanin 12 shtator 2002, f. 6.

2002, i gjithë personeli gjyqësor vendor u emëruan që ta ushtronin funksionin e tyre deri në fund të misionit të tij[467].

Nga ky procedim me administrimin e sistemit të drejtësisë, mund të përfundohet se UNMIK-u në këtë drejtim kishte aplikuar një qasje strategjike monopolistike. Por, pavarësisht kësaj, konform autorizimeve për një transferim progresiv të kompetencave dhe promovimit të vetëqeverisjes, UNMIK-u filloi ta aplikonte një qasje tjetër strategjike disi më oligopolistike në administrimin e sistemit të drejtësisë kosovare. Ky hap u mur në saje të miratimit të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë, e cila, ndër të tjera, parashihte edhe ndarjen e kompetencave në administrimin e drejtësisë në mes të UNMIK-ut dhe IPVQ-ve.

Korniza Kushtetuese, paraqiste një platformë mjaftë të qartë në lidhje me organizimin dhe administrimin e një sistemi profesional dhe të paanshëm të së drejtës. Siç thuhej në dispozitat e saj, "gjykatat janë përgjegjëse për administrimin e drejtësisë në Kosovë në përputhje me ligjin e zbatueshëm"[468]. Përveç kësaj, ajo përcaktonte edhe strukturën organizative të gjykatave, ku shprehimisht thuhej se Kosova ka Gjykatë Supreme, gjykata të qarqeve, gjykata komunale, dhe gjykata për kundërvajtje[469].

Sa i përket kësaj kornize të re ligjore, risia që përmbante ajo në krahasim me rregulloret e UNMIK-ut ka të bëjë me themelimin e një Kolegji të veçantë të Gjykatës Supreme mbi çështjet e Kornizës Kushtetuese. Por, ajo çka nuk ishte aspak risi për këtë kornizë ishte fakti që PSSP-ja do të ishte prapë se prapë autoriteti përfundimtar për çështje të gjyqësisë në Kosovë.

Në saje të shtjellimeve të rolit të komponentës së rendit dhe drejtësisë, është e rëndësisë së veçantë të shikohet se cila ka qenë performanca e funksionalizimit praktik të sistemit të gjyqësisë nga UNMIK-u.

Kur jemi tek matja praktike e performancës së UNMIK-ut në ngritjen dhe forcimin e këtij komponenti shtetndërtues në Kosovë, mund të thuhet se marrë në përgjithësi dhe në krahasim me komponentët tjerë, UNMIK-u ka dështuar në arritjen e kësaj objektive. Siç pohon Coelho, performanca e gjyqësisë së Kosovës nën

[467] Zaum, *The Sovereignty Paradox...*, p. 147.

[468] Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë, Pjesa IV, paragrafi 9.4.1.

[469] Po aty, 9.4.4.

administrimin e UNMIK-ut, në përgjithësi, konsiderohet të jetë më e dobët në krahasim me performancën e institucioneve tjera[470].

Atëherë është me rëndësi të konstatohet se në çka konsiston natyra e dobësisë së këtij sektori. Një konstatim mund të jetë ai që dobësinë e funksionalizimit të gjyqësorit në Kosovë gjatë kësaj periudhe ia atribuon disa problemeve të natyrës teknike[471], e veçanërisht atyre me natyrë parimore. Andaj, ndër problemet më kryesore të natyrës parimore që e kanë penguar funksionalizimin dhe efikasitetin e gjyqësorit kosovar mund të klasifikohen në tri grupe: Jo- uniteti i pushtetit gjyqësor në tërë territorin e Kosovës; ndërhyrja e ekzekutivit në gjyqësi, si dhe mos-respektimi i të drejtave të njeriut[472].

Sa i përket tendencave për ta funksionalizuar sistemin gjyqësor në tërë territorin e Kosovës nga ana e UNMIK-ut, e më vonë edhe nga IPVQ-t, problemi kryesor ka qenë mungesa e funksionalizimit të gjykatave në pjesët e Kosovës të banuara me shumicë serbe. Këto enklava kanë vazhduar ta ndjekin politikën e paralelizmit gjyqësor, duke bërë që gjykatat e Kosovës të mos kenë mundësi as *de facto* e as *de jure* ta shtrinin juridiksionin e tyre në këto pjesë. Ky problem nga organizatat ndërkombëtare në Kosovë, është vlerësuar si sfida më e madhe që shkakton fragmentarizmin gjyqësor në Kosovë[473] dhe që pa tejkalimin e saj nuk do të ketë një sistem të integruar dhe efikas gjyqësor.

Por, pavarësisht kësaj, problemi më i spikatur lidhur me vendosjen e një sistemi gjyqësor funksional dhe të paanshëm, si dhe një nga pasojat e rënies së prestigjit të UNMIK-ut dhe humbjes së besimit në gjyqësinë vendore ishte problemi i paraburgimeve me urdhër ekzekutiv nga PSSP-ja [474]. Kjo çështje ka nxitur dilemën më të madhe, sidomos në ndërhyrjen e pushtetit ekzekutiv ndaj atij gjyqësor, gjë që paraqet shkeljen më të rëndë të standardeve demokratike të qeverisjes. Siç është theksuar më herët, kjo erdhi si rezultat i autorizimit të PSSP-së për t'i ushtruar të tria autorizimet apo pushtetet qeveritare mbi bazën e parimit të pretendimeve. Me fjalë

[470] Coelho, "Building stable and effective states through international governance"..., p. 334.

[471] Problemet financiare, mungesa e personelit adekuat, mungesa e infrastrukturës fizike dhe një sërë problemesh të ngjashme.

[472] Reka, *UNMIK as aninternational governance…*, pp. 291-310.

[473] ICG, *Arritja e Ekuilibrit: Nivelet e Drejtësisë në Kosovë*, Raporti nr. 134 mbi Ballkanin 12 shtator 2002, faqe 10.

[474] Chesterman, *Justice Under International Administration...*, p. 5.

tjera, parimi i kontrollit dhe balancimit (check and balance) të pushteteve, as që u mendua të funksiononte gjatë qeverisjes së UNMIK-ut, i cili madje kishte mandatin, që siç thuhej në Rezolutën 1244, "(...) të themelonte dhe mbikëqyrte zhvillimin e institucioneve vetëqeverisëse demokratike"[475].

Për më tepër, pushteti i PSSP-së për paraburgime ekzekutive ka qenë një nga veprimet më të diskutueshme në fushën e drejtësisë penale dhe të drejtave njerëzore. Në verën e vitit 2000, PSSP-ja filloi të paraburgoste individë, pavarësisht lirimit të tyre të ligjshëm nga ana e autoriteteve gjyqësore[476]. Më i spikaturi si rast, ka qenë ai kur Afrim Zeqiri, një shqiptar i Kosovës, u arrestua me dyshimin për vrasjen e tre serbëve. Një prokuror shqiptar urdhëroi lirimin e tij në mungesë provash, duke ngritur kështu dyshime të animit gjyqësor. Si rezultat, vendimi u la në fuqi nga një gjykatës ndërkombëtar, por megjithatë Kouchner urdhëroi që Zeqiri të vazhdojë të jetë i ndaluar nën një "mbajtje ekzekutive", duke pretenduar se autoriteti për lëshimin e një urdhri të tillë vije për "shkaqe sigurie" dhe nga Rezoluta e Këshillit të Sigurimit[477].

Përveç çështjes së paraburgimeve ekzekutive, problemet tjera që e kanë zbehë prestigjin e gjyqësorit në Kosovë lidhur me promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut kanë qenë mjaft të shumta.

Siç dihet, përveç qëllimit për të ofruar siguri, qëllimi i dytë social për të legjitimuar autoritetin e administratave ndërkombëtare është promovimi i të drejtave të njeriut dhe demokracisë. Të tria administratat (Në BeH, Timorin Lindor dhe në Kosovë) janë themeluar në dritën e shkeljeve të gjera të të drejtave të njeriut gjatë konflikteve të mëparshme dhe për mbrojtjen e tyre në vijim. Dispozitat për të drejtat e njeriut u shfaqën dukshëm në dokumentet themeluese të këtyre administratave[478].

Në lidhje me kontekstin e administrimit të Kosovës, në parim UNMIK-u ishte munduar t'i përfshinte dhe implementonte sa më shumë që ka qenë e mundur të gjitha dokumentet ndërkombëtare që kishin të bëjnë me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Kjo praktikë i referohet nxjerrjes së rregullores së parë operative 1999/1. Kjo rregullore kishte deklaruar se të gjithë personat që mbajnë post publik ose që ushtrojnë detyra publike në Kosovë, ishin të obliguar të respektojnë standardet e

[475] Rezoluta 1244/1999, paragrafi 10.

[476] Marshall & Inglis, *The Disempowerment of Human Rights–Based Justice in the United Nations Mission in Kosovo,* 2003, p 113.

[477] Chesterman, *Justice Under International Administration...*, p. 5.

[478] Dominik Zaum, *The Authority of International...*, p. 15.

njohura ndërkombëtare të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe të përmbaheshin nga çdo akt i diskriminimit[479]. Në vazhdën e saj, ishte paraparë se ligjet vendore do të mund të zbatoheshin konform parimit të ligjshmërisë, për deri atëherë sa ato nuk do të binin në konflikt me këto standarde të të drejtave të njeriut. Përveç rregullores 1999/1, edhe rregullorja e UNMIK-ut 1999/24 kishte elaboruar mjaftë obligimet që kërkoheshin lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut. Më tej, në këtë rregullore ishin përfshirë në mënyrë dispozitive një numër i instrumenteve rajonale dhe ndërkombëtare, të tilla si Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ), si dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike (KNDCP)[480].

Atëherë, pas kësaj përpjekje sanksionuese të UNMIK-ut që përfshiu edhe këto konventa ndërkombëtare të të drejtave të njeriut si pjesë e ligjit të aplikueshëm, mund të shtrohet pyetja se a u zbatuan këto konventa nga vetë administrata ndërkombëtare, përkatësisht nga UNMIK-u dhe KFOR-i në Kosovë?

Siç pohon Stahn, nëse shqyrtohet legjislacioni i UNMIK-ut (nga ana e dispozitave), duhet të theksohet se legjislacioni i atëhershëm i OKB-së nuk ka dështuar në zbatimin e standardeve të rëndësishme të të drejtave dhe lirive ndërkombëtare të njeriut[481]. Madje sa u përket përpjekjeve të UNMIK-ut në këtë drejtim, mund t'i referohemi Rregullores 2000/38, e cila ishte baza juridike e themelimit të Institucionit të Ombudspersonit. Kjo rregullore deklaronte qartë se "Ombudspersoni mund të ofrojë këshilla dhe t'i bëjë rekomandime çfarëdo personi ose subjekti në lidhje me pajtueshmërinë e ligjeve dhe rregulloreve të brendshme me standardet e njohura ndërkombëtare"[482]. Por, pavarësisht anës dispozitive, praktikisht është vërtetuar se UNMIK-u përmes sistemit të rregulloreve kishte krijuar një kornizë normative të atillë që ofronte kufizime si për gjykatat në përgjithësi, ashtu edhe në garancitë për zhvillimin e proceseve gjyqësore të drejta. Përveç kësaj, kjo kornizë legjislative kishte fare pak mundësi për një shqyrtim gjyqësor ndaj veprimtarisë së vetë UNMIK-ut, e po ashtu edhe të KFOR-it. Këto praktika kanë bërë që të krijohet

[479] UNMIK Regulation 1999/1, 25 July 1999, art. 2.

[480] UNMIK Regolution 1999/24, 12 December 1999, Section 1, art.1.3,(a),(b).

[481] Carsen Stahn, International Territorial Administration in the former Yugoslavia"..., p. 154.

[482] UNMIK Regolution 2000/38, 30 June 2000, Section 2, art. 4.3.

praktikisht një mospërputhje e thellë në raport me obligimet ndaj të drejtave të njeriut ashtu siç parashihen në KEDNJ dhe KNDCP[483].

Siç u theksua edhe më lartë tek rastet e paraburgimeve ekzekutive, duket se shkeljet e të drejtave të njeriut kanë qenë më të theksuara në lëmin penal. Por, përveç kësaj, një nga veprimet e administratës ndërkombëtare në Kosovë që është konsideruar të ketë bërë shkelje të të drejtave të njeriut ishte edhe nxjerrja e Regullores 2000/47 nga UNMIK-u, e cila i jepte UNMIK-ut dhe KFOR-it imunitet kundër çdo procedure gjyqësore në Kosovë[484]. Lidhur me këtë rregullore, me kohë kishte reaguar edhe Ombudspersoni në Kosovë duke e informuar PSSP-në e atëhershëm Hans Hakerup, se kjo rregullore ishte në kundërshtim me parimet dhe konventat e KEDNJ-së[485]. Përveç këtij raporti, Institucioni i Ombudspersonit vazhdoi me publikimin e një sërë raportesh periodike të veçanta lidhur me adresimin e një sërë problemesh që lidheshin me sundimin e ligjit dhe të drejtat e njeriut, të cilat nuk u morën fort në konsideratë nga UNMIK-u.

Për më tepër, duke pasur parasysh faktin që UNMIK-u refuzonte çfarëdo gjetjesh për shkeljen e të drejtave të njeriut të garantuara ndërkombëtarisht nga ana e tij, bëri që disa qarqe hulumtuese të paralajmëronin se Kosova po e fuste vetën në një "vrimë të zezë të të drejtave të njeriut" në Evropë dhe në Botë[486]. Megjithëkëtë, nga qarqe tjera është vlerësuar se UNMIK-u dhe KFOR-i kanë bërë përpjekje të jashtëzakonshme brenda kapaciteteve të tyre në mënyrë që të sundojë rendi dhe ligji, duke kontribuar kështu në krijimin e një policie Kosovare dhe Sistemi Gjyqësor shumë etnik dhe pak a shumë funksional[487].

4.5 Komponentët e institucionalizimit dhe të demokratizimit

Është evident fakti që përveç promovimit të të drejtave të njeriut, administratat tranzicionale pothuajse gjithnjë kanë promovuar demokracinë si formën më të

[483] Stahn, "International Territorial Administration in the former Yugoslavia"..., p.154.

[484] Reka, *UNMIK as internacional governance...*, p.299.

[485] Special Report no.1 of Ombudsperson Institution in Kosovo, Recapitulation of the Conclusions, parag. 82, April 26, p,22.

[486]Matthew Willner-Reid, *Post-Colonial Governments of Leading Strings...*, p.50.

[487] Friedrich, "UNMIK in Kosovo: Struggling with Uncertainty"..., p. 262.

përshtatshme të qeverisjes në shoqëritë post-konfliktuale. Për shembull, të tri administratat kalimtare (në BeH, Kosovë dhe në Timorin Lindor), në njëfarë mënyre kanë qenë të mandatuara për krijimin e qeverive demokratike. Lidhur me këtë qëllim, ato kanë implementuar modele demokratike në organizimin e shoqërisë dhe në marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe shoqërisë në kuadër të aktivitetit të tyre shtetndërtues. Mirëpo, siç thekson Zaum, demokratizimi i këtyre shoqërive nuk ka qenë arsyeja për ndërhyrje ushtarake[488].

Ky fakt, tregon qartë se përpjekjet e administratave ndërkombëtare për të marrë përsipër realizimin e objektivave kaq komplekse, kanë bërë që procesi i shtetndërtimit në vetvete, të paraqitet një aktivitet shumë kompleks dhe ambicioz në të njëjtën kohë. Pa dyshim që njëra prej këtyre veprimtarive komplekse të shtetndërtimit, ka të bëjë me synimet në instalimin dhe mbarëvajtjen e një sistemi vetëqeverisës me tipare demokratike. Prandaj, jo rastësisht, pjesa më e madhe e administratave me mandat shtetndërtues, "përpjekjet për të zhvilluar institucione shtetërore kanë qenë fokusuar në reformën ose rikonstruksionin e sektorit politik, me një agjendë të qartë për zhvillimin e normave dhe praktikave demokratike"[489]. Kjo do të thotë që procesit të demokratizimit fillimisht i ka paraprirë procesit të institucionalizimit[490]*. Madje është argumentuar që shtetndërtimi në vetvete përbën krijimin e institucioneve të reja të qeverisjes dhe fuqizimin e atyre ekzistuese[491].

---

[488] Dominik Zaum, *The Authority of International Administrations...*, p. 16.

[489] Tansey, *Regime-building...*, p.3.

[490]* Pavarësisht këtyre qasjeve, është vlerësuar se "nuk mund të flasim për shtet-ndërtim kur e kemi parasysh që projekti politik i UNMIK-ut ishte rezoluta 1244, e cila ishte kundër vullnetit dhe interesave të popullit të Kosovë. Fillimisht kjo rezolutë nënkuptonte që të tjerët, e jo populli i Kosovë të vendoset për vete. Dhe,së dyti, kjo rezolutë ruante integritetin territorial dhe sovranitetin e ish Jugosllavisë, duke e trajtuar Kosovën pjesë integrale të saj. Është e vërtetë që UNMIK-u shpesh është dukur dhe ka operuar sikur të ishte vetë shteti i përhershëm e jo pushteti i përkohshëm, mirëpo kjo nuk do te thotë që bëhej fjalë për shtetndërtim por për uzurpim mekanizmash e institucionesh vendëse. Roli i UNMIK-ut nuk ka pasur lidhje me shtet-ndërtim. Funksioni i këtij misioni në Kosovë ka qenë ruajtja e stabilitetit politik e social, menaxhimi i krizës dhe aspak zgjidhja e saj. Kosova nuk ka pasur asnjëherë nevojë për UNMIK-un si mision ekzekutiv. Kosova ka pasur nevojë eventualisht për ndihmën e agjencive të caktuara të OKB-së. Por, jo për këtë mision i cili ishte mbivendosur mbi drejtësinë e policinë, mbi demokracinë dhe zgjedhjet, mbi administratën dhe shërbimet civile si dhe mbi ekonominë tonë": Albin Kurti, Intervistë e realizuar me shkrim, "Levizja Vetëvendosje", Prishtinë, 24.02.2014.

[491] Fukuyama, *Ndërtimi i Shtetit...*, f, 17.

Ky pohim nxjerrë në pah shumë qartë se aktualisht në agjendat e shtetndërtimit ndërkombëtar i jepet përparësi aplikimit të strategjisë, institucionalizimi para liberalizimit (demokratizimit). Por, pavarësisht kësaj, siç do të vërejmë në vijim të dyja proceset, edhe ai i institucionalizimit edhe ai i demokratizimit janë të ndërlidhur dhe e kushtëzojnë njëri-tjetrin në ndërveprim.

Kur jemi në kontekstin e analizës së rolit të UNMIK-ut në ngritjen e këtyre komponentëve shtetndërtues në Kosovë, ndër pyetjet që mund të parashtroheshin në lidhje me evoluimin e procesit të institucionalizimit dhe demokratizimit, do të mund të ishin: Çfarë strategjie ka aplikuar UNMIK-u në arritjen e këtij objektivi? Cila ka qenë qasja që e ka funksionalizuar këtë proces? Cilat kanë qenë instrumentet dhe faktorët që janë përfshirë në realizimin e këtij procesi? Sa ka arritur UNMIK-u ta ngrisë shkallën e legjitimitetit të tij, në sytë e popullatës dhe institucioneve lokale përmes këtij procesi? Cila ka qenë performanca e këtij misioni në përmbushjen e këtij objektivi?

Lidhur me strategjitë dhe qasjet fillestare që janë aplikuar nga ana e UNMIK-ut, në saje të aktivitetit të tij për ta ngritur këtë komponentë shtetndërtuese, mund të thuhet se iu është dhënë përparësi strategjisë "institucionalizimi para liberalizimit apo demokratizimit", për arritjen e së cilës është aplikuar qasja nga "poshtë-lartë" apo "buttom-up", sidomos lidhur me procesin e transferimit progresiv të kompetencave nga UNMIK-u drejt institucioneve vendore.

Shikuar në këtë kontekst, siç kemi vërejtur nga zhvillimet praktike në terren, mund të argumentohet se UNMIK-u përmes përdorimit të strategjisë fillestare të institucionalizimit përmes OJQ-ve, ka ndikuar në mënyrë vendimtare në procesin e demokratizimit të Kosovës në një fazë të mëvonshme. Madje, siç është, pohon Tansey, "procesi i brendshëm politik në Kosovë ka qenë i institucionalizuar përmes IPVQ-ve. Ndërtimi i shtetit (d.m.th, ndërtimi i institucioneve) e parapriu qëllimisht demokratizimin". Prandaj, sado që kjo qasje e UNMIK-ut është vlerësuar të ketë qenë shumë e instrumentalizuar dhe burokratike, megjithatë, ajo ka qenë një qasje e kalkuluar mbi bazën e përshtatshmërisë ndaj natyrës së problemeve që e kanë karakterizuar shoqërinë kosovare të pas luftës. Kjo do të thotë se bashkësia ndërkombëtare nuk ka vendosur rastësisht të aplikonte qasjen specifike nga "poshtë-lart" të demokratizimit përmes organizimit dhe mbajtjes të një sërë raundesh të zgjedhjeve, duke lëvizur nga zgjedhjet lokale (28 tetor 2000) drejt zgjedhjeve qendrore

(19 nëntor 2001)[492]. Kjo bën të kuptohet se organizimi dhe mbajtja e një sërë zgjedhjesh të lira dhe demokratike, shërbeu si instrumenti më i rëndësishëm në procesin e ngritjes së këtyre komponentëve. Por, përveç zgjedhjeve të lira, përfshirja e shoqërisë civile përmes aktivitetit të një numri të madh të Organizatave Joqeveritare (OJQ), gjithashtu është menduar të jetë një faktor i rëndësishëm dhe të ketë një rol konstituiv në procesin e institucionalizimit dhe demokratizimit në Kosovën e pas luftës.

Është më se e vërtetë dhe logjike që nuk mund të ketë demokratizim të një shoqërie pa mekanizma institucionalë që do të shërbenin si parakusht në promovimin e kësaj të parës. Mirëpo, në anën tjetër, nuk mund të ketë as institucione demokratike pa një proces elektoral të mirëfilltë dhe transparent që mundëson konsolidimin e këtyre mekanizmave. Kjo do të thotë që procesi elektoral shërben si një matricë lidhëse në mes këtyre dy proceseve shtetndërtuese, duke funksionuar pastaj si një proces trekëndësh. Madje ky funksionalizim i ndërlidhur tre-dimensional e ka karakterizuar në vazhdimësi ngritjen dhe funksionalizimin e këtyre dy komponentëve shtetndërtues edhe në Kosovë gjatë kohës së administrimit të saj nga UNMIK-u.

Bazuar në dispozitat e Rezolutës 1244, është e qartë që, *inter alia,* UNMIK-u ka qenë mandatar të organizojë dhe mbikëqyrë zhvillimin e institucioneve të përkohshme demokratike, dhe në mënyrë progresive të bëjë transferimin e autorizimeve te këto institucione pasi që ato të jenë funksionalizuar[493]. Po ashtu, kjo çështje u ritheksua edhe në raportin e Sekretarit të Përgjithshëm, sipas të cilit administrata ndërkombëtare në Kosovë duhej që në mënyrë progresive të bënte transferimin e autoritetit qeverisës tek institucionet vendore [494].

Pas kalimit të periudhës së parë emergjente të qeverisjes, UNMIK-u ndërmori disa hapa në krijimin e disa institucioneve vendore që kryesisht kishin karakter dhe rol konsultativ dhe nuk ishin të përfshira direkt në ushtrimin e autoritetit qeverisës të UNMIK-ut. Me këtë qasje, UNMIK-u u tregua jo efikas në

[492] Meurs, "Kosovo's Fifth Anniversary-On the Road to Nowhere?"..., p. 61.

[493] Rezoluta 1244 (1999), Paragrafi 11 (c,d).

[494] Report of the Secretary-General on the United Nations Administration in Kosovo, UN Doc S/1999/779 (12 July 1999), parag. 20.

lidhje me "kosovarizimin" e procesit të tranzicionit. Andaj, ushtrimi i autoritetit qeverisës në Kosovën e pasluftës, do të mund të analizohej ndaras në tri faza kohore: e para, 1999-2000, e dyta, 2000-2001 dhe e treta 2001-2008 [495].

Fazën e parë e ka karakterizuar fillimi i ndarjes së kompetencave qeverisëse të UNMIK-ut me strukturat e përkohshme vendore. Institucioni i parë lokal që u krijua për këtë qëllim, ishte Këshilli Transitor i Kosovës (KTK). KTK i përbërë nga 36 anëtarë dhe nën përfaqësimin e përfaqësuesve të partive kryesore politike kosovare, bashkësive fetare, si dhe përfaqësuesve të pavarur të shoqërisë civile. Këta anëtarë, të cilët emëroheshin nga PSSP-ja, kishin për detyrë që t'i siguronin atij vetëm këshilla politike[496]. Siç mund të vërehet, veçanërisht për nga mënyra e emërimit dhe për nga roli që kanë pasur anëtarët e KTK-së, ky këshill ka qenë i karakterizuar me një deficit total demokratik, dhe kryesisht ka qenë një forum i demokracisë nominale, gjë që e ka shtyrë faktorin vendor të adresojë kritika të ashpra për margjinalizimin e rolit të tyre që iu është bërë nga UNMIK-u në lidhje me pjesëmarrjen e tyre në jetën politike dhe institucionale të vendit.

Më vonë, në saje të insistimit të liderëve vendor, UNMIK-u ngriti Strukturën e Përbashkët Administrative të Përkohshme (SPAP) në fillim të vitit 2000. Kjo strukturë përbëhej nga njëzet departamente. Këto departamente kryesoheshin bashkërisht nga një zyrtarë vendor dhe një ndërkombëtar[497]. SPAP i kishte ngarkuar këto departamente me detyra për një qeverisje të përditshme në Kosovë[498]. Një skemë e organizimit të SPAP është dhënë në figurën 14.

[495] Stahn, 2008, pp. 320-322; Friedrich, "UNMIK in Kosovo: Struggling with Uncertainty"..., p. 255.

[496] Coelho, "Building stable and effective states through international governance"..., p.181.

[497] Weller, *Shtetësia e kontestuar*..., faqe 301-302.

[498] Hoff, *UN Transitional Administrations*..., p. 79.

Figura 14. Struktura e Përbashkët Administrative e UNMIK-ut (Janar 2000).



Burimi: Dominik Zaum, *The Sovereignty Paradox: The Norms and Politics of International Statebuilding*, NY, Oxford University Press, 2007, p.137.

Në kuadër të SPAP, ishte funksionalizuar edhe Këshilli i Përkohshëm Administrativ (KPA), në të cilin u ulën katër zyrtarë të UNMIK-ut dhe katër përfaqësuesit kosovarë të kryesuar nga PSSP-ja. Mirëpo, pavarësisht përfshirjes së strukturave vendore në këtë proces, prapë se prapë, nuk u dobësuan kompetencat ekskluzive ekzekutive të PSSP-së[499]. Lidhur me këtë qasje të UNMIK-ut, Tansey kishte argumentuar se këta trupa konsultativ në kuadër të UNMIK-ut, në njëfarë mënyre, më tepër janë krijuar me qëllim për të siguruar legjitimitetin e UNMIK-ut në fazat e tij fillestare, se sa që ato kishin hapur rrugën për politika demokratike në nivel lokal[500].

Në përgjithësi, është konsideruar se faza e dytë e transferimit të kompetencave qeveritare të UNMIK-ut, kishte filluar pas zgjedhjeve të para lokale në Kosovë (28

[499] Reka, *UNMIK as internacional administration...*, p. 219.

[500] Tansey, *Regime-building...*, p. 7.

Tetor 2000) [501]. Kjo fazë në fakt fillon me miratimin e Rregullores 2000/21 mbi themelimin e Komisionit Qendror Zgjedhor [502] dhe Rregullores 2000/39 për Zgjedhjet Komunale në Kosovë [503], që sipas disa studiueseve (Stahn), ky hap i UNMIK-ut, është konsideruar si baza e shtetndërtimit të Kosovës[504].

Rezultatet e këtyre zgjedhjeve inauguruan një sistem të ri të një bashkëqeverisjeje asimetrike në mes kosovarëve dhe ndërkombëtarëve në nivelin lokal[505]. Autorizimi përkitazi me ushtrimin e veprimtarive të autoriteteve lokale përcaktohej saktësisht nga Rregullorja 2000/45, e cila, pavarësisht faktit që këto struktura lokale tanimë kishin përfaqësuesit e tyre legjitim të dalë nga një proces elektoral, vazhdoi t'ia atribuonte kompetencat kryesore vendimmarrëse PSSP-së (neni 47), përkatësisht administratorit komunal (neni 48). Megjithëkëtë, kishte filluar transferimi progresiv i kompetencave nga UNMIK-u te autoritetet lokale, ashtu siç precizohej në dispozitat e para të kësaj rregullore:

"Në pritje të përcaktimit të statusit të ardhshëm të Kosovës, rregullorja, në pajtim me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit, themelon institucione provizore për vetëqeverisje autonome dhe demokratike në nivel komunal, si një hap progresiv në transferimin e përgjegjësive administrative nga UNMIK-u, i cili do të mbikëqyrë dhe të mbështesë konsolidimin e këtyre institucioneve"[506].

Në anën tjetër, administratori komunal kishte autorizime mjaft të gjera ekzekutive. Administrimi lokal realizohej nga Bordet Administrative të Komunave të kryesuar nga një Administrator Komunal i UNMIK-ut. Sa u përket funksioneve të Administratorit Komunal, pa dyshim që ndër autorizimet më të larta të tij, kanë qenë të lidhura me emërimin e anëtarëve të këtyre bordeve, madje pa e detyruar atë të vepronte sipas një rregulli preciz juridik sa i përket numrit të kosovarëve që do të përfshiheshin në bord. Në këtë kontekst, ai më tepër ka vepruar sipas prirjeve personale, të cilën qasje disa e kanë vlerësuar si: "për aq sa ishte e mundur"[507].

---

[501] Shih më tej në: Friedrich, 2005, p. 255; Reka, 2003, p. 218; Weller, 2009, f. 301-302.

[502] UNMIK Regolution 2000/21, 18 April, Section 1-4.

[503] UNMIK Regolution 2000/39, 08 July, Section 1-8.

[504] Stahn, *The Law and Practice of International Territorial Administration...*, p. 320.

[505] Reka, *UNMIK as internacional administration...*, p. 219.

[506] UNMIK Regolution 2000/45, 11 August 2000, Section 1, art. 1.1.

[507] Friedrich, "UNMIK in Kosovo: Struggling with Uncertainty"..., p. 257.

Megjithëkëtë, me kalimin e kohës, krahas transferimit progresiv të kompetencave nga UNMIK-u drejt institucioneve vendore në nivelin qendror, i njëjti transferim u bë edhe në nivelin lokal të qeverisjes. Ky proces filloi të aplikohej që nga zgjedhjet e para lokale të vitit 2000, e pastaj edhe në ato të vitit 2002 dhe 2004, ku Kuvendet Komunale, u autorizuan për të vetëqeverisur me një numër të madh të detyrave, tipike për një autoritet lokal. Ndër autorizimet më të theksuara për Kuvendet Komunale të pas këtyre zgjedhjeve, kanë qenë edhe ato që përfshinin shpalljen e rregulloreve. Kështu që, sado me të meta, procesi i transferimit të autorizimeve nga UNMIK-u drejt autoritetit te Kuvendet Komunale, është vlerësuar ta ketë shënuar hapin e parë konkret të UNMIK-ut në krijimin e institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë[508]. Por, pavarësisht këtij procesi, PSSP-ja akoma vazhdoi të mbetej autoriteti me fuqinë më të lartë ekzekutive në vend. Këtë autoritet, ndër të tjera, vazhdoi t'ia siguronte (neni 47, pika 1 dhe 2) e Rregullores 2000/45[509].

Fillimi i bartjes së autoritetit të UNMIK-ut te IPVQ-të, ka qenë e lidhur direkt me fazën e tretë. Kësaj radhe, procesit të transferimit progresiv të kompetencave drejt strukturave qendrore i ka paraprirë një rregullore tjetër e UNMIK-ut. Është fjala për Rregulloren 2001/9 (Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme të Kosovës). Kjo rregullore, parashihte krijimin e institucioneve autonome në nivelin qendror, ashtu siç parashihej në mandatin e UNMIK-ut.

Megjithëse luante rolin e një kushtetute, prapë se prapë, Korniza Kushtetuese nuk është menduar të jetë një dokument kushtetues nga ana e UNMIK-ut. Ky nuk ishte ligji më i lartë në fuqi, por ishte i një rangut të njëjtë me rregulloret e tjera. Kjo ishte bërë me qëllimin që UNMIK-u të mbetej brenda kufijve të Rezolutës 1244 për aq kohë sa kjo rezolutë nuk lejonte që Kosova të ketë një kushtetutë, sepse kjo do të shihej si një shkas për prejudikimin e statusit final e që normalisht ishte në kundërshtim me Rezolutën 1244[510]. Për më tepër, "edhe teksti përfundimtar reflekton fuqishëm natyrën ndërkombëtare të përpilimit të tij". Por, sidoqoftë, në përgjithësi, kjo kornizë u bë një instrument që shërbeu si kushtetutë në zhvillimin e proceseve politike në Kosovë[511]. Në fakt, Korniza Kushtetuese është vlerësuar ta ketë shërbyer si bazë për themelimin e

[508] Po aty, p. 257.

[509] UNMIK Regolution 2000/45, 11 August 2000, Section 47, art. 1-2.

[510] Crsen Stahn, "Constitution Without a State: Kosovo Under the United Nations Constitutional Framework for Self-Government", *LJIL* 14 (2001), p. 531.

[511] Weller, *Shtetësia e kontestuar*, 2009, faqe 303.

sistemit politik të Kosovës, dhe ta ketë përcjellë komplet evoluimin dhe transformimin e këtij sistemi që prej vitit 1999 deri me shpalljen e pavarësisë me 2008[512]. Pavarësisht faktit që Korniza Kushtetuese nuk bënte as një sqarim lidhur ma afatin kohor dhe përmbajtjesor të zgjidhjes së statusit final të Kosovës, të paktën ajo shërbeu mjaft efektshëm në përcaktimin e statusit të atëhershëm të Kosovës nën administrimin e UNMIK-ut. Siç mund të vërejmë në dispozitat e saj fillestare kjo kornizë ishte mjaft përgjithësuese në përcaktimin e kornizave bazë të organizimit të jetës institucionale dhe politike. Sipas saj:

"Kosova është një entitet nën administratën e përkohshme ndërkombëtare, që, me popullin e vet, ka atribute unike historike, juridike, kulturore dhe gjuhësore. Kosova është një territor i pandashëm anembanë të të cilit ushtrojnë përgjegjësitë e tyre institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes të themeluara në bazë të kësaj Kornize; Kosova përbëhet nga komunat, të cilat janë njësi territoriale bazë të vetëqeverisjes lokale me përgjegjësitë e përcaktuara nga legjislacioni i UNMIK-ut, që është në fuqi, mbi vetëqeverisjen lokale dhe komunat në Kosovë; Kosova do të qeveriset në mënyrë demokratike nëpërmjet organeve dhe institucioneve ligjvënëse, ekzekutive dhe gjyqësore në pajtim me këtë Kornizë Kushtetuese dhe Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara; dhe se institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes janë: (a) Kuvendi; (b) Kryetari i Kosovës; (c) Qeveria; (ç) Gjykatat; dhe (d) Organet e institucionet e tjera të parashtruara në këtë Kornizë Kushtetuese"[513].

Shikuar nga mënyra se si u hartua dhe u fuqizua ky dokument kushtetues, në dukje të parë, krijon një perceptim paradoksal sidomos lidhur me atë se si mundet ky dokument të promovojë institucione dhe qeverisje demokratike, kur vetë procesi i jetësimit të tij është bërë në mungesë të çdo kriteri liberal demokratik (për shembull ajo nuk u hartua nga një konventë kushtetuese). Si duket, qasja e transferit të kompetencave, nga ana e UNMIK-ut është përdorur si një strategji për ta mbushë boshllëkun e deficitit demokratik dhe si një justifikim për fuqizimin e legjitimitetit të tij, para opinionit ndërkombëtar dhe atij vendor.

I gjithë ky proces i transferimit të autorizimeve, erdhi pas zgjedhjeve të 17 nëntorit 2001, nga të cilat u inauguruan IPVQ-të me Kuvendin e Kosovës, si organi

[512] Narten, *Assessing Kosovo's Postwar Democratization...*, pp. 140.

[513] Korniza Kushtetuese për Vetqeverisjen e Përkohshme, Kreu 1 Dispozitat themelore, 1.1-1.5. Shkarkuar nga faqja zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

kryesor i vetëqeverisjes, i cili merrte rolin kryesor për bartjen e përgjegjësive të transferuara nga UNMIK-u. Këto përgjegjësi përfshinin të gjitha fushat e punëve qeveritare, duke filluar nga politika ekonomike dhe financiare, të transportit dhe çështjeve gjyqësore[514]. Por në raport me fuqitë e mbetura te PSSP-ja, prapë IPVQ-të ishin dytësore për nga rangu. Rrjedhimisht PSSP, *inter alia*, vazhdonte të mbajë një numër të kompetencave të rëndësishme për vete, duke e bërë atë autoritetin përfundimtar në çështjet e buxhetit dhe të emërimit të gjyqtarëve. Po ashtu, atij i mbetën edhe përgjegjësitë mbi politikat ekonomike te Kosovës, duke mos lënë anash as përgjegjësitë mbi TMK-në, marrëdhëniet ndërkombëtare, si dhe koordinimin me KFOR-in[515].

Kuvendi ishte institucioni më i rëndësishëm i vetëqeverisjes edhe në kuptimin inaugurues të dy institucioneve tjera, atë të presidentit dhe të qeverisë (kryeministrit dhe ministrave). Lidhur me inaugurimin e presidentit, Korniza Kushtetuese nuk parashihte zgjedhjen e tij direkt nga populli, por ai duhej të zgjidhej nga Kuvendi me një shumicë votash prej 2/3, që kërkonte një konsensus të gjerë politik. Konsensusi politik ishte i domosdoshëm edhe për krijimin e qeverisë. Prandaj, shikuar nga perspektiva kohore, konsensusi politik në mes partive kryesore e ka përcjellë vazhdimisht inaugurimin e IPVQ-ve. Për shembull, zgjedhjet e para të nivelit qendror të vitit 2001, prodhuan një president që vinte nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), një kryeministër nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), ku së bashku me to qeverisi edhe partia e tretë për nga madhësia Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). Edhe zgjedhjet e dyta të vitit 2004, formuan një qeveri të koalicionit, por kësaj radhe në mes të LDK-së dhe AAK-së. Megjithëkëtë, koalicioni politik ndërpartiak nuk mungoi as pas zgjedhjeve të treta të vitit 2007 që po ashtu formuan një qeveri të koalicionit në mes PDK-së, LDK-së dhe disa partive tjera më të vogla. Nga këto tri palë zgjedhje që promovuan IPVQ-të, vërehet se institucioni i presidentit ka qenë drejtuar nga radhët e LDK-së. Kurse, qeveria ka qenë ndërruar në mes PDK-së (dy herë) dhe AAK-së (një herë).

Gjatë kësaj periudhe të tri formacioneve të qeverive, ka ardhur vazhdimisht duke u shtuar edhe numri i ministrive përkatëse e bashkë me to edhe rritja e përgjegjësive

[514] Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme, Kreu 5 Përgjegjësitë e institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes, 5.1, (a-n).

[515] Friedrich, "UNMIK in Kosovo: Struggling with Uncertainty"..., p. 258.

në vetëqeverisjen e përkohshme. Përderisa qeveria e parë përbëhej nga dhjetë ministri, ajo e treta ndërkaq përbëhej nga pesëmbëdhjetë të tilla. Pra, struktura qeveritare e dalë nga zgjedhjet e vitit 2007, përbëhej nga: Ministria e Ekonomisë dhe Financave; Ministria e Energjisë dhe Minierave; Ministria e Tregtisë dhe Industrisë; Ministria e Drejtësisë; Ministria e Pushtetit Lokal; Ministria e Bujqësisë; Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit; Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë; Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve; Ministria e Shëndetësisë; Ministria e Mbrojtjes së Mjedisit; Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale; Ministria e Mbrojtjes së Pakicave dhe Kthimit të Refugjatëve[516].

Tanimë është e qartë se përveç strategjive dhe qasjeve të lartpërmendura që u aplikuan nga UNMIK-u me synimin e institucionalizimit dhe demokratizimit të shoqërisë kosovare, njëkohësisht, kjo veprimtari e UNMIK-ut ka qenë e kushtëzuar direkt edhe nga përfshirja e disa instrumenteve dhe faktorëve tjerë që e karakterizuan këtë rol shtetndërtues të UNMIK-ut. Për shembull, në njërën anë, mbajtja e një sërë raundesh të rregullta të zgjedhjeve si në nivelin lokal, ashtu edhe në atë qendror, ka shërbyer si një *instrument* tejet i rëndësishëm i agjendës së UNMIK-ut në arritjen e kësaj objektive. Kurse në anën tjetër, një vëmendje e veçantë duhet kushtuar edhe analizimit të rolit të shoqërisë civile si *faktorë* me rëndësi në procesin e institucionalizimit dhe demokratizimit në Kosovë.

Në fakt, UNMIK-u, përmes dizajnimit të sistemit elektoral, ka ndikuar direkt dhe indirekt në formësimin e kornizave të përgjithshme të sistemit politik në Kosovën e pasluftës. Andaj të vetëdijshëm për rolin e sistemeve elektorale si mekanizmat më të rëndësishëm për nxitjen e ndërveprimit politik, në një sistem politik të një shoqërie demokratike të caktuar, kemi zgjedhur të studiojmë dhe analizojmë teorikisht dhe praktikisht krijimin dhe funksionimin e sistemit elektoral në Kosovë, të ndërtuar dhe funksionalizuar nga UNMIK-u, respektivisht nga OSBE-ja, në kuadër të Shtyllës së tretë. Në këtë kontekst, ndër atributet më të rëndësishme që analizohen do të jenë: zgjedhjet si instrument i pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e institucionalizimit dhe demokratizimit të shoqërisë kosovare dhe si tregues i nivelit dhe llojit të kulturës politike të brendshme.

[516] Shih më tej për organizimin e IPVQ-ve në: Arsim Bajrami, *E Drejta e Kosovës në Tranzicion*, Prishtinë: UP, 2002), faqe 140-141.

Sa i përket rolit dhe rëndësisë që kanë zgjedhjet në promovimin e përfaqësimit politik brenda një shoqërie, studiuesit si Heywood, shpeshherë zgjedhjet i kanë cilësuar si zemrën e procesit politik apo vetë demokracinë në praktikë dhe se për këtë nocion, kryesori është parimi i përfaqësimit[517]. Madje, Schumpeter, zgjedhjet i kanë kualifikuar si një kriter minimal për demokracinë [518].

Meqenëse Kosova për më tepër se shtatë vite ka qenë nën administrimin direkt ndërkombëtar (dhe *de jure* vazhdon të mbetet ende në një lloj administrimi), atëherë analizimi i sistemit elektoral në Kosovë rezulton të jetë i një modeli *sui generis,* dhe pikërisht ky fakt mundëson që jashtëzakonisht të kuptohet qartë roli i zgjedhjeve, si instrument i participimit të qytetarëve në politikat dhe në jetën publike në Kosovë.

Sipas Tansey, duhet të kemi parasysh që politikat elektorale të administratave ndërkombëtare, përveç rolit që kanë në përcaktimin se çfarë qasje elektorale duhet aplikuar në demokratizimin e shoqërisë nën administrim, po ashtu, një tjetër element qendror i politikës zgjedhore që merren administratat ndërkombëtare, ka të bëjë edhe me projektimin e sistemit zgjedhor[519]. Përveç kësaj, akterët e jashtëm mund të këshillojnë në zgjedhjen, dhe nëse është e nevojshme, mund edhe të imponojnë përfundimisht sistemin zgjedhor. Sipas Tansey, praktikat e kohëve të fundit, sugjerojnë se autoritetet ndërkombëtare kanë një preferencë të qartë për sistemet proporcionale mbi ato mazhoritare. Kosova është një shembull i qartë ku UNMIK-u prezantoi (madje edhe imponoi) një sistem të përfaqësimit proporcional[520].

Nga viti 2000, në Kosovë janë organizuar dhe mbajtur shtatë palë zgjedhje. Pesë të parat janë organizuar dhe mbikëqyrur kryesisht nga UNMIK-u, përmes OSBE-së në kuadër të shtyllës së tretë, të asistuar edhe nga vendorët, kurse dy të fundit janë organizuar dhe mbajtur kryesisht nga vendorët dhe të asistuar nga ndërkombëtarët. Gjatë këtyre zgjedhjeve, vërehet qartë se në shumicën e tyre nuk ka pasur një prag elektoral, ka pasur gjithherë vende të rezervuara, dhe po ashtu, ato janë mbajtur në shumicën e rasteve me lista të mbyllura. Këto praktika, tregojnë për një karakter jo edhe aq sa duhet demokratik, dhe se kjo vinte për shkak të statusit specifik që kishte Kosova gjatë administrimit të saj nga UNMIK-u.

---

[517] Andew Heywood: *Politics* (UK: Palgrave McMillan, 3rd. Edition, 2007), pp. 247-255.

[518] Shih më tej në: Joseph Schumpeter, *Capitalism, Socialism, and Democracy* (New York: Harper and Row Torchbook, 1950), faqe 269.

[519] Tansey, *International Administration and Democratic Regime-Building...*, p. 11.

[520] Po aty, f. 11.

Madje kjo mund të konsiderohet edhe si një problematikë që ka çuar në rënien e pjesëmarrjes së qytetarëve në votime e rrjedhimisht edhe në përfaqësimin politik dhe në jetën institucionale të vendit. Lidhur me këtë, një pasqyrë e karakteristikave elektorale në Kosovë gjatë kësaj kohe është paraqitur në tabelën 4.

Tabela 4. Zgjedhjet dhe specifikat e sistemit zgjedhor në Kosovë 2000-2010.

Data	Lloji i zgjedhjeve	Sistemi	Vendet e rezervuara	Pragu elektor.	Pjesm-arrja%
28.10.00	Lokale	Propo.Lista të hapura	Zyrtarë minor. janë emëruar më vonë.	Jo	79
17.11.01	Qenrore	Prop.1 njësi zgjedh.Lista të mbyllura.	10 për serbët, 10 për pakicat tjera.	Jo	64
26.10.02	Lokale	Propo. Lista Të mbyllura.	0	0	54
23.10.04	Qendrore	Lista të mbyllura	0	0	49.52
17.11.07	Lokale Qendrore	Lista të hapura	Po	0	39.4
15.11.09	Lokale	Lista të hapura	Po	Po	45.36
12.12.10	Qendrore	Liata të hapura	Po	Po	47.5

Burimi: Tabela është ndërtuar mbështetur në të dhënat e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në Republikën e Kosovës.

Në bazë të rezultateve të pjesëmarrjes së qytetarëve me të drejtë vote, në zgjedhjet që janë mbajtur në Kosovë, vërejmë se përqindja ka ardhur duke rënë vazhdimisht. Për shembull diferenca në përqindje e bojkotit të zgjedhjeve prej atyre të parave me 79% deri në ato të fundit me 47.5% është 31.5%, çka do të thotë se hendeku ka ardhur duke u thelluar vazhdimisht. Grafikisht kjo gjendje është dhënë në figurën 15.

Figura 15. Përqindja e pjesëmarrjes së qytetarëve në zgjedhjet në Kosovë gjatë administrimit nga UNMIK-u.



Burimi: Grafiku është pasqyrë e të dhënave nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të Kosovës.

Mirëpo, përveç rolit që ka luajtur UNMIK-u në përcaktimin e natyrës së sistemit elektoral, ai po ashtu, në saje të këtij sistemi ka bërë përpjekje edhe për përcaktimin e llojit dhe nivelit të kulturës politike në Kosovë.

Në mbështetje të këtij argumenti vije edhe konstatimi që Zervaki ka nxjerrur nga studimi i tij mbi rolin e veprimtarive qeverisëse të administratave territoriale ndërkombëtare mbi një shoqëri të pas luftës. Sipas tij, përveç tjerash, administratat e OKB-së siç janë UNMIK-u dhe UNTAET-i, kanë kontribuar në krijimin e kulturave të reja politike kalimtare brenda sistemeve politike në Kosovë përkatësisht në Timorin Lindor[521].

Për të kuptuar rolin që ka luajtur UNMIK-u, në lidhje me kulturën politike të brendshme në Kosovë, përmes sistemit elektoral, më parë është e rëndësishme të ofrohet një skemë e tej thjeshtëzuar e konceptimit dhe klasifikimit të kulturës politike si një kategori analitike e shkencës politike. Në këtë drejtim do t'i referohemi qasjes së studiuesve Almond dhe Verba që kanë aplikuar në veprën e tyre: *The Civic Culture* (Kultura Qytetare).

Në këtë vepër, Almond dhe Verba e përcaktojnë kulturën politike si "shpërndarje e veçantë e modeleve të orientimit drejt objekteve politike në mesin e anëtarëve të një vendi", ku varësisht nga këto modele orientuese, këta autorë e bëjnë klasifikimin e

[521] Antonia Zervaki, "UN at crossroad: International Administration of Territories and Domestic Political Culture"..., p.16.

kulturës politike sipas tipit mendjengushtë (apo subjektive) dhe tipit të pjesëmarrjes. Pastaj, në saje të relacionit në mes këtyre dy tipave, ata e përcaktojnë tipin e kulturës qytetare e cila tërhiqet nga modeli racionalist-pjesëmarrës i qytetarisë që e mbështetë qeverinë demokratike, ku qytetarët në mënyrë aktive marrin pjesë dhe e ndikojnë politikën e vendit dhe kryesisht këtë e arrijnë përmes zgjedhjeve [522].

Në kontekstin e ndikimit të UNMIK-ut, në formësimin e kulturës politike në Kosovë, Zervaki pohon se qëllimi i UNMIK-ut si administratë ndërkombëtare ishte për të nxitur kalimin nga kultura politike subjektive apo mendjengushtë, në kulturën politike racionale apo të pjesëmarrjes aktive në jetën politike. Më konkretisht, UNMIK-u u përpoq për të konsoliduar apo edhe për të vendosur mbi popullatën kosovare atë çfarë është konceptuar si kulturë qytetare që "nuk është një kulturë moderne, por një që kombinon traditën me modernitetin, një kulturë pluraliste e bazuar në komunikim dhe bindje, një kulturë e konsensusit dhe larmisë, një kulturë që nuk lejon ndryshim, por e moderon atë"[523]. Ky koncept i "kulturës qytetare nga lartë" është i lidhur me hapjen dhe karakterin demokratik të shtetit që do të jetë krijuar[524].

Andaj, në bazë të këtij konstatimi teorik dhe veçanërisht bazuar në të dhënat empirike (shiko grafikun 9), mund të përfundojmë që niveli i pjekurisë së kulturës politike në Kosovë, mund të kategorizohet në atë të tipit të tretë, pra në atë pjesëmarrëse racionale. Kjo bëhet edhe më e theksuar, sidomos për faktin që në Kosovë nuk ka pasur një sistem elektoral edhe aq funksional, veçanërisht për shkak të karakterit të tij proporcional. Por, prapë se prapë, ky problem teknik ngelet shumë më i pa rëndësishëm në raport me problemin parimor dhe madhor, atë të mos definimit të saktë të agjendës politike të UNMIK-ut, në lidhje me definimin e statusit final të Kosovës.

Është e qartë që në shumë qarqe akademike, mbizotëron mendimi se mos definimi i një agjende kohore dhe përmbajtjesore nga ana e UNMIK-ut, në lidhje me zgjedhjen e statusit të Kosovës, ka qenë faktori kryesor që e ka minuar kohezionin e zhvillimeve në të gjitha sferat në Kosovë[525]. Dhe meqenëse për UNMIK-un më prioritare ka qenë

---

[522] Almond & Verba, *The Civic Culture*, Revised (Sage Publications, 1989): Cituar sipas: Feraj, *Shkenca Politike* (Tiranë, Pegi, 2004), f. 192.

[523] Cituar original nga Zervaki, "UN at crossroad: International Administration of Territories and Domestic Political Culture"..., p.17.

[524] Po Aaty, p.17.

[525] King dhe Mason, *Paqe me çdo kusht: Si dështoi bota në Kosovë*, 2006, f. 259-260.

promovimi i vetëqeverisjes, (pjesa e qartë e mandatit konform Rezolutës 1244), se sa legjitimimi i zhvillimeve të reja shoqërore dhe politike në terren, atëherë ky fakt ka reflektuar direkt si një pengesë për bashkësinë ndërkombëtare, që ta arrinte objektivin më madhor të saj: pra atë të krijimit që Zervaki e quan si "një *demos,* një shoqëri shumë etnike, në kontekstin e modelit të kulturës qytetare dhe jo një *etnos* që do të mbarështojë modelet mendjengushta të sjelljes"[526]. Kjo ka bërë që disa studiues ta quajnë procesin e demokratizimit në Kosovë si një "demokratizim i etnicizuar"[527].

Në vazhdën e analizimit të procesit të institucionalizimit dhe demokratizimit në Kosovë, UNMIK-u kishte rezervuar një rol mjaft të rëndësishëm edhe për shoqërinë civile. Madje kjo praktikë është bërë pjesë e pandashme e misioneve paqeruajtëse me agjendë shtetndërtuese.

Kohëve të fundit, pothuajse është bërë praktikë e zakonshme për administratat ndërkombëtare shumëdimensionale, që në kuadër të agjendës së tyre për krijimin e rrethanave për një paqe të qëndrueshme në një vend post-konfliktual, t'i ngrenë kapacitetet edhe të sektorit të shoqërisë civile, si një faktor i rëndësishëm që u kontribuon këtyre rrethanave[528]. Në frymën e synimeve strategjike të këtyre administratave, është vlerësuar se një shoqëri civile funksionale, përmes strategjive të buta, mund t'i ndihmojë këto administrata dhe vetë shoqëritë ku ato funksionojnë, t'i gjejnë dhe t'i adresojnë shkaqet e konfliktit përmes qasjes nga "poshtë-lart". Mënyra më e mirë ku OJQ-të do të mund të kontribuonin në këtë drejtim, është konsideruar në rolin që ato mund të luajnë në intensifikimin e bashkëpunimit politik të fokusuar në mirëbesim dhe ndërveprim reciprok[529]. Në këtë pikëpamje, shoqëria civile bashkëvepron dhe komunikon politikisht me shtetin përmes angazhimit në institucionet demokratike dhe formave të ndryshme të dialogut politik, dhe madje edhe përmes aktivizimit të lëvizjeve shoqërore në kontrollin ndaj punës së qeverisë.

Por në të vërtetë, cili ka qenë roli i shoqërisë civile dhe sa ka qenë ajo efikase me ndikimin e saj në realizimin e këtij procesi?

---

[526] Zervaki, "UN at crossroad: International Administration of Territories and Domestic Political Culture"..., p.17.

[527] Narten, "Assessing Kosovo's Postwar Democratization"..., p. 128.

[528] Max Stephenson & Laura Zanotti, *Peacebuilding Through Community-Based NGO's: Paradoxes and Possibilities* (Virginia: Kumarin Press, Virginia, 2012), pp.1-17.

[529] Joseph Coelho, "Vehicles for Transformation, or Tools for the Status Quo? Civil Society and International Statebuilding in Kosovo", *The WBP Review* 2, Issue 2 (2012), p. 8.

Si pjesë e agjendës së gjerë të misioneve të shtetndërtimit ndërkombëtar, donatorët ndërkombëtarë e kanë shikuar zhvillimin e një sektori të ri të OJQ-ve, si çështje kyçe për përparimin e Kosovës drejt stabilitetit, ndryshimit demokratik, dhe promovimin e multi-etnicitetit nga poshtë[530]. Shikuar për nga roli që mund të kenë OJQ-të në proceset e shtetndërtimit, sidomos në kuadër të komponentës së institucionalizimit dhe demokratizimit, është vërejtur se bashkësia ndërkombëtare ka pasur synime të qarta që përmes disa politikave të orientuara nga OJQ-të, të krijohej një partneritet i qëndrueshëm në mes shoqërisë civile dhe institucioneve qeverisëse. Ky partneritet ka qenë karakterizuar më së tepërmi me rolin ndihmës që OJQ-të mund ta luanin në demokratizimin e shoqërisë kosovare, i cili do te reflektonte pozitivisht edhe në procesin e shtetndërtimit në Kosovë[531].

Ç'është e vërteta, UNMIK-u që në fillim të administrimit të Kosovës, kishte aplikuar një qasje shumë të hapur lidhur me ngritjen e këtij sektori. Në këtë kohë, shoqëria civile në Kosovë kishte shënuar një ekspansion përmes OJQ-ve, për shkak të donacioneve të shumta ndërkombëtare dhe procedurave të lehta për regjistrim[532]. Në këtë drejtim, të dhënat flasin qartë se bashkësia ndërkombëtare në Kosovë, përmes funksionalizimit të shoqërisë civile, ka dhënë një kontribut të pakontestuar në procesin e demokratizmit shoqëror në përgjithësi. Për shembull, përderisa në Kosovë, zyrtarisht numëroheshin vetëm 130 OJQ në vitin 1999, numri i tyre është rritur në rreth pesëmijedhjetë fish me 2.500 dhe 3.000 sosh, deri në vitin 2004 dhe 2006. Madje, deri në vitin 2012, në Kosovë vlerësohej të ishin mbi 5,000 OJQ[533].

Por, pavarësisht këtij numri enorm, në planin veprues vlerësohet se vetëm 10% e këtyre OJQ-ve bënin implementimin e projekteve në terren. Kjo ka bërë që shumica dërmuese, me rreth 90% të tyre, të ishin fiktive, ose siç i kanë quajtur disa nën "hije", si pasojë e mos zotësisë së tyre për të siguruar mbështetje prej fondeve ndërkombëtare, për shkak të një performance të dobët që ato tregonin[534].

Një margjinalizim i rolit të shoqërisë civile, në ndikimin e saj në ndërtimin e kapaciteteve shtetndërtuese në Kosovë, përveç mungesës së fondeve, një pengesë tjetër erdhi edhe nga bojkoti që filloi t'u bëhej nga UNMIK-u, sidomos pasi që ky i

[530] Richmond & Franks, *Co-opting the Liberal Peace...*, p. 12-18.

[531] Coelho, "Vehicles for Transformation, or Tools for the Status Quo?"..., p.12.

[532] Richmond & Franks, *Co-opting the Liberal Peace...*, p. 12-14.

[533] Coelho, "Vehicles for Transformation, or Tools for the Status Quo?"..., p. 12.

[534] Narten, "Assessing Kosovo's Postwar Democratization"... pp. 129-130.

fundit filloi që rolin shtetndërtues ta barte te IPVQ-të, në kuadër të qasjes së tij të transferimit progresiv të kompetencave. Dhe përveç kësaj, si gjithherë, çështja e mos definimit të statusit, u bë problem edhe për avancimin e sektorit të shoqërisë civile në Kosovë.

Si përfundim është vlerësuar se paaftësia e UNMIK-ut për të trajtuar çështjen e statusit, ka penguar organizimin e shoqërisë civile kosovare në adresimin e çështjeve qendrore që drejtpërsëdrejti i kanë prekur ato dhe komunitetet që ato kanë përfaqësuar[535]. Një kritikë edhe më e rreptë në këtë drejtim vije nga Richmond, i cili pohon se shoqëria civile në të tilla kontekste, në të vërtetë duket se ekziston vetëm si një "komunitet i imagjinuar" - një pjellë e imagjinatës dhe aspiratave ndërkombëtare. Krahas kësaj, është e njohur edhe kritika për mungesën e një koordinimi dhe një strategjie afatgjate të OJQ-ve[536].

4.6 Komponentët e rindërtimit dhe zhvillimit ekonomik

Aktualisht konsiderohet se vlerat liberale perëndimore, të përfshira në agjendat e shtetndërtimit ndërkombëtar, sidomos në kuadër të tezës së paqes liberale, janë bërë gjithnjë e më të përhapura dhe më të zakonshme. Modelet e shtetndërtimit sipas kësaj teze përfshijnë "demokracinë liberale, një ekonomi të tregut, politikën ekonomike, të përcaktuara nga teoria e rritjes neoklasike, pjesëmarrjen e komunitetit në zhvillim, dhe një rol të fortë për shoqërinë civile dhe sektorin privat"[537]. Në fakt, në debatin bashkëkohor për shtetndërtimin, si një faktor për një paqe të qëndrueshme, konsiderohet se kombinimi i vlerave demokratike dhe atyre ekonomike konform idealeve liberale, mund të shërbejë si një ilaç efikas në zhdukjen e faktorëve konfliktual. Andaj, në pjesën dërmuese të administratave ndërkombëtare, agjendat e tyre kanë qenë të dominuara me synimet për rimëkëmbjen dhe zhvillimin e sektorit ekonomik, si një parakusht për një paqe të qëndrueshme. Kjo çështje ka qenë edhe më e theksuar në agjendat e qarta shtetndërtuese të këtyre administratave, pasi që ato kanë

[535] Coelho, "Vehicles for Transformation, or Tools for the Status Quo?:..., p. 14.

[536] Richmond & Franks, *Co-opting the Liberal Peace...*, pp. 6-7.

[537] Rita Augestad Knudsen, *Privatization in Kosovo: The International Project 1999–2008*, Norwegian Institute of International Affairs Report 2010, p.24.

vlerësuar se rindërtimi dhe zhvillimi ekonomik, paraqesin njërin nga komponentët esencial në shtetndërtimin ndërkombëtar.

Tanimë, është vlerësuar që procesi tranziror nga lufta në paqe dhe ai i shtetndërtimit, kanë dimensione të theksuara ekonomike dhe transformuese[538]. Kjo bëhet e qartë, veçanërisht duke u nisur nga praktikat standarde, të cilat e marrin si të mirëqenë faktin, se një shoqëri nuk mund të vetëqeveriset, nëse nuk ka burime gjeneruese të të hyrave të nevojshme për ta mbështetur funksionalizimin e institucioneve të saj. Këtu mbështetja nënkupton financimin e shpenzimeve për të gjitha shërbimet që ofron administrata shtetërore qeverisëse e një vendi. Kjo bënë të kuptohet, se pa infrastrukturë institucionale që do të gjeneronte një ekonomi të qëndrueshme dhe produktive, nuk mund të ndodhin procese transformuese në një shoqëri, e rrjedhimisht as ndryshime strukturore[539]. Edhe në kontekstin e Kosovës, tranzicioni drejt një ekonomie të tregut të lirë, ka qenë një element thelbësor i aktivitetit shtetndërtues të UNMIK-ut[540].

Kjo detyrë e autoritetit të UNMIK-ut është menaxhuar nga UE-ja përmes Shtyllës IV. Më konkretisht, përmes Shtyllës së IV-të është synuar të bëhet një modernizim i përgjithshëm i infrastrukturës ligjore dhe institucionale ekonomike në Kosovë. Ky ndryshim strukturor dhe infrastrukturor, është menduar që do të krijonte mundësi për funksionalizimin e një ekonomie të tregut konkurruese dhe efikase në Kosovë. Madje, UE-ja, synonte që me futjen e legjislacionit tregtar konform vetë standardeve të saj, të bëhej edhe zhvillimi ekonomik dhe njëkohësisht, të nisej edhe procesi i privatizimit në Kosovë[541]. Por, pavarësisht planeve dhe synimeve, praktikisht ngritja dhe forcimi i këtyre komponentëve shtetndërtues, si përgjegjësi e UE-së, që në fillim u pa të ishte një detyrë e vështirë, pasi që ekonomia e Kosovës në vitin 1999 ishte totalisht e rrënuar dhe çdo gjë duhej të fillonte nga zeroja[542].

Në lidhje me rolin që ka pasur UNMIK-u në rindërtimin dhe zhvillimin ekonomik në Kosovë, si komponentë standard shtetndërtuese, pyetjet më të rëndësishme që mund të shtroheshin do të ishin: Cila ishte strategjia e bashkësisë ndërkombëtare për rehabilitimin dhe zhvillimin e ekonomisë kosovare dhe me çfarë sfidash ka qenë

[538] Raris and Sisk, *The Dilemmas of Statebuilding...*, p. 129.

[539] Po aty, p. 129.

[540] Zaum, *The Sovereignty Paradox...*, p.153.

[541] Richmond & Franks, *Co-opting the Liberal Peace...*, p. 4.

[542] Knudsen, *Privatization in Kosovo...*, p.12.

ndeshur?, dhe cilët janë treguesit real të suksesit apo dështimit të këtyre përpjekjeve për arritjen e këtyre objektivave?

Elementët vendimtare të cilat kanë qenë pjesë e strategjisë ndërkombëtare për rehabilitimin e ekonomisë kosovare, mund të përmblidhen si vijon: "Ndihma emergjente dhe rindërtimi; Krijimi i një kornize institucionale dhe ligjore; Komercializimi dhe privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore dhe nxitja e zhvillimit të sektorit privat, etj[543].

Për realizimin e këtyre detyrave, Shtylla IV e UNMIK-ut kishte themeluar institucionet e mëposhtme në administratën ekonomike dhe financiare. Së pari ishte themeluar i ashtuquajturi Autoriteti Bankar dhe i Pagesave i Kosovës (BPK), që në njëfarë mënyre do ta luante rolin e bankës qendrore të Kosovës, pasi që ai u bë përgjegjës në licencimin e të gjitha institucioneve financiare, dhe po ashtu, ky autoritet kishte përgjegjësinë dhe autorizimet vendimtare për funksionalizimin e një sistemi bankar konform parimeve të ekonomisë së tregut. Ndërkohë, u themelua edhe Departamenti i Rindërtimit, që ishte përgjegjës të bënte monitorimin dhe koordinimin e aktiviteteve të UE-së në kuadër të Shtyllës IV. Përveç këtyre dy institucioneve të rrafshit ekonomik, në atë kohë funksiononte edhe i ashtuquajturi Autoriteti Qendror Fiskal (AQF), në kuadër të të cilit funksiononin edhe zyra për buxhet, administrata tatimore, si dhe shërbimi doganor. Listës së këtyre institucioneve iu ishin bashkangjitur edhe Departamenti i Shërbimeve Publike (DSHP), si dhe Departamenti i Tregtisë dhe Industrisë (DTI)[544]. Të gjitha këto institucione, konsiderueshëm e mbulonin funksionimin e infrastrukturës institucionale ekonomike të një shoqërie tipike, të sapo dalë nga lufta dhe nën administrimin ndërkombëtar. Madje, lidhur me themelimin e këtyre dhe institucioneve, Stahn kishte shkuar aq larg në vlerësimin e tij, saqë ai deklaroi se UNMIK-u me këtë hap i krijoi themelet e shtetit të Kosovës[545].

Rindërtimi si zhvillim. Në përgjithësi është vlerësuar se sfidat më urgjente me të cilat ndeshen administratat ndërkombëtare në administrimin e territoreve të dala nga lufta, kanë të bëjnë me përpjekjet për rimëkëmbjen e infrastrukturës së rrënuar ekonomike në përgjithësi. Këso situatash, paraqesin një sfidë serioze për këto

[543] ICG, *Kosova: Një strategji për zhvillimin ekonomik*, Raporti 123 për Ballkanin, Prishtinë/Bruksel, 19 dhjetor, 2001, f. 12.

[544] Po aty, f. 12.

[545] Stahn, *The Law and Practice of International Territorial Administration*..., p. 320.

administrata, sepse ato nuk mund të ndërmarrin asnjë hap për të vendosur kornizat e organizimit të jetës sociale në përgjithësi, mbi një bazë ekonomike të rrënuar.

Në vitin 1999, fokusi kryesor i bashkësisë ndërkombëtare dhe programeve të saj ishte i orientuar më tepër "në rindërtimin sesa në zhvillimin ekonomik"[546]. Kjo bëhet e qartë, sidomos ku shohim se rreth 70% e totalit të fondeve ndërkombëtare, vinin nga vendet e UE-së, dhe që koordinoheshin nga Komisioni Evropian, kishin për synim kryesor rindërtimin në raport me synimet për zhvillim. Si përgjegjëse për menaxhimin e programeve kryesore të ndihmës së UE-së në Kosovë, ishte Agjencia Evropiane për Rindërtim (AER), e cila pavarësisht që ishte agjenci financuese e UE-së, megjithatë ishte e shkëputur nga Shtylla IV. Për shembull, nëse flasim në shifra, AER vetëm brenda një viti (2000-2001), kishte menaxhuar me 547 milion €[547]. Kështu që, duke e parë një infrastrukturë totalisht të rrënuar të ekonomisë kosovare, AER u fokusua në ngritjen dhe funksionalizimin e kësaj infrastrukture. Konkretisht, ajo u drejtua tek funksionalizimi i "sektorit energjetik, strehimi, transporti dhe furnizimi me ujë, si dhe tek projektet ndihmëse në bujqësi, zhvillimin e ndërmarrjeve, shëndetësi, dhe qeverisjen lokale/shoqërinë civile"[548]. Në fakt, projekti ndërkombëtar i shtetndërtimit në Kosovë, në aspektin e investimeve për kokë banori, ishte njëri nga projektet më gjithëpërfshirëse i parë ndonjëherë[549].

Një specifikë që duhet theksuar, lidhur me mbështetjet për rindërtim, ka të bëjë me atë se donacionet kryesore të organizatave të ndryshme ishin të pajisura dhe të specializuara vetëm për ndihmë emergjente dhe jo për zhvillim. Kjo bëri që ndihma e emergjencës të kthehej në ndihmë për rindërtim dhe zhvillim vetëm në vitin 2000 [550]. Prandaj, edhe pse gjatë kësaj kohe ishin vënë në dispozicion burime të konsiderueshme ndërkombëtare për Kosovën, sidoqoftë, zhvillimi ekonomik (përtej rindërtimit të infrastrukturës fizike dhe kornizave makroekonomike), u bë një politikë e UNMIK-ut vetëm më vonë. Për shembull, në qoftë se shikohet për nga ana përmbajtjesore, porti i rregullt për UNMIK-un i qershorit të vitit 2003 i Sekretarit të Përgjithshëm Annan, deri në paragrafin 42 nuk mund të gjendet ndonjë specifikë që do

[546] Richmond & Franks, *Co-opting the Liberal Peace...*, p. 16.

[547] ICG, *Kosova: Një strategji për zhvillimin ekonomik*, Raporti 123 për Ballkanin, Prishtinë/Bruksel, 19 dhjetor, 2001, f. 13.

[548] Po aty, f.114.

[549] Augestad Knudsen, *Privatization in Kosovo...*, p. 10.

[550] ICG, Raporti 123 për Ballkanin, Prishtinë/Bruksel, 19 dhjetor, 2001, f. 13.

të tregonte për ndonjë plan konkret strategjik të UNMIK-ut, i cili do të merrej me zhvillimin e një ekonomie të qëndrueshme në Kosovë[551].

Pas kësaj, mbështetja e fuqishme përmes ndihmës ndërkombëtare gjatë pesë viteve të para të ndërhyrjes së jashtme në Kosovë, ndryshoi në mënyrë cilësore, nga një ndihmë emergjente humanitare në ndihmë disi më afatgjate për rindërtim dhe zhvillim. Ndryshimi konkret erdhi pas vitit 2003, ku pas Samitit të Selanikut, UE-ja do të merrte përgjegjësinë kryesore për asistencë ekonomike dhe financiare për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, duke përfshirë këtu edhe Kosovën. Kjo strategji e UE-së ishte harmonizuar në kuadër të mekanizmave të Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore" dhe "Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asocim". Prandaj, në raport me Kosovën, barra për ndihmë ekonomike do të kalonte prej programeve të OKB-së drejt UE-së[552].

Infrastruktura ligjore dhe institucionale. Kur jemi te analizimi i çështjeve rreth zhvillimit ekonomik, pa dyshim, faktorët më të rëndësishëm për ngritjen e këtij sektori në Kosovën e pas luftës, konsideroheshin investimet e jashtme dhe donacionet e organizatave ndërkombëtare. Mirëpo, ka qenë evident fakti që çdo drejtim i investitorëve dhe donacioneve të jashtme në Kosovë ka qenë i përcjellë me një pasiguri të dyfishtë: atë që lidhej me mungesën e sovranitetit të Kosovës, dhe paqartësinë tjetër, atë të mos precizimit të politikave për zgjidhjen e statusit final të saj. Këto dy paqartësi, detyrimisht reflektonin një pasiguri tek këta investitorë.

Në këtë drejtim, pasi që mungonte një bazë e juridiksionit afatgjatë, sa i përket ofrimit të garancioneve juridike për investitorët e huaj dhe që i referohej paqartësisë kohore lidhur me zgjidhjen e statusit të Kosovës, domosdoshmërisht u synua gjetja e rrugëve alternative për të siguruar një lloj garancioni të përkohshëm. Si shembull në këtë kontekst, mund ta sjellim praktikën që kishte ndjekur Banka Botërore, e cila i kishte justifikuar veprimtaritë e saj duke u mbështetur në faktin se, pasi që Kosova administrohej nga UNMIK-u, mandati i të cilit thirrej në një dokument të OKB-së, siç ishte Rezoluta 1244, atëherë ishte e mundur ofrimi i asistencës për këtë vend[553]. Prandaj, duke u gjendur përballë një sfide të tillë, me kalimin e kohës, UNMIK-u filloj

[551] Henry H. Perritt, *Final Status for Kosovo and Economic Sustainability* (Chicago: Chicago-Kent College of Law, 2004), pp. 268-269.

[552] Narten, "Assessing Kosovo's Postwar Democratization"..., p.146.

[553] ICG, Raporti 123 për Ballkanin, Prishtinë/Bruksel, 19 dhjetor, 2001, f. 16-17.

ta zgjidhte këtë problem përmes miratimit të një numri të konsiderueshëm të rregulloreve, të cilat e përmirësuan infrastrukturën ligjore dhe institucionale për një zhvillim eventual ekonomik.

Sa i përket infrastrukturës institucionale ekzistuese të asaj kohe, donatorët ishin përqendruar gjithnjë e më tepër në ngritjen e kapaciteteve të këtyre institucioneve. Por, një problem që e ka karakterizuar asistencën e jashtme nga donatorët ndërkombëtar, është mos gatishmëria e tyre për të dhënë të gjitha ato donacione sa edhe ishin premtuar. Sidoqoftë, hendeku në mes shifrave premtuese dhe atyre reale shkoi duke u ngushtuar nga viti në vit. Për shembull, në periudhën ndërmjet qershorit 1999 dhe fundit të vitit 2003, është vlerësuar se Kosova ka pranuar një ndihmë teknike me rreth 742 milion € ose 29% të zotimeve të donatorëve. Me kalimin e kohës, konkretisht në vitin 2004, ndihma teknike u vlerësua të ishte rreth 71 % e të gjitha zotimeve të donatorëve (ose 46 % të donacioneve të përgjithshme në vitin 2004)[554].

Një pasqyrë e përqindjes së investimeve të jashtme në sektorët përkatës të ekonomisë kosovare është paraqitur në figurën 16.

Figura 16. Shpenzimet e donatorëve në sektorë të ndryshëm në periudhën e rindërtimit: 1999-2004.



Burimi: Banka Botërore, *Asociacioni Ndërkombëtar për Zhvillim, Shkresa e përkohshme për Kosovën për periudhën* VF06-VF07, Raporti Nr. 35262-XK, 30 Mars, 2006, f. 16.

[554] Banka Botërore, *Asociacioni Ndërkombëtar për Zhvillim, Shkresa e përkohshme për Kosovën për periudhën* VF06-VF07, Raporti Nr. 35262-XK, 30 Mars 2006, f. 15.

Në saje të veprimtarisë rindërtuese të UNMIK-ut dhe veçanërisht në këtë drejtim, mund të nxirret një përfundim, se ky mision, në përgjithësi, ka bërë që infrastruktura institucionale në Kosovë të jetë mjaft e zhvilluar dhe efikase, sidomos duke pasur parasysh faktin se çdo gjë kishte filluar nga zeroja. Mirëpo, problemet më të theksuara kishin të bëjnë me infrastrukturën ligjore. Si pengesa më sfiduese në këtë drejtim ka qenë ajo që lidhej me mos definimin e statusit final. Për më tepër, problemet që vinin nga paqartësia e statusit final të Kosovës, më së tepërmi janë reflektuar gjatë procesit të privatizimit.

Privatizimi dhe komercializimi. Privatizimi, si një çështje "fundamentalisht politike", është bërë një *strategji ekonomike* e projekteve për shtetndërtimin ndërkombëtar, duke e avancuar atë në të gjithë botën si një pjesë vetë-evidente e tezës së paqes liberale[555]. Po ashtu, shikuar për nga rëndësia, është konsideruar se privatizimi qëndron në top-listë sa u përket përpjekjeve për reforma ekonomike neo-liberale[556]. Mbi këtë bazë është konsideruar që përfshirja e bashkësisë ndërkombëtare, përmes UNMIK-ut në procesin e privatizimit në Kosovë, ka qenë një shembull i qartë i shtetndërtimit ndërkombëtar[557], dhe se njëra nga synimet kryesore të saj ka qenë ngritja dhe funksionalizimi i një ekonomie mbi parimet neo-liberale.

Ndër hapat e parë që u ndërmorën në lidhje me privatizimin dhe komercializimin në Kosovë nga Departamenti i Tregtisë dhe Industrisë (DTI), si bartës i kësaj përgjegjësie, ishte regjistrimi dhe fillimi i privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore (NSH). Në fillim të misionit të UNMIK-ut, kishte rreth 350 NSH-të me mbi 60.000 të punësuar[558]që mund të privatizoheshin. Ky proces përbënte një sfidë shumë serioze, sepse përveç që duhej të kalohej një tranzicion i vështirë i reformimit të sektorit ekonomik, nga një ekonomi e planifikuar në një ekonomi të tregut, sfida bëhej edhe më komplekse për shkak se nuk dihej saktë se kush mund të kishte pronësi të vërtet mbi këto ndërmarrje: IPVQ-të, UNMIK-u, apo RFJ-ja. Kjo erdhi si rezultat i paqartësisë së statusit të ardhshëm të Kosovës dhe referimit që i bëhej nga ana e Rezolutës 1244, integritetit dhe sovranitetit territorial të RFJ-së mbi Kosovë. Ky

[555] Knudsen, *Privatization in Kosovo...*, p. 10.

[556] Perritt, *Final Status for Kosovo and Economic Sustainability...*, p. 287.

[557] Knudsen, *Privatization in Kosovo...*, p. 9.

[558] ICG, Raporti 123 për Ballkanin, Prishtinë/Bruksel, 19 dhjetor 2001, f. 19.

problem, ngriti një pyetje të rëndësishme ligjore në lidhje me atë se kush kishte autorizim për të privatizuar këto ndërmarrje.

Duke iu referuar Rezolutës 1244, RFJ kërcënonte investitorët potencialë me padi, nëse UNMIK-u do të vazhdonte më tutje me shitjen e NSH-ve. Për këto arsye, përpjekjet ndërkombëtare për të privatizuar NSH-të u ndërprenë. Kjo situatë politike, me probleme të tilla ligjore bëri që investitorët e huaj të mos ishin të gatshëm të rrezikojnë paratë e tyre në një territor të "pllakosur nga pasiguria"[559].

Megjithatë, përkundër këtyre sfidave, avokatët ndërkombëtarë nga vendet perëndimore, promovuan një numër të qasjeve të ndryshme për të privatizuar NSH-të e Kosovës. Për shembull, Shtylla IV e UNMIK-ut e themeloi Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) më 13 qershor 2002. AKM-ja kishte një personel dhe juridiksion të plotë, të ndarë nga UNMIK-u, dhe atë me qëllim që të zbuste rrezikun e përgjegjësisë së OKB-së. AKM-ja kishte të drejtën për të administruar NSH-të dhe privatizimin e tyre e bëri përmes dy metodave: "spin-off-it" dhe "likuidimit"[560].

Madje, një rrugë tjetër për tejkalimin e pengesave ligjore që u ndeshën gjatë procesit të privatizimit, u bë nga Departamenti i Tregtisë dhe Industrisë, kur ky i fundit filloi ta aplikonte qasjen e ashtuquajtur: "komercializim", 'si një fazë e përkohshme e ringjalljes së NSH-ve". Përmes kësaj qasje, kompanitë e ndryshme që vepronin në sektorët përkatës, do të kishin mundësi të kishin "kontrata menaxheriale" që u lejonte atyre të kishin një lloj pronësie mbi asetet e këtyre ndërmarrjeve, por që kontratat në fjalë nuk mund ta prejudikonin "pronësinë përfundimtare"[561].

Duke u bazuar në faktin që UNMIK-u kishte bërë përpjekje për zhvillimin e ekonomisë kosovare konform parimeve neo-liberale, kjo do të thotë se ai kishte ndjekur një strategji sipas parimeve të tezës së paqes liberale. Kjo strategji i ka shtyrë kritikët e kësaj teze t'i adresojnë një numër sfidash me të cilat bashkësia ndërkombëtare ka qenë ndeshur dhe të cilat, sipas tyre, nuk janë evituar në shkallë të kënaqshme.

Siç shprehej Richmond, ishte e qartë se zhvillimi ekonomik në Kosovë ishte kapur në një situatë paradoksale: "asnjë zhvillim pa status, dhe asnjë status pa zhvillim"[562]. Sipas Richmond, zhvillimi ekonomik në Kosovë ka qenë larg përputhjes me parimet e

[559] Coelho, "Building stable and effective states through international governance"..., p. 363.

[560] Knoll, "From Benchmarking to Final Status?"..., p. 652.

[561] ICG, raporti 123, f.20.

[562] Richmond & Franks, *Co-opting the Liberal Peace...*, p. 16.

tezës së paqes liberale. Më saktë, bashkësia ndërkombëtare është konsideruar të ketë dështuar në Kosovë, në insistimin e saj për një transformim rrënjësor dhe të nxituar të infrastrukturës ekonomike me qëllim që të bëhej një kalim nga një ekonomi centraliste socialiste, në një model kapitalist, sipas rregullave të ekonomisë së tregut. Rezultati final i kësaj përpjekje në këtë kontekst, ka qenë i përcjellur me një shkallë gjithnjë në rritje të papunësisë dhe varfërisë, si dhe të rënies së standardit të jetesës[563].

Pavarësisht kësaj, është e nevojshme që përpjekjet për zhvillimin ekonomik të Kosovës, të bëhen nën dritën e një analize të treguesve makroekonomik, përmes të cilëve, mund të masim edhe shkallën e performances së kësaj veprimtarie, duke nxjerrë në pah, sukseset dhe dështimet e këtij misioni në saje të këtij aktiviteti.

Në kuadër të analizave të rolit të komponentëve të rindërtimit dhe zhvillimit ekonomik, matja e performancës së zhvillimit dhe qëndrueshmërisë ekonomike në Kosovë është shumë me rëndësi. Rezultatet e nxjerrura, ofrojnë mundësi për konstatim real të shkallës së performances së UNMIK-ut dhe IPVQ-ve, në lidhje me përpjekjet e tyre për ngritjen dhe zhvillimin e sektorit ekonomik në Kosovën e pas luftës. Ndër treguesit më të rëndësishëm makroekonomik, të matshëm gjatë administrimit të saj nga UNMIK-u, janë: niveli i GDP-së, politikat monetare, si dhe gjendja e importit dhe eksportit (bilanci tregtar).

Sipas vlerësimeve të një raporti të Bankës Botërore, tregohet se prodhimi i përgjithshëm vendor (GDP) në Kosovë, për periudhën e menjëhershme të pas-luftës, kishte shënuar një trend të mirë të rritjes në krahasim me periudhën e mëvonshme, ku trendi i rritjes ka qenë më i zbehtë. Për shembull, në nëntor të vitit 2000, GDP –ja ishte 3 miliardë marka gjermane (ose 1.4 miliardë US$), apo rreth 1,400 marka për capita (për banorë). Këto shifra, në krahasim me ato të vitit 1999, tregonin një rritje të konsiderueshme në raport me 840 marka për capita, në nëntor 1999[564]. Me kalimin e kohës, GDP-ja në Kosovë gjatë periudhës 2004-2008 ka qenë ngritur prej 2,912.5 milion € në 3,851.4. GDP për banorë është rritur prej 1,427 € në vitin 2004 në 1,789 € në vitin 2008[565].

Në lidhje me planin financiar, edhe pse në Kosovë funksiononte Autoriteti Bankar, megjithatë, ky institucion nuk ishte përgjegjës për politikën monetare, pasi që

[563] Po aty, p. 17.

[564] ICG, raporti 123, f.2.

[565] Enti i Statistikave të Kosovës, Gross Domestic Product in Kosovo 2004 – 2009, Series 3: Economic Statistics, Pristina, November 2010.

Kosova përdorte njësinë monetare të një vendi tjetër (Gjermanisë). Megjithatë, edhe me këtë kufizim, ky autoritet kishte mundësi të bënte ushtrimin e shumë funksioneve bankare, madje edhe ato që janë tipike për një bankë qendrore të vendeve perëndimore[566].

Një zhvillim në fushën financiare, e që ka qenë lidhur edhe me Kosovën, i referohet ndërrimit të përdorimit të njësisë monetare në Kosovë, me ç'rast, Kosova filloi ta përdorte njësinë monetare "euro" në vend të markës gjermane, që do të thotë se "bashkësia ndërkombëtare, *de facto,* e vendosi Kosovën në territorin e "Eurozonës", madje edhe përpara shumë shteteve anëtare të UE-së"[567].

Lidhur me analizat rreth gjendjes së importit dhe eksportit, mund të bëhen disa konstatime të vlefshme për matjen e performancës së UNMIK-ut, në ngritjen e komponentës të zhvillimit ekonomik në Kosovë.

Nga disa qarqe profesionale është vlerësuar se Kosova ka aplikuar një regjim tregtar komplet të liberalizuar gjatë kohës së administrimit direkt të saj nga UNMIK-u (1999-2008), "pa kufizime për import dhe eksport, por edhe pa nxitje dhe stimulime të eksportit[568]. Për më tepër, në një analizë të raporteve import-eksport, vërejmë që bilanci tregtar i Kosovës gjatë kësaj kohe ka qenë negativ.

Në saje të analizave mbi importin, vërehet se Kosova, për shkak të rrënimit të ekonomisë së saj nga lufta, "ka importuar pothuajse të gjitha mallrat e konsumit dhe lëndëve të para". Varësia ndaj importit, megjithatë, filloi të ulej atëherë, kur prodhimi vendor ishte stimuluar paksa prej investime të jashtme. Por pavarësisht kësaj, varësia ndaj importit mbeti e lartë gjatë gjithë kohës, madje edhe atëherë kur filloi të shënohej një rritje në ekonominë vendore. Në fakt, kjo rritje ndikoj që po ashtu të rritej edhe importi. Shprehur në shifra, kjo rritje e importit, për shembull në periudhën 2005-2008, sillej nga 1.16 në 1.93 milion €, ose me 66,6%[569].

Në anën tjetër, përderisa importet ishin shumë të theksuara, eksportet në Kosovën e pas luftës pothuajse nuk ekzistonin fare. Me kalimin e kohës, një stimulim sado i vogël i

---

[566] ICG, raporti 123, f. 17.

[567] Coelho, "Building stable and effective states through international governance"...,pp. 358-359.

[568]Riinvest, *Investimet e Jashtme Direkte në Kosovë, Politika Ekonomike,* Raport hulumtues, 19 Shtator, 2002, faqe 24.

[569] The World Bank, *Kosovo Quarterly Economic Briefing 2009, (1),* Kosovo Exports and Imports, 2005-2009.

tyre ,u vërejt vetëm pas procesit të privatizimit të disa prej ndërmarrjeve prodhuese kryesore, të tilla si Feronikeli, ku menjëherë filloi një rritje e ndjeshme e eksportit, por që nuk arriti në më shumë se 6% të GDP-s. Një rritje më e konsiderueshme, u arrit ndërmjet viteve 2005 dhe 2008, ku eksportet u rritën nga 56 milion € në 199 milion €, një rritje prej 253%[570], por që prapë se prapë arritën të mbulonin vetëm 10,3% të totalit të importit[571]. Rrjedhimisht, kjo situatë ka bërë që bilanci tregtar në Kosovë, gjatë administrimit të saj nga UNMIK-u, të jetë kryesisht negativ. Një gjendje e importeve dhe eksporteve e paraqitur grafikisht është dhënë në figurën 17.

Figura 17. Qarkullimi në tregtinë e jashtme sipas viteve në vlerë.



Burimi: Enti i Statistikës së Kosovës, Statistikat e tregtisë së jashtme, Seria 3, 2007, f.9.

Duke pasur në konsideratë të gjitha shtjellimet e deritanishme që u bënë rreth procesit dhe komponnetëve shtetndërtuese në Kosovë, është shumë me rendësi të shohim se cili është opinion i shoqërisë kosovare lidhur me performance e aktivitetit shtetndërtues të UNMIK-ut në periudhën 1999-2008. Të dhënat në vijim, pasqyrojnë një matje empirike të bête në terren. Shih në vijim në figurën 18.

[570] The World Bank, *KQEB*, 2009.

[571] Po aty.

Figura 18. Deri në çfarë shkalle UNMIK-u ka funksionuar edhe si një agjent shtet-ndërtues në Kosovë?



KREU V:

ROLI I UNMIK-UT NË ZHVILLIMIN E PROCESIT DIPLOMATIK TË ZGJIDHJES SË STATUSIT FINAL TË KOSOVËS

5.1 Procesi i zgjidhjes së statusit të Kosovës, politika: "standardet para statusit"

Shtjellimet brenda këtij kreu, fokusohen në analizimin e procesit diplomatik për zgjidhjen e statusit final të Kosovës. Para së gjithash, këtu trajtohen të gjitha ato specifika që kanë qenë të rëndësishme për formësimin e këtij procesi. Dhe përveç kësaj, këto shtjellime do të jenë në shërbim të argumentimit se ky proces paraqet fazën finale apo konkretizimin e procesit të shtetndërtimit në Kosovë. Po ashtu, ndër të tjera, do të theksohet se procesi i zgjidhjes së statusit, ka qenë shfaqur si një urë lidhëse në mes procesit të qeverisjes dhe shtetndërtimit ndërkombëtar të Kosovës, dhe më vonë si finalizues i tyre. Në këtë kuptim, si shembull mund të jetë "Deklarata e Pavarësisë së Kosovës". Kjo deklaratë, si një dokument që e shpalli juridikisht shtetësinë e Kosovës, është nxjerrë nga Kuvendi i Kosovës, si organi më i rëndësishëm i IPVQ-ve. Në kuadër të komponentës qeverisëse të UNMIK-ut, kuvendi dhe institucionet tjera, ishin konsoliduar nga Korniza Kushtetuese, si njëra nga rregulloret e para operative të UNMIK-ut. Andaj, IPVQ-të si komponentët më të rëndësishëm shtetndërtues, e finalizuan vetë procesin e shtetndërtimit të Kosovës.

Për analizimin e procesit në fjalë, do të mund të shtroheshin disa pyetje mjaft sfiduese si: A lejonte Rezoluta 1244 të negociohej për zgjidhjen e statusit të Kosovës? Cili ka qenë roli i UNMIK-ut lidhur me këtë çështje, konform kësaj rezolute? Cilat ishin politikat e UNMIK-ut në adresimin e këtij problemi? Çfarë qasje diplomatike u aplikua nga bashkësia ndërkombëtare në raport me këtë proces? Cilat kanë qenë sfidat e ndeshura? Cilat kanë qenë rezultatet?, etj.

Edhe pas vendosjes nën administrimin e UNMIK-ut, prapë se prapë, problemi i Kosovës nuk u zgjidh përfundimisht. Mos definimi i statusit të saj final, mbeti çështja më problematike dhe që u bë preokupimi kryesor, si për popullsinë vendore, ashtu edhe për bashkësinë ndërkombëtare. Në fakt, çështja e zgjidhjes së statusit final të Kosovës, vuri edhe një herë në provë qarqet diplomatike ndërkombëtare dhe shfaqi natyrën e komplikueshmërisë së këtij problemi.

Çështja e zgjidhjes së statusit, e kishte ndikuar praktikën e përditshme të OKB-së. UNMIK-u ishte i detyruar "për të lundruar me mjeshtëri midis dy rreziqeve: atij të pavarësisë së Kosovës dhe sovranitetit të RFJ-së"[572]. Kjo ka bërë që komplet veprimtaria e UNMIK-u të ketë qenë ushtruar përballë presioneve politike që vinin nga dy drejtime. Në njërën anë, ato ishin nxitje e lidershipit dhe e shumicës së shqiptarëve të Kosovës, me insistimin që nga UNMIK-u të viheshin afate të qarta të përfundimit të mandatit të tij dhe të sqaroheshin afatet kohore në lidhje me pavarësimin e vendit. Në të njëjtën kohë, UNMIK-u përballej me kundërshtime nga Beogradi, i cili e perceptonte UNMIK-un si një cenim mbi sovranitetin e tij[573]. Në rrafshin e politikës ndërkombëtare, situatat dhe faktorët e tillë, kanë bërë që në radhët e akterëve dhe qendrave më të rëndësishme vendimmarrëse, të krijoheshin përshtypje se zgjidhja e statusit të Kosovës, të mos shihej si pjesë e agjendave të tyre brenda një afati të caktuar kohor. Si pasojë e kësaj, bashkësia ndërkombëtare si duket e praktikonte qasjen "shih dhe bëj", apo "se çështja e zgjidhjes së statusit final të Kosovës duhej lënë anash për sa më shumë që do të ishte e mundur"[574]. Mirëpo, i gjendur përballë një rezistence lokale të shoqërisë kosovare gjithnjë në rritje, UNMIK-u filloi të bënte thirrje për lëvizjen e mekanizmave vendimmarrëse ndërkombëtare, për të nisur një proces të zgjidhjes së statusit të Kosovës konform Rezolutës 1244.

Problemi filloi të shfaqej që nga interpretimi i parë i kësaj rezolute, e cila nuk ofronte ndonjë zgjidhje përfundimtare të sanksionuar më parë. Në fakt, Rezoluta 1244 ndihmoi vetëm në krijimin e një kornize të përgjithshme politike ndërkombëtare për zgjidhjen e këtij problemi[575]. Për më tepër, në këtë rezolutë theksohej se ajo:

"Vendos që përgjegjësitë kryesore të pranisë civile ndërkombëtare të përfshijnë: Përkrahjen për krijimin e një autonomie dhe vetëqeverisjeje përmbajtjesore në Kosovë deri në zgjidhjen përfundimtare, duke marrë tërësisht parasysh aneksin 2 dhe marrëveshjet e Rambujesë (S/1999/648)"[576].

Rezoluta 1244, e la të hapur çështjen e statusit final të Kosovës. Kjo krijoi mundësi që i gjithë procesi vijues i zgjidhjes së këtij statusi, të formësohej konform

[572] Stahn, *The Law and Practice of International Territorial Administration*..., p. 312.

[573] Po aty, p. 312.

[574] Weller, *Shtetësia e kontestuar*, 2009, f. 309.

[575] Reka, *UNMIK as international governance…,* p. 165.

[576] Rezoluta 1244 (1999), Paragrafi 11 (a).

parimeve të politikës ndërkombëtare, duke e zhvendosur këtë çështje nga të qenit juridike, në një çështje totalisht politike.

Për më tepër, natyra politike e këtij procesi, sidomos e shprehur përmes qasjes "shih dhe bëj" sipas Knoll, erdhi atëherë kur më në fund vetë bashkësia ndërkombëtare, e kuptoi se kishte ardhur koha për ta zgjidhur statusin e Kosovës, i cili nënkuptonte "mbylljen e hendekut të sovranitetit, të cilin bashkësia ndërkombëtare e kishte lënë të hapur që prej kur ajo mori funksione kalimtare të qeverisjes në vitin 1999 për një periudhë të pacaktuar kohore"[577].

Ashtu si kishte paraparë Marrëveshja e Rambujesë, në vitin 2002, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së i raportoi Këshillit të Sigurimit për udhëzimin e PSSP-së që t'i zhvillonte etapat dhe standardet (ang. benchmarks), përmes të cilave do të matej përparimi eventualisht i arritur[578]. Menjëherë pas kësaj, PSSP-ja i atëhershëm Steiner, kishte raportuar para Këshillit të Sigurimit se një sërë përparimesh të dukshme ishin arritur në Kosovë dhe se me këtë ishte hyrë në një fazë të re. Steiner shpjegoi se vetëm pasi të jenë përmbushur disa standarde, mund të fillonin bisedimet për statusin[579].

Përcaktimi i sferave kryesore të standardeve, që u bë përmes një "marrëveshje të koalicionit të partive kosovare" e ndërmjetsuar nga UNMIK-u dhe shtriheshin në: "Eksistimin institucioneve funksionale shtetërore; zbatimit të sundimit të ligjit; lirisë së lëvizjes; të drejtës së kthimit për të gjithë kosovarët; zhvillimit të ekonomisë së tregut; qartësisë së pronës; dialogut të normalizuar me Beogradin; dhe reduktimit dhe transformimit të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK)". Kjo politikë u përkrah nga Këshilli i Sigurimit dhe përfundimisht u rimodelua si "standardet para statusit[580].

Nga një interpretim më i gjerë në perspektivën e një agjende shtetndërtuese që mund t'i bëjmë politikës së "standardeve para statusit", duhet theksuar se kjo politikë ka pasur një funksion të katërfishtë. Në aspektin e parë, kjo politikë ka shërbyer në nivelin e dy "parakushteve". Parakushti i parë, në një afat më të shkurtër, ka qenë i kushtëzuar me fillimin e negociatave për statusin final, kurse parakushti i dytë, disi më afatgjatë, ka qenë i kushtëzuar me parapërgatitjen e shoqërisë kosovare për integrimet e ardhshme euro-atlantike. Aspekti i dytë i kësaj politike ka qenë manifestuar në

[577] Bernhard Knoll, *The Kosovo Status Process and the Prospect of Sovereignty* (OSCE: Yearbook, 2008), pp. 121.

[578] Shih më tej: UN Doc. S/2002/436, 22 April 2002.

[579] Hoff, *UN Transitional Administrations...*, p. 81.

[580] Weller, *Shtetësia e kontestuar*…, f. 310.

kuadër të dy "kushteve". Kushti i parë, si duket ka qenë shprehur si formë për ta mbuluar mos efikasitetin qeverisës të UNMIK-ut, ndërsa kushti i dytë, si duket, më tepër e ka luajtur rolin e forcimit të shtetësisë empirike.

Shikuar nga ana se si perceptohej kjo politikë e standardeve, para statusit nga institucionet e Kosovës dhe ato të Serbisë, tregon për ekzistencën e një hendeku të thellë të divergjencave. Për shembull, spektri politik në Kosovë, e riafirmoi edhe një herë qëndrimin, se tanimë, *de facto*, Kosova ishte e pavarur dhe vetëqeverisej nga institucionet e veta, dhe se procesi diplomatik për zgjidhjen e statusit, vetëm sa duhej ta bënte edhe *de jure* njohjen e pavarësisë së Kosovës, edhe pse ata kishin kritika ndaj qasjes diplomatike me të cilën bashkësia ndërkombëtare kishte filluar ta zgjidhte këtë status. Në anën tjetër, në Beograd u deklarua publikisht se negociatat për statusin e Kosovës nuk duhet të shtyheshin, pasi "vonesat e mëtejshme vetëm do të konsolidojnë shtetësinë *de facto* të Kosovës, një trend i papranueshëm për Serbinë"[581]. Këto deklarime u bënë në Pragë, në fillimin e negociatave të para teknike që u mbajtën në Vjenë me 14 tetor 2003, duke shfaqur frustrimet e të dyja palëve dhe duke treguar se ato ishin futur në një rrugë pa dalje. Veç tjerash, në planin diplomatik, sikur u dha një shenjë se UNMIK-u do të lëvizte me një hap konkret drejt një zgjidhjeje, për aq sa do të lëviznin palët negociatore. Por, meqenëse pritej pak progres drejt këtij procesi, disa qarqe diplomatike filluan të lëviznin me lansimin e një formule disi më të qartësuar.

Në këtë drejtim, një kthesë e madhe u dukë se u bë në nëntor të vitit 2003, kur nënsekretari amerikan, Mark Grossman[582] bëri të ditur se së shpejti do të fillonte një proces i ri në emër të vendeve të Grupit të Kontaktit, dhe premtoi se një rishqyrtim i statusit të Kosovës do të bëhej rreth mesit të vitit 2005. Por, siç u pa edhe më vonë, i gjithë ky proces, sillej rreth një lloj "politike të kushtëzimit", të tipit se "në qoftë se një grup i standardeve të specifikuara në qeverisje dhe në trajtimin e pakicave etnike është arritur nga kjo datë"[583]. Pas kësaj, Këshilli i Sigurimit e miratoi planin "Standardet për Kosovën", që vinte nga nisma e Grupit të Kontaktit, duke themeluar pesë grupe të përbashkëta pune, në mes UNMIK-ut dhe IPVQ-ve, për të planifikuar dhe koordinuar

[581]Meurs, "Kosovo's Fifth Anniversary-On the Road to Nowhere?"..., p. 69.

[582] Grossman in Kosovo, *Stresses "Standards Before Status"*, November 5, 2003, 06 November 2003, http://www.usembassy.it/file2003_11/alia/a3110609.htm (Qasur me 25.03.2013).

[583] Bernhard Knoll, "From Benchmarking to Final Status?"..., p.641.

përmbushjen e standardeve që do të vlerësoheshin nga UNMIK-u në raportet tremujore[584].

Edhe pse deklarata e Grossmanit ishte paraqitur si një platformë mjaft e qartë për përmbushjen e standardeve, prapë se prapë ajo si duket nuk arriti të amortizonte tensionet ndër etnike në Kosovë dhe qëndrimet antagoniste të lidershipit në Prishtinë dhe Beograd. Qëndrimet antagoniste, si duket reflektuan edhe mbi gjendjen në terren. Si rezultat i kësaj, në Kosovë, në mars të vitit 2004, shpërthyen trazira të dhunshme të motivuara politikisht dhe etnikisht. Këto trazira, treguan më së miri se cilat ishin gjasat për një pajtim të mundshëm ndër etnik, mbi bazën e të cilit eventualisht do t'i harmonizonin qëndrimet edhe liderët politikë të Prishtinës dhe të Beogradit, për një zgjidhje të pranueshme nga dy palët.

Ndonëse e pa deklaruar nga qendrat vendimmarrëse ndërkombëtare, ngjarjet e marsit reflektuan direkt mbi rrjedhën e procesit negociator. Në kuptimin metaforik, meqenëse po flitet për një proces dinamik, efekti i këtyre ngjarjeve mund të shpjegohej me "ligjin e parë të dinamikës" të Isac Newton-it. Sipas tij: "një trup do të vazhdojë të qëndroj në gjendjen e tij të mëparshme, derisa të ndërhyjë një forcë që bën të ndërrohet kjo gjendje"[585]. Andaj, një tregues i saktë mund të jenë hapat që mori UNMIK-u në shtyerjen e mëtejme të politikës së standardeve para statusit. Dy javë pas trazirave (31 mars), UNMIK-u e mori prapë në dorë procesin e standardeve, duke e implementuar Planin për Implementimin e Standardeve për Kosovën (PISK)[586].

Për më tepër, pas ngjarjeve të marsit, është argumentuar se kishte një "përshpejtim të elementeve të projektit për zbatimin e standardeve". Si pasojë e brishtësis që u tregua në fushën e sigurisë, e shkaktuar nga këto ngjarje, nga menaxhmenti i lartë i OKB-së u morën masa të menjëhershme për një shqyrtim të rolit të UNMIK-ut. Ky proces, iu besua ambasadorit Kai Eide, që ishte përfaqësuese i përhershëm i Norvegjisë në NATO[587]. Andaj, përmes këtij hapi, u bë e qartë se Kosova nuk mund të "sundohej" më, ashtu siç ishte "sunduar" deri atëherë[588].

---

[584] SC/8082 Press Release, 30/04/2004.

[585] Skënder Skënderi & Rashit Maliqi, *Fizika* (Prishtinë: UP, 2005), faqe 15-20.

[586] Marc Weller, *Negotiating the final status of Kosovo*, Institute for Security Studies EU, Paris, December 2008, p. 19.

[587] Weller, 2009, f. 312.

[588] Bashkim Rama, *Faktori shqiptar dhe siguria rajonale* (Tiranë: GEER, 2011), f.259.

Përveç kësaj, ngjarjet e marsit treguan se *status quo*-ja në Kosovë nuk mund të zgjatej më tepër, dhe se një zgjidhje sa më e shpejtë e statusit të Kosovës do të ishte në interes të paqes dhe stabilitetit rajonal. Sipas kësaj logjike, Kosova edhe njëherë u shfaq si rast ku u tregua "fuqia e të pafuqishmit". Ashtu si me rastin e shpërthimit të konfliktit të armatosur në vitin 1998, edhe me shpërthimin e trazirave të vitit 2004, Kosova tregoi se nëse nuk mundet të kontribuoj në ndërtimin e paqes dhe sigurisë rajonale, të paktën ajo mund të kontribuoj në prishjen e saj. Mbi këtë justifikim, mund të thuhet se bashkësia ndërkombëtare filloi të lëvizte më konkretisht në zgjidhjen e statusit final të Kosovës. Andaj, duke pasur në konsideratë këto zhvillime, mund të konstatohet se deri në fund të vitit 2004, qasja e UNMIK-ut dhe e bashkësisë ndërkombëtare ka funksionuar sipas një "politike të kushtëzuar". Deri në këtë kohë, procesi i zgjidhjes së statusit final, më tepër ka qenë karakterizuar nga natyra e tij procedurale, sesa esenciale.

Një fazë e re me hapa konkretë drejt zgjidhjes së statusit final, erdhi vetëm në vitin 2005. Ajo kryesisht identifikohet me raportin e ambasadorit Kai Eide për gjendjen në Kosovë, të paraqitur para sekretarit të përgjithshëm të OKB-së. Në këtë raport, ai konstatoi me kujdes se politikës "standardet para statusit" i mungonte besueshmëria dhe se do të duhej të zëvendësohej me "një politikë të mbështetur në prioritete dhe në standarde reale"[589]. Më në fund, ai argumentoi se: "(...) nuk do të ketë asnjë moment të mirë për të adresuar statusin e ardhshëm të Kosovës"[590]. Në vazhdën e kësaj, Eide theksoi se:

> "Procesi për statusin e ardhshëm duhet të nisej me kujdes. Të gjitha palët duhej të mblidheshin përgjatë gjithë procesit të statusit. Rezultati përfundimtar duhej të ishte stabil dhe i qëndrueshëm. Nuk duhej të vendoseshin afate artificiale. Njëherë që procesi të niste, nuk mund të bllokohej, por duhej të përfundohej"[591].

Po të analizohet detajisht ky paragraf i raportit të Eide-s, mund të kuptohet se faktorët ndërkombëtarë dhe ata lokalë, po futeshin në një rrugë shumë të vështirë të përcaktimit të statusit final të Kosovës. Meqenëse ishte një ndërmarrje diplomatike

[589] Po aty, f. 312-313.

[590] Hoff, *UN Transitional Administrations...*, pp. 82-83.

[591] UN Doc. S/2005/635, 7 October 2005.

tejet e komplikuar, në të u përfshinë qendrat më eminente ndërkombëtare të politikë bërjes dhe të vendimmarrjes.

5.2 Negociatat për statusin final të Kosovës: faktorët strukturor dhe kontekstual

Përpjekjet për zgjidhjen e statusit final të Kosovës, padyshim, kanë përbërë një sfidë vendimtare për bashkësinë ndërkombëtare në përgjithësi dhe për UNMIK-un në veçanti. Vlerësuar nga një perspektivë e përgjithshme, mund të thuhet se rasti i Kosovës nën administrimin ndërkombëtar ka promovuar disa praktika të reja edhe njëkohësisht unike. Risia ka qenë shfaqur kryesisht në mënyrën se si bashkësia ndërkombëtare e trajtoi problemin e zgjidhjes së statusit final të Kosovës, dhe se si kanë qenë të përfshirë dhe të koordinuar faktorët kryesorë vendimmarrës, lidhur me trajtimin e kësaj çështje.

Shikuar në retrospektivë, mënyra se si bashkësia ndërkombëtare menaxhoi me krizën e Kosovës në vitin 1999, dallon shumë nga mënyra se si ajo e trajtoi problemin e zgjidhjes së statusit final të saj. Dallimet shfaqen kryesisht në atë se cilat parime: ato juridike apo politike e kanë përcjellur dhe përfunduar procesin përkatës.

Procesi negociator për statusin final të Kosovës, *de jure* ka baraspeshuar në mes linjave të parimeve juridike dhe atyre politike ndërkombëtare. Kjo ka qenë e theksuar sidomos për nga mënyra se si iu kishte qasur bashkësia ndërkombëtare këtij procesi. Mirëpo, në zhvillim e sipër, procesi negociator, *de facto,* ka qenë i anuar dhe i dominuar nga parime totalisht politike. Kjo u bë e qartë, nga mënyra se si qendrat vendimmarrëse i trajtuan disa nga faktorët strukturorë që e kushtëzonin komplet procesin negociator.

Është argumentuar se, ishin tre faktorë strukturorë që përbënin një ambient të vështirë për të negociuar rreth statusit final të Kosovës. Dy të parët i referoheshin parimeve klasike të sistemit ndërkombëatr, kurse i treti, i referohej kryesisht parimeve moderne të këtij sistemi. Së pari, pozicionin që e mbante Beogradi karshi natyrës së statusit, përputhej me parimet që e ruajn sovranitetin dhe integritetin territorial të shteteve. Së dyti, ishte parimi i pëlqimit të shtetit, sipas të cilit obligimet nuk mund t'u imponoheshin shteteve në kundërshtim me vullnetin e tyre. Së treti, ishte parimi që afirmonte proklamimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, i cili po merrte rëndësi

gjithnjë e më shumë[592]. Në fakt, ashtu siç është elaboruar më sipër, dy parimet e para kanë qenë rikonceptuar vazhdimisht, të kushtëzuara pikërisht nga afirmimi i parimit të tretë që iu bë sidomos nga vendet perëndimore në epokën e pas Luftës së Ftohtë.

Në fakt, pikërisht këto parime, u bënë shkaktarë të ndarjeve në radhët e Grupit të Kontaktit (ShBA, Britania e Madhe, Franca, Gjermania, Italia dhe Rusia). Rusia insistonte në gjetjen e një zgjidhjeje konform respektimit të dy parimeve klasike të sistemit ndërkombëtar e që favorizoheshin nga Beogradi. Për dallim nga kjo, vendet perëndimore insistonin në faktin se këto dy parime ishin dytësore në raport me të tretin, pra parimin për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, i cili duhej ta konturonte zgjidhjen e statusit final, e që do të favorizohej nga autoritetet kosovare. Ky qëndrim i vendeve perëndimore, madje ishte shprehur edhe nga i dërguari special i Sekretarit të Përgjithshëm për statusin final të Kosovës Martti Ahtisaari, i cili kishte theksuar se: "Heqja antikushtetuese e autonomisë së Kosovës në vitin 1989 dhe ngjarjet tragjike që pasuan, e që rezultuan me administrimin ndërkombëtar të Kosovës, kanë çuar në një situatë në të cilën një kthim i Kosovës nën sundimin e Beogradit nuk është një opsion i zbatueshëm"[593].

Formati i negociatave. Shikuar nga ana strukturore, procesi negociator u hartua dhe u zhvillua kryesisht sipas linjave pak a shumë standarde dhe tipike me praktikën e proceseve negociatore në përgjithësi. Si zakonisht, ky proces u karakterizua me hartimin e një formati të bisedimeve, caktimin e vendit, kohën, udhëheqjen, ndërmjetësimin dhe implementimin e rezultateve eventuale[594]. Por, pavarësisht skemave standarde, procesi negociator për statusin final të Kosovës, ka qenë i karakterizuar edhe me shumë specifika unike të panjohura për praktikën negociuese. Të organizuara dhe të udhëhequra nga një trupë shumështresore, negociatat në fjalë u bënë elemente të përfshirjes së qendrave kryesore botërore të vendimmarrjes. Në to u përfshi Këshilli i Sigurimit, Grupi i Kontaktit, Organizatat Rajonale Politike dhe të Sigurisë, shtete dhe ekipe, si dhe një numër pafund i ekspertëve dhe burokratëve.

Shikuar nga aspekti përmbajtësor, negociatat për statusin e Kosovës, kishin një strukturë tejet komplekse, ku baza duhej kërkuar në Rezolutën 1244. Duke u bazuar në rekomandimet e raportit të ambasadorit Eide mbi vlerësimin e zhvillimeve politike në

[592] Weller, *Shtetësia e kontestuar…*, f. 317-318.

[593] Knoll, *The Kosovo Status Process and the Prospect of Sovereignty…*, p. 126.

[594] Shih më tej rreth organizimit dhe funksionalizimit të një procesi negociator në: Geoff Berridge, *Diplomacia: Teoria dhe praktika* (Tiranë: Dudaj, botimi i katërt, 2011), f. 51-143.

terren, Këshilli i Sigurimit i përcaktoj linjat e përgjithshme të këtyre negociatave [595], dhe në vazhdën e tyre, Këshilli i Sigurimit e kishte konfirmuar udhëheqjen e procesit të negociatave nga Grupi i Kontaktit, por që procesi, megjithatë zyrtarisht ishte punë e OKB-së [596].

Më 14 nëntor 2005, Sekretari i Përgjithshëm e emëroi ish- presidentin finlandez Martti Ahtisaari si të dërguar special për udhëheqjen e bisedimeve për statusin e Kosovës. Ahtisaari pati një liri maksimale të "fillojë një proces politik për përcaktimin e statusit të ardhshëm të Kosovës". Megjithëkëtë, vetëm një kornizë bazike ishte themeluar për të udhëhequr përpjekjet e tij, që u quajt Zyra e Emisarit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, për procesin e statusit të ardhshëm për Kosovën (UNOSEK)[597]. Shih figuën 19.

Figura 19. Grupi i Kontaktit në procesin e statusit të Kosovës, Janar 2006-Dhjetor 2007.



Burimi: Bernhard Knoll, *The Kosovo Status Process and the Prospect of Sovereignty*, OSCE Yearbook, 2008, pp. 124.

[595] Weller, *Shtetësia e kontestuar…*, f.319.

[596] Po aty, f. 323.

[597] Knoll, *The Kosovo Status Process and the Prospect of Sovereignty…*, p. 122.

Ndërkohë, sipas *modus operandi,* Grupi i Kontaktit[598], miratoi dhjetë "parimet udhëheqëse" për zgjidhjen e statusit të Kosovës. Në esencë, këto parime i vendosen linjat e kuqe për t'u imponuar nga ndërmjetësit në negociata[599]. Ndër parimet më të njohura ishin ato që bënë të qartë se nuk ka: kthim në situatën para vitit 1999, nuk ka ndarje të Kosovës dhe nuk ka bashkim të Kosovës me ndonjë shtet ose pjesë të një vendi tjetër[600]. Ndër të tjera, Grupi i Kontaktit theksoi se cilado që të ishte zgjidhja e statusit final, duhej të ishte e atillë që të ishte e pranueshme për popullin e Kosovës, dhe se entiteti i ri politik, do të duhet që në të ardhmen, me doemos ta ruante karakterin multietnik të përbërjes së tij shoqërore[601].

Pasi që u hartuan linjat kryesore që do ta përcillnin procesin negociator, diplomati Ahtisaari e inkurajoi palën kosovare dhe atë serbe për t'i ngritur ekipet e tyre negociuese, të cilat do t'i mbronin qëndrimet e tyre në negociatat për statusin. Autoritetet kosovare e formuan të ashtuquajturin "Grupi i unitetit", i përbërë nga forcat kryesore politike në vend.

Ashtu siç edhe pritej, qysh në fillim të procesit, palët paraqitën qëndrimet e tyre divergjente, lidhur me atë se cila zgjidhje do të ishte e pranueshme për ta. Përveç kësaj, një rrethanë tjetër që e komplikonte rrjedhën e procesit, ishin edhe parimet që do të duhej ndjekur nga palët, në lidhje me arritjen e një marrëveshje të mundshme. Siç e parashikonte ambasadori Eide, në raportin e tij, "se negociatat që një herë niseshin, ato nuk mund të bllokoheshin".

I dërguari i posaçëm i OKB-së, Ahtisaari, mbajti shtatëmbëdhjetë raunde bisedimesh të drejtpërdrejta në negociatat bilaterale dhe shumë konsultime ekspertësh mbi një periudhë prej katërmbëdhjetë muaj[602]. Në fillim, lidhur me çështjet për të cilat negociohej, u aplikua një qasje nga "poshtë-lartë" (buttom-up)[603]. Kjo do të thotë se u

---

[598] Pas defunksionalizimit të tij në vitin 1999 dhe zëvendësimit me Quint-in, ai u rikthye prapë në funksion në vitin 2003, dhe që në vitin 2005 ishte me një përbërje të re të zgjeruar duke përfshirë edhe Rusinë, NATO-n, Komisionin Evropian, Presidencën e UE, UNOSEK-un dhe UNMIK-un.

[599] Weller, *Negotiating the final status of Kosovo*, ISSEU…, p. 23.

[600] Shih më tepër në: U.S Department of State, *Statement by the Contact Group on the Future of Kosovo,* Bureau of European and Eurasian Affairs Washington, DC January 31, 2006 (Qasur me 09.09.2013).

[601] Stahn, *The Law and Practice of International Territorial Administration...*, p. 314-315.

[602] Stahn, *The Law and Practice of International Territorial Administration...*, p. 315.

[603] Knoll, *The Kosovo Status Process and the Prospect of Sovereignty…*, p. 127.

fillua me negocimin e çështjeve të natyrës mjaft teknike, siç ishte decentralizimi, për të kaluar më vonë te procesi i statusit. Edhe pse kishin filluar të shfaqeshin tendenca për bllokimin e procesit negociator nga të dyja palët, Grupi i Kontaktit ua rikujtoi edhe një herë palëve se "procesi nuk mund të bllokohej". Ai theksoi se procesi duhej të shkonte kah përfundimi. Po ashtu, Grupi i Kontaktit, theksoi se do të miratonte shkallën e angazhimit konstruktiv të të dyja palëve dhe do të nxirrte përfundime në bazë të kësaj[604].

Përderisa, Grupi i Kontaktit mund të ushtronte një ndikim mbi radhët e palës kosovare dhe asaj serbe për vazhdimin e negociatave dhe arritjen e kompromiseve, si do t'ia bënte ai për të siguruar një koherencë në radhët e veta? Kjo është pyetja së cilës nuk iu përgjigj dot askush.

Si duket, anëtarët perëndimorë gabuan në shenjë, kur kalkuluan se Rusia me përfshirjen e saj në Grupin e Kontaktit do të luajë një rol konstruktiv në rrjedhën dhe përfundimin e këtij procesi. Duke reaguar ndaj qëndrimeve të UNOSEK-ut, Rusia, bëri një lëvizje spontane, duke u tërhequr nga pozicioni i saj fillestar që lidhej me deklarimet për gatishmërinë e Rusisë për të luajtur një rol konstruktiv dhe për ta ruajtur kohezionin dhe unitetin brenda Grupit të Kontaktit. "Ajo gradualisht u distancua nga idetë e Ahtisarit, dhe filloi të zbulojë fytyrën e saj të vërtetë". Retorika e saj u përshkallëzua në mbështetje të pakompromis të pozitës së Serbisë në këto negociata. Ajo kundërshtoi fuqishëm dy elemente të këtij procesi: atë se nuk do të pranonte një zgjidhje të imponuar për Beogradin; dhe se e kundërshtonte idenë e një limiti kohor për fundin e procesit[605]. Perëndimoret ia ofruan këtë rol Rusisë, me qëllim që ajo të bëhej pjesë e Grupit të Kontaktit. Por, përmes kësaj qasje, u dukë se Rusia arriti ta "rifitonte dhe ruante fuqinë e bllokimit të vetë udhëheqjes së negociatave në nivel të Këshillit të Sigurimit dhe jo vetëm në nivel të Grupit të Kontaktit"[606].

Për më tepër, gjatë procesit negociator, Kosova u gjend në mes të përplasjes së Rusisë dhe vendeve perëndimore. Kosova si rast, edhe gjatë konfliktit të vitit 1999, edhe gjatë negociatave për statusin final, është përdorur si një praktikë eksperimentale në marrëdhëniet ndërkombëtare. Përderisa, shumica e vendeve perëndimore argumentonin se zhvillimet lidhur me rastin e Kosovës ishin shfaqur si praktikë *sui*

[604] Shih më tej në: Takim i nivelit të lartë rreth statusit të ardhshëm të Kosovës, Deklaratë e Grupit të Kontaktit (24 korrik, 2006), Vjenë.

[605] Knoll, *The Kosovo Status Process and the Prospect of Sovereignty…*, p. 131.

[606] Weller, *Shtetësia e kontestuar…*, f. 321.

generis, Rusia (dhe deri në një masë edhe Kina), argumentonin se rasti i Kosovës, sidomos në planin e definimit të statusit, do të krijonte një praktikë *precedente* për raste tjera.

Megjithatë, studiuesit argumentojnë që përmes aksiomës së *precedencës,* Rusia tentonte të përfaqësonte një pikë të lartë të influencës globale. Duke u thirrur në ruajtjen e parimeve të së drejtës ndërkombëtare, siç është parimi i ruajtjes së integritetit territorial, ajo vlerësoi se tanimë ishte momenti për arritjen e qëllimeve strategjike, tipike për synimet e një shteti si aktor racional konform logjikës së realizmit klasik. Qëllimi i parë kishte të bëjë me përpjekjen e saj, për të transmetuar një porosi në opinionin ndërkombëtar, se Rusia ende ishte një fuqi e madhe, zëri i së cilës do të duhej të dëgjohej më me respekt. Kurse qëllimi i dytë, lidhej me dëshirën e saj për "hakmarrjen mbi dështimin e Rusisë për të parandaluar bombardimet e NATO-s ndaj Serbisë në vitin 1999"[607].

Në këtë situatë të tendosur, në radhët e anëtarëve të Grupit të Kontaktit, në mes të marsit 2007, i dërguari special, Ahtisaari, ia prezantoi Sekretarit të Përgjithshëm, planin e tij të përpiluar me kujdes për pavarësinë e mbikëqyrur të Kosovës[608]. Raporti rekomandoi që "statusi i Kosovës duhet të jetë pavarësia e mbikëqyrur nga komuniteti ndërkombëtar"[609].

Ashtu siç pritej, propozimi i Ahtisaarit u kundërshtua fuqishëm nga Serbia dhe Rusia. Si rezultat i kësaj, në maj, tre anëtarët e përhershëm të Këshillit të Sigurimit: SHBA-të, Britania e Madhe dhe Franca, e kishin përpiluar një rezolutë që do të mundësonte implementimin e planit të Ahtisaarit. Por, pasi ato kuptuan indikacionet se Rusia do të përdorte veton për bllokimin e saj në Këshill, e bënë tërheqjen e saj[610]. Ndërkohë, kjo situatë u tejkalua konformë logjikës së tërheqjes, që u propozua nga UE-ja, meqenëse ndodhej në mes të një presioni të dyanshëm, si nga ai Rus, ashtu edhe nga ai i ShBA-ve. Përmes kësaj strategjie, që ishte tipike për stilin e diplomacisë

[607] Knoll, *The Kosovo Status Process and the Prospect of Sovereignty…*, p. 132.

[608] Plani i Ahtisaarit paraqitej në formën e dy dokumenteve: "Raporti i të Dërguarit Special i Sekretarit të Përgjithshëm mbi Statusin e Ardhshëm të Kosovës" katër-faqësh (Raporti i Ahtisaarit), dhe "Propozimi Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës" (Propozimi i Ahtisaarit) 63-faqësh: ICG, Raporti Nr. 185, 2007.

[609] ICG, *Zhbllokimi i Ngecjes në Kosovë: Përgjegjësi e Evropës,* Raport për Evropë Nr. 185, 21 gusht 2007, f.1.

[610] ICG, po aty, f.2.

evropiane, UE-ja synonte të "blejë më shumë kohë", kur "bëri thirrje për një periudhë të zgjatur kohe, në të cilin negociatat duhet të rifillonin"[611].

Bazuar në rezultatet finale të procesit negociator, u dukë se përpjekjet e akterëve ndërkombëtarë për të gjetur një zgjidhje të pranueshme nga të gjithë, sikur i ngjanë një loje të "mbledhjes së zerove"[612]. Por, akoma më dëshpërues ishte fakti që edhe pas përpjekjeve diplomatike shtesë, numrat që mblidheshin nuk dhanë më shumë se "zero".

5.3 Negociatat shtesë dhe shpallja e pavarësisë së Kosovës

Përpjekjet për zhbllokimin e procesit diplomatik për zgjidhjen e statusit të Kosovës, brenda Këshillit të Sigurimit erdhën po ashtu brenda këtij Këshilli. Një ndër iniciativat kryesore rreth kësaj çështjeje, u bë nga Rusia. Andaj, me kërkesën e saj, anëtarët e Këshillit të Sigurimit, vendosën të dërgonin në Kosovë një mision "fakt mbledhës", i cili qëndroi në terren për pesë ditë[613]. Pas vizitës në terren, ky mision konkludoi se komunitetet mbeten të ndara etnikisht dhe jetojnë në një masë të madhe veçmas nga njëri-tjetrit. Më tutje, misioni vlerësoi se performanca e UNMIK-ut në konsolidimin e një shoqërie multietnike, ishte relativisht e dobët dhe vuri në dukje situatën faktike në terren, ku serbët e Kosovës vazhdonin të bojkotonin në vazhdimësi institucionet vetëqeverisëse në Kosovë, duke i përkrahur më shumë "strukturat paralele" të cilat dirigjoheshin direkt nga Beogradi[614].

Negociatat e ndërmjetësuara nga "treshja" ShBA, UE, Rusi. Në planin diplomatik, lidhur me procedimin e mëtejshëm të zgjidhjes së statusit të Kosovës, u aplikua një qasje e stilit Francezo-Amerikane. Protagonistët kryesorë ishin, presidenti francez, Nicolas Sarkozy dhe ai amerikan, George Bush. Sarkozy, në Konferencën e G-8-ës, propozoi një periudhë 120 ditësh të negociatave shtesë. Ky propozim u pasua

---

[611] Knoll, *The Kosovo Status Process and the Prospect of Sovereignty…*, p. 132.

[612] Wller, *Shtetësia e kontestuar*..., f. 317.

[613] Report of the Security Council mission on the Kosovo issue, UN Doc. S/2007/256, 4 May 2007; Një analizë më gjerë është dhënë në: David Criekemans, *Final Status Negotiations on Kosovo within the UN Security Council*, Model United Nations - Flanders, 3rd Edition, Case 2007-2008, pp. 11-13.

[614] Hoff, *UN Transitional Administrations...*, p. 85.

nga deklarata që erdhi dy ditë më vonë (10 Qershor) nga presidenti Bush, gjatë vizitës së tij në Shqipëri, i cili deklaroi se "Kosova duhet të bëhet e pavarur"[615].

Menjëherë pas kësaj, edhe zyrtarisht, ShBA-të, Belgjika, Franca, Gjermania, Italia dhe Britania e Madhe, dolën me projektrezolutën, e cila përmbante elemente të propozimit të mëhershëm francez për negociata shtesë[616]. Siç duket, ky ishte një aktivitet alternativ diplomatik shumë mirë i koordinuar në radhët e perëndimorëve. Megjithëkëtë, prapë ishte qëndrimi rus ai që e bllokoi këtë iniciativë. Lidhur me këtë hap, ambasadori rus në OKB Vitaly Churkin, u shpreh se si duket "kjo është njëfarë automatizmi i fshehur i miratimit të planit të Ahtisaarit"[617]. Megjithëkëtë, Grupi i Kontaktit u pajtua në Vjenë, më 25 korrik, se bisedimet e reja do të udhëhiqen nga "treshja" SHBA, UE dhe Rusi, të dërguarit e të cilave filluan diplomacinë fluturuese[618].

Në saje të këtyre përpjekjeve, edhepse në kuadër të Këshillit të Sigurimit, përpjekjet diplomatike për zgjidhjen e statusit të Kosovës u zhvendosën në qarqe diplomatike shumë më të ngushta. Kësaj radhe, aktiviteti diplomatik ishte projektuar në një plan tredimensional, por që në parim nuk dallonte shumë nga procesi paraprak i koordinuar nga UNOSEK-u. Mirëpo, çudia qe se edhe pse fillimisht treshja deklaroi se ajo do të operonte konform Rezolutës 1244, si dhe parimeve të Grupit të Kontaktit të vitit 2005, ajo gjatë procesit në vijim u shmang dukshëm prej tyre.

Konform logjikës për të ofruar shërbime të mira dhe lehtësime për palën kosovare dhe atë serbe drejt një konsensusi, treshja mori edhe një rol shumë aktiv edhe në propozimin e zgjidhjeve alternative për palët, konformë shprehjes diplomatike "për të mos lënë as një gurë pa luajtur"[619]. Andaj, shikuar nga një këndvështrim i gjerë i veprimit diplomatik, treshja ShBA-Rusi-UE, për çështjen e statusit të Kosovës, të lë përshtypjen e treshes së Jaltës së vitit 1945. Mirëpo, për dallim nga Jalta, tani kishte një Gjerman që fliste në emër të UE-së, e jo një Anglez si Churchilli në Jaltë. Po ashtu,

---

[615] NBCNews, *Key dates in Kosovo's drive for independence,www.nbcnews.com* (Qasur me 10.04.2013).

[616] Weller, *Shtetësia e kontestuar…*, f. 363.

[617] EUobserver, Foreign Affairs, *Kosovo UN vote under way*, 18.07.2007 (Qasur me 09.04.2013).

[618] Të dërguarit ishin: Wolfgang Ishinger i Gjermanisë për BE-në, Frenk Wizner nga SHBA-të dhe Aleksander Botsan-Kharçenko i Rusinë. Shih në: ICG, Raporti Nr. 185, 2007, f. 2.

[619] Troika Press Statement, Vienna, 5 November 2007, 3rd paragraph.

një dallim tjetër ka të bëjë me autorizimet e tresheve. Përderisa ajo e Jaltës imponoi "zgjidhje", kjo e Kosovës, ashtu siç kishte deklaruar, nuk do të imponoonte direkt "zgjidhje" për palët. Por pavarësisht kësaj, ajo krijoi rrethana faktike që imponuan indirekt arritjen e një zgjidhjeje. Kështu që, duke lansuar të gjitha propozimet e mundshme për palët drejt arritjes së një konsensusi, treshja afirmoi edhe një herë se sistemi i marrëdhënieve ndërkombëtare funksionon konform parimeve reale të politikës. E njëri ndër këto parime është edhe ai që thekson se "të mëdhenjtë e bëjnë atë që duan, e të vegjlit e pranojnë atë që duhet ta pranojnë".

Për shembull, përkundër parimeve të deklaruara nga vet Grupi i Kontaktit, treshja dhe palët negociatore, propozuan opsione që silleshin nga autonomia; modelet e konfederatës e deri te pavarësia. Madje, palët ishim mjaft ambicioze, duke mos lënë pa shqyrtuar as modelet më specifike të zgjidhjeve për çështjet e sovranitetit, siç ishte edhe "Modeli i Taivanit" dhe "Modeli i Honkongut"[620]. Por, pavarësisht kësaj, as pala kosovare as ajo serbe nuk u tërhoqën nga qëndrimet e tyre në raport me posedimin e sovranitetit mbi Kosovën. Kështu që, edhe pas dhjetë sesioneve të negociatave, nuk u arrit një marrëveshje. Kjo rrethanë faktike, bëri treshen ndërmjetësuese të dalë me qëndrimin përfundimtar se:

> "Treshja ishte në gjendje për të lehtësuar diskutimet e nivelit të lartë, intensive dhe të pavarura mes Beogradit dhe Prishtinës. Megjithatë, palët nuk ishin në gjendje të arrijnë një marrëveshje mbi statusin përfundimtar të Kosovës. Asnjëra palë nuk ishte e gatshme të heqë dorë nga qëndrimi i saj mbi çështjen fundamentale të sovranitetit mbi Kosovën"[621].

Pas kësaj deklarate, u hapën rrugë për veprime të reja diplomatike në terren. Tani ndiqej me vëmendje çdo hap i palës kosovare, lidhur me reagimet e saj në raport me situatën politike të krijuar. Edhe për anëtarët perëndimorë të Grupit të Kontaktit ishin krijuar mundësi që t'i ndiqnin alternativat e lëna "rezervë" si një strategji për implementimin e planit të Ahtisaarit. Ato rivlerësuan se ky plan, mbeti varianti i fundit dhe më i miri për zgjidhjen e statusit final të Kosovës: që nënkuptonte pavarësimin e saj nën mbikëqyrjen e përkohshme ndërkombëtare. Pra, ato filluan të vepronin ashtu

[620] Shih më tej në Knoll, 2008, p. 131 dhe Weller, 2009, f. 366-374.

[621] Report of the European Union/United States/Russian Federation Troika on Kosovo, UN Doc. S/2007/723, 4 December 2007, 2nd paragraph, p.2.

siç ishin shprehur në deklaratën e lëshuar në prag të negociatave të treshes, me 20 korrik 2007, ku thuhej se:

> "Ne shpresojmë se këto negociata do të çojnë në marrëveshje ndërmjet palëve. Nëse jo, ne vazhdojmë të besojmë se Plani i Ahtisaarit është mënyra më e mirë për të ecur përpara"[622].

Në fakt, në përgjithësi vlerësohej se "plani i Ahtisaarit, mund të lexohej si projekt për formim të shtetit të Kosovës, por ishte i bazuar në një balanc delikat, në mes të një entiteti të mbikëqyrur nga ndërkombëtarët dhe një shteti të pavarur"[623]. Megjithëkëtë, "ai i ofronte Kosovës gjithë çfarë ishte e nevojshme për shtetësi"[624]. Kjo ishte arsyeja që pala kosovare, në koordinim të ngushtë me ndërkombëtarët, filloi të përgatitej për shpalljen e njëanshme të pavarësisë, duke e futur planin e Ahtisaarit si një instrument qenësor.

5.4 Shpallja e pavarësisë dhe inaugurimi *de jure* i shtetësisë së Kosovës

Me 17 shkurt 2008, Kuvendi i Kosovës, e miratoi një deklaratë me 109 vota, e cila e shpalli Kosovën shtet të pavarur. Më tej në këtë deklaratë thuhej:

> "Ne, udhëheqësit e popullit tonë, të zgjedhur në mënyrë demokratike, nëpërmjet kësaj Deklarate, shpallim Kosovën shtet të pavarur dhe sovran. Kjo shpallje pasqyron vullnetin e popullit tonë dhe është në pajtueshmëri të plotë me rekomandimet e të Dërguarit Special të Kombeve të Bashkuara, Martti Ahtisaari, dhe Propozimin e tij Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës (...). Ne, nëpërmjet kësaj, afirmojmë në mënyrë të qartë, specifike dhe të paevokueshme se Kosova do të jetë ligjërisht e obliguar të plotësojë dispozitat e përmbajtura në këtë Deklaratë, përshirë këtu veçanërisht obligimet e saj nga Plani i Ahtisaarit. Në të gjitha këto çështje, ne do të veprojmë në pajtueshmëri në parimet e së drejtës ndërkombëtare dhe rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, përfshirë Rezolutën 1244 (1999). Ne shpallim publikisht se të gjitha shtetet kanë

[622] Statement issued on 20 July 2007 by Belgium, France, Germany, Italy, United Kingdom and the United States of America, co-sponsors of the draft resolution on Kosovo presented to the UNSC on 17 July.

[623] ICG, *Kosova: pa alternativa të mira për Planin e Ahtisaarit,* Raport për Evropë, Nr. 182, 14 maj 2007, f. 3.

[624] Weller, *Shtetësia e kontestuar…*, f. 361.

të drejtën të mbështeten në këtë Deklaratë, dhe i bëjmë apel të na ofrojnë përkrahjen dhe mbështetjen e tyre"[625].

Shikuar përmbajtjen e kësaj deklarate, mund të thuhet se ajo përmbante një gjuhë të nënkuptuar diplomatike, duke sjellë implikime të rëndësishme juridike për Kosovën. Siç argumenton Weller, ky dokument, duke e përdorur nocionin e "deklaratës së njëanshme", rrjedhimisht krijoi obligime juridike *erga omnes*. Këto lloj obligimesh u mundësuan të gjitha shtetet tjera të mbështeteshin dhe të vepronin mbi bazën e tyre[626]. Në planin diplomatik, kjo deklaratë synonte t'i shmangej pengesës që do të vinte nga Serbia dhe Rusia, të cilat do të bënin thirrje për mosnjohje kolektive. Kjo ngase, siç do të mund të argumentonin këto dy shtete, shtetësia e Kosovës nuk mund të njihej për faktin se ajo u realizua njëanshëm në bazë të dispozitave të një plani (si ai i Ahtisaarit), pa miratimin e një rezolute nga Këshilli i Sigurimit. Kjo situatë, sipas parimeve klasike të së drejtës ndërkombëtare, mund të vlerësohej e "paligjshme". Andaj, mbi bazën e parimit *erga omnes*, u bë një tejkalim i kënaqshëm në aspektin e njohjes së shtetësisë së Kosovës[627].

Mbi bazën e kësaj qasje, Kosova menjëherë pas shpalljes së pavarësisë, mori njohje të konsiderueshme të shtetësisë së saj. Njohjet erdhën kryesisht nga ato vende me të cilat Kosova ishte koordinuar ngushtë për zgjidhjen e statusit. Mirëpo, ritmi i njohjeve nuk kishte shkuar ashtu siç kishin paraparë Republika e Kosovës dhe shtetet që e mbështetën. Tri fakte kryesore mund të kenë ndikuar si pengesë në këtë drejtim. Së pari, zgjidhja e statusit jashtë kornizave të Këshillit të Sigurimit, kishte shfaqur dilema te disa shtete që ta bënin njohjen e Kosovës. Së dyti, lobimi i fuqishëm i Serbisë me aleatët e saj, ishte ai që po ashtu ka zbehur gatishmërinë e disa shteteve për ta njohur Kosovën. Së treti, ka pasur të bëjë me faktin që disa shtete kishin probleme të brendshme[628] territoriale, dhe vlerësonin se njohja e Kosovës mund të shërbente si precedentë për shkëputjen eventuale të një pjese të territorit të tyre.

---

[625] Deklarata e Pavarësisë 17.02.2008, Republika e Kosovës, Kuvendi i Kosovës.

[626] Weller, *Negotiating the final status of Kosovo…*, p.70.

[627] Jure Vidmar, "International Legal Responses to Kosovo's Declaration of Independence"..., pp. 827-830.

[628] Chatham House, *Kosovo: International Law and Recognition,* A Summary of the Chatham House International Law Discussion Group meeting held on 22 April 2008. Chatham, p. 22.

Në planin koordinues, ashtu siç ishte paraparë në deklaratën e pavarësisë, filluan të zbatoheshin rekomandimet e Planit të Ahtisaarit. Mënyra e zbatimit ishte unike. Kjo erdhi si rezultat i vendosmërisë së UE-së dhe ShBA-ve për të zbatuar Planin e Ahtisaarit, pa një rezolutë të Këshillit të Sigurimit.

Në saje të këtij plani, një ditë para shpalljes së pavarësisë së Kosovës, Këshilli i UE-së, e dërgoi një mision që njihej si: Misionin e UE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX), prioritetet e të cilit ishin përcaktuar "të mbështetnin autoritetet e Kosovës në përpjekjet e tyre për të ndërtuar një sistem të sundimit të ligjit të qëndrueshëm dhe funksional". Ky mision, siç u pa më vonë, nuk e zëvendësoi UNMIK-un, por përkrah tij, ai më tepër pritej ta ushtronte një rol monitorues dhe këshillues për autoritetet e Kosovës[629].

Për ta përmbushur mandatin e tij në Kosovë, EULEX-i ka edhe një element tjetër të tij, Zyrën Civile Ndërkombëtare (ZCN), të kryesuar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar (PCN), ose Përfaqësuesi Special i Unionit Evropian (PSUE). Detyra e tij ishte të monitorojë dhe të mbikëqyrë zbatimin e Planit të Ahtisaarit për Kosovën. PCN / PSEU kishte disa kompetenca ekzekutive në jetën publike të Kosovës, në rastet kur autoritetet lokale dhe institucionet nuk vepronin në përputhje dhe sipas frymës së planit të Ahtisaarit[630].

Kur jemi te shqyrtimet e rolit që ka pasur prania ndërkombëtare në Kosovë, duhet theksuar që ky rol ka qenë kryesisht i natyrës konsultative dhe monitoruese. Në një vlerësim të përgjithshëm, ajo ka ndihmuar mjaft në ndërtimin e besimit te autoritetet Kosovare[631].

Sidoqoftë, pavarësisht këtyre situatave, Kosova filloi ta konsolidonte gjithnjë e më shumë shtetësinë e saj empirike. Këto përpjekje u bënë kryesisht në rrafshin e afirmimit të shtetësisë së saj në arenën ndërkombëtare. Këtë afirmim, Republika e

---

[629] Vidmar, "International Legal Responses to Kosovo's Declaration of Independence"..., p. 805.

[630] Enver Hasani, *From UNMIK to EULEX: An Outline of the Key Aspects of Governance, Cooperation and Confidence-Building Under the Conditions of International Supervision,* in: Cutting or Tightening the Gordian Knot? The Future of Kosovo and the Peace Process in the Western Balkans after the Decision on Independence, Ernst M. Felberbauer, Predrag Jureković, Frederic Labarre (Eds.), 16th Workshop of the Study Group, "Regional Stability in South East Europe", Vienna, October 2008, pp. 147-158.

[631] Po aty, p. 147-150.

Kosovës tentonte ta arrinte përmes marrjes të sa më shumë njohjeve nga shtetet anëtare të OKB-së. Por, në këtë drejtim, një pengesë mjaft komplekse për afirmimin e shtetësisë së Kosovës, erdhi nga Serbia, e cila në gusht të vitit 2008, e bëri një kërkesë pranë Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND) që të jepte një opinion nëse shpallja e njëanshme e pavarësisë së Kosovës e kishte shkelur ligjin ndërkombëtar. Mendimi këshillëdhënës i GJND-së, i cili nuk ka pasoja ligjore, ishte se shpallja e pavarësisë së Kosovës "nuk ka shkelur ligjin e përgjithshëm ndërkombëtar, Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit apo Kornizën Kushtetuese. Si rrjedhojë, nxjerrja e asaj deklarate nuk ka shkelur ndonjë rregullë të aplikueshme, të ligjit ndërkombëtar"[632]. Ky opinion, ndonëse pa pasoja ligjore për Serbinë, shikuar nga qëllimi i inicimit të tij, u kthye në një bumerang, nga se ai ishte nxjerrë në favor të Kosovës. Mirëpo, në anën tjetër, ky opinion nuk pati një efekt edhe aq pozitiv në shtimin e njohjeve të Kosovës, aq sa Kosova kishte pritur. Por, sidoqoftë, të paktën ai u bë një adut i fortë argumentues, që Kosova mund ta përdorte ndaj zërave skeptikë, të cilët shtetësinë e Kosovës e kontestonin sidomos në frymën e asaj që ajo ishte e kundërligjshme.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe Rezoluta 1244: një modus vikendi. Ashtu siç edhe pritej, shpallja e pavarësisë së Kosovës, krijoi rrethana të reja politike dhe juridike në terren. Por, edhe pas këtyre zhvillimeve, *status quo*-ja e pranisë civile dhe ushtarake ndërkombëtare, bazuar në trashëgiminë e Rezolutës 1244, mbeti e pandryshuar. Për më tepër, prania ndërkombëtare civile, vetëm sa u shtua në kontekstin e Kosovës së pavarur. Kjo erdhi si rezultat i asaj që, vetë deklarata e pavarësisë, e cila juridikisht bëri inaugurimin e themeleve të shtetësisë së Kosovës, e kishte paraparë vendosjen e një pranie civile ndërkombëtare. Këtë çështje ajo e proklamonte në përputhje me dispozitat e Planit të Ahtisaarit, konform të cilit edhe ishte formuluar.

Analizuar nga aspekti legal, kjo prani ka krijuar një lloj të paqartësisë ligjore, lidhur me qëndrimin që kanë mbajtur institucionet e ndryshme ndërkombëtare, në raport me statusin e ri të Kosovës. Ky kompleksitet ligjor, ka qenë shkaktuar edhe nga mos definimi i saktë i bazës legale të operimit të disa prej këtyre institucioneve. Për

[632] Shih më tej në: I.C.J, Report, *Accordance with International Law of the Unilateral Declaration of Independence in Respect of Kosovo, Advisory Opinion,* 22 July 2010, http://www.icj-cij.org/docket/files/141/15987.pdf (Qasur me 16.09.2013).

shembull, siç thekson Koeth, një paqartësi e tillë ka qenë mjaft evidente në rastin e raporteve në mes UNMIK-ut dhe EULEX-it. Pavarësisht asaj, që EULEX-i në Kosovë zyrtarisht ka qenë dhe është duke punuar nën UNMIK-un dhe autoritetin e tij ligjor që buron nga Rezoluta 1244, ZCN-ja nuk kishte një autorizim të tillë të Këshillit të Sigurimit të OKB-së[633]. Por, përveç kësaj, paqartësi ka pasur edhe në relacionet në mes vetë elementëve të EULEX-it. Për shembull, sipas Koeth, kjo rrëmujë në këtë drejtim është shkaktuar për faktin se PCN-ja e njihte zyrtarisht Kosovën si shtet të pavarur, por UE-ja, dhe kështu PSEU, nuk e bënin të njëjtën gjë. Kjo, sipas tij, kishte krijuar një "situatë skizofrenike"[634].

Sa i përket relacioneve në mes UNMIK-ut dhe EULEX-it, kjo situatë ishte krijuar nga një insistim i fuqishëm i Serbisë dhe Rusisë për mos transferim të autorizimeve nga UNMIK-u te EULEX-i. Në këto rrethana, gjatë fazës së menjëhershme në kontekstin e pas pavarësisë, Sekretari Ban Ki-moon, kërkoi një konsensus për të shkuar përpara në zgjidhjen e këtyre kontesteve dhe propozoi mënyrën: e të qenit "neutral ndaj statusit" [635]. Përveç kësaj, Ban Ki-moon, deklaroi se miratimi i pritshëm i Kushtetutës së Kosovës, do të paraqitej si një sfidë serioze për autoritetin e UNMIK-ut, të cilit do t'ia merrte autorizimet që kishte ky mision deri në atë moment[636]. Megjithëkëtë, qeveria e Kosovës kishte theksuar se do ta mirëpriste praninë e mëtejshme të UNMIK-ut, me kusht që ai t'i kryente vetëm punët e mbetura[637].

Por, cili ishte roli i Kushtetutës së Republikës së Kosovës në definimin e kësaj paqartësie ligjore të krijuar në Kosovë në kontekstin e pas pavarësisë?

Kushtetuta e Republikës së Kosovës e miratuar me 15 qershor 2008, nga ana dispozitive, ka rregulluar në mënyrë specifike vazhdimin e pranisë ushtarake ndërkombëtare (KFOR)[638]*, por ajo nuk specifikon ndonjë dispozitë për praninë civile

[633] Wolfgang Koeth, "State building without a state", *European Foreign Affairs Review* 15 (2010), p. 235.

[634] Po aty, p. 235.

[635] Weller, *Shtetësia e kontestuar…*, f.383.

[636] Report of the Secretary-General on the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo, UN Doc. S/2008/354, paragraph 7, 12 June 2008.

[637] Weller, *Shtetësia e kontestuar…*, f. 383.

[638]* Në nenin 153 thuhet se: "pavarësisht dispozitave tjera të kësaj Kushtetute, Prania Ndërkombëtare Ushtarake ka mandatin dhe kompetencat e përcaktuara nga instrumentet relevante ndërkombëtare, përfshirë Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, datë 26 mars 2007. Kryesuesi i

ndërkombëtare (UNMIK, OSBE, Këshilli i Evropës). Në fakt, miratimi i kësaj kushtetute, siç theksohej edhe në raportin e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së[639], *de facto* e ka kufizuar aktivitetin operacional të UNMIK-ut, por *de jure* jo. Kështu që, operimi i pranisë ndërkombëtare civile dhe ushtarake (përjashtuar ZCN), mbeti i varur direkt nga ndonjë vendim eventual i Këshillit të Sigurimit rreth Rezolutës 1244.

Kjo situatë e krijuar në terren, ka bërë që në Kosovën e pas pavarësisë, *de jure*, të operojnë dy autoritete qeverisëse: institucionet e Republikës së Kosovës, përmes kushtetutës së saj në fuqi, si dhe prania civile dhe ajo ushtarake ndërkombëtare, përmes Rezolutës 1244, po ashtu në fuqi. Për ta rregulluar këtë ngërç politik, është aplikuar marrëveshja e modelit *modus vivendi*, sipas së drejtës ndërkombëtare. Andaj *modus vivendi* në mes të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Rezolutës 1244, ka qenë shprehur në këtë formë: përderisa prania civile dhe ushtarake ndërkombëtare në Kosovë ndjek "politikën e të qenit neutral ndaj statusit" [640], Kushtetuta e Republikës së Kosovës, ligjërisht, nuk e shpallë këtë prani si *persona non grata*.

Megjithëkëtë, askush nuk mund ta mohojë faktin, se pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, *de facto*, UNMIK-u vazhdon të konsiderohet *persona non grata*, si nga shoqëria, ashtu edhe nga institucionet e Kosovës. Një qëndrim i tillë për shoqërinë dhe lidershipin kosovar, ka qenë forcuar, sidomos mbi bazën e zhvillimeve politike që kanë ndodhur në terren nga viti 2008 e deri më sot. Andaj, këto zhvillime kanë bërë që të krijohet perceptimi se prezenca e UNMIK-ut, pas pavarësimit të Kosovës, përbën një pengesë serioze në shtet-ndërtimin e kësaj të fundit.

Ky qëndrim, mbase mund të konsiderohet i vërtetë. Në favor të argumentimit të këtij konstatimi, mund të fokusohemi në analizimin e atyre zhvillimeve praktike që kanë ardhur si rezultat i vazhdimit të pranisë së këtij misioni në Kosovë, nga viti 2008 e deri më sot.

Pranisë Ndërkombëtare Ushtarake, në pajtim me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, data 26 mars 2007, është autoriteti final në zonën operative për sa i përket interpretimit të atyre aspekteve të marrëveshjes së përmendur që i referohen Pranisë Ndërkombëtare Ushtarake. Asnjë autoritet i Republikës së Kosovës nuk ka jurisdikcion, të rishikojë, të pakësojë ose përndryshe të kufizojë mandatin, kompetencat dhe detyrimet e referuara në këtë nen". Shih më tej në: Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 153.

[639] Report of the Secretary-General on the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo, UN Doc. S/2008/ 692, paragraph 21, 24 November 2008.

[640] Kosovar Center for Security Studies, *Mapping the UNSCR 1244 Legacy in Post-Independence Kosovo: Between Contestation and Recognition*, Prishtinë, May 2012, p. 24.

Pavarësisht nga fakti që kapacitetet operacionale të UMIKU-t janë reduktuar me rreth 80%, prapë se prapë, UNMIK-u, përmes zyrës së tij në "Mitrovicën Veriore", ka pasur një rol mjaft aktiv në këtë pjesë të territorit të Kosovës, e banuar me shumicë serbe. Andaj, duke vazhduar me praninë e tij, veprimtaria e UNMIK-ut është shfaqur si një "politikë e pretekstit të keq", si në rrafshin e brendshëm, ashtu edhe në atë ndërkombëtar.

Për shembull, në planin e brendshëm, duke u thirrur në prezencën e UNMIK-ut dhe në Rezolutën 1244 në fuqi, Serbia dhe komuniteti serb që jeton në Kosovë, e kanë përdorur këtë prani si një pretekst për bojkotim të autoriteteve shtetërore të Kosovës dhe të EULEX-it dhe pengimin e shtrirjes së autoritetit të tyre atje. Njëkohësisht, ky insistim i serbëve, nga ana e UNMIK-ut është përdorur si pretekst për ta justifikuar ushtrimin e mandatit të tij. Në anën tjetër, në planin ndërkombëtar, kjo politikë e pretekstit, është përdorur edhe nga qendrat më të rëndësishme vendimmarrëse botërore dhe nga një numër i caktuar i shteteve.

Për shembull, bazuar në këto rrethana faktike, Sekretari Ban Ki-moon kishte hartuar një "strategji përshtatëse" për rikonfigurimin e UNMIK-ut që parashihte bartjen e përgjegjësive te EULEX-i në fushat si: policia, gjyqësia, doganat, transporti dhe infrastruktura, kufijtë, dhe kishën serbe[641]. Kjo strategji u njoh si plani "gjashtë pikësh" i Ban Ki-moon-it. Përveç kësaj, në planin ndërkombëtar, këto rrethana po ashtu janë përdorur si pretekst nga disa shtete për ta refuzuar njohjen e shtetit të Kosovës, mbi bazën e logjikës, se në Kosovë ende operon UNMIK-u si autoriteti i vetëm i njohur me Rezolutën 1244.

Në fakt, të gjitha këto zhvillime të kushtëzuara nga prezenca e UNMIK-ut, kanë përbërë një sfidë serioze për forcimin faktik dhe juridik të shtetësisë së Kosovës të pas vitit 2008. Ndoshta rasti më ekstrem ka qenë përpjekja për imponimin e planit gjashtë pikësh të Sekretarit të Përgjithshëm, i cili shikuar nga përmbajtja e tij, paraqiste një kancer për shtetin e Kosovës, duke ia mohuar kësaj të fundit atributet themelore të sovranitetit dhe shtetësisë. Në njëfarë mënyre, duke mos përfshirë as një dispozitë nga Plani i Ahtisaarit dhe Deklarata e Pavarësisë së Kosovës, ky plan e kthente pozicionin e Kosovës në periudhën e "standardeve para statusit". Andaj, me plot të drejtë, ky plan qe refuzuar nga pala kosovare. Por, pavarësisht kësaj, prezenca e UNMIK-ut e ka

[641] For more information please see General Secretary's Statement (SC 9366); http://www.un.org/News/Press/docs/2008/sc9366.doc.htm (Qasur me 22.09.2013).

dëmtuar rëndë imazhin e Kosovës në arenën ndërkombëtare. Kjo ka qenë shprehur sidomos në aspektin e pengimit të njohjeve, të cilat ishin esenciale për forcimin e subjektivitetit juridik ndërkombëtar të Kosovës. Për shembull, disa shtete të cilat nuk kanë pasur ndonjë qëndrim të qartë në raport me statusin e ri të Kosovës, mund të kenë hezituar ta bëjnë njohjen e shtetit të Kosovës, pikërisht mbi bazën e perceptimit të situatës në terren. Ato mund të kenë qenë bindur se ky territor, me një prezencë të vazhduar ndërkombëtare, më tepër mund ta ketë përçuar mesazhin e një "konflikti të ngrirë". Ky perceptim, mund të jetë i fuqishëm ende te disa shtete. Ato mund të nisen nga fakti se vetë ideja e vazhdimit të kësaj pranie ndërkombëtare në këtë territor, është si rezultat i faktit se atje ka probleme që e justifikojnë këtë prani.

Një konstatim për efektin e dëmshëm të prezencës së më tutjeshme të UNMIK-ut në Kosovë, po ashtu, e konfirmojnë edhe vetë qytetarët e Republikës së Kosovës. Për shembull, nha hulumtimet në terren, të përmendura më lartë, shihet qartë që pjesa dërmuese e qytetarëve kanë shprehur qëndrimet e tyre se prezenca e UNMIK-ut në Kosovë, edhe pas shpalljes së Pavarësisë së saj, është e dëmshme për Kosovën, sidomos në drejtim të zbehjes së imazhit të shtetësisë së saj në arenën ndërkombëtare. Për më sakt, lidhur me këto opinione, shih në figurën 20.



Këto zhvillime në raport me Kosovën, paraqesin një shembull ilustrues të asaj çka Wilén e quan "situatë paradoksale e shtetndërtimit" nga administratat ndërkombëtare,

e cila shfaqet në dy tendenca: përderisa këto administrata kontribuojnë në forcimin e shtetit në fazat fillestare; më vonë ato shndërrohen në dobësuese të këtyre shteteve[642]. Lidhur me këto tendenca, faktet flasin që UNMIK-u ndoshta paraqet rastin më tipik.

Përveç këtyre fakteve, mund të argumentohet se prezenca e mëtutjeshme e UNMIK-ut është e dëmshme për Kosovën dhe si e tillë është e panevojshme dhe e pa kuptimtë. Madje, kjo bëhet edhe më kronikë, kur kemi parasysh zhvillimet më të reja në terren e që i atribuohen përfundimit të mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës, në vjeshtë të vitit 2012[643]* dhe nënshkrimit të marrëveshjes në mes Kosovës dhe Serbisë për normalizimin e marrëdhënieve në pranverë të vitit 2013[644]. Për më tepër, këto dy ngjarje politike, do të duhej të shërbenin si rrethana dhe parakushte reale për konsolidimin e një "strategjie dalëse" të UNMIK-ut nga Kosova.

Por, pavarësisht argumenteve për pa dobishmërinë e UNMIK-ut, problemi shfaqet pikërisht te mungesa e strategjisë dalëse të këtij misioni. Zaten, mungesa e kësaj strategjie ka qenë problemi më i madh që e ka shoqëruar UNMIK-un gjatë gjithë mandatit të tij. Për më tepër, mungesa e strategjisë dalëse, si duket e ka bërë UNMIK-un një "Promete të lidhur" në Kosovë, duke bërë që ky mision të veprojë sipas logjikës "shih dhe bëj". Andaj, nëse UNMIK-u vepron sipas qasjes që Stahn e quan: "s'ka dalje pa strategji"[645], kjo do të thotë se UNMIK-u do të qëndrojë në Kosovë edhe për një kohë të pacaktuar.

Këtë situatë e ka kuptuar mjaftë qartë lidershipi kosovar, i cili ka ndërmarrë disa hapa konkret për shtyrjen e mekanizmave ndërkombëtarë në hartimin e një strategjie të qartë dalëse për UNMIK-un. Njëra ndër to, është kërkesa e Kosovës e paraqitur në

---

[642] Wilén, *Paradoxes or Strategies in International Governance?...*, 2007.

[643]* Grupi Drejtues Ndërkombëtar për Kosovën, në mbledhjen e mbajtur me 02.07.2012 vendosi që mbikëqyrja e pavarësisë së Kosovës, të përfundojë në muajin shtator të po këtij viti. Në këtë takim u tha se plani i Ahtisaarit, në bazë të të cilit është shpallur pavarësia e Kosovës, "ë*shtë zbatuar në mënyrë thelbësore dhe me këtë autorizohen hapat përfundimtarë për përmbyllje të pavarësisë së mbikëqyrur dhe mbyllje të Zyrës Civile Ndërkombëtare*", http: //www. zeriamerikes. com/content/kosove-grupi-drejtues-vendosi-te-permbylle-pavaresine-e-mbikeqyrur/1352680.html (Qasur me 23.09.20013).

[644] Shih Ligji Nr. 04/L-199, për ratifikimin e marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,191,1057 (Qasur me 23.09.2013).

[645] Stahn, *The Law and Practice of International Territorial Administration...*, p.730.

mbledhjen e Këshillit të Sigurimit, të datës 29.08.2013, ku Ministri i Punëve të Jashtme i Republikës së Kosovës shfaqi qëndrimin se:

> "Është koha që ky këshill të shqyrtojë transformimin e misionit të UNMIK-ut në një zyrë politike të OKB-së. Në këtë drejtim, funksioni më i rëndësishëm që OKB-ja mund të luajë në Kosovë është që të na mbështesë në përgatitjen tonë për anëtarësim në Kombet e Bashkuara"[646].

Që janë pjekur kushtet dhe krijuar rrethana të reja për përfundimin e mandatit të UNMIK-ut, është një fakt që nuk mohohet as nga vetë PSSP-ja aktual i UNMIK-ut Farid Zarif. Ky i fundit, duke iu përgjigjur një kërkese të serbëve të cilët kishin kërkuar nga UNMIK-u t'i organizonte zgjedhjet në komunat veriore të Kosovës, kishte deklaruar se "kjo gjë më nuk është e mundur për shkak të rrethanave të reja që mbizotërojnë në Kosovë"[647].

Atëherë, cilat janë gjasat reale që të zgjidhet problemi i përfundimit të mandatit të UNMIK-ut, përkatësisht të shfuqizohet Rezoluta 1244, në kuadër të Këshillit të Sigurimit?

Në këtë drejtim, tejkalimi i *modus vivendi*-t, të krijuar në Kosovën e pas vitit 2008, pa dyshim, përbën një çështje mjaft komplekse. Zgjidhja e këtij problemi, përmes një rezolute të re të miratuar nga Këshilli i Sigurimit, mbetet sfidë në vete, pasi që dihen mirëfilli qëndrimet e Rusisë dhe Kinës, në raport me statusin e Kosovës. Përdorimi i vetos nga këto vende për zëvendësimin e Rezolutës 1244, me një të re përbën një kërcënim real.

Por, përveç tejkalimit të *modus vivendi*-t, sfida tjetër më serioze për qeverinë e Kosovës në rrafshin e politikës së jashtme, do të mbetet anëtarësimi në OKB. Andaj, për arritjen e kësaj objektive strategjike, diplomacia kosovare duhet të punojë në dy drejtime. Në planin e brendshëm, ajo duhet ta shuajë pretekstin që justifikon prezencën e UNMIK-ut. Kjo nënkupton përfshirjen e serbëve (sidomos të pjesës veriore) në jetën institucionale dhe politike në Kosovë. Këtë objektivë, ajo duhet ta arrijë konform Marrëveshjes së 19 prillit, e cila parasheh edhe normalizimin e jetës institucionale, ku

---

[646] Zëri i Amerikës, Lajme, 29.08.2013, http://www.zeriamerikes.com/content/kosova-security-council-hoxhaj-mrkic/1739595.html (Qasur me 24.09.2013).

[647] Transcript of SRSG interview with AP Friday 23 March 2012, http://www.unmikonline.org/Pages/srsgitw_ap23032012.aspx

një integrim eventual i serbëve në institucionet e Kosovës, do të duhej të përdorej si një "strategji dalëse" për UNMIK-un. Kurse në palnin e jashtëm diplomacia kosovare do të duhej të bënte përpjekje shtesë për ta fuqizuar pozicionin e Kosovës në Këshillin e Sigurimit, lidhur me kërkesën për transformimin e mandatit të këtij misioni.

Pra, në planin e politikës së jashtme, për arritjen e këtyre objektivave, diplomacia kosovare duhet të ndjekë një strategji të matur dhe të koordinuar mirë. Këtë, ajo duhet ta bëjë sidomos me vendet e komunitetit Euro-Atlantik, në nxitjen e tyre në sponsorizimin e një rezolute të re në Këshillin e Sigurimit, e cila eventualisht do ta zëvendësonte UNMIK-un me EULEX-in. Kjo mbase është rruga e vetme që Kosova duhet ta ndjekë në realizimin e objektivave të saj.

Nga matjet e opinionit kosvarë, në anketën e zvilluar në terren, opsioni që më së shumti ka marrur mbështetjen e qytetarëve lidhur me transformimin apo mbylljen e mandatit të UNMIK-ut, ka qenë ai që mbështet anëtarësimin e Kosovës në OKB, fillimisht duke ia siguruar kësaj të fundit edhe statusin e anëtarit vëzhgues. Për më gjerësisht, shih në figurën 21.



Figura 21. Cilët nga këta skenar politik ka gjasa të jenë më real për përmbylljen e mandatit të UNMIK-ut në një periudhë afatshkurtër?

Mirëpo, kur jemi te analizimi i përpjekjeve të diplomacisë kosovare për përmbylljen e mandatit të UNMIK-ut, respektivisht tejkalimit të Rezolutës 1244, duhet pasur në konsideratë qëndrimet e pesë anëtarëve të përhershëm të Këshillit të

Sigurimit. Andaj, bazuar në qëndrimet aktuale që mbajnë këto vende, del në pah se ato janë të njëjta me qëndrimet që mbaheshin nga këto vende, edhe në vitin 1999, kur u ishte jetësuar kjo rezolutë. Por, për dallim nga viti 1999, ku ShBA-të, Franca dhe Britania e Madhe, insistonin në kalimin e kësaj rezolute e që duhej bindur Rusinë dhe Kinën, tani pikërisht treshja perëndimore pritet të insistojë në shfuqizimin e saj e që prapë duhet bindur Rusinë dhe Kinën. Kjo situatë, afirmon edhe një herë se politika ndërkombëtare, sidomos në raportin në mes shteteve të mëdha dhe të vogla, funksionon sipas parimeve të realizmit klasik. Kësaj situate, ndoshta më së miri do t'i përgjigjej thënia franceze "Sa më shumë ndryshojnë gjërat, aq më tepër mbesin të njëjta".

AKRONIMET

AER - Agjensia Europiane për Rindërtim

AQF - Autoriteti Qendror Fiskal

ATN - Administrimi Territoril Ndërkombëtar

BPK - Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës

CIVPOL - Policia Civile e UNMIK-ut

COMKFOR - Komandanti i KFOR-it

DDR - Programi për Demilitarizim, Demobilizim dhe Ri-integrim

DFS - Departamenti i Mbështetjes Fushore

DPA - Departamenti i Kombeve të Bashkuara për Çështje Politike

DPKO - Departamenti i Operacioneve Paqeruajtëse

DTI - Departamenti i Tregtisë dhe Industrisë

GJK - Institutit Gjyqësor i Kosovës

GjND - Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë

ICISS - Komisioni Ndërkombëtar për Intervenimin dhe Sovranitetin Shtetëror

ICRC - Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq

ICTY - Tribunali për Krimet në Ish-Jugosllavi

IHT -Tribuna e Lajmeve Ndërkombëtare

ILEQE - Iniciativa Ligjore e Evropës Qendrore dhe Euro-aziatike

ILO - Organizata Ndërkombëtare e Punës

IPVQ - Institucionet e Përkohëshme të Vetëqeverisjes

KEDNJ - Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut

KFOR - Forca Ndërkombëtare e Sigurisë në Kosovë

KGJPK - Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial i Kosovës

KNDCP - Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike

KPK ÇL - Këshilli i Përbashkët Konsultativ për Çështje Legjislative

KS - Këshilli i Sigurimit

KVM - Misioni Verifikues në Kosovë

LDB - Lufta e Dytë Botërore

UNMIK - Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

MTA - Marrëveshja Tekniko-Ushtarake e Kumanovës

NAC - Këshilli Atlantik i Veriut

NATO - Organizata e Traktatit Veri-Atlantik

OCHA - Zyra për Koordinimin e Çështjeve Humanitare

OJA - Organizata e Juristëve Amerikan

OJQ - Organizatat Jo Qeveritare

OKB - Organizata e Kombeve të Bashkuara

OSCE - Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

PCN - Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar

PIC - Këshilli për Implementimin e Paqes

PSUE - Përfaqësuesi Special i Unionit Evropian

RFJ- Republika Federale e Jugosllavisë

RSFJ - Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë

SHPK - Shërbimi Policor i Kosovës

TMK - Trupat e Mbrojtjes së Kosovës

TMN - Teoritë e Marrëdhënieve Ndërkombëtare

UÇK - Ushtria Çlirimtare e Kosovës

UNDP - Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara

UNTA - Administratat Transnacionale të Kombeve të Bashkuara

USAID - Prodrami për Ndihmë i Shteteve të Bashkuara të Amerikës

USM - Unioni i Serbisë dhe Malit të Zi

WFO - Organizata Botërore e Ushqimit

WFP - Programi Ndërkombëtar për Ushqim

WHO - Organizata Botërore e Shëndetit

ZCN - Zyra Civile Ndërkombëtare

ZKL - Zyra Këshilluese Ligjore e OSBE-së

PËRFUNDIME

Bazuar nga studimet e mësipërme, lidhur me zhvillimet e paraqitura këtu si "rasti i Kosovës", mund të nxirren disa përfundime që përpiqen të bëjnë konstatime mbi gjendjen reale të këtyre zhvillimeve. Kjo do të thotë se përfundimet do të jenë të asaj natyre që do të paraqiten si elemente mbështetëse dhe testuese të tezave që parashtuam në fillim të këtij studimi.

Për shembull, lidhur me tezën e parë: *"Çështjet që kanë të bëjnë me evoluimin e statusit politiko-juridik të Kosovës, ndërmjet periudhës 1912-1999, përbëjnë përpjekjet e saj për vetvendosje dhe ndërkombëtarizim të problemit",* mund të sillen konstatimet si në vijm.

Populli i Kosovës, vazhdimisht ka bërë përpjekje për t'u ndërkombëtarizuar si problem (në kuadër të forumeve më të rëndësishme ndërkombëtare), që do të duhej trajtuar dhe zgjidhur konformë standardeve dhe praktikave ndërkombëtare, duke përfshirë edhe atë të vetëvendosjes. Në këtë kontekst, popullata e Kosovës, këtë të drejtë e justifikonte mbi dy kritere themelore të parimit të vetëvendosjes. Parimi i parë, i referohej së drejtës së shumicës për të vendosur për fatin e vet, kurse i dyti i referohej faktit që Kosova ishte aneksuar njëanshëm nga Serbia me 1912, gjë që paraqiste një fakt shtesë të së drejtës për shkëputje. Por, përkundër vullnetit të popullsisë shumicë, situata e anieksimit të Kosovës nga Serbia, u njohë në të gjitha forumet që trajtuan konstelacionet e shteteve ballkanike, përfshirë këtu Konferencën e Ambasadorëve në Londër me 1913 dhe Traktatin e Varsajës me 1918. Njëkohësisht, këto forume e bënë edhe mohimin e së drejtës së shqiptarëve të Kosovës për vetëvendosje.

Përveç kësaj, e drejta për vetëvendosje për shqiptarët e Kosovës, u mohua edhe një herë gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore. Për më tepër, në vitin 1945, Jugosllavia e vendosi një administratë ushtarake në Kosovë. Kjo ndodhi saktësisht kur Fuqitë e Mëdha në Jaltë ishin duke i ndarë sferat e tyre të interesit, dhe udhëheqësit jugosllavë krijuan rrethana të tilla që çështja e vetëvendosjes për shqiptarët të mos bëhej pjesë e agjendave punuese të këtyre fuqive. Në vazhdën e kësaj politike, e drejta e Kosovës për vetëvendosje u mohua prerazi edhe në Komisionin e Arbitrazhit të Konferencës së Paqes për Jugosllavinë, e që i referohet qasjes selektive të parimit *utti posidetis*, të aplikuar nga ky komision. Por, neglizhimi i ndërkombëtarizimit dhe zgjidhjes së problemit të Kosovës, vazhdoi edhe më tej. Në vitin 1995, marrëveshja e Dejtonit e

njohu Jugosllavinë e re (RFJ), e përbërë nga Serbia dhe Mali i Zi, duke e lënë edhe Kosovën si pjesë përbërëse e këtij entiteti. Kjo situatë bëri që një pjesë e akterëve politikë të Kosovës, t'a ndërronin strategjinë e veprimit përkitazi me ndërkombëtarizimin më efikas të problemit të Kosovës.

Të gjitha këto zhvillime në lidhje me Kosovën, shikuar në prizmin e hipotezës së parë, argumentojnë që problemi më i madh në teorinë e së drejtës për vetëvendosje është interpretimi dhe justifikimi i saj. Ndoshta rasti i Kosovës e paraqet më së miri natyrën kontradiktore të përmbajtjes së parimeve që proklamon e drejta për vetëvendosje. Kosova ka nxjerr në pah, më mirë se çdo rast tjetër, të metat e këtij parimi që d.m.th, tregon për natyrën organike-pluraliste të tij. Kjo do të thotë se të gjitha forumet që thirreshin në të drejtën e vetëvendosjes, u bënë pikërisht mohuesit e kësaj të drejte për Kosovën.

Kur jemi te testimi i hipotezës së dytë: *"Ndërkombëtarizimi i problemit të Kosovës lidhet direkt me ndërhyrjen ushtarake të NATO-s me 1999 në Kosovë"*, mund të nxirren një sërë përfundimesh mjaft specifike.

Nga sa u tha më lartë, u vërejt se rasti i Kosovës ishte një ngjarje tejet problematike dhe e komplikuar, madje më e komplikuara në kohët e fundit, e cila shumë herë u paraqit si një sfidë e rëndë për bashkësinë ndërkombëtare. Ishin pikërisht këto zhvillime dramatike ato që e bënë rastin e Kosovës të quhej "fundi i shekullit", në kuptimin që shënoi ngjarjen më dramatike të fundshekullit XX-të, dhe fillimin e shekullit XXI dhe që nxiti shfaqjen e një sërë zhvillimesh praktike të cilat ndikuan direkt në transformimin dhe krijimin e disa normave dhe doktrinave tjera të reja të së drejtës dhe marrëdhënieve ndërkombëtare.

Duke patur parasysh shpjegimet që u ofruan për rastin e Kosovës nga teoritë pozitiviste, u vërejt se në një farë mënyre, zhvillimet politike që ndodhën në Kosovë kishin pak a shumë karakter objektiv. Kështuqë, teoria realiste arriti të paraqesë një pjesë të konsiderueshme të këtij realiteti objektiv, sidomos në konsideratat që ajo i bënë luftës dhe rolit të përdorimit të forcës si faktorë të natyrshëm të sistemit anarkik ndërkombëtar. Njëkohësisht, realizmi argumentoi se ishte pikërisht forca ajo e cila e mundi dhe e ndali luftën, duke dëshmuar kështu për rolin dhe karakterin e saj si me bazë të dhënë. Poashtu, shikuar vështrimet realiste lidhur me rastin e Kosovës, mund të përfundojmë se ishte rasti i Kosovës ai që dëshmoi se fenomeni i forcës do ta karakterizojë përherë sistemin ndërkombëtar, dhe se gjithëherë do të ketë nevojë për përdorimin e forcës në mënyrë që të mund të vihen gjërat nën kontrollë.

Në anën tjetër, po ashtu mund të konkludohet se teoria liberale, edhe pse teori pozitiviste, zhvillimet lidhur me rastin e Kosovës i shpjegon ndryshe. Për shembull, liberalizmi e merr gjendjen e paqes, dhe jo të luftës, si me bazë natyrore, dhe luftën në Kosovë e shpjegon si një të keqe dhe devijim nga gjendja e dhënë e paqes. Dhe për më tej, liberalizmi argumenton se me vetë faktin e interesimit të bashkësisë ndërkombëtare për ta ndalur luftën dhe për t'i mbrojtur jetërat e njerëzve, dështmohet se ekziston një vullnet i përgjithshëm në këtë drejtim. Liberalët konkludojnë se rasti i Kosovës dha një mesazh të qartë për emancipimin e ndërgjegjës njerëzore dhe për gatitshmërinë e komunitetit nërkombëtar për të reaguar në mbrojtjen e dinjitetit njerëzor, kudo dhe kurdo që e kërkon nevoja.

Po ashtu mund të nxirren përfundime edhe sa i përket çështjeve që analizohen nga grupi i teorive postpoziviste të Marrëdhënieve Ndërkombëtare lidhur me rastin e Kosovës. Një konkludim ka të bëjë me vetë faktin që edhe vetë teoritë pozitiviste kanë divergjenca të thella rreth mënyrës së shpjegimit të zhvillimeve të rastit të Kosovës. Ky fakt, konkludojnë postpozitivistët, tregon nevojën e domosdoshme që ngjarja unikale e rastit të Kosovës të studiohet edhe nga teoritë e tjera. Dhe me vetë faktin që ngjarja ishte unikale, tregon për karakterin e saj konstruktues, e jo si me bazë të dhënë, gjë të cilën e mbronin pozitivistët.

Konkludimi më i qëndrueshëm për teoricientët kritikë, në lidhje me rastin e Kosovës, mbetet fakti që ky rast tregoi për disa dobësi të sistemit ndërkombëtar në trajtimin unik të çështjeve më të ndjeshme, dhe se njëherit ngriti sheshazi nevojën e domosdoshme për emancipimin e politikave vepruese të komunitetit ndërkombëtar. Pastaj u vërejt se teoria kritike ndërkombëtare nuk pajtohet aspak me mënyrën e tanishme të organizimit dhe funksionimit të sistemit ndërkombëtar. Sipas tyre, rasti i Kosovës, në disa drejtime, dështmoi për mungesën e një solidarizmi të mirëfilltë në marrëdhëniet ndërkombëtare, dhe që tregoi se duhet mbështetur më tepër në politika emancipuese.

Një përfundim nga i gjithë debati i zhvilluar deri tani, në kuadër të tri përspektivave teorike, lidhur me shpjegimet që sollën rreth kontekstit të përdorimit të forcës dhe të ndërhyrjes ushtarake, do të mund të ishte si vijon: Esenca e debatit, pak a shumë është fikusuar në atë, nëse përdorimi i kësaj force ka qenë ndërkombëtarisht dhe juridikisht e ligjshme. Kritikët për shembull janë fokusuar te fakti që ndërhyrja ushtarake e NATO-s nuk ka qenë e autorizuar me një rezolutë nga Këshilli i Sigurimit, gjë që është përceptur si cënim dhe anashkalim i Kartës së OKB-së. Në anën tjetër,

përkrahësit e ndërhyrjes argumentojnë se pavarësisht kësaj, kjo ndërhyrje nuk ka qenë jashta sferës të së drejtës ndërkombëtare. Në lidhje me këtë, ata këtë aksion e justifikojnë me faktin që në atë kohë, për shkak të raportit kundërthënës të forcave në Këshillin e Sigurimit, një rezolutë e Këshillit të Sigurimit nuk do të mund të ofronte mbulesë pasiqë ajo nuk do të mund të arrihej në saje të këtij raporti. Andaj një alternativë do të duhej të gjindej ndoshta te e drejta e intervenimit humanitar sipas së drejtës ndërkombëtare zakonore!

Ky argument, nuk sugjeron se ndërhyrja humanitare jashtë akomodimit të Kartës së OKB-së (d.m.th, e pa autorizuar nga Këshilli i Sigurimit nën Kapitullin VII) është *lex lata*, por ndoshta kjo është *lex ferenda*. Në këtë kontekst, intervenimi i NATO-s mund të ketë hedhur një themel për zhvillimin e një rregulli zakonor të ri të intervenimit humanitar, pa një rezolutë eksplicite të Këshillit të Sigurimit, konform Kapitullit VII. Por, kjo nuk ishte as një rregullë me bazë zakonore në kohën e ndërhyrjes, as nuk krijoi një rregullë të tillë. Sido që të jetë, ndërhyrja e NATO-s solli një fund të katastrofës humanitare në Kosovë.

Lidhur me procesin e menaxhimit dhe përfundimit të konfliktit të vitit 1999 në Kosovë, mund të nxirret një konstatim që tregon se ky proces ka qenë i drejtuar nga parime politike, por që ka përfunduar konform parimeve juridike. Për shembull, i gjithë procesi i ndërmarrur nga bashkësia ndërkombëtare për menaxhimin dhe zgjidhjen e krizës u bën në kuadër të qarqeve të ngushta diplomatike, (Konferenca e Rambujesë, Quint-i, NATO), por që u kurorëzuan në fund brenda kornizave të OKB-së, përkatësisht Rezolutës 1244.

Sa i përket analizimit të doktrinës së administrimit territorial të OKB-së dhe misioneve të saj paqeruajtëse, u vërejt se të gjitha operacionet e ndërmarrura, pavarësisht prej modelit dhe mandatit, shënuan një përpjekje serioze dhe njëkohësisht sfiduese të OKB-së në ndërtimin e një ambienti ndërkombëtar më paqësor.

Që nga viti 1948, sistemi paqeruajtës i OKB-së ka kontribuar në parandalimin dhe menaxhimin e konflikteve të dhunshme në mes dhe brenda shteteve, si dhe në mbështetjen e akterëve kombëtarë në mbrojtjen dhe ndërtimin e paqes pas konflikteve. Pra, e vetëdijshme për rëndësinë e këtij ambienti, OKB-ja megjithëkëtë, përveç operacioneve paqëruajtëse, ndërmori edhe një sërë masash dhe aktivitetesh të cilat kanë kontribuar fuqishëm në filozofinë e paqëruajtjes ndërkombëtare. Këto masa u realizuan në saje të përpjekjeve për reforma në kuadër të sistemit të paqëruajtjes. Këto reforma, si elemente funksionale, ndikuan më vonë në një transformim që u shfaq si

proces. Kjo erdhi si rezultat i kundërpërgjigjjes ndaj formave të reja të konflikteve dhe kërcënimeve të paqes, të cilat nuk mund të sanoheshin në kuadër të masave si monitorimi dhe sigurimi i një kufiri midis palëve ndërluftuese, që ishin tipike me operacionet e paqeruajtjes klasike apo tradicionale. Tanimë, për të siguruar paqe më të qëndrueshme në një mjedis kaq kompleks, ishte e nevojshme ndërmarrja e një sërë masash shumëdimensionale në përpjekje për ta arritur këtë objektivë.

Siç kemi mundur të vërejmë nga shtjellimet përgjatë këtij studimi, pavarësisht faktit që qëllimet dhe struktura institucionale e Kombeve të Bashkuara mbetet po ajo që ka qenë në fillim, megjithëkëtë, orientimet e saj lidhur me filozofinë paqeruajtëse kanë evoluar në një shkallë mjaft dinamike dhe të thellë. Përgjatë viteve të fundit, OKB-ja ka pësuar një sërë reformash sasiore dhe cilësore në sistemin e operacioneve të saj të paqes. Ndryshimet kanë ardhur si rezultat i ndërrimit të vetë natyrës së normave dhe praktikave në sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare.

Siç u vërejt, së bashku me ndërrimin e konstelacionit të politikës botërore, ka ndërruar edhe natyra e konflikteve ndërkombëtare. Si rrjedhojë, janë shfaqur situata konfliktuale unike dhe sfiduese për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare, duke e obliguar OKB-në, qoftë deklaruar apo jo, të ndërmarrë masa kompatibile me natyrën e këtyre konflikteve. Në këtë drejtim, për t'iu përshtatur natyrës së zhvillimeve të kërcënimeve të reja ndaj paqes, OKB-ja mori një sërë reformash transformuese me qëllim që të krijonte një koherencë dhe efikasitet më të lartë brenda radhëve të veta, në mënyrë që t'u përgjigjej në mënyrë sa më efektive këtyre sfidave kërcënuese. Në këtë plan kanë qenë ndërmarrë masa edhe lidhur me zgjerimin e qasjeve për krijimin e kushteve për ndërtimin e një paqeje më të qëndrueshme. Si pasojë, disa misione të reja të OKB-s, morën karakter unik, duke tejkaluar autorizimet klasike të fokusuara vetëm në paqëruajtje dhe monitorim, dhe që tani ato u bënë shumë më komplekse dhe të përgjegjshme. Shkalla më e lartë e përgjegjësive të tyre, mbërriti deri atje sa ato filluan të ushtronin kompetenca tipike klasike të një shteti sovran. Rasti më tipik i këtyre misioneve ishte ai i UNMIK-ut dhe i UNTAET-it. Në kuadër të këtyre dy misioneve, edhe pse shprehur jo qartë, administratat ndërkombëtare implementuan një mandat të dyfishtë; duke ushtruar atribute të një qeverie dhe shteti, dhe njëkohësisht duke kontribuar në ndërtimin e kapaciteteve shtendërtuese moderne.

Analizimi i specifikave rreth instalimit dhe funksionalizimit të UNMIK-ut, mundëson të bëhen disa konstatime, përmes të cilave bëhet testimi dhe argumentimi i

hipotezës së tretë: *"Kosova paraqet fenomenin e territorit të ndërkombëtarizuar me vendosjen e saj nën administrimin e UNMIK-ut: 1999-2008".*

Shikuar nga një këndvështrim i përgjithshëm, UNMIK-u paraqitet si rasti më unik në historinë e misioneve paqeruajtëse. Për shkak të natyrës së tij specifike, UNMIK-u ka promovuar praktikën më të re ku administratat ndërkombëtare, të vendosura në shoqëritë post-konfliktuale, marrin autorizime të gjera tipike me ato të një shteti modern. Kjo praktikë ka krijuar të ashtuquajturin fenomen të "territorit të ndërkombëtarizuar". Madje në kontekstin e administrimit territorial të Kosovës nga UNMIK-u, ky fenomen, sikur ishte sanksionuar edhe në vetë Rezolutën 1244. Vetë ideja e mandatit të UNMIK-ut, për ta promovuar *de facto* një autonomi substanciale për Kosovën, për *de jure* në kuadër të sovranitetit të Jugosllavisë, e kishte përcaktuar pozitën juridike të Kosovës si një territor nën administrimin e përkohshëm ndërkombëtar. Kjo ka bërë që statusi i ardhshëm i Kosovës të mbetej i paqartë për një kohë të pacaktuar.

Për shkak të natyrës unike, UNMIK-u, poashtu krijoi edhe një strukturë dhe plan unik për t'i implementuar objektivat e veta. Disa nga këto objektiva duheshin arritur në planin afatshkurtër, pra i referoheshin sanimit imediat të situatës humanitare; kurse disa të tjera kishin të bënin më tepër me menaxhimin e situatës së sanuar dhe duhej të arriheshin në një plan pak më afatgjatë. Natyra e objektivave që duhej t'i përmbushte UNMIK-u, i kanë dhënë atij një mandat me natyrë të dyfishtë. Njëkohësisht ai ka ushtruar autorizime mjaft të gjera, tipike me rolet e një qeverie; krahas funksioneve që ka luajtur në konsolidimin e elementeve shtetërore për Kosovën, duke u shfaqur si një agjent shtet-ndërtues.

Praktikat qeverisëse të UNIMK-ut në Kosovën e pasluftës, sidomos në fazën emergjente, kanë promovuar një shembull unik të përfshirjes së administratave ndërkombëtare në përmbushjen e detyrave *de facto* të një qeverie të shtetit. Për ta përmbushur këtë mandat, në kontekstin e Kosovës, bashkësia ndërkombëtare ia kishte atribuuar UNMIK-ut një shkallë shumë të gjerë të autorizimeve administrative të cilat i realizojnë si të përqendruara.

Në rastin e administrimit të Kosovës nga UNMIK-u, këto autorizime iu veshën PSSP-së dhe u ushtruan prej tij mbi bazën e parimit pretendues. Ndonëse kjo mund të ketë qenë një strategji efikase në planin emergjent afatshkurtër; në planin afatgjatë është vërejtur se kjo qasje krijoi një tendosje të thellë te akterët lokal, të cilët më vonë e vënë në pikëpyetje komplet legjitimitetin e autoritetit të kësaj administrate. Këtë

problem e ka ndeshur UNMIK-u menjëherë pas vendosjes së tij. Si rezultat i kësaj, ai ka filluar ta aplikojë strategjinë e transferimit progresiv të autoritetit të tij drejt strukturave lokale, por duke e ruajtur njëkohësisht primatin e pushtetit për vetën e tij. Këtë strategji, UNMIK-u e realizoi kryesisht në tri faza të ndara.

Një problem që e ka përcjellur procesin e transferimit të kompetencave nga UNMIK-u drejt IPVQ-ve, ka qenë ai i mos definimit të një afati kohor, gjë që shkaktonte tensione të vazhdueshme në mes të këtyre dy autoriteteve qeverisëse. Këto tensione kanë qenë të dëmshme për komplet procesin e demokratizimit dhe legjitimitetin e bashkëqeverisjes në sytë e opinionit kosovar. Kjo ngase, legjitimiteti i UNMIKU-t dëmtohej në saje të justifikimeve që vinin nga IPVQ-të, se ato "nuk mund të bënin më tepër" edhe pse po bënin presion të vazhdueshëm për të zhgarkuar kompetenca nga UNMIK-u sa më shumë që ishte e mundur.

Problemi më i theksuar, megjithatë, është paraqitur në paqartësinë e strategjive të tij për zgjidhjen e problemeve vitale të përditshmërisë së shoqërisë kosovare, dhe në atë më të rëndësishmin, paqartësinë e strategjisë për ta zgjidhur statusin final të vendit, e cila do të shërbente si një strategji dalëse. Rrjedhimisht, kjo paqartësi u konstatua se prodhoi një frustrim dhe pakënaqësi në sytë e opinionit kosovar, gjë që e shtyu atë në përdorimin e rrugëve më ekstreme për të reaguar ndaj mënyrës së qeverisjes së administratës ndërkombëtare në vend. Kjo gjë bëri që çështja e legjitimitetit të UNMIK-ut të vihej në një dilemë serioze, duke u bërë shkaku kryesor i ndasive dhe i mos bashkëpunimit në mes të autoriteteve lokale dhe ndërkombëtare.

Konstatimet në vijim shkojnë në mbështetje të hipotezës së katërt se: "*Përmes ushtrimit të autoritetit të gjerë qeverisës, UNMIK-u në Kosovë është shfaqur si një agjent shtetndërtues".*

Nga shtjellimet e mësipërme lidhur me përpjekjet për ndërtimin e komponentëve shtetndërtues në Kosovë, mund të nxirren disa përfundime specifike. Së pari, komplet qasja e UNMIK-ut e aplikuar në realizimin e këtij procesi, ka qenë unike në krahasim me praktikat e tjera të shtetndërtimit ndërkombëtar. Meqenëse shtetndërtimi në rastin e Kosovës u realizua në kuadër të një sërë rrethanash shumë specifike, bëri që Kosova të jetë një praktikë unike në këtë drejtim. Kjo natyrë unike ka bërë që të ndiqen edhe strategji më specifike shtetndërtuese, duke aplikuar edhe qasje të tilla që kanë shkuar gjithnjë e më tepër larg çdo praktike standarde shtetndërtuese.

Përveç kësaj, mund të adresohet një problem gjeneral që e ka përshkuar këtë proces! Pa dyshim, ai i atriduohej paqartësisë së statusit final të Kosovës. Mirëpo, ky

problem në sferat që nuk ishin peng i paqartësisë së statusit final, e ka reflektuar më pak ndikimin e tij. Andaj, UNMIK-u, së bashku edhe me IPVQ-të, treguan një efikasitet më të madh në konsolidimin e atyre komponentëve që ishin si pjesë e mandatit të tij të qartë. Para së gjithash, këto i referohen komponentës së sigurisë dhe asaj institucionale.

Mirëpo, pavarësisht suksesit më të dukshëm të UNMIK-ut në ngritjen e kapaciteteve institucionale dhe vetëqeverisëse, edhe brenda këtij sektori ka pasur të meta të konsiderueshme. Gjithsesi, kjo ka qenë kushtëzuar nga paqartësia e statusit të ardhshëm të vendit. Kjo situatë ka krijuar të meta serioze në socializimin politik dhe proceset e kulturës qytetare të ndërtimit të identitetit politik.

Megjithëkëtë, paqartësia e statusit final, në një formë disi më të theksuar, ka qenë prezente në përpjekjet e UNMIK-ut dhe IPVQ-ve për konsolodimin e komponentës së rendit dhe drejtësisë. Por, përveç kësaj, reflektimi negativ i çështjes së statusit ishte akut në ndikimin e tij në çështjet që kishin të bënin me komponentët e rindërtimit dhe zhvillimit ekonomik. Treguesi më i saktë i mos efikasitetit të UNMIK-ut në raport me konsolidimin e këtyre dy komponentëve, ndoshta mund të jetë gjendja reale në terren. Sot, edhe pas pavarësimit, problemet më të rënda që e pllakosin shtetësinë e Kosovës, janë ato që lidhen me brishtësinë e sektorit të rendit dhe drejtësisë, në njërën anë, dhe stagnimit zhvillimor ekonomik, në anën tjetër.

Poashtu, mbetja e zgjidhjes së statusit final të Kosovës si çështje e hapur, kishte implikime të drejtpërdrejta për veprimtarinë rindërtuese dhe zhvillimore të UNMIK-ut. Ky problem, kishte kompromentuar perspektivat e progresit politik dhe ekonomik. Përveç kësaj, paqartësia e statusit politik të Kosovës, u bë pengesë serioze për këtë të fundit, për të qenë pjesë e institucioneve financiare ndërkombëtare, apo që të tërhiqte investimet e huaja. Kostoja e këtij hendikepi politik dhe ekonomik u bë edhe më alarmante, sidomos kur dihet rendësia e këtyre faktorëve në nxitjen e punësimit dhe zvogëlimin e varfërisë. Kështuqë zgjatja e *status quo*-së, u bë një sfidë vendimtare për UNMIK-un dhe IPVQ-të, drejt zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm për Kosovën.

Lidhur me politikat e UNMIK-ut për zhvillimin ekonomik të Kosovës, mund të konstatohet se ato kanë qenë më tepër të një natyre "infuzioniste". Këto politika kanë qenë të orientuara më tepër drejt rindërtimit sesa drejt krijimit të një baze për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm. Andaj, bazuar në këto politika të UNMIK-ut, mund të vlerësojmë se i vetmi komponent zhvillimor i ekonomisë kosovare, ka qenë rindërtimi, pra "rindërtimi si zhvillim".

Disa konstatime që mund të nxirren në lidhje me procesin e zgjidhjes së statusit të Kosovës, përbëjnë një çështje mjaft delikate. Ato u referohen karakteristikave që e kanë përcjellur këtë proces si dhe rrethanave të krijuara nga zhvillimi i tij.

Shikuar nga këndi se cilat kanë qenë parimet që e kanë formësuar dhe drejtuar procesin e zgjidhjes së statusit të Kosovës, mund të konstatohet se ky proces ka qenë i përshkruar nga një ndërrim i rolit në mes parimeve politike dhe juridike. Edhe pse komplet ky proces ka qenë përshkruar nga parimet juridike, d.m.th, brenda kornizave të Rezolutës 1244, prapë se prapë, ai përfundoi jashtë formatit të OKB-së, pra, në qarqe të ngushta politike (si Grupi i Kontaktit), dhe i dominuar nga parimet politike.

Politika e UNMIK-ut e "standardeve para statusit" të vitit 2002, shikuar nga mënyra se si e procedonte çështjen e zgjidhjes së statusit të Kosovës, ishte totalisht me "karakter kushtëzues". Kjo politikë, më vonë, përmes qasjes "standardet dhe statusi", mori disi një "karakter stimulues", për të kaluar te një politikë me "karakter ndërmjetësues". Por, megjithë karakterin e saj të trefishtë, roli i UNMIK-ut rezultoi të jetë vetëm lehtësues në këtë proces.

Edhe pse sipas Rezolutës 1244, çështja e zgjidhjes së statusit parashihej të arrihej brenda konditave të OKB-së, procesi për zgjidhjen e statusit përfshinte më shumë se OKB-në. Në fakt, në këtë proces u përfshinë qendrat kryesore vendimmarrëse në politikën botërore (Grupi i Kontaktit i zgjeruar), gjë që tregoi edhe një herë për natyrën komplekse të problemit të Kosovës. Në të vërtetë, çështja e definimit të statusit të Kosovës pas shtatë viteve të administrimit të saj nga UNMIK-u, u bë një shkaktar i përplasjes së pesë fuqive më të mëdha vendimmarrëse. Kjo çështje, në fakt, sikur i riaktualizoi ndarjet ideologjike të Luftës së Ftohtë në radhët e anëtarëve të Këshillit të Sigurimit.

Shikuar në planin makro të politikës ndërkombëtare, qasja që ka mbajtur Rusia në raport me Kosovën, ka përbërë një pengesë shumë më të rëndë se sa vetë Serbia. Si gjatë konfliktit të vitit 1999, ashtu edhe gjatë zgjidhjes së statusit final, pozicioni rus u bë problem kronik në konsolidimin e shtetit të Kosovës. Edhe sot, Rusia përbën pengesën kryesore për anëtarësimin e Kosovës në OKB dhe mekanizma tjerë bashkëpunues. Krejt kjo fuqi e Rusisë, sigurisht, i atribuohet pozitës së saj në Këshillin e Sigurimit dhe sidomos të drejtës së saj për veto. Ky fakt, siç dihet, bëri që statusi i Kosovës të rrëshqasë nga një zgjidhje në kuadër të parimeve të së drejtës ndërkombëtare, në një zgjidhje alternative përmes parimeve të politikës ndërkombëtare.

Megjithëse nuk solli rezultatet e pritshme, procesi politik për zgjidhjen e statusit të Kosovës, sidoqoftë, shënon një hap të rëndësishëm në lidhje me definimin e këtij statusi dhe shtetndërtimit në Kosovë. Atributet kryesore të tij kanë qenë të shprehura në formën që ai në fund të fundit ofroi një propozim për zgjidhje. Ndonëse ky propozim nuk u miratua nga Serbia dhe Rusia, megjithëkëtë, ai prodhoi një zgjidhje në terren. Siç dihet, konformë propozimit të Ahtisarit, u miratua deklarata e pavarësisë dhe kushtetuta e Republikës së Kosovës, të cilat paraqesin themelet e shtetësisë së Kosovës.

Madje, përveç kësaj, mund të konstatohet se procesi politik i zgjidhjes së statusit të Kosovës, ka patur një rol të konsiderueshëm edhe në procesin e shtetndërtimit në Kosovë. Ky rol ka qenë me natyrë indirekte. Për shembull, përmbushja e disa standardeve nga IPVQ-të, gjatë procesit të zgjidhjes së statusit, e që binin në fushat e ngritjes së kapaciteteve vetëqeverisëse, ka qenë kontributi më i rëndësishëm në këtë plan. Kjo ngase, pikërisht nga këto institucione u bë inaugurimi i bazës juridike dhe empirike të shtetësisë së Kosovës. Këto konstatime e mbrojnë tezën e pestë se *"Procesi i zgjidhjes së statusit të Kosovës përbën hapin konkretizues (por jo përmbyllës) të shtetndërtimit ndërkombëtar në Kosovë"*.

Procesi i vazhdimit të shtetndërtimit në Kosovë vazhdoi edhe pas pavarësimit. Në këtë rrugë gjysmë dekadëshe që prej deklarimit të pavarësisë së saj, Kosova ka tentuar t'i përmbushë dy rrugë madhore: E para: Kosova ka arritur ta forcoi subjektivitetin e saj ndërkombëtar gradualisht; E dyta: edhe pse deri tani me një lloj të "pavarësisë së kushtëzuar" nga një monitorim ndërkombëtar, dhe e njohur nga më shumë se gjysma e shteteve të botës, megjithatë Kosova po bënë përpjekje të vazhdueshme për funksionalizimin e institucioneve si komponentja kryesore shtetndërtuese.

Në fakt, këto dy punë e kanë kushtëzuar njëra-tjetrën në kuptimin që kanë ndikuar në efikasitetin, përkatësisht në degradimin e procesit përkatës. Megjithatë, më i theksuar ka qenë ndikimi i pozitës së saj ndërkombëtare mbi atë shtetndërtuese. Këtu mendohet për pengesat që ka sjell fakti i mos njohjes nga një pjesë e konsiderueshme e shteteve, veçanërisht nga disa vende anëtare të UE-së, duke e zbehur në disa drejtime fuqinë e subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës. Mirëpo, sidoqoftë, Kosova funksionon si shtet, duke i dhënë një argument shtesë shkollës natyraliste të së drejtës ndërkombëtare se ekzistenca e shtetit është më tepër çështje faktike se sa juridike. Është kështu sepse, pavarësisht që Kosova nuk siguroi njohje të mjaftueshme për

anëtarësim në OKB, prapë se prapë, ajo u bë anëtare e disa mekanizmave global të fuqishëm falë mbështetjes nga shtetet më të fuqishme.

Kjo çështje riafirmoi edhe një herë faktin se në trajtimin e problemit të Kosovës nga bashkësia ndërkombëtare, dominuese, ka qenë gjuha e marrëdhënieve ndërkombëtare ndaj asaj të së drejtës ndërkombëtare. Kjo gjë u vërejt edhe në planin integrues të Kosovës në mekanizmat rajonal dhe global. Për pesë vite, Kosova u bë anëtare e forumeve kryesore globale si: Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore, e poashtu edhe e disa mekanizmave rajonalë si CEFTA dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Kjo praktikë, argumetoi se, pavarësisht që Kosova po e konsolidonte identitetin e saj prej sovrani, ajo kohë pas kohe, duke u bërë pjesë e këtyre strukturave integruese e barti një pjesë të këtij sovraniteti të saj.

Së fundmi, suksesi më i madh në këto dy rrugë, është që Kosova arriti të dëshmojë se ky shtet paraqet një faktor sigurie dhe stabiliteti, si në planin e brendshëm ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Kjo do të thotë se Kosova, marrë në përgjithësi, paraqet një storie suksesi, apo për ta përmbyllur me një thënie diplomatike, “në Kosovë është bërë shumë, por, akoma ka mbetur shumë për t’u bërë”.

BURIMET DHE LITERATURA

Burime primare:

Anketimi dhe vlerësimi i opinionit të shoqërisë kosovare lidhur me veprimtarinë e UNMIK-ut në Kosovë: 1999-2008 (209 të anketuar me 22 mostra).

Intervista dhe konsultime me njohës dhe udhëheqës të proceseve politike në Kosovë të lidhura me veprimtarinë e UNMIK-ut:1999-2008.

Burime sekondare:

Studime dhe Analiza

1. **A New Partnership Agenda** Charting a New Horizon for UN Peacekeeping, Department of Peacekeeping Operations and Department of Field Support, New York, July 2009.
2. **Abaz Lleshi**, *Gjeopolitika e Ballkanit dhe perspektivat e sigurisë në rajon*, "GEER", Tiranë, 2009.
3. **Achim Wennmann**, *Grasping the Strengths of Fragile States: Aid Effectiveness Between 'Top-down' and 'Bottom-up' Statebuilding*, Centre on Conflict, Development and Peacebuilding (CCDP), 2010.
4. **Adam Day**, *No Exit Without Judicary: Learning a Lesson from UNMIK's Transitional Adminstration in Kosovo*, Wisconsin International Law Journal Vol. 23, No. 2, 2006.
5. **Adam Roberts**, *What is a Military Occupation?*, British Year Book of International Law, 55, 1984.
6. Agreement between the Republic of Indonesia and the Kingdom of the Netherlands concerning West New Guinea (West Irian), arts IV to VI, see Annex of the contribution of D. Gruss, in this Volume and A/RES/1752 (XVII) of 21 September 1962.
7. **Ahmet Davutoglu**, *Thellësia strategjike, Pozita ndërkombëtare e Turqisë*, LOGOS-A, Shkup, 2010.
8. **Aidan Hehir**, *Humanitarian Intervention after Kosovo: Iraq, Darfur and the Record of Global Civil Society*, Palgrave Macmillan, 2008.
9. **Aidan Hehir & Neil Robinson**, *State-Building theory and practice*, Routledge, 2007.

10. **Alan Whaites**, *States in Development: Understanding State-building*, Governance and Social Development Group Policy and Research Division, 2008.
11. **Alan Collins**, *Studime Bashkëkohore të sigurisë*, EUT Press, Tiranë 2010.
12. **Albrecht Schnabel and Ramesh Thakur** (eds.), *Kosovo and the Challenge of Humanitaraian Intervention:* Selective Indignation, Collective Action, and International Citizenchip, United Nations University Press, Tokyo, New York, Paris, 2000.
13. **Aleksandër Kocani**, *Metodat e Kërkimit në Shkencat Sociale (Cikël leksionesh)*, UFO University Press, Tiranë, 2006.
14. **Michael Waller, Kyril Drezov and Buulent Gokay** (eds.), *Kosovo: The Politics of Delusion,* edited by, London; Portland, OR: Frank Cass, 2001.
15. **Alexander Wendt**, *Anarchy is What States Make of It: The Social Construction of Power Politics*, International Organization, Vol. 46, No. 2, 1992.
16. **Alexander Wendt**, Social Theory of International Politics, Cambridge University Press, 1999.
17. **Alexandros Yanis**, *The UN as Government in Kosovo*, Global Governance 10, 2004.
18. **Alina Menocal**, *State Building for Peace: a new paradigm for international engagement in post-conflict fragile states?*', *Third World Quarterly*, 32 (10), 2011.
19. **Gabriel Almond & Sidney Verba**: The Civic Culture Revised. Sage Publications 1989.
20. **Andew Heywood**: *Politics,* Third edition Palgrave McMillan 2007.
21. **Andreas Zimmermann and Carsten Stahn**, *Yugoslav Territory, United Nations Trusteeship or Sovereign State? Reflections on the Current and Future Legal Status of Kosovo*, in: Nordic Journal of International Law, 70/2001.
22. **Antonia Zervaki**, *UN at crossroad: International Administration of Territories and Domestic Political Culture, The Kosovo and East Timo Experience*, University of Peloponnese, 2008.

23. **Antonia Zervaki**, "UN at crossroad: International Administration of Territories and Domestic Political Culture, The Kosovo and East Timor Experience", *UNISCI Discussion Papers* 18 (2008).

24. **Arsim Bajrami**, *E Drejta e Kosovës në Tranzicion*, Prishtinë 2002.
25. **Arsim Bajrami**, *Sistemi Kushtetues i Republikës së Kosovës,* FAMA, Prishtinë, 2011.
26. **Bardhok Bashota**, *The role of theory of international relations in explicating global political events,* Iliria International Review, Felix–Verlag, Holzkirchen, Germany and Iliria College, Pristina, Kosovo, 2011/1.
27. **Barry Buzan**, *From International to World Society*? English Scool Theory and the Social Structure of Globalisation, Published by Cambridge University Press, 2004.
28. **Barry R. Posen**, *The Security Dilemma and Ethnic Conflict*, Survival 35(1), Spring 1993, 27-47.
29. **Bashkim Rama**, *Faktori shqiptar dhe siguria rajonale*, GEER, Tiranë 2011.

30. **Bekim Baliqi**, "Externes State-Building durch die Vereinten Nationen: Am Fallbeispiel des Kosovo", PhD. Diss., Wien, im August 2008.

31. **Bernhard Knoll**, *From Benchmarking to Final Status? Kosovo and The Problem of an International Administration's Open-Ended Mandate,* The European Journal of International Law Vol. 16 no.4, EJIL, 2005, p. 652.

32. **Bernhard Knoll**, *Legitimacy and UN Administration of Territory,* Journal of International Law & Policy, Vol. IV, 2007.
33. **Bernhard Knoll**, *The Kosovo Status Process and the Prospect of Sovereignty,* OSCE Yearbook, 2008.

34. **Blerim Reka**, *E Drejta e Unionit Evropian,* Instituti i Kosovës për Integrime Euro-Atlantike (KIEAI), Prishtinë, 2000.
35. **Blerim Reka**, *New Legislation in Post War Kosova: The sui generis Model of National and International Co-Participation on the Exercise of Soveregnity,* Kosova Law Riview, Vol, IV, no.4, 1999.
36. **Blerim Reka**, *The Geopolitics and Techniques of EU Enlargement,* ASPECT, Brussels, 2010.

37. **Blerim Reka**, *UNMIK as an international governance in post-war Kosova: NATO's Intervention, UN Administration and Kosovar Aspirations,* Logos-A, 2003.
38. **Bob Matthews & Liz Ross**, *Metodat e Hulumtimit (Udhëzues praktik për shkencat sociale dhe humane),* Qendra për Arsim Demokratik (CDE), Tiranë, 2010.
39. **Boris Kondoch**, *Human Rights Law and UN Peace Operations in Post Conflict Situations,* edited by Nigel D. White and Dirk Klaaskn, Manchester University Press 2005.
40. **Boutros Boutros-Ghali**, *Agenda for Peace,* UN Document, New York, January, 31, 1992.
41. **Boutros Boutros-Ghali**, *An Agenda for Peace: Preventive Diplomacy, Peacemaking and Peace-keeping*, A/47/277, S/24111, New York: United Nations, 1992.
42. **Boutros Boutros-Ghali**, *Building Peace and Development 1994,* New York: United Nations, 1994.
43. **Boutros Boutros-Ghali**, *Improving the Capacity of the United Nations for Peacekeeping*: Report of the Secretary-General (A/48/403, S/26450).
44. **Boutros Boutros-Ghali**, *Supplement to An Agenda for Peace. Position Paper of the Secretary General on the Occasion of the Fiftieth Anniversary of the United Nations*, S/1995/1, 3. Januar 1995.
45. **Bryan Hehir**, *Kosovo: A War of Values and the Values of War,* First published in *America vol.* 180, May 15, 1999.
46. **Clara Portela**, *Humanitarian Intervention, NATO and International Law: Can the Institotion of Humanitarian Intervention Justify Unauthorised Action?* Research Report 00.4, December, Berlin 2000.
47. **Carles W. Kagley**, *Politikat Botërore: tendenca dhe transformimi,* botimi i 12-të, UFO Press, Tiranë 2009.
48. **Carsen Stahn**, C*onstitution Without a State: Kosovo Under the United Nations Constitutional Framework for Self-Government, LJIL* 14, 2001.

49. **Carsen Stahn**, *The Law and Practice of International Territorial Administration: Versailles to Iraq and beyond*, Cambridge University Press, 2008.
50. **Carsten Stahn,** *International Territorial Administration in the Former Yugoslavia: Origins, Development and Challenges Ahead,* Heidelberg Journal of International Law, Stuttgart, 61/1/2000.
51. **Chatham House**, *Kosovo: International Law and Recognition,* A Summary of the Chatham House International Law Discussion Group meeting held on 22 April 2008.
52. **Christine Chinkin**, *The legality of NATO's action in the former republic of Yugoslavia (FRY) under international law,* International & comparative law quarterly, 49 (4), 2000.
53. **Corneliu Bjola**, *Legitimising the Use of Force in International Politics: Kosovo, Iraq and the ethics of intervention,* Taylor & Francis e-Library, 2009.
54. **Cynthia Weber & Thomas J. Biersteker**, *Reconstructing the Analysis of Sovereignty:* Concluding Reflections and Direc-tions for Future Research, in State Sovereignity As Social Construct, 1996.
55. **David Armstrong, Lorna Lloyd, John Redmond**, *Organizatat Ndërkombëtare në Politikën Botërore,* AIIS, Tiranë, 2010.
56. **David Chandler**, *Empire in Denial: The Politics of State-Building,* London, Pluto Press, 2006.
57. **David Chandler**, *Kosovo and the Remaking of International Relations,* Rewiew Essay, The Global Review of Ethnopolitics Vol. 1, no. 4, June 2002.
58. **David Chandler**, *The State-Building Dilemma: Good Governance or Democratic Government?* Draft paper presented at Roundtable on Development, Under-Development and Armed Conflict Military Centre for Strategic Studies Rome, 25 October 2004.
59. **David Criekemans**, *Final Status Negotiations on Kosovo within the UN Security Council,* Model United Nations - Flanders, 3rd Edition, Case 2007-2008.

60. **David E. McNabb**, *Research Methods for Political Science: Quantitative and Qualitative Methods*. N.Y., New York: M.E. Sharpe, 2004.

61. **David Fidler**, "A Theory of Open-Source Anarchy*", Indiana Journal of Global Legal Studies* 15 (2008).
62. **David M. Malone**, *The UN Security Council: From the Cold War to the 21st Century*, Lynne Rienner Publishers website, 2004.
63. **David Marshall & Shelley Inglis**, *The Disempowerment of Human Rights–Based Justice in the United Nations Mission in Kosovo,* Harvard Human Rights Journal / Vol. 16, 2003.
64. **David Morrison**, *How NATO's "humanitarian intervention" in Kosovo led to a humanitarian catastrophe*, April 2011.
65. Department of Peacekeeping Operations and Department of Field Support, *A New Partnership Agenda Charting a New Horizon for UN Peacekeeping*, New York, July 2009.

66. **Didier Pascquée & Stewen Dewulf**, *International Territorial Administrations and the Rule of Law: The Case of Kosovo*, Essex Human Rights Review Vol. 4 No. 1, February 2007.

67. **Dominik Zaum**, *The Authority of International Administrations in International Society*, University of Oxford, 2006.
68. **Dominik Zaum**, *The Sovereignty Paradox: The Norms and Politics of International Statebuilding,* NY, Oxford University Press, 2007.

69. **Eduardo S. Neves-Silva**, *Critical Theory and Post-positivism: IR and the significance of Philosophy,* Paper prepared for the SGIR Sixth Pan-European Conference on International Relations, Section 2, Central Concepts in IR: a meta-theoretical conversation Panel 7, Meta-theory of IR Theory Panel, Turin, 12-15 September 2007.
70. **Edward Luck**, *The Secretary-General in a unipolar world,* in *Secretary or General? The UN Secretary-General in the World Politics*, Edited by Simon Chesterman, Cambridge University Perss, New York 2007.
71. **Edward Newman**, Roland Paris and Oliver P. Richmond (eds.), *New perspectives on liberal peacebuilding*, United Nations University Press, 2009.

72. **Enver Hasani**, "Self Determination, Territorial Integrity and International Stability: The Case of Yugoslavia", PhD diss. National Defence Academy, Institute for Peace Support and Conflict, Management, Vienna, 2003.
73. **Enver Hasani**, *From UNMIK to EULEX: An Outline of the Key Aspects of Governance, Cooperation and Confidence-Building Under the Conditions of International Supervision,* in: Cutting or Tightening the Gordian Knot? The Future of Kosovo and the Peace Process in the Western Balkans after the Decision on Independence, Ernst M. Felberbauer, Predrag Jureković, Frederic Labarre (Eds.), 16th Workshop of the Study Group, "Regional Stability in South East Europe", Vienna, October 2008.
74. **Enver Hasani**, *How much the international law can impact in resolving of Kosovo's issue?,* Authorial article**,** 2006.
75. **Eric D. Weitz**, A Century of Genocide, Utopias of Race and Nation, Princeton University Press, 2003.
76. **Erwin A. Schmidl**, *The International Operation in Albania, 1913-14, International Peacekeeping,*1999.
77. **Esat Stavileci**, *UNSC Resolution 1244 me një vështrim të vaçantë në kornizën kushtetuese*, Kosova Law Review, Vol. VI, no 3, Vjeshtë, 2001, f. 13; Esat Stavileci, *Kosova nën Administrimin Ndërkombëtar*, Gjakovë, 2000.
78. **Francis Fukuyama**, *Fundi i Historisë dhe Njeriu i Fundit,* Zenith, Prishtinë, 2006.
79. **Francis Fukuyama**, *Ndërtimi i Shtetit: Qeverisja dhe Rendi Botëror në Shekullin e 21-të,* AIIS Tiranë, 2010.
80. **Fred Shernoff**, *Theory and Metatheory in International Relations,* (Concepts and Contending Accounts), Plgrave Macmillan, first publiched, 2007.
81. **Geoff Berridge**, *Diplomacia: Teoria dhe praktika*, botimi I katërt, Sh.B. Dudaj, Tiranë 2011.
82. **Gerald F.Gaus**, *Justificatory Liberalism*: An essay on Epistemology and Political Theory, Oxford University Press, 1996.
83. Handbook on United Nations, *Multidimensional Peacekeeping Operations*, Peacekeeping Best Practices Unit, Department of Peacekeeping Operations, United Nations December, 2003.

84. Handbook on United Nations, p. 1-2; United Nations Peacekeeping Operations Principles and Guidelines, UN/ DPO & DFS, New York, January 2010.
85. **Hans J. Morgenthau dhe Kenneth W.Thompson**, *Politika Ndërmjet Kombeve*, Lufta për Pushtet dhe Paqe, Instituti për Studime Ndërkombëtare, Tiranë, 2008.
86. **Hans J. Morgenthau and Kenneth W.Thompson**, *Politics Among Nation*, The Struggle for Power and Peace, Six Edition, New York, 1985.
87. **Hans Kelsen's** pure theory of law*: legality and legitimacy*, Oxford University Press, 2007.
88. **Hedley Bull**, *Shoqëria Anarkike*, (Një studim i rendit në politikën botërore), AIIS, Tiranë, 2010.
89. **Hedley Bull**, *Shoqëria anarkike*, Një studim i rendit në politikën botërore, 2010.
90. **Henry H. Perritt**, *Final Status for Kosovo and Economic Sustainability*, Chicago-Kent College of Law, March 2004.
91. **Henry Kissinger**, *A ka nevojë Amerika për një politikë të jashtme*, Botimi i parë, Tiranë, 2003.
92. **Henry Kissinger**, *Diplomacia*, botimi i parë, Tiranë, 1999.
93. **Holli Thomas**, *Cosmopolitan Sovereignty*, Institute for Citizenship and Globalisation, Deakin University, October 2004.
94. **Hugh Beach**, "Secessions, interventions and just war theory: the case of Kosovo", *Pugwash Study Group on Intervention, Sovereignty and International Security* 1 (2000). Avaliable: http: //www.pugwash. org/reports/rc/beach.htm
95. **Hurst Hannum**, "Self-Determiantion, Yugoslavia, and Europe: Old Wine in New Bottles?" *Transnational Law and Contemprorary Problems* 3 (1997).
96. Hysamedin Feraj, *Shkenca Politike* (një hyrje), botimi i parë, Tiranë 2004.
97. **J.L. Holzgrefe & Robert O. Keohane** (eds.), *Humanitarian Intervention: Ethical, Legal and Political Dilemmas,* Cmbridge University Press 2003.

98. **James Pattison**, *Humanitarian Intervention and the Responsibility to Protect Who Should Intervene?* Oxford University Press, USA 2010.

99. **James Pettifer**, *Ushtria Çlirimtare e Kosovës: Nga një luftë e fshehtë në një kryengritje të Ballkanit, 1948-2001,* Tiranë, Onufri, 2013.

100. **Jens Narten**, *Assessing Kosovo's Postwar Democratization Between External Imposition and Local Self-Government*, Taiwan Journal of Democracy, Volume 5, No.1: July 2009.

101. **Jill Steans**, Lloyd Pettiford, Thomas Diez, Imad El-Anis, *An Introduction to International Relations Theory: Perspectives and Themes,* Third Edition, Routledge, 2013.

102. **Jocelyn Coulon**, *Whatever Happened to Peacekeeping? The Future of a Tradition*, Canadian Defence & Foreign Affairs Institute, 2010.

103. **Joel C. Beauvais**, *Benevolent Despotism: A Critique of U.N. State-Building in East Timor*, 2001.

104. **John Baylis and Stive Smith**, *The Globalization of World Politics, An introduction to international relations,* Oxford University Press, Third Edition, New York 2005.

105. **John Baylis, James Wirtz, Colin Gray & Eliot Cohen**, *Strategjia në botën bashkëkohore: Hyrje në studimet e strategjisë*, UET Press, Tiranë 2013.

106. **John G.Stoessinger**, *Përse Kombet Shkojnë në Luftë,* Instituti i Studimeve Ndërkombëtare, Tiranë, 2007.

107. **John H. Jackson**, Sovereignty - Modern: A New Approach to an Outdated Concept, Georgetown University Law Cente, 2003.

108. **Joschka Fischer**, *Vitet kuq-gjelbër* (Politika e jashtme gjermane-nga Kosova e deri më 11 shtator), KOHA, Prishtinë 2007.

109. **Jose-Luis Herrero Ansora**, *The United Nations in Kosovo: Finding the Path throught the Maze*, in: Favorita Papers of Diplomatiche Akademie,Vienna, 2001.

110. **Joseph B. Coelho**, *Building stable and effective states through international governance: the politics of technocratic interventions*, Northeastern University Boston, Massachusetts October, 2008.

111. **Joseph Coelho**, *Vehicles for Transformation, or Tools for the Status Quo? Civil Society and International Statebuilding in Kosovo*, The WBP Review, Volume 2, Issue 2, Summer/Autumn 2012.

112. **Joseph M. Ellis**, *What Should We Expect IR theory to do?: What Should We Expect?: Theorizing Towards a Normative IR Theory*. Friday, March, 17 2006.

113. **Joseph Rouse**, *Power/Knowledge*, Division I Faculty Publications, Paper 34, Wesleyan University, 1-1-2005.

114. **Joseph Schumpeter**: Capitalism, Socialism, and Democracy, New York: Harper and Row Torchbook, 1950.

115. **Joshua S.Goldstein**, *Marrëdhëniet Ndërkombëtare*, botimi i katërt, Tiranë, 2003.

116. **Joshua Stren**, *NATO Collective Security or Defense: The Future of NATO in Light of Expansion and 9/11*, Düsseldorfer Institut für Außen- und Sicherheitspolitik (DIAS), Nr. 32, 2010.

117. **Jure Vidmar**, *International Legal Responses to Kosovo's Declaration of Independence*, Vanderbilt Journal of Transnational Law, Vol. 42:779, 2009.

118. **Jürgen Friedrich**, *UNMIK in Kosovo: Struggling with Uncertainty*, Max Planck Yearbook of United Nations Law, Volume 9, 2005.

119. **Karl Popper**, *Mjerimi i Historicizmit*, botimi i parë,Tiranë 1996.

120. **Karl Popper**, *Për filozofinë dhe shkencën (Vepra dhe punime të përzgjedhura)*: Sh.B. 'Fan Noli' Tiranë, 2009.

121. **Karl Popper**, *The Logic of Scientific Discovery*, Routledge London & New York, 2005.

122. **Kathryn Sikkink**, *Human Rights, Principled Issue-Networks, and Sovereignty in Latin America*, International Organization, Vol. 47, No. 3. 1993.

123. **Kenneth Waltz**, *Theory of International Politics,* University of Clifornia, Berkely 1979.

124. **KIPRED & CASIN**, Administrimi *dhe qeverisja në Kosovë, Mësimet e mësuara dhe ato që mbeten për t'u mësuar, Tërësia e Kompetencave, Rehabilitimi i shoqërive të shkatërruara nga lufta,* Prishtinë/Gjenevë, qershor 2005.

125. **Kofi Annan**, *Two Concepts of Sovereignty,* The Economist, Vol. 352, issue 137, 1999.

126. **Kofi Annan**, *We the Peoples, The Role of the United Nations in the 21st Century*. United Nations, New York 2000.

127. Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë.

128. Kosovar Center for Security Studies, *Mapping the UNSCR 1244 Legacy in Post-Independence Kosovo: Between Contestation and Recognition,* Prishtinë, May 2012.

129. **Kristen Boon**, *Legislative Reform in Post-conflict Zones:* Jus Post Bellum *and the Contemporary Occupant's Law-Making Powers,* McGill Law Journal, Vol. 50 2005.

130. **Lassa Francis Lawrence Oppenheim**, *International Law,* Vol 1, Longman, 1948.

131. **Laura Wise**, *Was NATO's Intervention in Kosovo in 1999 'Just'?,* e-International Relations, the world's leading website for students of international relationas, June 21, 2013.

132. **Lawrence C.Mayer**, John Burnett, Susane Ogden, *Politikat Krahasuese* (popujt dhe teoritë në ndryshimin e botës), Tiranë, 2001.

133. **Lekë Sokoli**, *Metodat e Kërkimit në Shkencat Sociale*, Instituti i Sociologjisë, Tiranë, 2009.

134. **Lenard Cohen**, *Kosovo. From Interim Status to Enhanced Sovereignty*, Strategic Insights, Vol. 5, no.1, January 2006.

135. **Lindsey Cameron**, *Accountability of International Organisations Engaged in the Administration of Territory*, University Centre for International Humanitarian Law, 2006.

136. **Lindsey Cameron**, *Accountability of International Organisations Engaged in the Administration of Territory*, University Centre for International Humanitarian Law, 13 February, 2006.

137. **Lisen Bashkurti**, *Kombet e Bashkuara dhe Rendi i ri Botëror*, GEER, Tiranë, 2010.

138. **Louis B. Sohn and Thomas Buergenthal**, *International Protection of Human Rights*, Indianapolis: Bobbs-Merrill, 1973.

139. **Louise Andersen**, *UN Peace Operations in the 21st Centyry: State-Building and Hybridity*, DIIS REPORT, 2007.

140. **Marc Weller**, *Negotiating the final status of Kosovo*, Institute for Security Studies EU, Paris, December, 2008.

141. **Marc Weller**, *Shtetësia e kontestuar*: *Administrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi*, KOHA, Prishtinë, 2009.

142. **Margaret Macmillan**, *Paris 1919* (Gjashtë muaj që ndryshuan botën), Botimi i parë, Plejad, 2006.

143. **Marshall & Inglis**, *The Disempowerment of Human Rights–Based Justice in the United Nations Mission in Kosovo,* 2003.

144. **Martha Finnemore**, *Constructing Norms of Humanitarian Intervention, The Culture of National Security: Norms and Identity in World Politics*, edited by Peter J. Katzenstein, 2002.

145. **Martin Dixon**, *E drejta ndërkombëtare*, AIIS, Tiranë, 2011.

146. **Matthew Willner-Reid**, *Post-Colonial Governments of Leading Strings:* The Legitimacy and Accountability of International Transitional Administrations, University: Coimbra, Portugal, 2005.

147. Memorandumi i qeverisë së RFJ-së mbi Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së (1999), Pjesa II, i datës 5 nëntor 1999.

148. **Michael Ignatieff**, *Empire Lite: Nation-Building in Bosnia, Kosovo and Afganistan,* UK, Vintage 2003.

149. **Michael Ignatieff**, *Gjaku dhe Përkatësia* (Udhtime në Nacionalizmin e Ri), DITURIA, Tiranë, 2000.

150. **Nathaniel Beck**, *Political Methodology - A Welcoming Discipline Department of Political Science* University of California, San Diego, May 11, 1999.

151. **Nele Matz**, *Civilization and the Mandate System under the League of Nations as Origin of Trusteeship,* Max Planck Yearbook of United Nations Law, Volume 9, 2005.

152. **Nicolas Lemay-Hébert**, *State-building from the Outside-In:UNMIK and its paradox,* The Journal of Public and International Affairs ,Princenton University, Woodrow Wilson School of Public and International Affairs, 20, 2009.

153. **Nina Wilén**, *Paradoxes or Strategies in International Governance? The Case of Kosovo*, Paper presented at REGIMEN Conference 'Le nouveau système international' in Mons, 7 March 2007.

154. **Noam Chomsky**, *The New Military Humanitarism: Lesson from Kosovo,* Common Courage Press, 1999.

155. **Noam Chomsky**, *Crisis in the Balkans*, Z Magazine, May, 1999: Chomsky.info

156. **Norman Rich**, *Diplomacia e Fuqive të Mëdha 1814-1914,* Sh.B., TOENA, Tiranë, 2006.

157. **OECD/DAC** Discussion Paper, *Concepts and Dilemmas of State Building in Fragile Situations,* From Fragility to Resilience, 2008.

158. **Oisín Tansey**, *International Administration and Democratic Regime-Building*, Nuffield College, Oxford, 2006.

159. **Oliver Schmitt**, *Kosova-Histori e Shkurtër e një Treve Qendrore Ballkanike,* Sh.B. Koha, Prishtinë, 2012.

160. **Oliver P. Richmond & Jason Franks**, *Co-opting the Liberal Peace: Untying the Gordian Knot in Kosovo,* Centre for Peace and Conflict Studies, University of St Andrews, UK, 2007.

161. **Oliver P. Richmond**, *Understanding the Liberal Peace*, University of St Andrews, p. 11, This essay is based in part upon his new study, *The Transformation of Peace,* Palgrave, forthcoming 2005.

162. **Paul Horton**, *The Sociology of Social Problems, New Jeresy*, 1991.

163. **Paul R. Hensel**, *The More Things Change:Recognizing and Responding to Trends in Armed Conflict*, Florida State University, 2001.

164. **Paul Taylor, Sam Daws, and Ute Adamczick-Gerteis** (eds.), *Documents on Reform of the United Nations,* Aldershot: Dartmouth, 1997.

165. **Quynh-Nhu Vuong**, *U.S. Peacekeeping and Nation-Building: The Evolution of Self-Interested Multilateralism*, Berkeley Journal of International Law, Volume 21/ Issue 3 Article 15, 2012.

166. **Raino Maleus & Knut Midgaard**: *Filozofia Politike*. Botimi 2, ROZAFA, Prishtinë, 2007.

167. **Ralph Wilde**, *From Danzing to East Timor and Beyond:* The Role of International Territorial Administration, The American Journal of International Law, Vol.95, No.3, July, 2001.

168. **Ralph Wilde**, *Taxonomies of International Peacekeeping: An Alternative Narrative*, ILSA Journal of International & Comparative Law, Vol. 9, 2003.

169. **Raportit Brahimi**, veçanërisht seksionet II, III, IV dhe V. Në: *Raporti i Grupit të ekspertëve në misionet paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara*, Kombet e Bashkuara, A/55/305 S/2000/809, 21 gusht 2000.

170. **Rdovan Vukadinoviç**, *Marrëdhëniet Politike Ndërkombëtare*, Kolegji Universitat "Victory", Prishtinë, 2006.

171. **Rdovan Vukadinoviç**, *Marrëdhëniet Ndërkombëtare nga Lufta e Ftohtë deri te Rendi Global,* Kolegji Universitat "Victory", Prishtinë, 2007.

172. **Richard Caplan**, *A New Trusteeship? The International Administration of War-Torn Territories,* New York: Oxford University Press for International Institute for Strategic Studies, 2002.

173. **Richard Caplan**, *International Governance of War-Torn Territories* (Rule and Reconstruction), Oxford University Press, 2005.

174. **Richard Caplan**, "International Diplomacy and the Crisis in Kosovo", International Affairs 74 (1998).

175. **Rita Augestad Knudsen**, *Privatization in Kosovo: The International Project 1999–2008*, Norwegian Institute of International Affairs Report 2010.

176. **Robert E.Godin** (ed.) *The Oxford Handbook of Political Science*, New York: Oxford University Press, 1996.

177. **Roland Paris & Timothy D.Sisk** (eds.), *The Dilemmas of Statebuilding Confronting the contradictions of postwar peace operations*, Routledge 2009.

178. **Roland Paris**, *At War's End: Building Peace after Civil Conflict*, Cambridge, Cambridge University Press, 2004.

179. **Rory J.Conces**, *Justifying Coercive and Non-Coercive Intervention*, Strategic and Humanitarian Arguments, University of Nebraska at Omaha, Acta Analytica, Volume 16 issue 27/2001.

180. **Rüdiger Wolfrum**, *International Administration in Post-Conflict Situations by the United Nations and Other International Actors*, Max Planck Yearbook of United Nations Law, Volume 9, 2005.

181. **Scott Burchill** et al., *Theories of International Relations*, Second Edition, Palgrave, 2001.

182. **Sean Kay**, *Nato, the Kosovo war, and neoliberal theory*, Contemporary Security Policy, Volume 25, Number 2, August 2004.

183. **Sean McFate**, *The Link Between DDR and SSR in Conflict- Affected Countries*, Special Report 238, United States Institute of Peace, May 2010.

184. **Simon Chesterman**, *Justice Under International Administration: Kosovo, East Timor and Afghanistan*, An International Peace Academy Report, September 2002.

185. **Simon Chesterman**, *Review Essay: International Territorial Administration and the Limits of Law*, New York University School of Law, 2010.

186. **Simon Chesterman**, *You, the People: The United Nations, Transitional Administration, and State-Building,* A Project of the International Peace Academy, Oxford University Press, 2004.

187. **Skënder Skënderi & Rashit Maliqi**, *Fizika*, Prishtinë, 2005.

188. Statement issued by Belgium, France, Germany, Italy, United Kingdom and the United States of America, co-sponsors of the draft resolution on Kosovo presented to the UNSC on 17 July, 2007.

189. **Stefan Lehne**, *Resolving Kosovo's Status*, Austrian Institute for International Affairs, Policy Paper Juni 2009.

190. **Stephen M.Walt**, *International Relations:* One World, Many Theories, University of Chicago, Spring 1998.

191. **Stephen T. Hosmer**, "The Conflict Over Kosovo: Why Milosevic Decided to Settle When He Did", *RAND Research Brief* MR-1351-AF (2001).

192. **Steven C.Roach**, editor, Critical *theory and internacional relations* (a reader), by Taylor & Francis Group, 2008.

193. **Stijn van Hoff**, *UN Transitional Administrations, Creating Legitimate Government,* Utrecht, July 2011.

194. **Susan L.Woodward**, *Ballkan Tragedy, Chaos and Dissolution after the Cold War,* The Brookings Institute, Washington DC, 1995.

195. **The Kosovo Report Conflict**, *International Response, Lessons Learned, The Indepedent International Commission on Kosovo*, Published in the United States by Oxford University Press Inc., New York, 2000.

196. **The World Bank**, *Kosovo Quarterly Economic Briefing 2009, (1),* Kosovo Exports and Imports, 2005-2009.

197. **Tim Dunne, Milja Kurki, Steve Smith**, *Teori të Marrëdhënieve Ndërkombëtare, disiplina dhe shumëllojshëria*, UET Press, 2010.

198. Troika Press Statement, Vienna, 5 November 2007.

199. United States Institute of Peace, *Certificate Course in Conflict Analysis*, Produced by the Education and Training Center, Version date: January 30, 2008.

200. United Nations Development Programme, Position Paper Policy, Vancouver Model United Nations, The 13th Annual Conference, February 14-16, 2014.

201. **Veton Latifi**, *Politikologjia*, botimi i parë, Shkup, 2008.

202. **Veton Latifi**, *Teoritë e Shkencës Politike*, botimi i parë, 2007.

203. **Wesley K.Clark**, *Të bësh luftë moderne, Libri 2.* "ZËRI", Prishtinë, 2003.

204. **William J. Durch** et al., *The Brahimi Report and the Future of UN Peace Operations*, The Henry L. Stimson Center, 2003.

205. **Wim van Meurs**, *Kosovo's Fifth Anniversary-On the Road to Nowhere?* Center for Applied Policy Research, The Global Review of Ethnopolitics Vol. 3, no. 3-4, March/June 2004.

206. **Winrich Kühne**, *UN-Friedenseinsätze verbessern - Die Empfehlungen der Brahimi-Kommission*, in: Sabine von Schorlemer (Hrsg.), Praxishandbuch UNO. Die Vereinten Nationen im Lichte globaler Herausforderungen, Springer-Verlag Berlin u.a. 2003.

207. **Wolfgang F Danspeckgruber**, *The Self-Determination of Peoples: Community, Nation, and State in an Interdepedent World*, Lynne Rienner Publishers, USA, 2002.

208. **Wolfgang Koeth**, *State building without a state*, European Foreign Affairs Review, Vol. 15, Iss. 2. 2010.

209. **Wolfgang Petrisch**, *Forward in, Human Rights in Bosnia and Herzegovina after Dayton: From Theory to Practice*, edited by Prof. Dr. Wolfgang Benedek, Hague 1999.

210. **Wolfgang Schreiber**, *Kriege und bewaffnete Konflikte 2012* (Ein erster Überblick), Institut für Politikwissenschaft Arbeitsgemeinschaft Kriegsursachenforschung (AKUF), Nr. 11, Analysen Dezember 2012.

211. **Yuji Uesugi**, *Chapter 4 The Nexus between UN Peacekeeping and Human Security*: Reviewing the Functions of UN Peacekeeping from a Perspective of Human Security, IPSHU English Research Report Series No.19

Conflict and Human Security: A Search for New Approaches of Peace-building, 2004.

212. **Zbigniev Brzezinski**, *Jashtë Kontrollit*, Trazira që e përfshin botën në prag të shekullit XXI, Shtëpia Botuese ELENA GJIKA, Tiranë, 1993.
213. **Zbigniew Brzezinski**, *Zgjedhja: Dominim Global apo Udhëheqje Globale*, Botimi i parë, Shtëpia Botuese Zenith, Prishtinë 2006.
214. **Zejnullah Gruda**, *E Drejta Ndërkombëtare Publike, botimi i plotësuar dhe i përmirësuar*, UP, Prishtinë, 2003.

Dokumente politike dhe juridike

215. UNSCR 1160 (1998)
216. UNSCR 1199 (1998).
217. UNSCR 1244 (1999).
218. UNSCR 128 (1958).
219. UNSCR 203 (1965).
220. UNSCR 2100 (2013).
221. UNSCR 644 (1989).
222. UNSCR 690 (1991).
223. UNMIK Regolution 1999/1.
224. UNMIK Regolution 1999/9.
225. UNMIK Regolution 1999/24
226. UNMIK Regolution 2000/21.
227. UNMIK Regolution 2000/38.
228. UNMIK Regolution 2000/39.
229. UNMIK Regolution 2000/45.

Raporte dhe publikime tjera

230. Advisory Opinion of 20 July 1962, I.C.J.
231. 1986 ICJ Reports, p.554.

232. Banka Botërore, *Asociacioni Ndërkombëtar për Zhvillim, Shkresa e përkohshme për Kosovën për periudhën* VF06-VF07, Raporti Nr. 35262-XK, 30 Mars, 2006.

233. Deklaratë e Grupit të Kontaktit,Vjenë, 24 korrik, 2006.

234. Enti i Statistikave të Kosovës, Gross Domestic Product in Kosovo 2004 – 2009, Series 3: Economic Statistics, Pristina, November 2010.

235. Human Right Watch, Askund *në agjendë Dështimi i vazhdueshëm për të kërkuar përgjegjësi në Kosovë pas marsit 2004*, Vëllimi 18, Nr. 4(D), Maj 2006.

236. ICG, *Arritja e Ekuilibrit: Nivelet e Drejtësisë në Kosovë*, Raporti nr.134 mbi Ballkanin 12 shtator 2002.

237. ICG, *Kosova: Një strategji për zhvillimin ekonomik*, Raporti nr. 123 për Ballkanin, Prishtinë/Bruksel, 19 dhjetor, 2001.

238. ICG, *Kosova: pa alternativa të mira për Planin e Ahtisaarit*, Raport për Evropë, Nr. 182, 14 maj 2007.

239. ICG, *Kosova: Sfida e tranzicionit*, Raport për Evropë i Grupit të Krizave numër 170, 17 shkurt 2006.

240. ICG, *The New Kosovo Protectorate*, Balkans Report N°69, Sarajevo, 20 June 1999.

241. ICG, *Waiting for UNMIK: Local Administration in Kosovo*, Ballkan Report, N° 79 Prishtinë/Priština, 18 October 1999.

242. ICG, *Zhbllokimi i Ngecjes në Kosovë: Përgjegjësi e Evropës*, Raport për Evropë Nr. 185, 21 gusht 2007.

243. International Herald Tribune (IHT)11 november, 1999.

244. International Herald Tribune (IHT), 8 february, 2000.

245. Opinioni numër 3 i Komisionit të Badinterit, 11 Janar 1992.

246. OSCE (Mission in Kosovo), *Review of the Criminal Justice System*, Departmant of Human Rights and Rule of Law, February – July, 2000.

247. Report of the European Union/United States/Russian Federation Troika on Kosovo, UN Doc. S/2007/723, 4 December 2007.

248. Report of the Secretary-General on the United Nations Administration in Kosovo, UN Doc S/1999/779, 12 July 1999.

249. Report of the Secretary-General on the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo, UN Doc. S/2008/354, paragraph 7, 12 june 2008.

250. Report of the Security Council mission on the Kosovo issue, UN Doc. S/2007/256, 4 May 2007.

251. Report of UN Secretary General to UN Security Council on UNMIK, (S/1999/779, 12 July 1999.

252. Report of UN Secretary General to UN Security Council pursuant paragraph 10 of UNSC Resolution 1244/1999, (S/1999/672).

253. Report the Secretary-General on the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo, UN Doc S/2007/134, 9 March 2007.

254. Riinvest, *Investimet e Jashtme Direkte në Kosovë*, *Politika Ekonomike*, Raport hulumtues, 19 Shtator, 2002.

255. SC/8082 Press Release, 30/04/2004.

256. Special Report no.1 of Ombudsperson Institution in Kosovo, Recapitulation of the Conclusions, 2001.

257. UN Doc. S/2002/436, 22 April 2002.

258. UN Doc. S/2005/635, 7 October 2005.

259. UNMIK Regulation 1999/1, 25 July 1999.

Burime nga interneti.

- Daily Telegraph, 28 June 1999. Avaliable: http://www.david-morrison.org.uk/kosovo/kosovo-humanitarian-catastrophe.htm
- Deklarata e Pavarësisë 17.02.2008, Republika e Kosovës, Kuvendi i Kosovës (Qasur me 10.09.2013).

- EUobserver, Foreign Affairs, *Kosovo UN vote under way,* 18.07.2007 (Qasur me 09.04.2013).
- General Secretary's Statement (SC 9366); http://www.un.org/ News/Press/docs/2008/ sc9366. doc.htm (Qasur me 22.09.2013).
- Grossman in Kosovo, *Stresses "Standards Before Status"*, November 5, 2003, 06 November 2003, http://www.usembassy.it/file2003_11/alia/a3110609.htm (Qasur me 25.03.2013).
- http://www. zeriamerikes. com/ content/ kosove-grupi-drejtues-vendosi-te-permbylle pavaresine -e- mbikeqyrur/1352680. html (Qasur me 23.09.20013).
- I.C.J, Report, *Accordance with International Law of the Unilateral Declaration of Independence in Respect of Kosovo, Advisory Opinion,* 22 July 2010, http://www.icj-cij.org/docket/files/141/15987.pdf (Qasur me 16.09.2013).
- Ligji Nr. 04/L-199, për ratifikimin e marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, http://www. kuvendikosoves.org/?cid=1, 191,1057 (Qasur me 23.09.2013).
- Lindsey Cameron and Rebecca Everly, *Conceptualizing the Administration of Territory by International Actors*, Global Law Books- www.globallawbooks.org.
- NBCNews, *Key dates in Kosovo's drive for independence,www.nbcnews.com* (Qasur me 10.04.2013).
- Transcript of SRSG interview with AP Friday 23 March 2012, http://www.unmikonline.org/Pages/srsgitw_ap23032012.aspx
- U.S Department of State, *Statement by the Contact Group on the Future of Kosovo,* Bureau of European and Eurasian Affairs Washington, DC January 31, 2006 (Qasur me 09.09.2013).
- United Nations Peacekeeping Operations Principles and Guidelines, UN/ DPO & DFS, New York, January 2010. (Qasur me 10.05.2013).
- United Nations Peacekeeping Operations: 1948-2013, UNO, official web page (Qasur me 23.04.2013)

- United Nations Peacekeeping, *peacekeeping operations, history of peacekeeping*: http://www.un.org/en/peacekeeping/operations/history.shtml (Qasur me 15.05.2013).
- Zëri i Amerikës, Lajme, 29.08.2013, http: // www. zeriamerikes. com/ content/kosova-security-council-hoxhaj-mrkic/1739595. html (Qasur me 24.09.2013).
- http://www.cgpacs.uci.edu/files/cgpacs/docs/2010/working_papers/nicholas_onuf_humanitarian_intervention.pdf
- http://www.ethnopolitics.org/ethnopolitics/archive/volumeI/issue4/chandler.pdf.
- http://www.pugwash.org/reports/rc/beach. htm
- http:/ /polisciprof. blogspot. com/2006/03/ what-should-we-expect-irtheory-todo.html.
- http:/ /sacred- sovereign. Uchicago .edu / jbh- kosovo. html.
- http://www.tokashqiptare.com/analizat/analiza-2006/ shkurt/shkurt-java2-12.htm.
- http://archive.sgir.eu/uploads/NEVES-SILVA-sgir_ct-pp.pdf.
- http://www.oup.com/uk/orc/bin/0199271186/01student/zcases/01kosovo/realist.pdf.
- http://www.v4ce.net/members/pernetta/documents/TIRCasestudiesKosovo.pdf.
- http://www.vetevendosje.org/sh/index.php?option=com_content&task=view&id=104&Itemid=43.
- http://www.pugwash.org/publication/op/opv1n1.htm.
- http://www.unomaha.edu/religion/ConcesJustify.pdf.
- https://kb.osu.edu/dspace/bitstream/1811/31992/2/NATO,%20THE%20KOSOVO%20WAR,%20AND%20NEOLIBERAL%20THEORY.pdf
- http://www.unosek.org/unosek/en/docref.htm
- http://www.iai.it/pdf/book_reviews/sossai.pdf

ANEKS

Mostra e anketës.